

Liabona



Fjalime në Konferencën e Përgjithshme

Thirren Të Shtatëdhjetë
të rinj dhe Presidencë
e re e Përgjithshme e
Shkollës të së Dielës



© HOWARD LYON, NUK LEHET KOPIMI

Një Bari, nga Howard Lyon

Këtu Jezu Krishti viziton neftët në Amerikë në përmbushje të një profecie që Ai ua tregoi njerëzve në Jerusalem:

“Unë kam edhe dele të tjera që nuk janë të kësaj vathe; duhet t’i mbledh edhe ato, dhe ato do ta dëgjojnë zërin tim, dhe do të jetë një tufë e vetme dhe një Bari i vetëm” (Gjoni 10:16; shih edhe 3 Nefi 15:21).

SESIONI I PARADITES TË SË SHITUNËS

- 4 Mirësevini në Konferencë
Presidenti Tomas S. Monson
- 6 Çmimi – dhe Bekimet –
e të Qenit Dishepull
Plaku Xhefiri R. Holland
- 9 Barra e Gëzueshme e Dishepullimit
Plaku Ronald A. Rasband
- 12 Krishti, Shëlbuesi
Plaku Karlos H. Amado
- 15 Mbrojtja nga Pornografia – një
Shtëpi e Përqendruar te Krishti
Linda S. Rivs
- 18 Vorbullat e Erërave Shpirtërore
Plaku Nil L. Andersen
- 22 Një Trashëgimi e Paçmueshme
e Shpresës
Presidenti Henri B. Ajring

SESIONI I PASDITES TË SË SHITUNËS

- 26 Mbështetja e Drejtuesve të Kishës
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 28 Raporti i Departamentit të Kontrollit
Financiar të Kishës, 2013
Kevin R. Xhergensen
- 28 Raporti Statistikor, 2013
Bruk P. Hejls
- 29 Lëreni Besimin Tuaj të Dalë në Pah
Plaku Rasëll M. Nelson
- 32 “Ju Kam Dhënë Shëmbullin”
Plaku Riçard G. Skot
- 35 “Nëse Më Doni,
Zbatoni Urdhërimet e Mia”
Plaku Robert D. Hejls
- 39 Le të Mos Marrim Udhën e Gabuar
Plaku Klaudio D. Zivic
- 41 Çfarë Po Mendon Ti?
Plaku W. Krejg Zuik
- 44 Rrënjët dhe Degët
Plaku Kuentin L. Kuk

SESIONI I PRIFTËRISË

- 49 Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë
Plaku Dallin H. Ouks
- 53 Çfarë Lloj Njerëzish?
Plaku Donald L. Hallstrom
- 56 Brezi i Zgjedhjeve
Rendëll L. Rid
- 58 A Po Flini Gjatë Rivendosjes?
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 62 Burri i Priftërisë
Presidenti Henri B. Ajring
- 66 Ji i Fortë dhe Guximtar
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I MËNGJESIT TË SË DIELËS

- 70 Mirënjohës në të Gjitha Rrethanat
Presidenti Diter F. Uhtdorf
- 78 Ndjekja e Ecurisë
Plaku M. Rasëll Ballard
- 81 “Mos Ki Frikë, Sepse Unë
Jam me Ty”
Xhin A. Stivens
- 84 Katër Minutat Tuaja
Peshkopi Geri E. Stivenson
- 87 I Duronin Barrët e Tyre me Lehtësi
Plaku Dejvid A. Bednar
- 91 Dashuria – Thelbi i Ungjillit
Presidenti Tomas S. Monson

SESIONI I PASDITES TË SË DIELËS

- 94 Dëshmia
Presidenti Bojd K. Paker
- 97 Jeto i Vërtetë ndaj Besimit
Plaku Uilliam R. Uolker
- 100 Bindje nëpërmjet Besnikërisë Sonë
Plaku L. Tom Peri
- 103 Profeti Jozef Smith
Plaku Lorens E. Korbrixh
- 106 Ku Është Thesari Juaj
Plaku Majkëll Xhon U. Teh
- 108 Në Qoftë Se Ju Mungon Urtia
Plaku Markos A. Aidukaitis
- 111 Ringjallja e Jezu Krishtit
Plaku D. Tod Kristoferson
- 115 Kur Prapë të Takohemi
Presidenti Tomas S. Monson

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E GRAVE

- 116 Mbajtja e Besëlidhjeve Na Mbron,
Na Përgatit dhe Na Fuqizon
Rozmari M. Uiksom
- 119 Motëria: O, Sa Nevojë Kemi
për Njëra-Tjetrën!
Boni L. Oskarson
- 122 Kërkohen: Duar dhe Zemra
për Përsheptimin e Punës
Linda K. Barton
- 125 Bija në Besëlidhje
Presidenti Henri B. Ajring
- 72 Autoritetet e Përgjithshme dhe
Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës
së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të
Ditëve të Mëvonshme
- 129 Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë
- 130 Ata na Folën Neve: Ta Bëjmë
Konferencën Pjesë të Jetës Sonë
- 132 Lajme të Kishës



Përmbledhje për Konferencën e Përgjithshme Vjetore të 184-t

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË SHTUNËS, 5 PRILL 2014

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.
Lutja e hapjes: Plaku Karl B. Kuk.
Lutja e mbylljes: Plaku W. Kristofer Uadell.
Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Klei Kristiansen dhe Riçard Eliot, organistë: “Sa i Fortë Një Themel”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 6; “Press Forward, Saints”, *Hymns*, nr. 81, përsht. Wilberg, i pabotuar; “Lead, Kindly Light”, *Hymns*, nr. 97, përsht. Wilberg, i pabotuar; “Choose the Right”, *Hymns*, nr. 239; “A New Commandment I Give unto You,” Gates, bot. nga Jackman; “Come, O Thou King of Kings”, *Hymns*, nr. 59, përsht. Murphy, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË SHTUNËS, 5 PRILL 2014

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.
Lutja e hapjes: Plaku Jan S. Ardern.
Lutja e mbylljes: Linda K. Barton.
Muzika nga një kor i bashkuar nga Instituti i Oremit, Juta; Rajën Eget, drejtues; Boni Gudlajfin dhe Linda Margets, organiste. “Glory to God on High”, *Hymns*, nr. 67, përsht. Manookin, bot. nga Jackman; “I Lived in Heaven”, *Children’s Songbook*, 4, përsht. Beebe, bot. nga Larice Music; “Të Falemi, Zot, për Profetin”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 36; “Lart në Majën e Malit”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 30, përsht. Duffin, bot. nga Duffin.

SESIONI I PRIFTËRISË I MBRËMJES TË SË SHTUNËS, 5 PRILL 2014

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.
Lutja e hapjes: Plaku LeGrand R. Kurtis i Riu
Lutja e mbylljes: Rasëll T. Osguthorp.
Muzika nga një kor i priftërisë nga Universiteti “Brigam Jang” - Ajdaho; Randall Kempton dhe Kevin Brouner, drejtues; Endriu Ansuorth, organist: “Saints, Behold How Great Jehovah”, *Hymns*, nr. 28, përsht. Kempton, i pabotuar; “Secret Prayer”, *Hymns*, nr. 144, përsht. Kasen, bot. nga Jackman; “Rejoice, the Lord Is King”, *Hymns*, nr. 66; “Abide with Me!” *Hymns*, nr. 166, përsht. Kempton, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PARADITES TË SË DIELËS, 6 PRILL 2014

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Henri B. Ajring.
Lutja e hapjes: Plaku L. Uitni Klejton.
Lutja e mbylljes: Nill F. Mariot.
Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg, drejtues; Riçard Eliot dhe Endriu Ansuorth, organistë: “Come, We That Love the Lord”, *Hymns*, nr. 119; “On This Day of Joy and Gladness”, *Hymns*, nr. 64; “Punës Le t’i Vihemi”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 10, përsht. Elliott, i pabotuar; “Mësom’ t’Ec’ në Dritë”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 66; “A Child’s Prayer”, *Children’s Songbook*, 12, përsht. Perry, bot. nga Jackman; “Guide Us, O Thou Great Jehovah”, *Hymns*, nr. 83, përsht. Wilberg, i pabotuar.

SESIONI I PËRGJITHSHËM I PASDITES TË SË DIELËS, 6 PRILL 2014

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Presidenti Diter F. Uhtdorf.
Lutja e hapjes: Peshkopi Din M. Dejvis.
Lutja e mbylljes: Plaku Benjamin De Hojos.
Muzika nga Kori i Tabernakullit; Mak Uilberg dhe Rajën Mërfi, drejtues; Linda Margets dhe Boni Gudlajf, organiste: “E Ëmbël Është Puna”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 13, përsht. Murphy, i pabotuar; “Qëndroj Plot Habi”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 22, përsht. Murphy, i pabotuar; “Hark, All Ye Nations!” *Hymns*, nr. 264; “Come, Let Us Anew”, *Hymns*, nr. 217, përsht. Wilberg, i pabotuar.

MBLEDHJA E PËRGJITHSHME E GRAVE E MBRËMJES TË SË SHTUNËS, 29 MARS 2014

Kryesimi: Presidenti Tomas S. Monson.
Drejtimi: Boni L. Oskarson.
Lutja e hapjes: Emri Elizabet Smith.
Lutja e mbylljes: Ofa Kaufusi.
Muzika nga një kor i bashkuar i Fillores, Të Rejave dhe Shoqatës së Ndhmës nga kunje përgjatë Uasç Frontitë Emili Uadli, drejtuese; Boni Gudlajf, organiste: “Hark, All Ye Nations!” *Hymns*, nr. 264; “Daughters in His Kingdom”, Creamer, i pabotuar, shoqëruar me organo, flaut, violinë dhe violonçel; “Fëmi i Per’ndis’ Jam”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58, përsht. DeFord, i pabotuar; potpuri, përsht. Mohlman, i pabotuar: “Lord, I Would Follow Thee”, *Hymns*, nr. 220 dhe “Love One Another”, *Hymns*, nr. 308; “Punës Le t’i Vihemi”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 10, përsht. Huff, i pabotuar.

MUNDËSOHEN BISEDAT E KONFERENCËS

Për të gjetur biseda të konferencës së përgjithshme në internet në shumë gjuhë, vizitoni faqen conference.lds.org dhe përzgjidhni një nga gjuhët. Bisedat mundësohen gjithashtu në programin për celularë Gospel Library. Përgjithësisht, brenda gjashtë javëve pas konferencës së përgjithshme, mundësohen regjistrime zanore në qendrat e shpërndarjes.

MESAZHET E MËSIMIT TË SHTËPISË DHE TË VIZITËS MËSIMORE

Për mesazhet e mësimit të shtëpisë dhe të vizitës mësimore, ju lutemi përzgjidhni atë fjalim që u përgjigjet më mirë nevojave të atyre që vizitoni.


NË KOPERTINË

Përpara: Foto nga Christina Smith.
Prapa: Fotografi nga Leslie Nilsson.

FOTOGRAFIMI I KONFERENCËS

Pamjet nga konferenca e përgjithshme në Solt-Lejk-Siti u morën nga Welden C. Andersen, Cody Bell, Randy Collier, Weston Colton, Scott Davis, Craig Dimond, Nathaniel Ray Edwards, Lloyd Eldredge, Ashlee Larsen, John Luke, Leslie Nilsson, Christina Smith, dhe Byron Warner; në Gilbert, Arizonë, SHBA, nga Jamie Dale Johnson; në Hajlends Renç, Kolorado, SHBA, nga Rebecca Morgeneegg; në Meksiko-Siti, Meksikë, nga Israel Gutiérrez; në Norkros, Xhorxhia, SHBA, nga David Winters; në Palmirë, Nju-Jork, SHBA, nga Brent Walton; në Plezënt Grouv, Juta, SHBA, nga Jeremy Hall; në Raimond, Alberta, Kanada, nga Rhonda Steed; në Shën-Petersburg, Rusi, nga Vladimir Egorov; në San-Paolo, Brazil, nga Lauren Fochetto; në Sidnei, Australi, nga Colin Ligertwood; në Ulan-Bator, Mongoli, nga Kylie Sneddon; në Vienë, Austri, nga Frank Helmrich; dhe në Uashington, Jutë, SHBA, nga James Iliff Jeffery.





TREGUESI I FOLËSVE

Aidukaitis, Markos A., 108
 Ajring, Henri B., 22, 62, 125
 Amado, Karlos H., 12
 Andersen, Nil L., 18
 Ballard, M. Rasëll, 78
 Barton, Linda K., 122
 Bednar, Dejvid A., 87
 Hallstrom, Donald L., 53
 Hejls, Robert D., 35
 Holland, Xhefri R., 6
 Korbrixfon, Lorens E., 103
 Kristoferson, D. Tod, 111
 Kuk, Kuentin L., 44
 Monson, Tomas S., 4, 66, 91, 115
 Nelson, Rasëll M., 29
 Oskarson, Boni L., 119
 Ouks, Dallin H., 49
 Paker, Bojd K., 94
 Peri, L. Tom, 100
 Rasband, Ronald A., 9
 Rid, Randall L., 56
 Rivs, Linda S., 15
 Skot, Riçard G., 32
 Stivens, Xhin A., 81
 Stivenson, Geri E., 84
 Teh, Majkëll Xhon U., 106
 Uhtdorf, Diter F., 26, 58, 70
 Uiksom, Rozmari M., 116
 Uolker, Uilliam R., 97
 Zivic, Klaudio D., 39
 Zuik, W. Krejg, 41

TREGUESI TEMATIK

Anëtarët misionarë, 78
 Autoriteti, 49
 Besëlidhjet, 22, 84, 87, 116, 122, 125
 Besimi, 29, 78, 81, 97, 100, 108
 Bindja, 6, 18, 35, 84, 100
 Dashuria, 6, 32, 41, 58, 91, 115, 119
 Dashuria hyjnore, 91
 Denjësia, 53
 Dëshmia, 94
 Dishepullimi, 6, 9, 18, 122
 Drejtësia, 111
 Drejtësia, 6
 Dhembshuria, 91
 Egoizmi, 58
 E liga, 29
 Emri i Kishës, 78
 E vërteta, 29, 94, 103, 108
 Falja, 91
 Familja, 44, 49
 Fatqeqësia, 9, 18, 70, 81, 87, 106
 Fryma e Shenjtë, 22, 94, 100
 Gratë, 49, 119
 Guximi, 6, 18, 66
 Historia familjare, 44
 Integriteti moral, 29, 66
 Jeta e përjetshme, 22
 Jezu Krishti, 6, 9, 12, 18, 22, 29, 32, 37, 40, 58, 70, 87, 94, 103, 111
 Jozef Smithi, 22, 39, 66, 103
 Komunikimi, 41
 Konferenca e përgjithshme, 4, 115
 Libri i Mormonit, 18
 Liria e Zgjedhjes, 35, 56, 100

Lutja, 15, 56, 62, 81
 Martesa, 18, 41, 49
 Mirënjohja, 70
 Mirësia, 91
 Motëria, 119, 125
 Ndershmëria, 62
 Ordinancat, 94
 Pendimi, 39, 84
 Perëndia Ati, 81, 94
 Përndjekja, 6
 Përparësitë, 58, 106
 Përlulesia, 106
 Pionierët, 70, 97
 Pornografia, 15, 53, 58
 Priftëria, 49, 53, 62
 Prindërimi, 94
 Profetët, 97, 103, 108
 Puna misionare, 32, 78
 Ringjallja, 12, 111
 Rivendosja, 58
 Sakrifika, 97
 Shembulli, 32, 62
 Shërbimi, 9, 32, 53, 58, 62, 119, 122
 Shkrimet e Shenjta, 29, 56
 Shlyerja, 12, 15, 18, 87, 111
 Shpresa, 22
 Teknologjia, 44, 56, 108
 Tempujt, 4, 44, 97, 116
 Urtësia, 103, 108
 Varësia, 15, 58
 Vdekja, 12, 111
 Vetëdisiplinimi, 84
 Zbulesa, 103, 108



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Mirësevini në Konferencë

Jemi . . . të bashkuar në besimin tonë dhe në dëshirën tonë për të dëgjuar dhe mësuar nga mesazhet që do të na paraqiten.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, sa i kënaqur jam që t'ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë mbarëbotërore të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Jemi mbledhur së bashku si një familje e madhe, me më shumë se 15 milionë anëtarë, të bashkuar në besimin tonë dhe në dëshirën tonë për të dëgjuar dhe mësuar nga mesazhet që do të na paraqiten.

Gjashtë muajt e shkuar kanë kaluar shpejt ndërsa puna e Kishës ka shkuar përpara e papenguar. Ishte privilegjim, vetëm pak më shumë se një muaj më parë, që të përkushtoja Tempullin e Gilbertit në Arizonë, një strukturë e mrekullueshme. Mbrëmjen përpara përkushtimit, u zhvillua një aktivitet kulturor në parkun Diskaveri aty pranë. Dymbëdhjetë mijë të rinj paraqitën një program 90-minutësh. Vallëzimet, këngët dhe paraqitjet muzikore ishin të jashtëzakonshme.

Kjo zonë kishte përjetuar një stinë veçanërisht të thatë dhe besoj se shumë lutje ishin dërguar drejt qiellit gjatë disa javëve paraprirëse për shiun aq të nevojshëm. Për fat të keq, ai erdhi

pikërisht përpara shfaqjes dhe qëndroi gjatë gjithë paraqitjes! Pavarësisht nga fakti që të rinjtë u bënë qull nga shiu dhe patën të ftohtë nga temperatura e ulët, ne të gjithë e ndiem Shpirtin e Zotit. Tema e programit, “Jeto i Vërtetë ndaj Besimit” – mendoni për atë: “Jeto i Vërtetë ndaj Besimit” – u portretizua mrekullisht nga të rinj dhe të reja të buzëqeshur dhe entuziastë. Pavarësisht nga gjithë shiu i ftohtë, kjo qe një përvojë plot besim dhe frymëzuese që këta të rinj do ta çmojnë gjithmonë si thesar dhe do t’ua tregojnë fëmijëve dhe nipërve e mbesave të tyre në vitet që do të vijnë.

Ditën pasuese, u zhvillua përkushtimi i Tempullit të Gilbertit në Arizonë. Ai u bë tempulli i 142-të funksionues në Kishë. Ndryshe nga mbrëmja e mëparshme, dita ishte e bukur dhe e mbushur me diell. Sesionet qenë vërtet frymëzuese. Në pjesëmarrje me mua ishin Presidenti Henri B. Ajring, Plaku e Motra Ted R. Kelister, Plaku e Motra Uilliam R. Uolker dhe Plaku e Motra Kent F. Riçards.

Në maj do të përkushtohet Tempulli i Fort Lloderdejlit në Florida.



Tempuj të tjerë janë programuar për t’u përfunduar dhe përkushtuar më vonë në këtë vit. Në vitin 2015 presim të përfundojmë dhe përkushtojmë tempuj të rinj në shumë pjesë të botës. Ky proces do të vazhdojë. Kur të gjithë tempujt e njoftuar më parë të përfundohen, ne do të kemi



170 tempuj në funksionim në mbarë botën.

Edhe pse tani po i përqendrojmë përpjekjet tona në përfundimin e tempujve të njoftuar më parë dhe nuk do të njoftojmë ndonjë tempull të ri në të ardhmen e afërt, ne do ta vazhdojmë procesin e përcaktimit të nevojave dhe

të gjetjes së vendeve për tempuj që ende do të vijnë. Njoftime do të bëhen atëherë në konferenca të përgjithshme të ardhshme. Ne jemi një popull tempullndërtues dhe tempullfrekuentues.

Tani, vëllezër dhe motra, ne mezi po presim të dëgjojmë mesazhet që do të na paraqiten sot dhe nesër. Ata

që do të na flasin, kanë kërkuar ndihmë dhe drejtim nga qielli, kur kanë përgatitur mesazhet e tyre.

Të gjithë ne, këtu dhe kudoqoftë – u mbushëshim me Shpirtin e Zotit dhe u lartësofshim e u frymëzofshim ndërsa dëgjojmë e mësojmë. Në emrin e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, amen. ■



Nga Xhefri R. Holland,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Çmimi – dhe Bekimet – e të Qenit Dishepull

Jini të fortë. Jetojeni ungjillin me besnikëri edhe pse të tjerët përreth jush nuk e jetojnë.

Presidenti Monson, ne ju duam. Ju ia keni dhënë jetën tuaj dhe shëndetin tuaj çdo thirrjeje që Zoti u ka dhënë ndonjëherë, veçanërisht detyrës së shenjtë që mbani tani. Kjo Kishë e tërë ju falënderon për shërbimin tuaj të palëkundur dhe për përkushtimin tuaj të padështueshëm ndaj detyrës.

Me admirim dhe inkurajim për çdo njeri që do të duhet të mbetet i palëkundur në këto ditë të mëvonshme, unë u them të gjithëve dhe veçanërisht rinisë së Kishës së, në qoftë se nuk e keni përjetuar tashmë, ju një ditë do ta gjeni veten të thirrur për ta mbrojtur besimin tuaj apo ndoshta për të duruar njëfarë abuzimi vetjak, thjesht ngaqë jeni anëtar i Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Çaste të tilla do të kërkojnë si kurajë edhe mirësjellje nga ana juaj.

Për shembull, një motër misionare më shkroi kohët e fundit: “Unë dhe shoqja ime pamë një burrë të ulur në një stol në qendër të qytetit duke ngrënë drekën e tij. Teksa i shkuam më afër, ai ngriti sytë dhe pa etiketat tona misionare. Me një shikim të tmerrshëm në sy, ai u ngrit me rrëmbim dhe ngriti dorën që të më

qëllonte. Iu shmanga tamam në kohë, vetëm që ai të arrinte ta pështynte ushqimin e tij kudo mbi mua dhe të fillonte të na shante me fjalët më të tmerrshme. U larguam pa thënë asnjë fjalë. U përpoqa ta fshija ushqimin nga fytyra ime, vetëm që të ndieja një masë pureje patatesh që më goditi në kokë nga pas. Nganjëherë është e vështirë të jesh një misionare, sepse pikërisht në atë çast doja të kthehesha, ta mbërtheja atë burracak dhe t’i thoja: ‘Ç’TË ZURI! Por nuk e bëra.’

Kësaj misionareje të përkushtuar unë i them, fëmijë e dashur, ti, në vetë mënyrën tënde të përlulur, ke hedhur hapin brenda një rrethi burrash dhe grash tepër të spikatur, të cilët, sikurse tha profeti Jakob i Librit të Mormonit, e kanë “konsider[uar] vdekjen e [Krishtit] dhe [kanë] dur[uar] kryqin e tij, dhe [kanë] mbaj[ur] turpin e botës”¹.

Në të vërtetë, për Jezusin Vetë, vëllai i Jakobit, Nefi, shkroi: “Dhe bota, për shkak të paudhësisë së vet, do ta gjykojë atë të jetë një gjë pa vlerë; prandaj ata e fshikullojnë atë dhe ai e duron atë, dhe ata e godasin atë dhe ai e duron atë. Po, ata pështynë mbi të dhe ai e duron atë, për shkak të dashurisë së përzemërt të tij dhe të

shpirtmirësisë së tij kundrejt fëmijëve të njerëzve.”²

Në përputhje me përvojën e vetë Shpëtimtarit, ka pasur një histori të gjatë mospranimi dhe një çmim mjaft të dhimbshëm, të paguar nga profetët dhe apostujt, misionarët dhe anëtarët në çdo brez – nga të gjithë ata që janë përpjekur ta nderojnë thirrjen e Perëndisë për ta lartësuar familjen njerëzore drejt “një udh[e] më të shkëlqyer”³.

“Dhe ç’të them më . . . [për ata]?” pyet shkruesi i librit të Hebrenjve.

“[Ata] të cilët . . . ua zunë grykën luanëve,

fikën fuqinë e zjarrit, shpëtuan nga tehu i shpatës, . . . u bënë të fortë në betejë, thyen ushtritë [në luftë] . . .

[I panë] të vdekurit e tyre . . . të ringjall[en]; . . . [ndërkohë që] të tjerët u torturuan . . .

Dhe . . . hoqën përqeshje dhe goditje [mizore], . . . pranga dhe burgime.

U vranë me gurë, . . . me sharrë, u prenë, [u tunduan], u vranë nga shpata, . . . u endën të mbuluar me lëkurë dhënshe e dhish, nevojtarë, të pikëlluar [e] të keqtrajtuar

(ata për të cilët] bota nuk ishte e denjë) . . . u sollën nëpër shkretëtira e nëpër male, nëpër shpella dhe nëpër guva të dheut.”⁴

Sigurisht engjëjt e qiellit vajtuan ndërsa shënonin këtë çmim të të qenit dishepull në një botë që është shpesh armiqësore ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Shpëtimtari Vetë derdhi lotët e Tij për ata që, për qindra vjet, nuk ishin pranuar dhe ishin vranë në shërbimin e Tij. Dhe tani, Ai nuk po pranohej dhe do të vritej.

“Jeruzalem, Jeruzalem”, thirri Jezusi, “që i vret profetët dhe i vret me gurë ata që të janë dërguar! Sa herë kam dashur t’i mbledh bijtë e tu ashtu si i mbledh kloçka zogj të vet nën krahe, por ju nuk deshët!

Ja, shtëpia juaj po ju lihet e shkretë.”⁵



Dhe atje gjendet një mesazh për çdo të ri dhe të re në këtë Kishë. Ju mund të pyesni veten nëse ia vlen të mbani një qëndrim moral të guximshëm në shkollën e mesme apo të shkoni në një mision, vetëm që t'i shihni bindjet tuaja më të vyera të fyhen ose të ndeshen me shumë gjëra në një shoqëri e cila ndonjëherë e përqesh një jetë përkushtimi fetar. Po, ia vlen ajo, sepse zgjedhja tjetër është që t'i kemi "shtëpitë" tona të lëna "të shkreta" – individët të shkretë, familjet të shkreta, lagjet e banimit të shkreta dhe kombet të shkreta.

Prandaj këtu ne kemi barrën e atyre që thirren për ta mbartur mesazhin e Mesias. Përveç mësimdhënies, nxitjes dhe përgëzimit të njerëzve (kjo është pjesa e këndshme e të qenit dishepull), herë pas here po këta lajmëtarë thirren për t'u shqetësuar, për të paralajmëruar dhe nganjëherë thjesht për të vajtuar (kjo është pjesa e dhembshme e të qenit dishepull). Ata e dinë fare mirë se rruga që çon drejt tokës së premtuar "ku rrjedh qumështi dhe mjalti"⁶ i domosdoshmërisë, kalon nëpërmjet udhës së Malit Sinai, ku rrjedhin gjërat që "do të" dhe "nuk do të" bëjmë.⁷

Për fat të keq, lajmëtarët e urdhërimeve të caktuara në mënyrë hyjnore,

shpesh nuk janë më të pëlqyer sot sesa ishin në lashtësi, ashtu sikurse mund ta vërtetojnë tani të paktën ato dy motra misionare që u pështrën dhe u spërkatën me patate. *Urrejtja* është një fjalë e shëmtuar, por gjenden ata njerëz sot të cilët do të thonin me Ababin e mbrapshtë: "Unë e urrej [profetin Mikajah], sepse nuk profetizon kurrë ndonjë gjë të mirë për mua, por vetëm [profetizon] të keqen"⁸. Ajo lloj urrejtjeje për ndershmerinë e një profeti pati si çmim për Abinadin jetën e tij. Kur ai i tha mbretit Noe: "Meqë unë ju kam thënë të vërtetën, ju jeni zemëruar me mua. . . . Pasi unë kam folur fjalën e Perëndisë, ju më keni gjykuar që jam i çmendur"⁹ ose, ne mund të shtojmë, provincial, patriarkal, fanatik, i pasjellshëm, mendjengushtë, i dalë mode dhe i moshuar.

Është sikurse Zoti Vetë iu drejtua në vajtim profetit Isaia:

"[Këta] bij . . . nuk duan të dëgjojnë ligjin e Zotit,

[ata] u thonë shikuesve: 'Mos kini vegime', dhe profetëve: 'Mos na profetizoni gjëra të vërteta, na tregoni gjëra të këndshme, na profetizoni gjëra mashtruese.

Dilni jashtë rruge, braktisni shtegun e drejtë, largoni nga sytë tona të Shenjtin e Izraelit!"¹⁰

Mjaft trishtueshëm, miqtë e mi të rinj, është një tipar i epokës sonë që, nëse njerëzit duan ndonjë perëndi, ata duan që ato të jenë perëndi që nuk kërkojnë shumë, perëndi të rehatshme, perëndi të buta, të cilët jo vetëm që nuk e lëkundin varkën, por as nuk e bëjnë atë të lundrojë, perënditë që na bien krahëve me përgëzim, na bëjnë të qeshim nën hundë, pastaj na thonë të shkojmë e të mbledhim lule.¹¹

S'është veçse njeriu që po e krijon Perëndinë sipas vetë shëmbëlltyrës së tij! Nganjëherë – dhe kjo duket ironia më e madhe e të gjithave – këta njerëz e citojnë emrin e Jezusit si dikush që ishte po ky lloj i Perëndisë "se rehatshme". Vërtet? Ai, i cili tha se jo vetëm nuk duhet t'i thyejmë urdhërimet, por as nuk duhet ta *mendojmë* thyerjen e tyre. Dhe nëse vërtet mendojmë rreth thyerjes së tyre, ne tashmë i kemi thyer ato në zemrën tonë. A tingëllon kjo si doktrinë "e rehatshme", e këndshme për t'u dëgjuar dhe e mirënjohur te lokali i preferuar?

Po për ata që thjesht dëshirojnë ta shohin mëkatën apo ta prekin atë nga një largësi? Jezusi tha prerazi, nëse syri yt të çon në mëkat, hiqe. Nëse dora jote të çon në mëkat, preje.¹² "Nuk erdha të sjell paqen, por shpatën"¹³, i paralajmëroi Ai ata që menduan se

fliste vetëm fjalë të rëndomta qetësuese. S'ka dyshim përse, predikim pas predikimi, komunitetet vendore iu "lut[ën] . . . që të largohet nga krahina e tyre"¹⁴. S'ka dyshim përse, mrekulli pas mrekullie, fuqia e Tij nuk u njoh si prej Perëndisë, por si prej djallit.¹⁵ Është e dukshme që parulla e mirënjohuri ku pyetet "Çfarë do të bënte Jezusi", nuk do të sjellë gjithmonë një përgjigje të mirëpritur.

Në kulmin e shërbesës së Tij në vdekshmëri, Jezusi tha: "Ta doni njëritjetrin, ashtu si unë ju kam dashur juve"¹⁶. Për t'u siguruar që ata e kuptuan saktësisht se çfarë lloj dashurie ishte ajo, Ai tha: "Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia"¹⁷ dhe "ai . . . që do të shkelë një nga . . . urdhërime[t] më

të vogla, dhe do t'u ketë mësuar kështu njerëzve, do të quhet . . . më i vogli në mbretërinë e qiejve"¹⁸. Dashuria si e Krishtit është gjëja që na nevojitet më shumë të kemi në këtë planet, pjesërisht ngaqë drejtësia gjithmonë mendohej se e shoqëronte atë. Kështu, nëse dashuria pritet të jetë motoja jonë, sikurse *duhet* të jetë, atëherë me anë të fjalës së Atij që është personifikimi i dashurisë, ne duhet ta braktisim shkeljen dhe çfarëdo grimce të nxitjes së saj tek të tjerët. Jezusi qartësisht e kuptoi atë që shumë njerëz në kulturën tonë moderne duket se e harrojnë: që ka një ndryshim thelbësor midis urdhërimit për ta falur mëkatin (gjë të cilën Ai pati një aftësi të pafundme për ta bërë) dhe paralajmërimit kundrejt

tolerimit të mëkatit (gjë të cilën Ai kurrë nuk e bëri, as edhe një herë).

Miq, veçanërisht miqtë e mi të rinj, merrni zemër. Dashuria e pastër si e Krishtit, duke rrjedhur nga drejtësia e vërtetë, mund ta ndryshojë botën. Unë dëshmoj se ungjilli i vërtetë dhe i gjallë i Jezu Krishtit është mbi tokë dhe ju jeni anëtarë të Kishës së Tij të vërtetë dhe të gjallë, duke u përpjekur për ta shpërndarë atë. Unë jap dëshmi për këtë ungjill dhe për këtë Kishë, me një dëshmi të veçantë për çelësat e rivendosur të priftërisë, të cilët i hapin udhë fuqisë dhe efektshmërisë së ordinancave shpëtuese. Unë jam më i sigurt që ata çelësa janë rivendosur dhe që ato ordinanca janë, edhe një herë, të disponueshme nëpërmjet



Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, sesa jam i sigurt që qëndroj para jush te kjo foltore dhe ju qëndroni të ulur para meje në këtë konferencë.

Jini të fortë. Jetojeni ungjillin me besnikëri edhe pse të tjerët përreth jush nuk e jetojnë. Mbrojini bindjet tuaja me mirësjellje dhe me dashamirësi, por mbrojini ato. Një histori e gjatë e zërave të frymëzuar, përfshirë ata që do t'i dëgjoni në këtë konferencë dhe zërin që ju dëgjuat nga vetë Presidenti Tomas S. Monson, ju tregojnë udhën drejt shtegut të të qenit dishepuj të krishterë. Ai është një shteg i ngushtë dhe i ngushtuar, pa shumë liri veprimi, por në të udhëtimit mund të bëhet me emocion dhe sukses, “me . . . vendosmëri në Krisht[in], . . . [me] një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit”¹⁹. Duke ndjekur plot kurajë një udhë të tillë, ju do të farkëtoni besim të patundur, do të gjeni siguri kundrejt erërave të liga që fryjnë, madje shigjeta në shtjellën e erës, dhe do ta ndjeni forcën si të një shkëmbi të Shëlbuesit tonë, mbi të cilën, nëse e ndërtoni veten tuaj si dishepuj të përkushtuar, ju *nuk mund* të bini.²⁰ Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Jakobi [LİM] 1:8.
2. 1 Nefi 19:9.
3. 1 Korintasve 12:31; Ethëri 12:11.
4. Hebrejve 11:32–38.
5. Mateu 23:37–38.
6. Eksodi 3:8.
7. Shih Eksodi 20:3–17.
8. 2 Kronikave 18:7.
9. Mosia 13:4.
10. Isaia 30:9–11.
11. Shih Henry Fairlie, *The Seven Deadly Sins Today* (1978), f. 15–16.
12. Shih Mateu 5:29–30.
13. Mateu 10:34.
14. Marku 5:17.
15. Shih Mateu 9:34.
16. Gjoni 15:12.
17. Gjoni 14:15.
18. Mateu 5:19; theksimi i shtuar.
19. 2 Nefi 31:20.
20. Shih Helamani 5:12.



Nga Plaku Ronald A. Rasband,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Barra e Gëzueshme e Dishepullimit

T'i mbështetim udhëheqësit tanë është një privilegj; ai vjen i lidhur me një përgjegjësi vetjake për ta mbajtur së bashku barrën e tyre dhe për të qenë dishepuj të Zotit.

Më 20 maj të vitit të kaluar, një tornado e stërmadhe grushtoi rrethinat e Oklahoma-Sitit, në zemër të Amerikës, duke lënë gjurmë shkatërrimi mbi 1.6 km të gjerë dhe 27 km të gjatë. Kjo stuhi, një sulm i furishëm tornadosh shkretuese, e shndërrroi peizazhin dhe jetën e njerëzve në shtegun e vet.

Pikërisht një javë pasi goditi stuhia e stërmadhe, unë u caktova të vizitoja zonën ku shtëpitë dhe sendet vetjake qenë shpërndarë nëpër lagjet e rrafshuara e të rrënuara.

Përpara se të largohesha, fola me profetin tonë të dashur, Presidentin Tomas S. Monson, që u gëzohet shumë punëve të tilla për Zotin. Me respekt të lindur jo vetëm nga detyra e tij, por edhe nga mirësia e tij, pyeta: “Çfarë dëshiron që të bëj? Çfarë dëshiron që të them?”

Ai më kapi për dore me butësi, siç do të kishte bërë me çdonjërin prej viktimave dhe me çdonjërin prej njerëzve që po ndihmonin lidhur me shkatërrimin, po të kishte qenë atje dhe tha:

“Së pari, thuaju atyre që i dua.

Së dyti, thuaju se po lutem për ta.

Së treti, të lutem, falënderoju të gjithë ata që po ndihmojnë.”

Si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, mund ta ndieja peshën mbi supet e mi në fjalët që Zoti i tha Moisiut:

“Mblijdhmë shtatëdhjetë njerëz nga pleqtë e Izraelit, që ti i njej si pleq të popullit dhe funksionarë të tij; . . .

Unë do të zbris dhe aty do të flas me ty; do të marr pastaj nga Fryma që është mbi ty [Moisi] dhe do t'ua kaloj atyre, me qëllim që ta mbajnë bashkë me ty barrën e popullit, dhe të mos e mbash ti vetëm.”¹

Këto janë fjalë nga kohët e lashta e prapëseprapë mënyrat e Zotit nuk kanë ndryshuar.

Aktualisht në Kishë, Zoti ka thirrur 317 Të Shtatëdhjetë, që po shërbejnë në 8 kuorume, për t'iu ardhur në ndihmë Dymbëdhjetë Apostujve në mbajtjen e barrës së vendosur mbi Presidencën e Parë. E ndiej gëzueshëm atë përgjegjësi në thellësi të shpirtit tim, sikurse bashkëvëllezërit e mi. Megjithatë, ne nuk jemi të vetmit që po ndihmojmë në këtë punë të lavdishme. Si anëtarë të Kishës në botën mbarë, ne të gjithë kemi mundësinë



e mrekullueshme për të bekuar jetën e të tjerëve.

Kisha mësuar nga profeti ynë i dashur se çfarë u nevojitej njerëzve të tronditur nga stuhia – dashuri, lutje dhe vlerësim për duart ndihmëtare.

Këtë pasdite, secili prej nesh do të ngrejë ndershmërisht krahun e tij të djathtë e të mbështetë Presidentën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve si profetë, shikues e zbulues të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ky nuk është thjesht formalitet e as nuk ruhet vetëm për ata që thirren në shërbim të përgjithshëm. T'i mbështetim udhëheqësit tanë është një privilegj; ai vjen i lidhur me një përgjegjësi vetjake për ta mbajtur së bashku barrën e tyre dhe për të qenë dishepuj të Zotit Jezu Krisht.

Presidenti Monson ka thënë:

“Ne jemi të rrethuar nga ata që kanë nevojë për vëmendjen tonë, ndihmën tonë, mbështetjen tonë, ngushëllimin tonë dhe mirësinë tonë – qofshin ata pjesëtarë të familjes, miq, të njohur apo të huaj. Ne jemi duart e Zotit këtu në tokë, me autorizimin për të shërbyer dhe për të ngritur moralisht fëmijët e Tij. Ai varet nga secili prej nesh. . . .

‘. . . Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre . . . , këtë ma bëtë mua’ [Mateu 25:40].”²

A do të përgjigjemi me dashuri kur para nesh të jetë një mundësi për të bërë një vizitë, një telefonatë, për të shkruar një pusullë, ose për të kaluar një ditë duke plotësuar nevojat e dikujt tjetër? Apo do të jemi si i riu i cili deklaroi t'i zbatonte të gjitha urdhërimet e Perëndisë:

“Të gjitha këto gjëra unë i kam zbatuar që në rini; çfarë më mungon tjetër?”

Jezusi i tha: ‘Në qoftë se do të jesh i përsosur, shko, shit ç’të kesh, jepua të varfërve dhe ti do të kesh një thesar në qiell; pastaj eja dhe më ndiq mua.’³

I riu po thirrej për një shërbim më të madh në krah të Zotit për të bërë punën e mbretërisë së Perëndisë në tokë, e prapëseprapë ai u largua “sepse kishte pasuri të madhe”.⁴

Çfarë ndodh me zotërimet tona? Ne mund ta shohim se çfarë mund të bëjë një tornado me to në vetëm pak minuta. Është shumë e rëndësishme për të gjithë ne që të mundaohemi t'i mbledhim thesaret tona në qiell – duke e përdorur kohën, talentet dhe lirinë tonë të zgjedhjes në shërbim të Perëndisë.

Jezu Krishti vazhdon ta bëjë thirrjen: “Eja dhe më ndiq”.⁵ Ai eci nëpër vendlindjen e Tij me ndjekësit e Tij në një mënyrë vetëmohuese. Ai vazhdon të ecë me ne, të na qëndrojnë pranë e

të na udhëheqë. Të ndjekësh shembullin e Tij të përsosur është ta njohësh dhe ta nderosh Shpëtimtarin që i ka mbajtur të gjitha barrët tona nëpërmjet Shlyerjes së Tij të shenjtë e shpëtuese, vepra më e madhërishme e shërbimit. Ajo që Ai kërkon nga secili prej nesh, është të jemi të aftë dhe të gatshëm ta mbajmë “barrën” e gëzueshme të dishepullimit.

Kur isha në Oklahoma, pata mundësinë të takohesha me disa familje të rrënuara nga tornadot e fuqishme. Teksa po bisedoja me familjen Sorrels, u preka veçanërisht nga përvoja e bijës së tyre, Torit, që në atë kohë ishte në klasën e pestë të shkollës fillore Plaza Tauërs. Ajo dhe nëna e saj janë këtu me ne sot.

Tori dhe një dorë shokësh e shoqesh u mblodhën kruspull në një tualet si strehë teksa tornado gjemonte nëpër shkollë. Dëgjoni teksta e lexoj, me vetë fjalët e Torit, rrëfimin e asaj dite:

“Dëgjova diçka që goditi çatinë. Mendova se ishte thjesht shkrepimë. Tingulli u bë gjithnjë e më i fortë. Bëra një lutje që Ati Qiejlor të na mbronte e të na mbante të sigurt të gjithëve. Befas, dëgjuam një tingull të lartë si ai i fshesës me korrent dhe çatia u zhduk pikërisht mbi kokat tona. Kishte shumë erë dhe copëra që fluturonin rreth e

rrotull e po goditnin çdo pjesë të trupit tim. Jashtë ishte errësirë dhe dukej sikur qielli ishte i zi, por nuk ishte ai – ishte brendësia e tornados. Unë thjesht mbylla sytë duke shpresuar e duke u lutur se do të mbaronte shpejt.

Papritmas u bë qetësi.

Kur i hapa sytë, pashë një shenjë [rrugore] ‘Ndal!’ mu përpara syve të mi! Ajo pothuajse po më prekte hundën.”⁶

Tori, e ëma, tre nga vëllezërit e motrat e saj dhe shokë të shumtë që ishin gjithashtu në shkollë me të, i mbijetuan mrekullisht tornados; shtatë prej shokëve të tyre të shkollës nuk ia dolën.

Atë fundjavë, vëllezërit me priftëri u dhanë shumë bekime anëtarëve që kishin vuajtur në stuhi. Pata nderin t’i jepja Torit një bekim. Teksa i vendosa duart e mia mbi kokën e saj, më erdhi në mendje një shkrim i shenjtë i parapëlqyer: “Unë do të shkoj përpara fytyrës suaj. Unë do të jem në të djathtën e në të majtën tuaj dhe Shpirti im do të jetë në zemrat tuaja e engjëjt e mi përreth jush, për t’ju ngritur lart.”⁷

E këshillova Torin ta mbante mend ditën kur një shërbëtor i Zotit i vuri duart e tij mbi kokën e saj dhe shqiptoi se në stuhi ajo ishte mbrojtur nga engjëjt.

Zgjatja për të shpëtuar njëri-tjetrin, nën çdo rrethanë, është një matje e përvetshme dashurie. Ky është shërbimi që dëshmoval në Oklahoma atë javë.

Shpesh, na jepet mundësia për t’i ndihmuar të tjerët në kohë nevoje. Si anëtarë të Kishës, ne të gjithë kemi një përgjegjësi të shenjtë që “të mbaj[më] barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta”⁸, “të vajto[më] me atë që vajtojnë”⁹, të “ngr[emë] duart që varen poshtë dhe [të] forco[më] gjunjët e këputur”¹⁰.

Vëllezër e motra, sa mirënjohës është Zoti për secilin dhe çdonjërin prej jush, për orët dhe veprat e panumërta të shërbimit, qoftë të mëdha

apo të vogla, që ju jepni me kaq bujari e mirësjellje çdo ditë.

Mbreti Beniamin dha mësim në Librin e Mormonit: “Kur jeni në shërbimin e bashkëqenieve tuaja, ju jeni vetëm në shërbimin e Perëndisë tuaj”¹¹.

Përqendrimi tek të shërbyerit ndaj vëllezërve e motrave tona mund të na udhërrëfejë që të marrim vendime hyjnore në jetën tonë të përditshme e na përgatit që ta vlerësojmë e ta duam atë që Zoti do. Duke bërë kështu, ne e dëshmojmë me vetë jetën tonë se jemi dishepujt e Tij. Kur jemi të angazhuar në punën e Tij, ne e ndiejmë Shpirtin e Tij me vete. Ne rritemi në dëshmi, besim, mirëbesim dhe dashuri.

Unë e di se Shëlbuesi im jeton, madje Jezu Krishti dhe që Ai flet me

dhe nëpërmjet profetit të Tij, Presidentit tonë të dashur Tomas S. Monson, në këtë kohë, kohën tonë.

E gjetshim të gjithë gëzimin që vjen nga shërbimi i shenjtë i mbajtjes së barrave të njëri-tjetrit, madje dhe ato të thjeshtat e të voglat, është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Numrat 11:16–17.
2. Tomas S. Monson, “Çfarë Kam Bërë për Dikë Sot?” *Liahona*, nëntor 2009, f. 86, 87.
3. Mateu 19:20–21.
4. Mateu 19:22.
5. Mateu 19:21.
6. Përvojë e Victoria (Tori) Sorrels-it, e ritreguar më 16 janar 2014.
7. Doktrina e Besëlidhje 84:88.
8. Mosia 18:8.
9. Mosia 18:9.
10. Doktrina e Besëlidhje 81:5.
11. Mosia 2:17.





Nga Plaku Karlos H. Amado,
i Të Shtatëdhjetëve

Krishti, Shëlbuesi

Sakrifica e [Shëlbuesit] i bekoi të gjithë, që nga Adami, njeriu i parë, deri te njeriu i fundit i të gjitha qenieve njerëzore.

Jezu Krishti, Biri i Perëndisë, lindi dhe vdiq në rrethana të pashoqe. Ai jetoi dhe u rrit në kushte të përlurura, pa të mira materiale. Ai tha për Vetën: “Dhelprat kanë strofka dhe zogjtë e qiellit fole; kurse Biri i njeriut nuk ka ku ta mbështesë kokën” (Lluka 9:58).

Ai kurrë nuk mori nderime, për-krahje, miratim, as trajtim të privilegjuar nga udhëheqësit politikë të tokës apo nga udhëheqësit fetarë të kohës së Tij. As nuk u ul në vendet e para të sinagogave.

Predikimi i Tij ishte i thjeshtë dhe, megjithëse shumë njerëz e ndiqnin Atë, shërbesa e Tij gjithmonë u përqendrua te bekimi i njerëzve një e nga një. Ai kreu mrekulli të panumërta mes atyre që e pranuan Atë si të Dërguarin e Perëndisë.

Ai u dha Apostujve të Tij autoritet dhe fuqi të bënin mrekulli “[dhe] . . . vepra . . . edhe më të mëdha” nga ato që kreu Vetë (Gjoni 14:12), por Ai kurrë nuk u dha atyre privilegjin për të falur mëkatet. Armiqtë e Tij u zemëruan kur e dëgjuan të thoshte: “Shko dhe mos mëkato më” (Gjoni 8:11) ose “Mëkatet e tua të janë falur” (Lluka 7:48). Ajo e drejtë i përkiste vetëm Atij, ngaqë Ai është Biri i Perëndisë dhe ngaqë Ai do të paguante për ato mëkate me Shlyerjen e Tij.

Fuqia e Tij mbi Vdekjen

Fuqia e Tij mbi vdekjen ishte një tjetër cilësi hyjnore. Jairo i madh, kryetar i sinagogës, iu përgjërua “të shkonte në shtëpinë e tij, sepse ai kishte një vajzë të vetme . . . , që ishte për vdekje” (Lluka 8:41–42). Mësuesi e dëgjoji lutjen e tij dhe, ndërsa po ecnin, një shërbëtor erdhi te Jairo dhe i tha: “Vajza jote vdiq, mos e shqetëso Mësuesin” (Lluka 8:49). Pasi hyri në shtëpi, Jezusi u kërkoi të gjithëve që të dilnin jashtë dhe menjëherë, duke e kapur atë nga dora, i tha: “Çohu!” (Lluka 8:54).

Në një rast tjetër, ndërsa po udhëtonte për në qytetin e Nainit, Ai hasi një kortezh varrimi, një të ve duke vajtuar për vdekjen e birit të saj të vëtëm. Plot mëshirë, Ai preku arkivolin dhe tha: “Djalosh, unë të them, çohu” (Lluka 7:14). Njerëzit, kur panë mrekullinë, bërtitën: “‘Midis nesh doli një profet i madh’ dhe: ‘Perëndia e vizitoi popullin e vet’ (Lluka 7:16). Kjo mrekulli qe edhe më mbresëlënëse për t’u përmendur, pasi tashmë e kishin shpallur zyrtarisht të vdekur djaloshin dhe ishin rrugës për ta varrosur. Me dy të rinj të kthyer përsëri në jetë, prova e autoritetit dhe e fuqisë së Tij mbi vdekjen i mahniti besimtarët dhe i mbushi me frikë përgojuesit.

Rasti i tretë ishte më mbresëlënësi. Llazari, Marta dhe Maria qenë vëllai

dhe motrat, të cilët Krishti do t’i vizitonte shpesh. Kur njerëzit e njoftuan që Llazari ishte sëmurë, Ai qëndroi dy ditë përpara se të nisej për të shkuar te familja. Duke e ngushëlluar Martën për vdekjen e vëllait të saj, Ai i dëshmoi asaj në mënyrë të prerë: “Unë jam ringjallja dhe jeta; ai që beson në mua, edhe sikur të duhej të vdesë do të jetojë” (Gjoni 11:25).

Kur Shpëtimtari u kërkoi vajtesve ta hiqnin gurin nga varri, Marta i pëshpëriti me druajtje: “Zot, ai tashmë qelbet, sepse ka vdekur prej katër ditësh” (Gjoni 11:39).

Atëherë Jezusi me dashuri i kujtoi asaj: “A nuk të thashë se po të besosh, do të shohësh lavdinë e Perëndisë?” (Gjoni 11:40). Dhe pasi e kishte thënë këtë, thirri me zë të lartë:

“Llazar, eja jashtë!

Atëherë i vdekuri doli” (Gjoni 11:43–44).

Pas katër ditëve të Llazarit në varr, armiqtë e Birit të Perëndisë u përballën me provë të pakundërshtueshme që nuk mund ta shpërfillnin, zvogëlonin apo shtrembëronin dhe ata, në mënyrë të pakuptimë dhe të ligë, “që nga ajo ditë . . . vendosën ta vrasin” (Gjoni 11:53).

Urdhërimi i Ri

Më vonë, Krishti i gjallë kremtoi në Jerusalem, bashkë me Apostujt e Tij, Festën e Tij të fundit të Pashkës, vendosi ordinancën e sakramentit dhe u dha atyre urdhërimin që ta donin njëri-tjetrin me shërbesë të çiltër.

Agonia e Tij në Gjetseman

Pas kësaj, në shfaqjen më të madhërishe të dashurisë së Tij për njerëzimin dhe me ushtrimin e plotë të vullnetit të Tij, Ai eci me guxim dhe vendosmëri për t’u përballuar me sprovën e Tij më të rëndë. Në Kopshtin e Gjetsemanit, në vetmi të plotë,



Ai vuajti agoninë më të fuqishme, duke i dalë gjak nga çdo por. Në nënshtrim të plotë ndaj Atit të Tij, Ai shleu për mëkatet tona dhe gjithashtu mori mbi Vete sëmundjet dhe hidhërimet tona, në mënyrë që të dinte se si të na vinte në ndihmë (shih Alma 7:11–13).

Ne jemi në borxh me Të dhe Atin tonë Qiellor pasi sakrifica e Tij i bekoj të gjithë, që nga Adami, njeriu i parë, deri te njeriu i fundit i të gjitha qenieve njerëzore.

Dënimi dhe Kryqëzimi i Shpëtimtarit

Kur agonja e Tij në Gjetseman përfundoi, Ai me vullnet të lirë iu dorëzua

përndjekësve të Tij. I tradhtuar nga një prej [pasuesve] të Tij, Ai u dënua nxitimthi, në një mënyrë të padrejtë si dhe të paligjshme, në një gjyq si të manipuluar, ashtu edhe të mangët. Po atë natë, Ai u akuzua për krimin e blasfemisë dhe u dënua me vdekje. Në urrejtjen dhe etjen e tyre për hakmarrje – ngaqë Ai u dëshmoi se ishte Biri i Perëndisë – armiqtë e Tij komplotuan që Pilati ta dënonte Atë. Me atë qëllim, ata e ndryshuan akuzën e blasfemisë në kryengritje, në mënyrë që vdekja e Tij të bëhej me anë të kryqëzimit.

Dënimi i Tij mes romakëve ishte edhe më mizor: talljet dhe përqeshja e

tyre ndaj mbretërisë së Tij shpirtërore, kurorëzimi poshtërues me një kurorë gjembash, fshikullimi i dhembshëm i Tij dhe agonja e zgjatur e Kryqëzimit të Tij publik, ishin të gjitha një paralajmërim i qartë për çdo njeri që mund të guxonte ta shpallte veten e tij ose të saj dishepull të Tij.

Në çdo çast të vuajtjes së Tij, Shëlbuesi i botës shfaqti vetëkontroll të jashtëzakonshëm. Ai përherë mendoi për t'i bekuar të tjerët; Ai, me mirësi e dhembshuri, iu lut Gjonit që të kujdesej për nënën e Tij, Marien. Ai i kërkoi Atit të Tij në Qiell që t'i falte ekzekutesit të cilët e kryqëzuan. Me

përmbushjen e punës së Tij në tokë, Ai ia dorëzoi shpirtin e Tij Perëndisë dhe dha frymën e fundit. Trupi fizik i Krishtit u çua në varr dhe mbeti atje tri ditë.

Puna e Shëlbuesit mes të Vdekurve

Ndërsa dishepujt e Tij po vuanin nga trishtimi, shkurajimi dhe pasiguria, Shpëtimtari ynë, në një fazë tjetër të planit të lavdishëm të Atit të Tij, e zgjeroi shërbesën e Tij në një mënyrë të re. Në periudhën e shkurtër prej tri ditësh, Ai punoi në mënyrë të palodhur për të organizuar punën e pamasë të shpëtimit mes të vdekurve. Ato ditë u kthyen në disa nga ditët më shpresëdhënëse për familjen

e Perëndisë. Gjatë asaj vizite, Ai i organizoi pasuesit e Tij besnikë në mënyrë që ata t'u jepnin lajmet e gëzueshme të shëlbimit atyre që në jetë nuk arritën të dinin për planin e lavdishëm ose që nuk e kishin pranuar atë. Tani ata do të kishin mundësinë që të çliroheshin nga robëria e tyre dhe të shëlbeshin nga Perëndia i të gjallëve dhe i të vdekurve (shih DeB 138:19, 30–31).

Frytet e Para të Ringjalljes

Me përmbushjen e punës së Tij në botën e shpirtave, Ai u kthye në tokë – për ta bashkuar përgjithmonë shpirtin e Tij me trupin e Tij fizik. Megjithëse Ai e kishte shfaqur

plot autoritet fuqinë e Tij mbi vdekjen, rrëfimet e shkrimeve të shenjta për ata që Ai i kishte kthyer në jetë përpara Ringjalljes së Tij, tregojnë që ata vetëm sa ishin kthyer në një jetë që ishte zgjatur në mënyrë të mrekullueshme; ata prapëseprapë do të vdisnin.

Krishti që i pari që u ringjall që kurrrë të mos vdiste më, për të zotëruar përgjithmonë një trup të përsosur, të përjetshëm. Në gjendjen e Tij të ringjallur, Ai iu shfaq Maries, e cila sapo e njohu, filloi ta adhuronte. Shëlbuesi ynë, me dhembshuri të madhe, e paralajmëroi atë lidhur me gjendjen e Tij të re dhe të lavdishme: “Mos më prek, sepse ende nuk u ngjita te Ati im” (Gjoni 20:17) – duke dhënë një dëshmi tjetër që shërbesa e Tij në botën e shpirtave ishte e vërtetë dhe e plotë. Atëherë, duke përdorur një gjuhë që pohonte realitetin e Ringjalljes së Tij, Ai tha: “Unë po ngjitem tek Ati im dhe Ati juaj, te Perëndia im dhe Perëndia juaj” (Gjoni 20:17). Pasi shkoi tek Ati i Tij, Ai u kthye sërish dhe iu shfaq Apostujve të Tij. “U tregoi atyre duart e veta dhe brinjën. Dishepujt pra, kur e panë Zotin, u gëzuan” (Gjoni 20:20).

Shëlbuesi Do Të Kthehet

Unë dëshmoj se Krishti do të kthehet në një mënyrë shumë të ndryshme nga ardhja e Tij e parë. Ai do të vijë në pushtet dhe lavdi me të gjithë Shenjtorët e drejtë dhe besnikë. Ai do të vijë si Mbret i mbretërve dhe Zot i zotërve, si Princi i Paqes, Mesia i premtuar, Shpëtimtari dhe Shëlbuesi, për të gjykuar të gjallët dhe të vdekurit. E dua dhe i shërbej Atij me të gjithë zemër, dhe lutem që të mund të shërbejmë me gëzim e përkushtim dhe që të mund t'i qëndrojmë besnikë Atij deri në fund. Në emrin e Tij, Jezu Krishtit, amen. ■





Nga Linda S. Rivs,
Këshilltare e Dytë në Presidencën e
Përgjithshme të Shoqatës së Ndhmës

Mbrojtja nga Pornografia – një Shtëpi e Përqendruar te Krishti

Filtri më i mirë në botë . . . është filtri i brendshëm vetjak që vjen nga një dëshmi e thellë dhe e qëndrueshme.

Të dashur vëllezër e motra, sot, unë jam e bekuar që kam 13 nipërit dhe mbesat e mia më të rritur në sallë. Kjo më ka bërë që të pyes “Çfarë dua që nipërit dhe mbesat e mia të dinë?” Këtë mëngjes do të doja t’i flisja hapur familjes sime dhe tuajës.

Ne si udhëheqës, jemi gjithnjë e më shumë të shqetësuar rreth shkatërrimit që pornografia po shkakton në jetën e anëtarëve të Kishës dhe të familjeve të tyre. Satani po sulmon me furi të paparë.

Një arsye pse ne jemi këtu në tokë është që të mësojmë t’i kontrollojmë pasionet dhe ndjenjat e trupave tanë tokësorë. Këto ndjenja të dhëna nga Perëndia na ndihmojnë që të dëshirojmë të martohemi e të kemi fëmijë. Marrëdhënia intime e martesës midis një burri dhe një gruaje që sjell fëmijë në vdekshmëri ka për synim që të jetë edhe një përvojë e bukur, e dashur që lidh së bashku dy zemra

të përkushtuara, bashkon si shpirtin edhe trupin, dhe sjell një plotësi gëzimi e lumturie ndërsa mësojmë ta vendosim njëri-tjetrin të parin. Presidenti Spenser W. Kimball dha mësim se në martesë, “bashkëshorti/ja . . . bëhet kryesori/ja në jetën e bashkëshortit ose bashkëshortes, dhe. . . [asnjë] interes tjetër [apo] individ [ose] gjë tjetër nuk do të marrë ndonjëherë përparësi ndaj shokut/shoqes së jetës. . . .

. . . Martesa nënkupton përkushtim të plotë dhe besnikëri të plotë.”¹

Shumë vite më parë, një nga fëmijët tanë ishte mjaft e brengosur. Hyra në dhomën e saj, ku ajo hapi zemrën dhe më shpjegoi se kishte qenë te shtëpia e një shoqeje dhe rastësisht kishte parë imazhe e veprime befasuese e shqetësuese në televizor midis një burri dhe një gruaje pa rroba. Ajo filloi të qante me ngashërim dhe shprehu se sa keq ndihej për atë që kishte parë dhe dëshironte që të mund ta hiqte

nga mendja. Unë isha kaq mirënjohëse që ajo më besoi, duke më dhënë një mundësi që t’ia qetësoja zemrën e pafajshme e të lënduar dhe ta ndihmoja të dinte se si të mernte lehtësim nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit tonë. Më kujtohen ndjenjat e shenjta që pata ndërsa u gjunjëzuam së bashku si nënë e bijë dhe kërkuam ndihmën e Atit tonë Qiellor.

Shumë fëmijë, të rinj dhe të rritur ekspozohen pa dashje ndaj pornografisë, por një numër në rritje si i burrave dhe i grave po zgjedhin ta shohin atë dhe tërhiqen vazhdimisht, derisa u bëhet varësi. Këta persona mund ta dëshirojnë me gjithë zemrën e tyre që të dalin nga ky kurth, por shpesh nuk mund ta mposhtin atë vetë. Sa mirënjohës jemi kur këta njerëz të dashur zgjedhin të na besojnë neve si prindër ose një udhëheqësi të Kishës. Do të ishte gjë e mençur të mos reagonim me tronditje, zemërim ose mospranim, e cila mund t’i bëjë ata të heshtin sërisht.

Ne si prindër dhe udhëheqës duhet të këshillohemi me fëmijët e të rinjtë tanë rregullisht, duke i dëgjuar me dashuri dhe mirëkuptim. Ata duhet t’i dinë rreziqet e pornografisë dhe mënyrën se si e pushton ajo jetën, duke shkaktuar humbjen e Shpirtit, ndjenja të shtrembëruara, gënjeshtër, humbjen e vetëkontrollit dhe harxhim pothuaj të plotë të kohës, mendimit dhe energjisë.

Pornografia është më e ulët, më e ligë dhe më e dukshme se kurrë më parë. Ndërsa këshillohemi me fëmijët tanë, së bashku ne mund të krijojmë një plan familjar me standarde dhe kufij, duke qenë aktivë për t’i mbrojtur shtëpitë tona me filtra në pajisjet elektronike. Prindër, a jemi ne të vetëdijshëm se pajisjet celulare me kapacitet interneti, jo kompjuterat, janë shkaktori më i madh?²



Raimond, Alberta, Kanada

Të rinj dhe të rritur, nëse bini në kurthin e Satanit, të pornografisë, mbani mend sa i mëshirshëm është Shpëtimtari ynë i dashur. A e kuptoni se sa fort ju do dhe ju ka për zemër Zoti, madje edhe tani? Shpëtimtari ynë ka fuqinë për t'ju pastruar e shëruar. Ai mund t'ju heqë dhembjen e trishtimin që ndieni dhe mund t'ju bëjë sërish të pastër nëpërmjet fuqisë së Shlyerjes së Tij.

Ne si udhëheqës jemi gjithashtu shumë të shqetësuar për bashkëshortët dhe familjet e atyre që vuajnë nga varësia e pornografisë. Plaku Riçard G. Skot ka kërkuar: "Nëse ju vetë jeni të lirë nga një mëkat i rëndë, mos vuani në mënyrë të panevojshme pasojat e mëkateve të tjetrit. . . . Ju mund të ndieni dhembshuri. . . . Prapëseprapë, ju nuk duhet të merrni mbi vete ndjenjën e përgjegjësisë për ato veprime."³ Dijeni se nuk jeni vetëm. Ka ndihmë. Janë të disponueshme mbledhjet e shërimit nga varësia për bashkëshortët, përfshirë mbledhjet me telefon, të cilat u mundësojnë bashkëshortëve të telefonojnë në një mbledhje dhe të marrin pjesë nga vetë shtëpitë e tyre.

Vëllezër e motra, si i mbrojmë fëmijët dhe të rinjtë tanë? Filtrat janë mjete të dobishme, por filtri më i mirë në botë, i vetmi që përfundimisht do të funksionojë, është filtri i brendshëm vetjak që vjen nga një dëshmi e thellë dhe e qëndrueshme për dashurinë e Atit tonë Qiellor dhe sakrificën

shlyese të Shpëtimtarit tonë për secilin prej nesh.

Si i udhëheqim fëmijët tanë për t'u kthyer thellë në besim dhe për të pasur qasje ndaj Shlyerjes së Shpëtimtarit? Më pëlqen shumë deklarata e profetit Nefi në lidhje me atë që bëri populli i tij për t'i forcuar të rinjtë e kohës së tij: "Ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, [dhe] ne profetizojmë mbi Krishtin . . . që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t'i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre"⁴.

Si e bëjmë këtë në shtëpitë tona? Disa prej jush më kanë dëgjuar të flas se sa të turbulluar u ndiem unë dhe bashkëshorti im, Meli, si prindër të katër fëmijëve të vegjël. Ndërsa përballë me sfidat e të qenit prind dhe



përmbushjen e kërkesave të jetës, ne ishim të dëshpëruar për ndihmë. Ne u lutëm dhe u përgjëruam për të ditur se çfarë të bënim. Përgjigja që erdhi, ishte e qartë: "Nuk ka problem nëse shtëpia është rrëmujë e fëmijët janë ende me pizhamat e tyre dhe disa përgjegjësi lihen pa bërë. Gjërat e vetme që me të vërtetë kanë nevojë të përmbushen në shtëpi janë studimi i shkrimeve të shenja e lutja e përditshme dhe mbrëmja familjare e përjavshme."

Ne po përpiqeshim t'i bënim këto gjëra, por ato nuk kishin gjithmonë përparësi dhe, në mes të kaosit, ndonjëherë lireshin pas dore. Ne ndryshuam përqendrimin tonë dhe u përpoqëm të mos shqetësoheshim për gjërat më pak të rëndësishme. Përqendrimi ynë u bë të flisnim, gëzoheshim, predikonim dhe dëshmonim për Krishtin duke u përpjekur të luteshim çdo ditë e t'i studionim shkrimet e shenja dhe të kishim mbrëmje familjare të përjavshme.

Kohët e fundit një mikeshë më paralajmëroi: "Kur ti u kërkon motrave t'i lexojnë më shumë shkrimet e shenja dhe të luten më shumë, kjo i streson ato. Ato tashmë ndiejnë sikur kanë shumë [punë] për të bërë."

Vëllezër e motra, duke qenë se e di nga përvojat e mia vetjake dhe ato me bashkëshortin tim, unë duhet të dëshmoj për bekimet e studimit të përditshëm të shkrimeve të shenja e të lutjes dhe të mbrëmjes familjare të përjavshme. Këto janë pikërisht zakone që ndihmojnë në largimin e stresit, në dhënien e drejtimit në jetën tonë dhe shtimin e mbrojtjes për shtëpitë tona. Pastaj, nëse pornografia ose sfida të tjera i godasin familjet tona, ne mund t'i lutemi Zotit për ndihmë dhe të presim udhëheqje të madhe prej Shpirtit, duke e ditur se kemi bërë atë që Ati ynë na ka kërkuar të bëjmë.

Vëllezër e motra, nëse këto gjëra nuk janë zakon në shtëpitë tona, të gjithë ne mund të fillojmë tani. Nëse fëmijët tanë janë të rritur dhe nuk pranojnë të na bashkohen, ne mund të fillojmë nga vetja jonë. Ndërsa e bëjmë [këtë], ndikimi i Shpirtit do të fillojë t'i mbushë shtëpitë dhe jetën tonë dhe, me kalimin e kohës, fëmijët mund të reagojnë.

Mbani mend se Apostujt e gjallë kanë premtuar gjithashtu se, ndërsa i kërkojmë paraardhësit tanë dhe i përgatitim emrat e vetë familjes sonë për në tempull, ne do të mbrohemi tani dhe gjatë gjithë jetës sonë, ndërsa e mbajmë veten tonë të denjë për një rekomandim tempulli.⁵ Çfarë premtimesh!

Të rinj, merrni përgjegjësi për vetë mirëqenien tuaj shpirtërore. Fikeni celularin tuaj nëse është e nevojshme, këndoni një këngë Filloreje, lutuni për ndihmë, mendoni për një shkrim të shenjtë, largohuni nga një film, përfytyrojini Shpëtimtarin, merreni denjësisht sakramentin, studioni broshurën *Për Forcën e Rinisë*, jini një shembull për miqtë tuaj, besojini një prindi, shkoni të takoni peshkopin tuaj, kërkoni ndihmë dhe kërkoni këshillim profesional nëse është e nevojshme.

Çfarë dua që nipërit dhe mbesat e mia të dinë? Dua që ata dhe ju të dini se unë e di që Shpëtimtari jeton dhe na do. Ai e ka paguar çmimin për mëkatet tona por ne duhet të gjuhëzohemi përpara Atit tonë në Qiell, me përlulesi të thellë, duke rrefyer mëkatet tona dhe duke iu përgjyruar Atij për falje. Ne duhet të duam t'i ndryshojmë zemrat e dëshirat tona dhe të jemi mjaft të përlulur për të kërkuar ndihmën dhe faljen e atyre që mund të kemi lënduar ose braktisur.

E di se Jozef Smithi e pa Perëndinë, Atin tonë Qiellor dhe

Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Dëshmoj se ne kemi një profet të gjallë mbi tokë, Presidentin Tomas S. Monson. Dëshmoj gjithashtu se ne nuk do të udhëhiqemi kurrë në rrugë të gabuar nëse i vëmë veshin këshillës së profetit të Perëndisë. Dëshmoj për fuqinë e besëlidhjeve tona dhe të bekimeve të tempullit.

Unë e di se Libri i Mormonit është i vërtetë! Unë nuk mund ta shpjegoj fuqinë e këtij libri të mrekullueshëm. Unë vetëm e di se, i shoqëruar me lutjen, Libri i Mormonit mbart fuqinë për t'i mbrojtur familjet, për t'i forcuar marrëdhëniet dhe për të dhënë besim vetjak përpara Zotit. Unë dëshmoj për

këto gjëra, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. *Teachings of Presidents of the Church: Spencer W. Kimball* (2006), f. 199–200.
2. Shih Clay Olsen, "What Teens Wish Parents Knew" (fjalim dhënë në Konferencën e Koalicionit të Jutës Kundër Pornografisë, 22 mars, 2014); utahcoalition.org.
3. Richard G. Scott, "To Be Free of Heavy Burdens", *Liahona*, nëntor 2002, f. 88.
4. 2 Nefi 25:26.
5. Shih Dejvid A. Bednar, "Zemrat e Fëmijëve do të Kthehen", *Liahona*, nëntor 2011, f. 24–27; Riçard G. Skot, "Gëzimi i Shëlbimit të të Vdekurve", *Liahona*, nëntor 2012, f. 93–95; Nil L. Andersen, "Find Our Cousins!" (fjalim dhënë në RootsTech 2014 Family History Conference, 8 shkurt, 2014); lds.org/prophets-and-apostles/unto-all-the-world/find-our-cousins.





Nga Plaku Nil L. Andersen,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Vorbullat e Erërave Shpirtërore

Mos i lejoni vorbullat e erërave që t'ju tërheqin poshtë. Këto janë ditët tuaja – për të qëndruar të fortë, si dishepuj të Zotit Jezu Krisht.



Ju përshëndes këtë mëngjes – veçanërisht të rinjtë që janë këtu në Qendrën e Konferencave si dhe në mbarë botën. Ju jeni një brez i zgjedhur me një fat të veçantë dhe unë ju flas veçanërisht juve.

Shumë vite më parë, ndërsa po vizitonim familjen tonë në Florida, një tornado ra jo shumë larg prej nesh. Një grua që jetonte në një shtëpi të lëvizshme, u fut në banjë për të qenë e sigurt. Shtëpia filloi të dridhej. Pak çaste kaluan. Atëherë ajo dëgjoji zërin e fqinjit të saj: “Ndodhem këtu, në dhomën e ndenjes”. Duke dalë nga banja, për habinë e saj të madhe, ajo

zbuloi se tornadoja e kishte ngritur dhe mbartur në ajër shtëpinë e saj, duke e vendosur tërësisht drejt e mbi shtëpinë e lëvizshme të fqinjit të saj.

Miq të mi të rinj, bota nuk do të rrëshqasë me qetësi drejt Ardhjes së Dytë të Shpëtimtarit. Shkrimet e shenjata shpallin se “gjithë gjërat do të jenë në rrëmuje”¹. Brigam Jangu tha: “Mua m’u zbulua në fillimin e kësaj Kishe, që Kisha do të përhapej, përparonte, rritej e zgjerohej dhe në përpjesëtim të drejtë me shpërndarjen e Ungjillit mes kombeve të tokës, po ashtu do të rritej fuqia e Satanit”².

Më shqetësuese se tërmetet dhe luftërat e profetizuara³, janë vorbullat e erërave shpirtërore, të cilat mund t’ua shkulin nga rrënjët themelet tuaja shpirtërore dhe mund ta vendosin shpirtin tuaj në vende që asnjëherë nuk i përfytyruat të mundura, nganjëherë duke mos e vënë re fare se jeni lëvizur.

Vorbullat më të këqija janë tundimet e kundërshtarit. Mëkati gjithmonë

Pemët që rriten në një mjedis plot erë, bëhen më të forta.

ka qenë pjesë e botës, por kurrë nuk ka qenë kaq i arritshëm, i pangopshëm dhe i pranueshëm. Gjendet, sigurisht, një forcë e fuqishme që do t’i mposhtë vorbullat e mëkatit. Ajo quhet pendim.

Jo të gjitha vorbullat në jetë shkaktohen nga veprimet tuaja. Disa vijnë për shkak të zgjedhjeve të gabuara të të tjerëve dhe disa vijnë thjesht ngaqë jetojmë në vdekshmëri.

Kur ishte djalë i ri, Presidenti Bojd K. Paker vuajti nga sëmundja gjymtuese e poliomielitit. Kur Plaku Dallin H. Ouks ishte shtatë vjeç, babai i tij vdiq papritur. Kur Motra Karol F. Mek-Konki, e presidencës së përgjithshme të Të Rejave, ishte adoleshente, prindërit e saj u divorcuan. Sfidat do t’ju vijnë juve, por kur mirëbesoni te Perëndia, ato do ta forcojnë besimin tuaj.

Në natyrë, pemët që rriten në një mjedis plot erë, bëhen më të forta. Teksa erërat fshikullojnë përreth një fidani të njomë, forcat brenda pemës bëjnë dy gjëra. Së pari, ato i nxitin rrënjët që të rriten më shpejt dhe të shpërndahen më larg. Së dyti, forcat brenda në pemë fillojnë të krijojnë struktura qelizore që në fakt i bëjnë trungun dhe degët më të trasha e më



elastike ndaj trysnisë së erës. Këto rrënjë dhe degë më të forta e mbrojnë pemën nga erërat që patjetër do të kthehen.⁴

Ju jeni pafundësisht më të çmuar për Perëndinë sesa një pemë. Ju jeni biri i Tij ose bija e Tij. Ai e bëri shpirtin tuaj të fortë dhe të aftë për të qenë i patundur kundrejt vorbullave të jetës. Vorbullat e erës në rininë tuaj, sikurse era kundrejt një peme të njomë, mund ta rritin forcën tuaj shpirtërore, duke ju përgatitur për vitet e ardhshme.

Si do të përgatiteni për vorbullat tuaja të erës? “Mbani mend . . . është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj; që kur djalli të çojë erërat e tij të fuqishme, . . . shigjetat e tij në shtjellë të erës, . . . kur i gjithë breshëri i tij dhe furtuna e tij e fuqishme do të lëshohen mbi ju, nuk do të ketë fuqi . . . t’ju tërheqë . . . për shkak të shkëmbit mbi të cilin jeni ndërtuar.”⁵ Kjo është siguria juaj në vorbullën e erës.

Presidenti Tomas S. Monson ka thënë: “[Atje ku] dikur standardet e Kishës dhe standardet e shoqërisë përgjithësisht përputheshin, tani ka një ndryshim të madh midis nesh dhe ai po rritet gjithnjë e më shumë”⁶. Ky ndryshim, për disa njerëz, trazon vorbulla të forta shpirtërore. Më lejoni të jap një shembull.

Muajin që shkoi, Presidenca e Parë dhe Kuorumi i Të Dymbëdhjetëve botuan një letër për udhëheqësit e Kishës në mbarë botën. Pjesërisht ajo thoshte: “Ndryshimet në ligjin civil nuk e ndryshojnë, në të vërtetë nuk mund ta ndryshojnë, ligjin moral që Perëndia ka themeluar. Perëndia pret nga ne që t’i mbajmë të pandryshuara dhe t’i zbatojmë urdhërimet e Tij, pavarësisht nga mendimet ose prirjet e ndryshme në shoqëri. Ligji i Tij për dëlirësinë është i qartë: marrëdhëniet seksuale



janë të përshtatshme vetëm midis një burri dhe një gruaje që janë zyrtarisht dhe ligjërisht të martuar si bashkëshort e bashkëshorte. Ne ju nxitim të rishikoni . . . doktrinën që përmbahet në ‘Familja: Një Proklamatë drejtuar Botës’.”⁷

Ndërsa bota rrëshqet larg prej ligjit të Zotit për dëlirësinë, ne nuk rrëshqasim. Presidenti Monson tha: “Shpëtimtari i njerëzimit e përshkroi veten që ishte në botë, por jo prej bote. Ne, gjithashtu, mund të jemi në botë, por jo prej bote kur kundërshtojmë konceptet false dhe mësimet false dhe qëndrojmë të vërtetë në atë që Perëndia ka urdhëruar.”⁸

Ndërkohë që shumë qeveri dhe njerëz me qëllime të mira e kanë ripërcaktuar martesën, Zoti nuk e ka ripërcaktuar. Që nga fillimi fare, Perëndia e përcaktoi martesën midis një burri dhe një gruaje – Adamit dhe Evës. Ai i përcaktoi qëllimet e martesës që të shtrihen përtej kënaqësisë dhe arritjes vetjake të të rriturve dhe, më e rëndësishme, duke përparuar drejt një vendndodhjeje ideale ku fëmijët të lindin, rriten dhe ushqehen shpirtërisht. Familjet janë thesari i qiellit.⁹

Përse mendoni se vazhdojmë të flasim për këtë? Sikurse tha Pali: “Ne nuk i drejtojmë sytë ndaj gjërave që duken, por ndaj gjërave që nuk shihen”¹⁰. Si Apostujt të Zotit Jezu Krisht, ne kemi përgjegjësinë të japim mësim planin e Krijuesit tonë për fëmijët e Tij dhe të paralajmërojmë për pasojat e shpërfilljes së urdhërimeve të Tij.

Kohët e fundit fola me një vajzë të Dafinave nga Shtetet e Bashkuara. Po citoj nga mesazhi i saj elektronik:

“Vitin që shkoi, disa shokë dhe shoqe të mia në Facebook filluan të shkruanin qëndrimin e tyre lidhur me martesën. Shumë mbanin anën e martesës midis njerëzve të së njëjtës gjini dhe disa të rinj SHDM shënuan se i ‘pëlqenin’ ato diskutime. Unë nuk bëra asnjë koment.


Vendosa ta shpreh bindjen time lidhur me martesën tradicionale në një mënyrë të kujdesshme.

Te fotografia e profilit tim, shtova fjalët: ‘Unë besoj në martesën midis një burri dhe një gruaje’. Pothuajse menjëherë fillova të marr mesazhe. ‘Je egoiste’. ‘Ke paragjykime’. Dikush më krahasoi me një pronare skllëvërisht. Dhe mora këtë shënim nga një shoqe e ngushtë, e cila është anëtare e fortë e Kishës: ‘Ke nevojë që të arrish te mendimet e kohës. Gjërat po ndryshojnë dhe duhet të ndryshosh edhe ti.’

“Unë nuk kundërveprova”, tha ajo, “por nuk e hoqa deklarinimin tim”.

Ajo përfundon: “Nganjëherë, siç tha Presidenti Monson: ‘Duhet të qëndroni vetëm’. Shpresoj se si të rinj, ne vërtet do të qëndrojmë së bashku për të qenë të vërtetë ndaj Perëndisë e ndaj mësimëve të profetëve të Tij të gjallë.”¹¹

Me shumë shqetësim për ne duhet të jenë ata që po ndeshen me tërheqjen fizike ndaj së njëjtës gjini. Kjo është një vorbull me një shpejtësi të



Pasi shpalli besimin e saj në martesën tradicionale, një Dafinë mori disa mesazhe negative nga miqtë.

jashtëzakonshme. Dua të shpreh dashurinë dhe admirimin tim për ata që po ndeshen plot kurajë me këtë sprovë të besimit dhe po qëndrojnë të vërtetë ndaj urdhërimeve të Perëndisë!¹² Por çdokush, pavarësisht nga vendimet dhe bindjet e tij ose të saj, meriton mirësinë dhe vëmendjen tonë.¹³

Shpëtimtari na mësoi të duam jo vetëm miqtë tanë, por edhe ata që nuk janë dakord me ne – dhe madje ata që na hedhin poshtë. Ai tha: “Sepse, po të doni vetëm ata që ju duan, çfarë shpërblimi do të keni? . . . Dhe nëse përshëndetni vetëm vëllezërit tuaj, çfarë bëni të veçantë?”¹⁴

Profeti Jozef Smith na paralajmëroi të “[ruhemi] prej vetëkënaqjes” dhe ta zmadhojmë zemrën kundrejt gjithë burrave dhe grave derisa të ndiejmë se “i marrim ata mbi supet tanë”¹⁵. Në ungjillin e Jezu Krishtit nuk ka vend për tallje, kërcënim apo fanatizëm.

Nëse keni një pyetje lidhur me këshillën nga udhëheqësit e Kishës, ju lutemi t’i diskutoni shqetësimet tuaja me ndershmëri me prindërit dhe udhëheqësit tuaj. Ju keni nevojë për forcën që vjen nga mirëbesimi i profetëve të Zotit. Presidenti Harold B. Li tha: “E vetmja siguri që ne kemi si anëtarë të kësaj kishe, është të . . .

mësojmë t’u vëmë veshin fjalëve dhe urdhërimeve që Zoti do të japë përmes profetit të Tij. . . . Do të ketë disa gjëra që kërkojnë durim dhe besim. Ju mund të mos e pëlqeni atë që vjen. . . . Mund të kundërshtojë pikëpamjet tuaja politike . . . pikëpamjet tuaja shoqërore . . . mund të ndërhyjë në . . . jetën tuaj shoqërore. Por nëse ua vini veshin këtyre gjërave, si nga goja e Vetë Zotit, . . . ‘portat e ferrit nuk do të hapen kundër jush . . . dhe Zoti Perëndi do t’i shpërndajë fuqitë e errësirës përpara jush . . .’ (DeB 21:6).¹⁶

Një tjetër mbrojtje e fuqishme nga vorbullat e jetës është Libri i Mormonit.

Kur Presidenti Henri B. Ajring ishte adoleshent, familja e tij lëvizoi në një qytet të ri. Fillimisht ai e mendoi lëvizjen të pakëndshme dhe bëri pak miq. Ai ndjeu se nuk përshtatej me studentët në shkollën e tij të mesme. Vorbullat po e rrethonin. Çfarë bëri ai? E drejtoi energjinë e tij te Libri i Mormonit, duke e lexuar shumë herë.¹⁷ Vite më vonë, Presidenti Ajring dëshmoi: “Më [pëlqen të] kthehem te Libri i Mormonit dhe të ushqehem thellësisht

dhe shpesh”¹⁸. “[Ai] është dëshmia më e fuqishme, e shkruar që kemi, se Jezusi është Krishti.”¹⁹

Zoti ju ka dhënë një mënyrë tjetër për të qëndruar të patundur, një dhuratë shpirtërore më të fuqishme sesa vorbullat e erërave të kundërshtarit! Ai tha: “Qëndroni . . . në vende të shenjta dhe mos lëvizni”²⁰.

Kur unë isha adoleshent, kishte vetëm 13 tempuj në Kishë. Tani ka 142. Tetëdhjetë e pesë përqind e anëtarëve të Kishës jetojnë brenda një largësie prej 320 km nga një tempull. Zoti i ka dhënë brezit tuaj një mundësi më të madhe për të hyrë në tempujt e Tij të shenjtë, sesa ndonjë brezi tjetër në historinë e botës.

A keni qëndruar ndonjëherë në tempull, të veshur në të bardha, duke pritur që të bëni pagëzime? Si u ndiet? Ka një ndjenjë të fuqishme shenjtërie në tempull. Paqja e Shpëtimtarit i nënshton vorbullat rrethuese të botës.

Mënyra se si ndiheni në tempull është një model për mënyrën si dëshironi të ndiheni në jetën tuaj.²¹

Gjejini gjyshërit e gjyshet tuaja dhe kushërinjtë tuaj të largët, të cilët jetuan përpara jush. Merrini me vete





emrat e tyre në tempull.²² Kur mësoni për paraardhësit tuaj, ju do të shihni modele të jetës, të martesës, të fëmijëve; modele të drejtësisë; dhe me raste, modele që ju do të dëshironi t'i shmangni.²³

Më vonë në tempull ju do të mësoni më shumë rreth Krijimit të botës, rreth modeleve në jetën e Adamit dhe të Evës dhe, më e rëndësishmja, rreth Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

Vëllezërit dhe motrat e mia të reja, sa shumë ju duam, ju admirojmë dhe lutemi për ju. Mos i lejoni vorbullat e erërave që t'ju tërheqin poshtë. Këto janë ditët tuaja – për të qëndruar të fortë, si dishepuj të Zotit Jezu Krishtit.²⁴

Ndërtojeni themelin tuaj më vendosmërisht mbi shkëmbin e Shëlbuesit tuaj.

Çmojini më plotësisht jetën dhe mësimet e Tij të pakrahasueshme.

Ndiqini më zellshmërisht shembullin e Tij dhe urdhërimet e Tij.

Përqafojini më thellësisht dashurinë e Tij, mëshirën dhe hirin e Tij dhe dhuratat e fuqishme të Shlyerjes së Tij.

Ndërsa i bëni këto, unë ju premtoj se ju do t'i shihni vorbullat për çfarë janë në të vërtetë – prova, tundime, shpërqendrimet ose sfida që ju

ndihmojnë të rriteni. Dhe ndërsa jetoni me drejtësi vit pas viti, ju siguroj se përvojat tuaja do t'ju pohojnë herë pas here se Jezusi është Krishti. Shkëmbi shpirtëror nën këmbët tuaja do të jetë i fortë dhe i sigurt. Ju do të ngazëllehëni që Perëndia ju ka vendosur këtu që të jeni pjesë e përgatitjeve përfundimtare për kthimin e lavdishëm të Krishtit.

Shpëtimtari tha: “Nuk do t'ju lë bonjakë, do të kthehem te ju”²⁵. Ky është premtimi i Tij për ju. Unë e di se ky premtim është i vërtetë. Unë e di se Ai jeton, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 88:91.
2. *Discourses of Brigham Young*, përzgji. John A. Widtsoe (1954), f. 72.
3. Shih Dallin H. Oaks, “Preparation for the Second Coming”, *Liahona*, maj 2004, f. 7–10.
4. Shih A. Stokes, A. H. Fitter dhe M. P. Coultts, “Responses of Young Trees to Wind and Shading: Effects on Root Architecture”, *Journal of Experimental Botany*, vëll. 46, nr. 290 (shtator 1995), f. 1139–1146.
5. Helamani 5:12.
6. Tomas S. Monson, “Fuqia e Priftërisë”, *Liahona*, maj 2011, f. 66.
7. Letër e Presidencës së Parë, 6 mars 2014; shih edhe Dejvid A. Bednar, “Ne Besojmë në Qenien të Dëlirë”, *Liahona*, maj 2013, f. 41–44; Dallin H. Oaks, “Nuk do të Kesh Perëndi të Tjerë”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 72–75; *Për Forcën e Rinisë* (broshurë, 2011), f. 35–37.

8. Tomas S. Monson, “Fuqia e Priftërisë”, *Liahona*, maj 2011, f. 67.
9. Plaku Rasëll M. Nelson tha: “Martesa është farkëtuesi i rendit shoqëror. . . . Ai bashkim nuk është thjesht midis bashkëshortit dhe bashkëshortes; ai përfshin një bashkëpjesëmarrje me Perëndinë” (“Nurturing Marriage”, *Liahona*, maj 2006, f. 36). Shih edhe Mateu 19:5–6.
10. 2 Korintasve 4:18.
11. Letërkëmbim dhe bashkëbisedim vetjak, 17 mars 2014; shih edhe Tomas S. Monson, “Kini Guxim të Qëndroni Vetëm”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 60–67.
12. Shih Jeffrey R. Holland, “Helping Those Who Struggle with Same-Gender Attraction”, *Liahona*, tetor 2007, f. 40–43.
13. Edhe kur antikrishti Korihor kërkoi që ta shkatërronte besimin e njerëzve, ligjet e Perëndisë e mbrojtën atë kundrejt ndëshkimit: “Tani, nuk kishte ndonjë ligj kundër besimit të një njeriu; pasi ishte rreptësisht në kundërshtim me urdhërimet e Perëndisë, që të kishte një ligj i cili do t'i sillte njerëzit në një gjendje pabarazie. . . . Në qoftë se një njeri dëshironte t'i shërbente Perëndisë, ishte privilegji i tij; . . . por në qoftë se nuk besonte në të, nuk kishte ndonjë ligj për ta ndëshkuar” (Alma 30:7, 9). Neni i njëmbëdhjetë i besimit thotë: “Ne shpallim privilegjin e adhurimit të Perëndisë së Plotfuqishëm në përputhje me zërin e ndërgjegjes sonë dhe u lejojmë të gjithë njerëzve të njëjtin privilegj, që ata duhet të adhurojnë si, ku dhe çfarë të zgjedhin”.
14. Mateu 5:46–47.
15. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 456, 457.
16. *Teachings of Presidents of the Church: Harold B. Lee* (2000), f. 84–85; shih edhe Robert D. Hejls, “Konferenca e Përgjithshme: Forcimi i Besimit dhe i Dëshmisë”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 6–8.
17. Shih Robert I. Eaton dhe Henry J. Eyring, *I Will Lead You Along: The Life of Henry B. Eyring* (2013), f. 40.
18. Henry B. Eyring, *Choose Higher Ground* (2013), f. 38.
19. Henry B. Eyring, *To Draw Closer to God* (1997), f. 118.
20. Doktrina e Besëlidhje 87:8; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 45:32.
21. Shih Doktrina e Besëlidhje 52:14.
22. Shih Neil L. Andersen, “Find Our Cousins!” (fjalim i mbajtur në RootsTech 2014 Family History Conference, 8 shkurt 2014); lds.org/prophets-and-apostles/unto-all-the-world/find-our-cousins.
23. Shih Dejvid A. Bednar, “Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 24–27.
24. Shih Helamani 7:9.
25. Gjoni 14:18.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Një Trashëgimi e Paçmueshme e Shpresës

Kur zgjidhni nëse do ta bëni apo mbani një besëlidhje me Perëndinë, ju zgjidhni nëse do t'iu lini një trashëgimi shprese atyre që mund të ndjekin shembullin tuaj.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, disa prej jush u ftuan në këtë mbledhje nga misionarët e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Ata misionarë mund t'ju kenë ftuar tashmë të bëni zgjedhjen e bërjes së besëlidhjes me Perëndinë duke u pagëzuar.

Të tjerë prej jush po dëgjojnë, sepse pranuan ftesën e një prindi, një bashkëshorteje apo ndoshta të një fëmije, të bërë ndaj jush me shpresën se do të zgjidhni t'i vendosni besëlidhjet, që i keni bërë tashmë me Perëndinë, sërish në qendër të jetës suaj. Disa prej jush që po dëgjojnë, e kanë bërë tashmë zgjedhjen për t'u kthyer te Shpëtimtari dhe po ndiejnë sot gëzimin e mikpritjes së Tij.

Kushdo që jeni dhe kudo qofshi, ju mbani në duart tuaja lumturinë e më tepër njerëzve nga sa mund të përfytyroni tani. Çdo ditë dhe çdo orë, ju mund të zgjidhni të bëni ose të mbani një besëlidhje me Perëndinë.

Kudo që jeni në shtegun e trashëgimit të dhuratës së jetës së përjetshme,

ju keni mundësinë për t'u treguar shumë njerëzve udhën për te një lumturi më e madhe. Kur zgjidhni nëse do ta bëni apo mbani një besëlidhje me Perëndinë, ju zgjidhni nëse do t'iu lini një trashëgimi shprese atyre që mund të ndjekin shembullin tuaj.

Ju dhe unë, jemi bekuar me premtimin e një trashëgimie të tillë. Për një pjesë të madhe të lumturisë sime në jetë, i detyrohem një burri që nuk e takova kurrë në jetën në vdekshmëri. Ai ishte një jetim që u bë një prej stërgjyshërve të mi. Ai më la një trashëgimi të paçmueshme shprese. Më lini t'ju tregoj pak për rolin që ai luajti në krijimin e asaj trashëgimie për mua.

Ai quhej Hainrih Ajring. Ai u lind në familje shumë të kamur. I ati, Eduardi, kishte një pronë të madhe në Koburg, në atë që sot është Gjermania. E ëma ishte Dukësja Sharlot Von Blomberg. Babai i saj ishte kujdestari i tokave të mbretit të Prusisë.

Hainrihu ishte djali i parë i Sharlotës dhe Eduardit. Sharlota vdiq në

moshën 31-vjeçare, pas lindjes së fëmijës së saj të tretë. Eduardi vdiq pak kohë pas kësaj, pasi i kishte humbur të gjitha pronat dhe pasurinë në një investim të dështuar. Ishte vetëm 40 vjeç. Ai la tre fëmijë jetimë.

Hainrihu, stërgjyshi im, i humbi që të dy prindërit e tij dhe një trashëgimi të madhe tokësore. Ai mbeti pa asnjë kacidhe. Ai shënoi në historinë e tij se ndjeu që shpresa e tij më e mirë qëndronte tek të shkuarit në Amerikë. Edhe pse nuk kishte as familje as miq atje, ai kishte një ndjenjë shprese rreth të shkuarit në Amerikë. Në fillim, ai shkoi në qytetin e Nju-Jorkut. Më vonë ai u shpërngul në Seint-Luis në Misuri.

Në Seint-Luis, një prej bashkëpunëtorëve të tij, ishte shenjtor i ditëve të mëvonshme. Prej tij, ai mori një kopje të broshurës së shkruar nga Plaku Parli P. Prat. E lexoi atë dhe më pas studioi çdo fjalë që mund të siguronte rreth shenjtorëve të ditëve të mëvonshme. Ai u lut për ta ditur nëse kishte vërtet engjëj që iu shfaqën njerëzve, nëse kishte një profet të gjallë dhe nëse e kishte gjetur ai një fe të vërtetë e të dhënë nëpërmjet zbulësës.

Pas dy muajsh studimi e lutjeje të kujdesshme, Hainrihu pa një ëndërr në të cilën iu tha të pagëzohej. Një burrë, emrin dhe priftërinë e të cilit e ruaj si kujtim të shenjtë, Plaku Uilliam Braun, do ta kryente ordinancën. Hainrihu u pagëzua në një pellg me ujë shiu, më 11 mars të vitit 1855, në orën 7:30 të mëngjesit.

Unë besoj se Hainrih Ajringu e dinte atëherë se ajo që unë po ju mësoj sot, është e vërtetë. Ai e dinte se lumturia e jetës së përjetshme vjen nëpërmjet lidhjeve familjare që vazhdojnë përgjithmonë. Edhe pse e kishte gjetur jo prej shumë kohësh planin e Zotit për lumturinë, ai e dinte se shpresa e tij për gëzim të përjetshëm varej nga zgjedhjet e lira të të tjerëve



për ta ndjekur shembullin e tij. Shpresa e tij për lumturi të përjetshme varej nga njerëz që ende nuk ishin lindur.

Si pjesë e trashëgimisë së familjes sonë për shpresën, ai la një histori për pasardhësit e tij.

Në atë histori, unë mund ta ndiej dashurinë e tij për ata prej nesh që do ta ndiqnin atë. Në fjalët e tij, unë e ndiej shpresën që pasardhësit e tij mund të zgjedhin ta ndjekin atë në shtegun e kthimit për te shtëpia jonë qiellore. Ai e dinte se nuk do të ishte për t'u bërë një zgjedhje e vetme dhe e madhe që të arrihej kjo, por shumë zgjedhje të vogla. Citoj nga kjo histori:

“Që nga koha që e dëgjova për herë të parë Plakun Endrjus të fliste . . . e kam ndjekur gjithnjë mbledhjen e shenjtoreve të ditëve të mëvonshme dhe rastet janë vërtet shumë të rralla, kur nuk kam arritur të shkoj në mbledhje, duke qenë në të

njëjtën kohë detyra ime t'i ndjek këto mbledhje.

E përmend këtë në historinë time që fëmijët e mi të mund ta imitojnë shembullin tim e të mos e shpërfillin kurrë këtë . . . detyrë të rëndësishme për t'u mbledhur me shenjtoret.”¹

Hainrihu e dinte se, në mbledhjet e sakramentit, ne mund ta përtërinim premtimin tonë për ta kujtuar gjithmonë Shpëtimtarin dhe për ta pasur gjithmonë Shpirtin e Tij me ne.

Ishte ai Shpirt që e përkrahu atë në misionin në të cilin u thirr, vetëm pak muaj pasi pranoi besëlidhjen e tij të pagëzimit. Ai la si trashëgimi shembullin e tij të të qëndruarit besnik në misionin e tij për gjashtë vjet në ato që atëherë quheshin Territorët Indiane. Për të marrë lirinë e tij nga misioni, ai eci dhe hipi në një karavan karrocash nga Oklahoma për në Solt-Lejk-Siti, në një largësi prej afërsisht 1.770 km.

Shpejt pas kësaj, u thirr nga profeti i Perëndisë për t'u shpërngulur në Jutën jugore. Nga aty, iu përgjigj një thirrjeje tjetër për të shërbyer një mision në vendlindjen e tij, në Gjermani. Më pas, ai pranoi ftesën e një Apostulli të Zotit Jezu Krisht për të ndihmuar në ndërtimin e kolonive të shenjtoreve të ditëve të mëvonshme në Meksikën veriore. Prej andej, u thirr në Meksiko-Siti si një misionar kohëplotë. Ai i kreu me nder ato thirrje. Ai dergjet i varrosur në një varrezë të vogël në Kolonia Huarez, në Çiuaua të Meksikës.

I radhit këto fakte, jo për të shpallur madhështi për të ose për atë që ai bëri, apo për pasardhësit e tij. I radhit ato fakte për ta nderuar atë për shembullin e besimit e të shpresës që ishte në zemrën e tij.

Ai i pranoi ato thirrje për shkak të besimit të tij se Krishti i ringjallur dhe Ati ynë Qiellor i ishin shfaqur Jozef Smithit në një korije pemësh në shtetin e Nju-Jorkut. Ai i pranoi ato, sepse kishte besim se çelësat e priftërisë në Kishën e Zotit ishin rivendosur me fuqinë për t'i vulosur familjet përgjithmonë, vetëm nëse ato do të kishin besim të mjaftueshëm për t'i mbajtur besëlidhjet e tyre.

Sikurse Hainrih Ajringu, paraardhësi im, ju mund të jeni i pari në familjen tuaj që hapni udhën drejt jetës së përjetshme, përgjatë shtegut të besëlidhjeve të shenjta, të bëra e të mbajtura me zell e besim. Çdo besëlidhje sjell me vete detyra dhe premtime. Për të gjithë ne, sikurse ishin për Hainrihun, ato detyra janë ndonjëherë të thjeshta, por shpesh janë të vështira. Por kujtoni, detyrat duhet të jenë të vështira ndonjëherë, sepse qëllimi i tyre është që të na lëvizin përgjatë shtegut për të jetuar përgjithmonë me Atin Qiellor dhe Birin e Tij të Dashur, Jezu Krishtin, në familje.

Ju i mbani mend fjalët nga libri i Abrahamit:

“Dhe atje qëndroi një mes tyre, që ishte sikurse Perëndia, dhe ai u tha atyre që ishin me të: Ne do të zbre- sim, sepse ka hapësirë atje, dhe do të marrim prej këtyre materialeve ne do të bëjmë një tokë në të cilën këta të mund të banojnë;

Dhe ne do t'i provojmë me këtë, për të parë nëse ata do t'i bëjnë të gjitha gjërat që Zoti, Perëndia i tyre, do t'i urdhërojë;

Dhe ata që e ruajnë gjendjen e parë, atyre do t'u shtohet; dhe ata që nuk e ruajnë gjendjen e parë, nuk do të kenë lavdi në të njëjtën mbretëri me ata që e ruajnë gjendjen e tyre të parë; dhe ata që e ruajnë gjendjen e tyre të dytë, do të kenë lavdi të shtuar mbi kokat e tyre përherë e përgjithmonë.”²

Ruajtja e gjendjes sonë të dytë, varet nga bërja e besëlidhjeve prej nesh me Perëndinë dhe kryerja me besnikëri e detyrave që ato kërkojnë prej nesh. Duhet besim te Jezu Krishti si Shpëtimtari ynë për t'i mbajtur besë- lidhjet e shenjta për tërë jetën.

Për shkak se Adami dhe Eva ranë, ne kemi tundim, sprova dhe vdekje si trashëgiminë tonë të përgjithshme. Megjithatë, Ati ynë i dashur Qiellor, na dha dhuratën e Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit, si Shpëtimtarin tonë. Ajo dhuratë e madhe dhe bekimi i Shlyer- jes së Jezu Krishtit sjell një trashëgimi të përgjithshme: premtimin e Ringjall- jes dhe mundësinë për jetë të përjet- shme për të gjithë ata që janë lindur.

Më i madhi i të gjitha bekimeve të Perëndisë, jeta e përjetshme, do të na vijë vetëm kur ne bëjmë besëlidhjet e ofruara në Kishën e vërtetë të Jezu Krishtit me anë të shërbëtorëve të Tij të autorizuar. Për shkak të Rënies, ne të gjithë kemi nevojë për efektet pastruese të pagëzimit dhe të vënies së duarve për të marrë dhuratën e Frymës së Shenjtë. Këto ordianca duhet të kryhen nga ata që zotërojnë

autoritetin e duhur të priftërisë. Më pas, me ndihmën e Dritës së Krishtit dhe të Frymës së Shenjtë, ne mund t'i mbajmë të gjitha besëlidhjet që bëjmë me Perëndinë, veçanërisht ato të ofruara në tempujt e Tij. Vetëm në atë mënyrë dhe me atë ndihmë, mundet dikush ta shpallë trashëgiminë e vet, që i përket si fëmijë i Perëndisë, në një familje përgjithmonë.

Disave që po më dëgjojnë, kjo mund t'iu duket thujse një ëndërr e pashpresë.

Ju keni parë prindër besnikë të pikëllohen prej fëmijëve që nuk i kanë pranuar besëlidhjet e tyre me Perëndinë ose që kanë zgjedhur t'i thyejnë ato. Por, ata prindër, mund të marrin zemër e shpresë nga përvoja të tjera prindërore.

Bijtë e Almës dhe të mbretit Mosia u kthyen nga rebelimi i ashpër kundër besëlidhjeve dhe urdhërimeve të Pe- rëndisë. Alma i Riu e pa të birin, Kori- antonin, të kthehej nga mëkati i rëndë në shërbimin besnik. Libri i Mormonit shënon edhe mrekullinë e lamanitëve që e lanë mënjanë traditën e të urryer- rit të drejtësisë për të bërë besëlidhjen që të vdisnin për të ruajtur paqen.

Një engjëll iu dërgua Alma të riut dhe bijve të Mosias. Engjëlli erdhi për shkak të besimit dhe lutjeve të etërve të tyre dhe të popullit të Perëndisë. Nga ata shembuj të fuqisë së Shlyer- jes që vepron në zemrat njerëzore, ju mund të merrni kurajë e ngushëllim.

Zoti na e ka dhënë ne të gjithëve burimin e shpresës teksa mundohemi t'i ndihmojmë ata që i duam, që ta pranojnë trashëgiminë e tyre të përjet- shme. Ai na ka bërë premtime teksa vazhdojmë të përpiqemi t'i mbledhim njerëzit tek Ai, edhe kur ata e kundër- shtojnë ftesën e Tij për ta bërë këtë. Kundërshtimi i tyre e trishton Atë, por Ai nuk heq dorë, as ne nuk duhet ta bëjmë. Ai jep shembullin e përkryer

për ne me dashurinë e Tij ngulmu- ese: “Dhe përsëri, sa herë do t'ju kisha mbledhur sikurse një kllaçkë mbledh zogjtë e saj nën krahët e saj, po, O ju njerëz të shtëpisë së Izraelit që keni rënë; po, O ju njerëz të shtëpisë së Izraelit, ju që banoni në Jeruzalem, sikurse dhe ju që keni rënë; po, sa herë do t'ju kisha mbledhur sikurse një kllaçkë mbledh zogjtë e saj, por ju nuk keni dashur”³.

Ne mund të mbështetemi tek ajo dëshirë e padështueshme e Shpë- timtarit për t'i kthyer të gjithë fëmijët shpirtërorë të Atit Qiellor në shtëpinë e tyre me Të. Çdo prind, gjysh dhe stërgjysh besnik e kanë të përbashkët atë dëshirë. Ati Qiellor dhe Shpëtim- tari janë shembujt tanë të përkryer të asaj që ne mund dhe duhet të bëjmë. Ata nuk e imponojnë kurrë drejtësinë, sepse drejtësia duhet të zgjidhet. Ata e bëjnë drejtësinë të dallueshme për ne dhe na lënë të shohim se frytet e saj janë të këndshme.

Çdo njeri i lindur në botë e merr Dritën e Krishtit, e cila na ndihmon të shohim e të ndiejmë se çfarë është e drejtë dhe çfarë është e gabuar. Perëndia ka dërguar shërbëtorë të vdekshëm, të cilët, me anë të Frymës së Shenjtë, na ndihmojnë ta njohim atë që Ai do të dëshironte të bënim dhe atë që Ai e ndalon. Perëndia e bën tërheqëse zgjedhjen e së drejtës duke na lënë t'i ndiejmë pasojat e zgjedhje- ve tona. Nëse zgjedhim të drejtën, ne vërtet do të gjejmë lumturi – përfun- dimisht. Nëse zgjedhim të ligën, vjen pikëllim e brengosje – përfundimisht. Ato pasoja janë të sigurta. Prapëse- prapë, ato shpesh vonohen për një qëllim. Nëse bekimet do të ishin të menjëhershme, zgjedhja e së drejtës nuk do të krijonte besim. Dhe duke qenë se, edhe pikëllimi ndonjëhe- rë vonohet shumë, duhet besim që ta ndiejmë nevojën për të kërkuar

falje për mëkatin herët, në vend që ta bëjmë pasi t'i ndiejmë pasojat e tij pikëlluese e të dhembshme.

Baba Lehi u pikëllua për zgjedhjet e bëra nga disa prej bijve të tij dhe familjet e tyre. Ai ishte një njeri i shkëlqyer dhe i mirë – një profet i Perëndisë. Ai u dëshmoi shpesh atyre për Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Ai ishte një shembull bindjeje dhe shërbimi kur Zoti e thirri që t'i linte të gjitha zotërimet e tij tokësore për ta shpëtuar familjen e tij nga shkatërrimi. Pikërisht në fundin e jetës së tij, ai ende po u dëshmonte fëmijëve të tij. Ashtu si Shpëtimtari – dhe pavarësisht fuqisë së tij për t'i njohur zemrat e tyre dhe për ta parë të ardhmen, si atë të trishtuar edhe atë të mrekullueshme – Lehi vazhdoi të priste krahëhapur për ta çuar familjen e tij drejt shpëtimit.

Sot, miliona pasardhës të Baba Lehit po e përligjin shpresën e tij për ta.

Çfarë mund të bëjmë ju dhe unë për të mësuar nga shembulli i Lehit? Ne mund të mësojmë nga shembulli i tij duke i studiuar shkrimet e shenjta me lutje dhe me anë të vrojtimit.

Ju sugjeroj që të mendoni me këndvështrim afatshkurtër dhe afatgjatë teksa përpiqeni t'ia jepni trashëgiminë e shpresës familjes suaj. Në këndvështrimin afatshkurtër, do të ketë shqetësime dhe Satani do të ulërijë. Dhe ka gjëra për të cilat duhet pritur me durim, me besim, duke e ditur se Zoti vepron në kohën e Vet dhe në mënyrën e Vet.

Ka disa gjëra që mund t'i bëni që herët, kur ata që doni janë të vegjël. Kujtoni se lutja e përditshme familjare, studimi i shkrimeve të shenjta si familje dhe dhënia e dëshmisë sonë në mbledhjen e sakramentit janë më të lehta dhe më të efektshme kur fëmijët janë të vegjël. Fëmijët e vegjël shpesh, janë më të ndjeshëm ndaj Shpirtit nga sa e kuptojmë ne.



Kur të jenë më të rritur, ata do t'i mbajnë mend himnet që kënduan me ju. Madje, më tepër se të kujtojnë muzikën, ata do të mbajnë mend fjalët e shkrimeve të shenjta dhe të dëshmisë. Fryma e Shenjtë mund t'i sjellë të gjitha gjërat në kujtesën e tyre, por fjalët e shkrimeve të shenjta dhe të himneve do t'iu kujtohen më gjatë. Ato kujtime do të ushtrorjnë një tërheqje që mund t'i kthejë ata kur enden larg për një kohë, ndoshta për vite, nga shtegu i kthimit për te jeta e përjetshme.

Do të na duhet këndvështrimi afatgjatë kur ata që i duam, e ndiejnë tërheqjen e botës dhe reja e dyshimit duket se e trondit besimin e tyre. Ne kemi besim, shpresë dhe dashuri hyjnore për të na udhërrëfyer ne dhe për t'i forcuar ata.

E kam parë atë si një këshilltar i dy profetëve të gjallë të Perëndisë. Ata janë individë me personalitete të pashembullta. Prapëseprapë, ata duket se kanë të përbashkët një optimizëm të përhershëm. Kur dikush vë alarmin për diçka në Kishë, përgjigja e tyre më e shpeshtë është: “O, gjërat do të rregullohen”. Ata në përgjithësi dinë më shumë rreth problemit sesa njerëzit që ngrenë alarmin.

Ata e njohin gjithashtu mënyrën e Zotit dhe ndaj, ata kanë gjithnjë shpresë rreth mbretërisë së Tij. Ata e dinë se Ai është në krye të saj. Ai

është i gjithëfuqishëm dhe Ai tregon kujdes. Nëse e lini Atë të jetë udhëheqësi i familjes suaj, gjërat do të rregullohen.

Disa prej pasardhësve të Hainrih Ajringut duket se janë endur në rruqë të gabuar. Por shumë prej stërstërnipërve të tij shkojnë në tempujt e Perëndisë në 6:00 të mëngjesit për të kryer ordianca për paraardhës që nuk i kanë takuar kurrë. Ata shkojnë për shkak të trashëgimisë së shpresës që la ai. Ai la një trashëgimi që po shpallet nga shumë prej pasardhësve të tij.

Pas gjithçkaje që ne mund të bëjmë me besim, Zoti do ta përligjë shpresën tonë për bekime më të mëdha për familjet tona, nga sa mund të përfytyrojmë. Ai dëshiron më të mirën për ata dhe për ne, si fëmijët e Tij.

Ne jemi të gjithë fëmijë të një Perëndie të gjallë. Jezusi i Nazaretit është Biri i Tij i Dashur dhe Shpëtimtari ynë i ringjallur. Kjo është Kisha e Tij. Në të janë çelësat e priftërisë dhe prandaj familjet mund të jenë përgjithmonë. Kjo është trashëgimia jonë e paçmueshme e shpresës. Unë dëshmoj se kjo është e vërtetë, në emrin e Zotit Jezu Krisht, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Henry Eyring reminiscences, 1896, dorëshkrim, Church History Library, f. 16–21.
2. Abrahami 3:24–26.
3. 3 Nefi 10:5.



Paraqitur nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Mbështetja e Drejtuesve të Kishës

Propozohet që ne të mbështetim Tomas Spenser Monson, si profet, shikues dhe zbulues, si dhe si President të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme; Henri Benion Ajring, si Këshilltar të Parë në Presidencën e Parë; dhe Diter Fridrih Uhtdorf, si Këshilltar të Dytë në Presidencën e Parë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë atë.

Ata që janë kundër, nëse ka, mund ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështetim Bojd Kenneth Paker, si President të

Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve, dhe ata që vijojnë, si anëtarë të atij kuorumi: Bojd K. Paker, L. Tom Peri, Rasëll M. Nelson, Dallin H. Ouks, M. Rasëll Ballard, Riçard G. Skot, Robert D. Hejls, Xhefri R. Holland, Dejvid A. Bednar, Kuentin L. Kuk, D. Tod Kristoferson dhe Nil L. Andersen.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë në të njëjtën mënyrë.

Propozohet që ne të mbështetim këshilltarët në Presidencën e Parë dhe Kuorumin e Dymbëdhjetë Apostujve

si profetë, shikues e zbulues.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Kundër, në qoftë se ka, me të njëjtën shenjë.

Në këtë kohë lirojmë nga thirrja me vlerësim të sinqertë Plakun Ted R. Kelister si Autoritet të Përgjithshëm dhe anëtar të Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne në një votim vlerësimi, lutemi ta tregojnë atë.

Propozohet që ne të mbështetim Plakun Lin G. Robins si anëtar të Presidencës së Kuorumeve të Të Shtatëdhjetëve.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.

Propozohet që ne të lirojmë sa vijojnë nga thirrjet si Të Shtatëdhjetë Zonalë, duke filluar nga data 1 maj 2014:

Pedro E. Abularak, Hulio A. Angulo, Viktor A. Askonavieta, Duk So Bei, Huan C. Barros, Kolin H. Briknell, Denis C. Brimhall, Tomas M. Çerrington, Kim B. Klark, Uin R. Djusnap, Rodolfo C. Franko, G. Guilermo Garsia, Hulio C. González, Mauro Hunot De Maria, Leri S. Keçer, Dejvid E. LeSjër, Paulo C. Loureiro, Stiven J. Land, Abraham Martinez, Hugo E. Martinez, Sergei N. Mikulin, Kristofer B. Mandei, Hirofumi Nakacuka, Çikao Oishi, Alehandro S. Patanía, Renato M. Petla, Anatoli K. Reshetnikov, Xhonatan C. Roberts, J. Krejg Rou, Robert B. Smith, Uarren G. Tejt, Hesbon O. Usi, Taniela B. Uakolo, Rendi W. Uilkinson dhe Çi Hong (Sam) Uong.

Ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur mirënjohjen për shërbimin e tyre të shkëlqyer, lutemi ta tregojnë.

Propozohet që të lirojmë nga thirrjet me një votim vlerësimi Vëllëzërit Rasëll T. Osguthorp, Dejvid M.



Uashington, Juta, SHBA



Mek-Konki dhe Methju O. Riçardson si presidenca e përgjithshme e Shkollës të së Dielës.

Gjithashtu u njoftojmë lirim nga thirrjet të gjithë anëtarëve të bordit të përgjithshëm të Shkollës të së Dielës.

Të gjithë ata që dëshirojnë të bashkohen me ne për t'u shprehur vlerësimin këtyre vëllezërve dhe motrave për shërbimin dhe përkushtimin e tyre të shquar, lutemi ta tregoni.

Propozohet që ne të mbështetim si anëtarë të rinj të Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve Çi Hong (Sam) Uong dhe Jorg Klebingat dhe si anëtarë të rinj të Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve Leri S. Keçer dhe Hugo E. Martinez.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata kundër, me të njëjtën shenjë.

Propozohet që të mbështetim personat që vijojnë, si Të Shtatëdhjetët Zonalë të rinj: Hulio Sezar Akosta, Blejk R. Alder, Alen C. Allard, Taiçi Aoba, Karlos F. Arredondo, Vladimir N. Astashov, Horge T. Beserra, Majkëll H. Bërn, Romulo V. Kabrera, Hose Klaudio F. Kampos, Nikolas Kastanjeda, Uolter Çatora, Fuk Çuen Zeno Çou, J. Kevin Ens, K. Mark Frost, Mauricio G. Gonzaga, Leonard D. Grir, Hose Isagerre, Majkëll R. Xhensen, Adolf Johan Johanson, Te Gul Jung, Visit

Khanakham, Serhi A. Kovalov, Sergio Krasnoselski, Milan F. Kunz, Brajan R. Larsen, Geraldo Lima, W. Zhan-Pier Lono, Tasara Makasi, Khumbulani Medletçi, Dejl H. Mank, Eduardo A. Norambuena, Jutaka Onda, Raimundo Paseko De Pinjo, Marko Antonio Rais, Stiven K. Randall, R. Skot Runia, Aleksei V. Samaikin, Eduin A. Sekston, Raul H. Spitale, Karlos Uolter Trevinjo dhe Huan A. Urru.

Të gjithë që janë dakord, ju lutem tregojeni atë.

Ata që janë kundër, nëse ka.



Propozohet që ne të mbështetim Ted R. Kelister si president të përgjithshëm të Shkollës të së Dielës, me Xhon S. Taner si këshilltar të parë dhe Devin G. Durrant si këshilltar të dytë.

Ata që janë dakord, mund ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër, mund ta tregojë po ashtu.

Vëmë re se Vëllezërit Taner dhe Durrant janë që të dy duke shërbyer aktualisht si presidentë misioni dhe, si rrjedhim, nuk janë të pranishëm këtu në Qendrën e Konferencave.

Ata do ta fillojnë shërbimin e tyre zyrtarisht në presidencën e përgjithshme të Shkollës të së Dielës në vijim të lirit të tyre nga thirrja si presidentë misioni në korrik 2014.

Propozohet që ne të mbështetim Autoritetet e tjera të Përgjithshme, Të Shtatëdhjetët Zonalë dhe presidencat e përgjithshme të organizatave ndihmëse me përbërjen e tyre të tanishme.

Ata që janë dakord, lutemi ta tregojnë atë.

Ndonjë kundër mund ta tregojë.

Faleminderit, vëllezër dhe motra, për votimin tuaj mbështetës dhe për besimin e lutjet tuaja të vazhdueshme në emrin tonë.

I ftojme Autoritetet e Përgjithshme të sapothirrura që të vijnë e të zënë vendet e tyre në panel. ■

Raporti i Departamentit të Kontrollit Financiar të Kishës, 2013

Paraqitur nga Kevin R. Xhergensen,
Drejtor Administrimi, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës

Drejtuar Presidencës së Parë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

Të dashur Vëllezër: Siç përshkruhet me anë të zbulës në seksionin 120 të Doktrinës e Besëlidhjeve, Këshilli mbi Planifikimin e Të Dhjetave – i përbërë nga Presidencë e Parë, Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve dhe Peshkopata Kryesuese –autorizon shpenzimin e fondeve të Kishës. Subjektet e Kishës i shpenzojnë fondet në përputhje me buxhetet, politikat dhe procedurat e miratuara.

Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës, i cili përbëhet nga profesionistë të licencuar dhe është i pavarur nga të gjitha departamentet e tjera të Kishës, ka përgjegjësinë të kryejë kontrolle financiare me qëllim që të japë siguri të arsyeshme në lidhje me kontributet e marra, shpenzimet

e bëra dhe mbrojtjen e pasurive të Kishës.

Bazuar mbi kontrollet financiare të kryera, Departamenti i Kontrollit Financiar të Kishës është i mendimit se, në çdo hollësi të rëndësishme, kontributet e marra, shpenzimet e bëra dhe pasuritë e Kishës për vitin 2013, janë regjistruar dhe administruar në harmoni me buxhetet, politikat dhe praktikatat llogaritëse të miratuara të Kishës. Kisha ndjek praktikatat që u jepen mësim anëtarëve të saj të jetuarit brenda një buxheti, të shmangies së borxhit dhe kursimit për një rast nevojë.

I paraqitur me respekt nga
Departamenti i Kontrollit të Kishës
Kevin R. Xhergensen
Drejtor Administrimi ■

Raporti Statistikor, 2013

Paraqitur nga Bruk P. Hejls,
Sekretar i Presidencës së Parë

Për informimin e anëtarëve të Kishës, Presidencë e Parë ka nxjerrë raportin statistikor që vijon, lidhur me rritjen dhe gjendjen e Kishës deri më 31 dhjetor 2013.

Njësi të Kishës

Kunje	3.050
Misione	405
Distrikte	571
Lagje dhe Degë	29.253

Anëtarësia e Kishës

Anëtarësia e Përgjithshme	15.082.028
Fëmijë të Rinj të Regjistruar	115.486
Të Kthyer të Pagëzuar	282.945

Misionarë

Misionarë Kohëplotë	83.035
Misionarë në Shërbim të Kishës	24.032

Tempuj

Tempuj të Përkushtuar gjatë vitit 2013 (Tempulli i Tegusigalpës në Honduras)	1
Tempuj në Funkionim në Fund të Vitit	141





Nga Plaku Rasëll M. Nelson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Lëreni Besimin Tuaj të Dalë në Pah

Nga dita në ditë, në shtegun tuaj drejt fatit tuaj të përjetshëm, shtojeni besimin tuaj. Shpalleni besimin tuaj! Lëreni besimin tuaj të dalë në pah!

Të dashur vëllezër e motra, ju shprehim ndjenjat tona më të thella të dashurisë dhe të mirënjohjes për ju. Ne jemi mirënjohës për detyrat tona ndër ju.

Në një fluturim të kohëve të fundit, piloti ynë njoftoi se gjatë uljes sonë do të ndesheshim me turbulencë dhe se të gjithë pasagjerët duhet t'i lidhnin mirë rripat e sigurimit. Sigurisht, turbulenca erdhi. Qe vërtet e fortë. Në anën tjetër të ndenjësve dhe disa rreshta prapa meje, një grua të frikësuar e zuri paniku. Pas çdo rënieje frikësuese në lartësi dhe lëkundjeje tronditëse, ajo bërtiste fort. Bashkëshorti i saj u përpoq ta qetësonte, por pa rezultat. Britmat e saj hysterike vazhduan derisa e kaluam atë zonë turbulente dhe u ulëm të sigurt në tokë. Gjatë periudhës së saj të ankthit, ndjeva keqardhje për të. Duke qenë se besimi është kundërhelmi për frikën, në heshtje dëshirova që të mund t'ia kisha forcuar besimin.

Më vonë, teksa pasagjerët po dilnin nga aeroplani, bashkëshorti i kësaj gruaje më foli. Ai tha: “Më vjen keq që ime shoqe ishte kaq e tmerruar. E vetmja mënyrë se si mund ta qetësoja ishte që t'i thosha se: ‘Plaku Nelson



është në këtë fluturim, kështu që s'ka nevojë të shqetësohesh’.”

Nuk jam i sigurt nëse prania ime në atë fluturim duhet t'i kishte dhënë asaj ndonjë ngushëllim, por do të them se një nga realitetet e jetës në vdekshmëri është që besimi ynë do të sprovohet e do të sfidohet. Ndonjëherë ato sprova

vijnë ndërsa hasim ato që duken të jenë përballje për jetë a vdekje. Për këtë grua të frikësuar, një aeroplan me lëkundje të vullshme përfaqësonte një nga ato çastet kur ne vihemi ballë për ballë me forcën e besimit tonë.

Kur flasim për besimin – besimin që mund të lëvizë malet – nuk jemi duke folur për besimin në përgjithësi, por për besimin në Zotin Jezu Krisht. Besimi në Zotin Jezu Krisht mund të përforcohet kur mësojmë për Të dhe e jetojmë fenë tonë. Doktrina e Jezu Krishtit u krijua nga Zoti për të na ndihmuar të shtonim besimin tonë. Në gjuhën e përditshme të sotme, sidoqoftë, fjala *fe* mund të ketë kuptime të ndryshme për njerëz të ndryshëm.

Fjala *fe* në kuptimin e plotë të fjalës do të thotë “të kapesh përsëri” ose “të lidhesh sërish” te Perëndia.¹ Pyetja që mund t'i bëjmë vetes, është: a jemi lidhur në mënyrë të sigurt te Perëndia kështu që besimi ynë del në pah, apo jemi lidhur në të vërtetë te diçka tjetër? Për shembull, të hënave në mëngjes më ka kapur veshi biseda rreth lojërave sportive profesioniste që ishin zhvilluar të dielën e mëparshme. Për disa prej këtyre sportdashësve të etur, kam pyetur veten nëse “feja” e tyre do t'i “lidhte” ata vetëm te gjëra që kanë lidhje me sportin.

Secili nga ne mund ta pyesë veten, ku qëndron besimi ynë? A qëndron te një skuadër? A qëndron te një markë? A qëndron te një njeri i famshëm? Edhe skuadrat më të mira mund të mos ia dalin. Njerëzit e famshëm mund të veniten. Ka vetëm një Njeri tek i cili besimi juaj është gjithmonë i sigurt, dhe është te Zoti Jezu Krisht. Dhe ju duhet ta lini besimin tuaj të dalë në pah!

Perëndia shpalli tek *i pari* i Dhjetë Urdhërimeve të Tij: “Nuk do të kesh perëndi të tjerë para meje”.² Ai gjithash-tu tha: “Shihni tek unë në çdo mendim;



mos dyshoni, mos kini frikë”³. Prapëseprapë, kaq shumë njerëz shikojnë vetëm te gjendja e llogarisë së tyre bankare për paqe ose te bashkëqeniet njerëzore për shembuj që t’i ndjekin.

Doktorët, akademikët dhe politikanët shpesh vihen para një prove të besimit. Në ndjekje të qëllimeve të tyre, a do të dalë në pah feja e tyre apo do të fshihet ajo? A janë lidhur sërish te Perëndia apo te njeriu?

Unë pata një sprovë të tillë dekada më parë kur një prej kolegëve të mi të trupës mjekësore më qortoi që nuk arrija ta veçoja njohurinë time profesionale nga bindjet e mia fetare. Ai kërkoi që të *mos* i ndërthurja me njëra-tjetrën. Si mund ta bëja atë? E vërteta është e vërtetë! Ajo nuk është e ndashme dhe asnjë pjesë e saj nuk mund të lihet mënjane.

Qoftë nëse e vërteta rrjedh prej një laboratorit shkencor apo nëpërmjet zbulësës, e gjithë e vërteta buron nga Perëndia. E gjithë e vërteta është pjesë e ungjillit të Jezu Krishtit.⁴ Por, po më kërkohet të fshihja besimin tim. Unë nuk u pajtova me kërkesën e kolegut tim. E lashë besimin tim të dilte në pah!

Në të gjitha orvatjet profesionale kërkohen standarde të trepta përpikërie. Studiuesit e çmojnë fort lirinë e tyre të shprehjes. Por liria e plotë nuk mund

të përjetohet nëse një pjesë e njohurisë së një personi shpallet si “jashtë kufijve” prej rregullave të njerëzve.

E vërteta shpirtërore nuk mund të shpërfilllet – veçanërisht urdhërimet hyjnore. Mbajtja e urdhërimeve hyjnore sjell bekime, çdo herë! Shkelja e urdhërimeve hyjnore sjell humbje të bekimeve, çdo herë!⁵

Problemet gëlojnë në këtë botë ngaqë ajo është e mbushur me njerëz të papërsosur. Synimet dhe dëshirat e tyre ndikohen thellë nga besimi i tyre ose nga mungesa e besimit. Shumë njerëz vënë përparësi të tjera përpara Perëndisë. Disa e sfidojnë lidhjen e fesë me jetën moderne. Si në çdo epokë, po kështu sot ka nga ata që e përqeshin ose e dënojnë ushtrimin e lirë të fesë. Disa madje e fajësojnë fenë për një numër të të këqijave në botë. Pa dyshim, ka pasur raste kur mizori janë kryer në emër të fesë. Por të jetuarit e fesë së pastër të Zotit, që do të thotë të përpiqesh të bëhesh dishepull i vërtetë i Jezu Krishtit, është një mënyrë të jetuari dhe një zotim i përditshëm që do të sigurojnë udhëheqje hyjnore. Ndërsa e përdorni fenë tuaj, ju po ushtroni besimin tuaj. Ju po e lini besimin tuaj të dalë në pah.

Zoti e dinte që fëmijëve të Tij do t’ju duhej të mësonin se si ta gjenin Atë. “Sepse e ngushtuar është porta”,

tha Ai, “dhe e ngushtë është udha që çon në ekzaltim . . . , dhe pak janë ata që e gjejnë atë.”⁶

Shkrimet e shenja sigurojnë një nga mënyrat më të mira për ta gjetur udhën tonë dhe për të qëndruar në të. Njohuria për shkrimet e shenja siguron mbrojtje të çmuar gjithashtu. Për shembull, gjatë gjithë historisë, infeksione si “ethja e lindjes” morën jetën e shumë nënave dhe foshnjave të pafajshme. Prapëseprapë, Dhiata e Vjetër i kishte parimet e sakta të të vepruarit me pacientët e infektuar, të shkruara mbi 3.000 vjet më parë!⁷ Shumë njerëz u shuan pasi kërkimi i njeriut për njohuri nuk arriti t’ia vinte veshin fjalës së Zotit!

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, çfarë na mungon në jetën tonë nëse po “mësoj[më] gjithnjë, [por] kurrë nuk mund të arrij[më] në njohjen e plotë të së vërtetës”⁸? Ne mund të fitojmë njohuri të mrekullueshme nga shkrimet e shenja dhe të marrim frymëzim nëpërmjet lutjeve të besimit.

Të vepruarit në këtë mënyrë do të na ndihmojë ndërsa marrim vendime të përditshme. Veçanërisht kur ligjet e njeriut krijohen dhe vihen në zbatim, ligjet e Perëndisë duhet të jenë gjithmonë standardi ynë. Kur përballemi me çështje të diskutueshme, ne duhet së pari të kërkojmë udhëheqjen e Perëndisë.

Ne duhet “[t’i] përshta[tim] të gjitha shkrimet e shenjta për ne . . . për përfitimin dhe mësimin tonë”. Rreziku ngre pritë kur ne përpiqemi ta veçojmë veten me shprehje të tilla si “jeta ime personale” ose madje “sjellja ime më e mirë”. Nëse dikush përpiqet ta ndajë jetën e vet në pjesë të tilla të veçuara, ai njeri nuk do të ngrihet kurrë në lartësinë e duhur të integritetit të vet personal – për të mos u bërë kurrë gjithçka që vetja e tij apo e saj e vërtetë mund të jetë.

Tundimi për të qenë njeri me popullaritet mund t’i japë përparësi opinionit publik përpara fjalës së Perëndisë. Fushatat politike dhe strategjitë e marketingut përdorin gjerësisht sondazhe të opinionit publik për të zhvilluar planet e tyre. Rezultatet e atyre sondazheve janë informative. *Por* vështirë se mund të përdoren si bazë për të shfajësuar mosbindjen ndaj urdhërimeve të Perëndisë! Edhe nëse “gjithkush po e bën atë”, e gabuara kurrë nuk është e drejtë. Ligësia, gabimi dhe terri nuk do të jenë kurrë e vërteta, edhe nëse gëzojnë popullaritet. Një paralajmërim nga shkrimi i shenjtë shpall këtë: “Mjerë ata që e quajnë të mirë të keqen dhe të keqe të mirën, që ndërrojnë terrin në dritë dhe dritën në terr”¹⁰.

Pas Luftës I Botërore, një këngë disi provokuese fitoi popullaritet. Duke nxitur pamoralshmërinë, ajo bënte be që 50 milionë njerëz nuk mund ta kenë gabim. Por në të vërtetë, 50 milionë njerëz *mund* ta kenë gabim – plotësisht gabim. Pamoralshmëria është ende pamoralshme në sytë e Perëndisë, i cili një ditë do t’i gjykojë të gjitha veprat dhe dëshirat tona.¹¹

Krahasojeni frikën dhe mosbesimin kaq të përhapur në botë sot me besimin dhe kurajën e vajzës sime shumë të dashur, Emilisë, e cila tani jeton në anën tjetër të velit. Ndërsa

jeta e vdekshme po e linte trupin e saj të pushtuar nga kanceri, ajo mezi mund të fliste. Por me një buzëqeshje në fytyrën e saj, ajo më tha: “Babi, mos u shqetëso për mua. E di se do të jem mirë!” Besimi i Emilisë po dilte në pah – po dilte në pah me shkëlqim – në atë çast të dhimbsur, pikërisht kur kishim më tepër nevojë për të.

Kjo nënë e re, e bukur e pesë fëmijëve kishte besim të plotë tek Ati i saj Qiellor, te plani i Tij dhe te mirëqenia e përjetshme e familjes së saj. Ajo në mënyrë të sigurt ishte lidhur sërish te Perëndia. Ajo qe plotësisht besnike ndaj besëlidhjeve të bëra me Zotin dhe me bashkëshortin e saj. Ajo i donte fëmijët e saj, por ishte në paqe, pavarësisht nga ndarja e pashmangshme prej tyre. Ajo kishte besim tek e ardhmja e saj dhe gjithashtu tek e ardhmja e tyre, ngaqë kishte besim tek Ati ynë Qiellor dhe Biri i Tij.

Në vitin 1986, Presidenti Tomas S. Monson tha: “Sigurisht të gjithë përballlemi me frikë, provojmë tallje dhe hasim kundërshtim. Paçim guximin për t’iu kundërvënë miratimit të përgjithshëm, guximin për t’i mbrojtur parimet. Guximi, jo kompromisi, e sjell buzëqeshjen e miratimit të Perëndisë. . . . Mbani mend se të gjithë njerëzit kanë frikë, por edhe ata që përballen me frikën e vet me [besim] kanë guxim.”¹²

Këshilla e Presidentit Monson qëndron përjetë! Kështu që ju lutem, vëllezërit dhe motrat e mia të dashura: Nga dita në ditë, në shtegun tuaj drejt fatit tuaj të përjetshëm, shtojeni besimin tuaj. Shpalleni besimin tuaj! Lëreni besimin tuaj të dalë në pah!¹³

Unë lutem që në mënyrë të sigurt do të lidheni sërish te Perëndia, që të vërtetat e Tij të përjetshme do të skaliten në zemrën tuaj përgjithmonë. Dhe unë lutem që, gjatë gjithë jetës suaj, ju



do ta lini besimin tuaj të dalë në pah!
Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Kur një foshnje lind, kordoni i kërthizës lidhet në dy vende dhe pritët midis atyre dy ligaturave. Një ligaturë është një lidhje – një lidhje e fiksuar mirë. Fjala *fe* [religion] vjen nga fjalët-rrënjë të latinishtes: *re* që do të thotë “përsëri” ose “sërisht” dhe ka mundësi nga *ligare* që do të thotë “të lidhësh” ose “të kapësh”. Pra, ne e kuptojmë që feja “i lidh besimtarët me Perëndinë”.
2. Eksodi 20:3. Përveç kësaj, Zoti tha: “Konvertohuni, largohuni nga idhujtë tuaj dhe hiqni . . . të gjitha gjërat tuaja të neveritshme” (Ezekieli 14:6).
3. Doktrina e Besëlidhje 6:36.
4. Shih Spencer W. Kimball, *The Teachings of Spencer W. Kimball*, bot. Edward L. Kimball (1982), f. 391.
5. Shih Mosia 2:41; Doktrina e Besëlidhje 58:30–33; 82:10. Ky parim është i vërtetë për këdo, pasi “Perëndia nuk tregohet i anshëm” (Veprat e Apostujve 10:34); shih edhe Moroni 8:12.
6. Doktrina e Besëlidhje 132:22.
7. Shih Levitiku 15:13.
8. 2 Timoteut 3:7
9. 1 Nefi 19:23.
10. Isaia 5:20.
11. Shkrimi i Shenjtë na mëson: “Ejani te Zoti, tek i Shenjti. Kujtoni se shtigjet e tij janë të drejta. Vini re, udha për njeriun është e ngushtë, por ajo shtrihet në një drejtim të drejtë para tij dhe ruajtësi i portës është i Shenjti i Izraelit; dhe ai nuk punëson shërbëtorë aty; dhe nuk ka udhë tjetër përveç nëpërmjet portës; pasi ai nuk mund të mashtrohet, pasi Zoti Perëndi është emri i tij” (2 Nefi 9:41).
12. Thomas S. Monson, “Courage Counts”, *Ensign*, nëntor 1986, f. 41. Në një rast tjetër, Presidenti Monson dha këtë këshillë frymëzuese: “Për të jetuar shkëlqyeshëm, ne duhet të zhvillojmë aftësinë që ta përballojmë vështirësinë me kurajë, zhgënjimin me hare dhe ngadhnjimin me përlësi. . . . Ne jemi bij dhe bija të një Perëndie të gjallë, sipas shëmbëlltërisë së të cilit jemi krijuar. . . . Ne nuk mund ta kemi me sinqeritet këtë bindje pa përjetuar një ndjesi tërësisht të përtërirë force dhe fuqie, madje forcën për të jetuar urdhërimet e Perëndisë, fuqinë për t’u bërë ballë tundimeve të Satanit” (“Yellow Canaries with Gray on Their Wings”, *Ensign*, July 1973, f. 43).
13. “I mohoni vetes çdo ligësi” (Moroni 10:32). Nuk duhet të frikësohesh më shumë nga njeriu sesa nga Perëndia (shih Doktrina e Besëlidhje 3:7; 59:5).



Nga Plaku Riçard G. Skot,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“Ju Kam Dhënë Shëmbullin”

Shëmbulli më i madhërishtëm që eci ndonjëherë mbi tokë, është Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. . . . Ai na fton ta ndjekim shëmbullin e Tij të përkryer.

Ndërsa kam përsiatur mbi detyrën time për të ndarë ungjillin, kam reflektuar për njerëz të dashur ndikimi i ëmbël i të cilëve më ndihmoi të gjej shtegun e caktuar hyjnisht, që e ndihmoi përparimin tim shpirtëror. Në kohë të rëndësishme në jetën time, Ati në Qiell më bekoj me dikë që u kujdes për mua aq sa të ndihmonte për t’i udhëhequr zgjedhjet e mia në një drejtim të duhur. Ata zbatuan këto fjalë të Shpëtimtarit: “Unë, në fakt, ju kam dhënë shëmbullin që ashtu siç kam bërë unë, bëni edhe ju”¹.

Kur isha fëmijë i vogël, babai im nuk ishte anëtar i Kishës dhe nëna ime ishte bërë më pak aktive. Ne jetonim në Uashington, D.K. dhe prindërit e nënës sime jetonin më shumë se 2.500 milje (4.000 kilometra) larg, në shtetin e Uashingtonit. Disa muaj pas ditëlindjes sime të tetë, Gjyshe Uitëlli udhëtoi përmes të gjithë vendit për të na vizituar. Gjyshja ishte e shqetësuar se as unë, as vëllai im më i madh, nuk ishim pagëzuar. Nuk e di se çfarë u tha ajo prindërve të mi për këtë, por e di vërtet se një mëngjes ajo na çoi në një park vëllanë tim dhe mua dhe na

tregoi ndjenjat e saj mbi rëndësinë e të qenit të pagëzuar dhe të pjesëmarrjes rregullisht në mbledhjet e Kishës. Nuk i mbaj mend hollësitë e asaj që tha ajo, por fjalët e saj prekën diçka në zemrën time dhe shpejt vëllai im dhe unë u pagëzuam.

Gjyshja vazhdoi të na përkrahte. Më kujtohet se çdo herë që vëllait tim ose mua na caktohej të bënim një bisedë në kishë, ne do ta merrnim në telefon për t’i kërkuar disa sugjerime. Brenda pak ditësh, një bisedë e shkruar me dorë do të mbërrinte me postë. Pas njëfarë kohe, sugjerimet e saj u ndryshuan në një skicim idesh që kërkonte më shumë përpjekje nga ana jonë.

Gjyshja përdori pikërisht sasinë e duhur të guximit dhe respektit për ta ndihmuar babanë tonë të kuptonte sa e rëndësishme ishte të na çonte në kishë me makinë për mbledhjet tona. Në çdo mënyrë të përshtatshme, ajo na ndihmoi të ndienim një nevojë për ungjillin në jetën tonë.

Më e rëndësishmja, ne e dinim se Gjyshja na donte dhe se ajo e donte ungjillin. Ajo ishte një shëmbull i mrekullueshëm! Sa mirënjohës jam

për dëshminë që ajo ndau me mua kur isha shumë i vogël. Ndikimi i saj e ndryshoi drejtimin e jetës sime ndaj të mirës së përjetshme.

Më vonë, kur isha gati të diplomohesha në universitet, unë rashë në dashuri me një vajzë të re e të bukur që quhej Xhenin Uotkins. Mendova se edhe ajo po fillonte të kishte disa ndjenja të thella për mua. Një natë kur ne po flisnim për të ardhmen, ajo me kujdes futi në diskutim një thënie që e ndryshoi jetën time për gjithmonë. Ajo tha: “Kur të martohem, do të martohem në tempull me një misionar të kthyer e besnik”.

Nuk kisha menduar shumë për një mision përpara kësaj. Atë natë, shtysa ime për ta marrë parasysh një shërbim misionar, ndryshoi jashtë mase. Shkova në shtëpi dhe nuk mund të mendoja për asgjë tjetër. Ndenja zgjuar gjithë natën. Isha plotësisht i shpërqendruar nga studimet e mia të nesërmen. Pas shumë lutjesh, mora vendimin të takohesha me peshkopin tim dhe të filloja aplikimin tim për misionar.

Xhenina nuk më kërkoi asnjehere që të shërbeja një mision *për të*. Ajo më donte mjaftueshëm sa të më tregonte bindjen e saj dhe pastaj më dha mundësinë të zgjidhja drejtimin e vetë jetës sime. Ne të dy shërbyem në misione dhe më vonë u vulosëm në tempull. Guximi dhe zotimi i Xheninës ndaj besimit të saj kanë sjellë gjithë ndryshimin në jetën tonë së bashku. Jam i sigurt se nuk do ta kishim gjetur lumturinë që gëzojmë, pa besimin e saj të fortë në parimin e shërbimit ndaj Zotit së pari. Ajo është një shembull i mrekullueshëm, i drejtë!

Që të dyja, Gjyshe Uitëlli dhe Xhenina më deshën mjaftueshëm sa të më tregonin bindjen e tyre se ordiancat e ungjillit dhe shërbimi ndaj Atit në Qiell do ta bekonin jetën time. Asnjëra prej tyre nuk më detyroi apo nuk më



bëri të ndihesha keq për njeriun që isha. Ato thjesht më deshën mua dhe e deshën Atin në Qiell. Që të dyja e dinin se Ai mund të bënte më shumë me jetën time nga sa mund të bëja unë vetë. Secila më ndihmoi me guxim në mënyra të dashura për të gjetur shtegun e lumturisë më të madhe.

Në ç'mënyrë secili prej nesh mund të bëhet një ndikim i tillë thelbësor? Ne duhet të jemi të sigurt që t'i duam sinqerisht ata që duam t'i ndihmojmë me drejtësi, kështu që ata mund të fillojnë të zhvillojnë mirëbesim në dashurinë e Perëndisë. Për kaq shumë njerëz në botë, sfida e parë në pranimin e ungjillit është të zhvillojnë besim në një Atë në Qiell, që i do ata përsosurisht. Është më e lehtë të zhvillohet ai besim kur ata kanë miq ose pjesëtarë të familjes që i duan ata në një mënyrë të ngjashme.

Të dhënit e mirëbesimit ndaj tyre me dashurinë tuaj, mund t'i ndihmojë ata të krijojnë besim në dashurinë e

Perëndisë. Pastaj, nëpërmjet komunikimit tuaj të dashur e të matur, jeta e tyre do të bekohet ngaqë ju do të tregoni mësimet që keni mësuar, përvojat që keni pasur, dhe parimet që keni ndjekur, për të gjetur zgjidhje për vetë betejet tuaja. Tregoni interesimin tuaj të sinqertë për mirëqenien e tyre; pastaj jepni dëshminë tuaj për ungjillin e Jezu Krishtit.

Ju mund të ndihmoni në mënyra që bazohen te parimi dhe doktrina. Nxitini ata që i doni, që të përpiqen fort për ta kuptuar atë të cilën Zoti do të donte që ata të bënin. Një mënyrë si ta bëni këtë është që t'u bëni pyetje të cilat i bëjnë të mendohen, dhe më pas t'u jepni kohë të mjaftueshme – qofshin orë, ditë, muaj apo më shumë – për të përsiatuar dhe për të kërkuar që t'i gjejnë përgjigjet vetë. Ju mund të keni nevojë t'i ndihmoni të dinë se si të luten dhe se si të dallojnë përgjigje ndaj lutjeve të tyre. Ndihmohini të dinë se shkrimet e shenja janë një burim



jetësor për të marrë dhe dalluar përgjigje. Në atë mënyrë ju do t'i ndihmoni të përgatiten për mundësi dhe sfida të ardhshme.

Qëllimi i Perëndisë është “të bëj[ë] të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”². Kjo është themelore për gjithçka bëjmë. Nganjëherë ne përfshihemi kaq shumë në gjëra që i mendojmë magjepsëse, ose përpihemi kaq shumë nga përgjegjësia të rëndomta, sa që i harrojmë synimet e Perëndisë. Kur e përqendroni vazhdimisht jetën tuaj te parimet më themelore, ju do të merrni një kuptueshmëri të asaj që duhet të bëni, dhe do të prodhoni më shumë fryte për Zotin.

Kur e përqendroni jetën tuaj te parimet themelore të planit të shpëtimit, ju do të përqendrohni më mirë në të treguarin e asaj që dini, sepse e kuptoni rëndësinë e përjetshme të ordinancave të ungjillit. Ju do ta tregoni atë çka dini në një mënyrë që i nxit miqtë tuaj të dëshirojnë të forcohen shpirtërisht. Ju do t'i ndihmoni njerëzit tuaj të dashur që të duan të zotohen për t'iu bindur të gjitha urdhërimeve të Tij dhe për të marrë mbi vete emrin e Jezu Krishtit.

Kujtoni se kthimi në besim i individëve është vetëm një pjesë e punës. Gjithmonë përpiquni fort t'i forconi familjet. Jepni mësim me një largpamësi për rëndësinë e vulosjes së familjeve në tempull. Për disa familje

kjo mund të kërkojë vite. I tillë që rasti me prindërit e mi. Shumë vite pasi unë u pagëzova, babai im u pagëzua dhe, më vonë, familja ime u vulos në tempull. Babai im shërbeu si vulosës në tempull dhe nëna ime shërbeu atje me të. Kur e keni largpamësinë për ordinancat vulosëse të tempullit, ju do të ndihmoni për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë në tokë.

Kujtoni, t'i doni ata është themeli i fuqishëm për të ndikuar tek ata që dëshironi t'i ndihmoni. Ndikimet e Gjyshe Uitëllit dhe të bashkëshortes sime, Xheninës, do të kishin qenë të papërfillshme po të mos e kisha ditur më parë se ato më donin dhe dëshironin që unë të kisha më të mirën në jetë.

Si një shoqëruar për atë dashuri, kini mirëbesim tek ata. Në disa raste

Sidnei, Australi



mund të duket e vështirë t'u mirëbesoni, por gjeni njëfarë mënyre që t'u mirëbesoni atyre. Fëmijët e Atit në Qiell mund të bëjnë gjëra mahnitëse kur ndihen të mirëbesuar. Secili fëmijë i Perëndisë në vdekshmëri, e zgjedhi planin e Shpëtimtarit. Mirëbesoni se, po t'u jepet mundësia, ata do ta zgjedhin atë sërish.

Tregoni parimet që i ndihmojnë ata të cilët i doni, që të ecin përpara nëpër shtegun drejt jetës së përjetshme. Kujtoni, ne të gjithë rritemi rresht pas rreshti. Ju keni ndjekur të njëjtin model në kuptueshmërinë tuaj për ungjillin. Mbajeni të *thjeshtë* ndarjen tuaj të ungjillit.

Dëshmia juaj vetjake e Shlyerjes së Jezu Krishtit, është një mjet i fuqishëm. Burime shoqëruese janë lutja, Libri i Mormonit dhe shkrime të tjera të shenjta, si dhe zotimi juaj ndaj ordinancave të priftërisë. Të gjitha këto do ta lehtësojnë drejtimin prej Shpirtit, mbi të cilin është kaq vendimtare për ju që të mbështeteni.

Që të jeni të efektshëm dhe të bëni ashtu siç ka bërë Krishti³, përqendrohuni tek këto parime bazë të ungjillit: *Shlyerja e Jezu Krishtit e bën të mundur bërjen tonë më shumë si Ati ynë në Qiell, që të mund të jetojmë së bashku përjetësisht në njësitë tona familjare.*

Nuk ka doktrinë më themelore për punën tonë sesa Shlyerja e Jezu Krishtit. Në çdo mundësi të

përshtatshme, dëshmoni për Shpëtimtarin dhe për fuqinë e sakrificës së Tij Shlyese. Përdorni shkrime të shenjta që na japin mësim për Të dhe arsyen përse Ai është modeli i përsosur për çdonjërin në jetë.⁴ Juve do t'ju duhet të studioni me zell. Mos u përthithni aq shumë në gjëra të parëndësishme sa të humbisni të mësuarin e doktrinës dhe të mësimet e Zotit. Me një themel vetjak të fortë doktrinor, ju do të jeni një burim i fuqishëm për ndarjen e të vërtetave jetike me të tjerë që kanë nevojë skajshëm për to.

Ne i shërbejmë më së miri Atit tonë në Qiell duke ndikuar drejtësisht tek të tjerët dhe duke u shërbyer atyre.⁵ Shembulli më i madhërishëm që eci ndonjëherë mbi tokë, është Shpëtimtari ynë, Jezu Krishti. Shërbesa e Tij në vdekshmëri ishte e mbushur me mësimdhënie, shërbim dhe dashuri ndaj të tjerëve. Ai u ul me individë që u gjykuan të ishin të padenjë për shoqërimin e Tij. Ai e desh secilin prej tyre. Ai i dalloj nevojat e tyre dhe u mësoi ungjillin e Tij. Ai na fton ta ndjekim këtë shembull të përkryer.

Unë e di se ungjilli i Tij është shtegu për te paqja dhe lumturia në këtë jetë. U kujtoqshim ne që të bëjmë ashtu siç bëri Ai duke i ndarë dashurinë, mirëbesimin dhe njohurinë tonë për të vërtetën me të tjerët që nuk e kanë përqaftuar ende dritën e shkëlqyeshme të ungjillit. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Gjoni 13:15.
2. Moisiu 1:39.
3. Shih Gjoni 13:15.
4. Shih për shembull Lluca 22:39–46; Gjoni 8:3–11; Filipianëve 4:13; Jakobi [Bibël] 5:15–16; 1 Gjoni 1:7; 2 Nefi 1:15; 2; 25:17–30; 31; Jakobi [LiM] 4; Alma 7; 42; 3 Nefi 11–30; Moroni 10:32–33; Doktrina e Besëlidhje 18:10–16; 19:13–19; 29:3; 88:1–13; 138:2–4; Moisiu 5:6–12.
5. Shih Mateu 22:35–40; Mosia 2:17.



Nga Plaku Robert D. Hejls,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“Nëse Më Doni, Zbatoni Urdhërimet e Mia”

Përdorimi i lirisë sonë të zgjedhjes për t'u bindur do të thotë të zgjedhim të “bëj[më] ç’është’ e drejt’ [dhe pranimin që] pasojat le t’vazhdojnë”.

Vëllezër e motra, nga të gjitha mësimet që marrim nga jeta e Shpëtimtarit, asnjëri nuk është më i qartë dhe më i fuqishëm se mësimi i bindjes.

Shembulli i Shpëtimtarit

Në Këshillin paratokësor në Qiell, Luciferi ngriti krye kundër planit të Atit Qiuellor. Ata që e ndoqën Luciferin, i dhanë fund përparimit të tyre përjetshëm – kini kujdes se kë ndiqni!

Pastaj Jezusi shprehu zotimin e Tij për t'u bindur, duke thënë: “Atë, vullneti yt u bëftë dhe lavdia qoftë e jotja përgjithmonë”¹. Gjatë gjithë shërbesës së Tij, “Ai vuajti tundime, por nuk ua vuri veshin atyre”². Në të vërtetë, “[Ai] mësoi të jetë i bindur nga ato që pësoi”³.

Për shkak se Shpëtimtari ynë që i bindur, Ai shleu për mëkatet tona, duke e bërë të mundur ringjalljen tonë e duke përgatitur udhën për ne që të kthehemi tek Ati ynë Qiuellor, i cili e dinte se ne do të bënim gabime teksa

mësonim bindjen në vdekshmëri. Kur bindemi, ne e pranojmë sakrificën e Tij, pasi ne besojmë se nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, i gjithë njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit.⁴

Jezusi na mësoi të bindemi me fjalë të thjeshta, që janë të lehta për t'u kuptuar: “Nëse më doni, zbatoni urdhërimet e mia”⁵ dhe “Eja e më ndiq”⁶.

Kur pagëzohemi, ne “m[arrim] mbi vete emrin e Krishtit” dhe hyjmë “në besëlidhje me Perëndinë se [ne do të] je[m] të bindur deri në fund të jetës [sonë]”⁷. Çdo të diel, ne e përtërijmë atë besëlidhje pagëzimi duke marrë sakramentin dhe duke dëshmuar se jemi të gatshëm t'i mbajmë urdhërimet. Ne kërkojmë falje për çdo mendim, ndjenjë apo veprim që nuk është në harmoni me vullnetin e Atit tonë Qiuellor. Teksa pendo kemi duke u larguar nga mosbindja e duke filluar të bindemi sërish, ne tregojmë dashurinë tonë për Të.

Llojet e Bindjes

Teksa e jetojmë ungjillin, ne përparojmë në aftësinë tonë për ta kuptuar bindjen. Nganjëherë, mund të tundohemi të ushtrojmë atë që unë e quaj “bindja e njeriut të natyrshëm”, në të cilën ne nuk e pranojmë ligjin e Perëndisë për hir të zgjuarsisë ose dëshirave tona apo madje edhe popullaritetit. Për shkak se ushtrohet gjerësisht nga kaq shumë njerëz, ky

shtrembërim i bindjes i pakëson standardet e Perëndisë në kulturën tonë dhe në statutet tona ligjore.

Nganjëherë, ne mund të marrim pjesë në “bindjen përzgjedhëse” duke pretenduar se e duam dhe e nderojmë Perëndinë, ndërkohë që përzgjedhim se cilat prej urdhërimeve e mësimëve të Tij – dhe mësimëve e këshillës së profetëve të Tij – do të zbatojmë plotësisht.



Disa njerëz binden në mënyrë përzgjedhëse, sepse nuk mund t'i kuptojnë të gjitha arsyet e një urdhërimit, njësoj sikurse fëmijët nuk i kuptojnë gjithnjë arsyet e rregullave të prindërve të tyre. Por ne e dimë gjithnjë arsyen përse e ndjekim profetin, sepse kjo është Kisha e Jezu Krishtit dhe është Shpëtimtari që i drejton profetët e Tij në të gjitha periudhat ungjillore.

Ndërsa thellohet kuptueshmëria jonë rreth bindjes, ne e dallojmë rolin thelbësor të lirisë së zgjedhjes. Kur Jezusi ishte në Kopshtin e Gjetsemanit, Ai u lut duke thënë: “Ati im, në qoftë se është e mundur, largoje prej meje këtë kupë; megjithatë, jo si dua unë, por si do ti”⁸. Perëndia nuk do t'ia hiqte Shpëtimtarit lirinë e zgjedhjes, prapëseprapë Ai mëshirshëm dërgoi një engjell që ta forconte Birin e Tij të Dashur.

Shpëtimtari hasi një provë tjetër në Golgotë, ku mund të kishte thirrur ushtri të tëra engjëjsh që ta zbritnin nga kryqi, por Ai bëri zgjedhjen e Tij vetjake për të duruar me bindje deri në fund e për ta përfunduar sakrificën e Tij shlyese, edhe pse kjo nënkuptonte vuajtje të madhe, madje vdekje.

Bindja e pjekur nga ana shpirtërore është “bindja e Shpëtimtarit”. Ajo merr shtysë nga dashuria e vërtetë për Atin Qiellor dhe Birin e Tij. Kur bindemi me gatishmëri, sikurse bëri Shpëtimtari, ne u japim jetë fjalëve nga Ati Qiellor: “Ky është Biri im i dashur, në të cilin jam kënaqur”⁹. Dhe ne shpresojmë të dëgjojmë, pasi të hyjmë në praninë e Atit tonë Qiellor: “Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik; . . . hyr në gëzimin e zotit tënd”¹⁰.

Përdorimi i lirisë sonë të zgjedhjes për t'u bindur do të thotë të zgjedhim të “bëj[më] ç'është e drejt' [dhe pranimin që] pasojat le t'vazhdojnë”¹¹. Kjo kërkon zotërim të vetvetes dhe na sjell siguri, lumturi të përjetshme dhe



një ndjesi përmbushjeje neve dhe, me anë të shembullit, atyre që janë përreth nesh; dhe gjithnjë përfshin një zotim të thellë vetjak për t'i mbështetur udhëheqësit e priftërisë dhe për t'i zbatuar mësimet e këshillat e tyre.

Pasojat

Për zgjedhjen nëse vërtet do të bindemi apo jo, është përherë e dobishme të kujtojmë pasojat e zgjedhjeve tona. A e kuptonin Luciferi dhe ndjekësit e tij pasojën e zgjedhjes për të mos e pranuar planin e Atit Qiellor? Nëse po, përse e bënë një zgjedhje kaq të tmerrshme? Ne mund t'i bëjmë vetes një pyetje të ngjashme: Pse ndonjëri prej nesh zgjedh të jetë i pabindur kur ne i dimë pasojat e përjetshme të mëkatit? Shkrimet e shenja na japin përgjigje: arsyeja përse Kaini dhe disa fëmijë të Adamit dhe Evës zgjodhën të mos bindeshin, është ngaqë “e donin Satanin më shumë sesa Perëndinë”¹².

Dashuria jonë për Shpëtimtarin është çelësi për bindje si ajo e Shpëtimtarit. Teksa mendohe mi të jemi të bindur në botën e sotme, ne shpallim

dashurinë dhe respektin për të gjithë fëmijët e Atit Qiellor. Prapëseprapë, është e pamundur që kjo dashuri për të tjerët t'i ndryshojë urdhërimet e Perëndisë, që u dhanë për të mirën tonë! Për shembull, urdhërimi “. . . mos vrit as mos bëj diçka të ngjashme”¹³, bazohet te ligji shpirtëror që i mbron të gjithë fëmijët e Perëndisë, madje edhe ata që nuk kanë lindur ende. Përvoja e gjatë tregon se, kur ne e shpërfillim këtë ligj, si pasojë vjen hidhërimi i pamatshëm. Gjithsesi, shumë njerëz besojnë se është e pranueshme t'ia marrësh jetën një fëmije të palindur për arsye parapëlqimi apo volie.

Dhënia e arsyeve për mosbindjen nuk e ndryshon ligjin shpirtëror apo pasojat e tij, por çon në pështjellim, paqëndrueshmëri, endje në udhë të panjohura, humbje të rrugës e pikëllim. Si dishepujt të Krishtit, ne kemi një detyrim të shenjtë për t'i përkrahur ligjet, urdhërimet e Tij dhe besëlidhjet që i marrim mbi vete.

Në dhjetor të vitit 1831, disa prej vëllezërve u thirrën që të ndihmonin për të zbutur ndjenjat armiqësore që

ishin zhvilluar kundrejt Kishës. Nëpërmjet Profetit Jozef Smith, Zoti i drejtoi ata në një mënyrë të pazakontë, madje befasuese:

“Ngatërrojini armiqtë tuaj; u bëni thirrje që të takohen me ju, si në publik, edhe në fshehtësi. . . .

Prandaj, le të sjellin ata arsyet e tyre të forta kundër Zotit.

. . . Nuk ka asnjë armë që formohet kundër jush, që do të përparojë;

Dhe nëse dikush ngre zërin e tij kundër jush, ai do të ngatërrohet në kohën time.

Prandaj, i mbani urdhërimet e mia; ato janë të vërteta dhe besnike.”¹⁴

Mësime në Shkrimet e Shenjta

Shkrimet e shenja janë plot me shembuj profetësh që i kanë marrë mësimet e bindjes nga përvoja e tyre vetjake.

Jozef Smithit iu mësu an pasojat e dorëzimit ndaj trysnisë së mirëbërësit, mikut dhe shkruarit të tij, Martin Harrisit. Në përgjigje të lutjeve të Martinit, Jozefi i kërkoi leje Zotit që t'ia jepte hua 116 faqet e para të dorëshkrimit të



Librit të Mormonit, që Martini të mund t'ia tregonte ato familjes së tij, por Zoti i tha Jozefit të thoshte jo. Martini iu lut Jozefit ta pyeste Zotin përsëri. Pas kërkesës së tretë të Jozefit, Zoti u dha leje pesë njerëzve të caktuar që ta shqyrtonin dorëshkrimin. “Martini e lidhi veten me këtë marrëveshje me besëlidhjen më solemne të mundshme. Kur mbërriti në shtëpi dhe mbi të u ushtrua trysni, ai e harroi betimin e tij solemn dhe i lejoi të tjerët ta shikonin dorëshkrimin, me rezultatin që me anë të dredhive, dorëshkrimi i iku nga duart”¹⁵ dhe humbi. Për pasojë, Jozefi u qortua nga Zoti dhe iu hoq leja për ta vazhduar përkthimin e Librit të Mormonit. Jozefi vuajti dhe u pendua për shkeljen e tij që iu dorëzua trysnisë së të tjerëve. Pas një periudhe, Jozefi u lejua ta niste aty ku e kishte lënë punën e tij për përkthimin. Jozefi kishte marrë një mësim të vlefshëm bindjeje që i shërbeu për gjithë pjesën tjetër të jetës!

Profeti Moisi jep një shembull tjetër. Kur Moisiu mori me bindje një

grua nga Etiopia, Miriami dhe Aaroni folën kundër tij. Por Zoti i qortoi ata duke thënë: “Me [Moisiun] unë flas sy për sy”¹⁶. Zoti e përdori këtë rast të jashtëzakonshëm për t’u dhënë mësim anëtarëve të Kishës në periudhën tonë ungjillore. Në vitin 1830, Hiram Pejxhi pretendoi se mori zbulesë për Kishën. Zoti e korrigjoi atë dhe u mësoi shenjtorëve: “Ti duhet t’u bindesh këtyre gjërave që unë i jap [Jozefit], sikurse edhe Aaroni”¹⁷, “sepse ai i merr ato, sikurse edhe Moisiu”¹⁸.

Bindja sjell bekime “dhe kur ne fitojmë ndonjë bekim nga Perëndia, është me anë të bindjes ndaj atij ligji mbi të cilin ai bazohet”¹⁹.

Bindja na mësohet me anë të shembullit. Nga mënyra se si jetojmë, ne u mësojmë fëmijëve tanë: “Mëso urtësi në rininë tënde; po, mëso në rininë tënde të zbatosh urdhërimet e Perëndisë”²⁰.

Bindja na bën gjithnjë e më të fortë, të aftë për të duruar me besnikëri prova dhe sprova në të ardhmen. Bindja në Gjetseman e përgatiti Shpëtimtarin

që të bindej e të duronte deri në fund në Golgotë.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, fjalët e Almës shprehin ndjenjat e zemrës sime:

“Dhe tani, vëllezërit e mi të dashur, unë jua kam thënë këto gjëra që të mund të zgjoj në ju ndjenjën e detyrës suaj ndaj Perëndisë, që ju të mund të ecni të pafajshëm para tij. . . .

Dhe tani unë do të doja që ju të jeni të përlurur dhe të nënshtuar dhe të butë; . . . duke qenë të zellshëm në zbatimin e urdhërimeve të Perëndisë në të gjitha kohët.”²¹

Jap dëshminë time të veçantë se Shpëtimtari jeton. Për shkak se ai u bind, “çdo gju do të gjuhëzohet dhe çdo gjuhë do të pohojë . . . se ai është [Shpëtimtari ynë]”²². Paçim dashuri shumë të thellë për Të dhe besofshim tek Ai me besim aq plotësisht sa edhe ne të bindemi, t’i mbajmë urdhërimet e Tij e të kthehemi për të jetuar me Të përgjithmonë në mbretërinë e Perëndisë sonë, është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moisiu 4:2.
2. Doktrina e Besëlidhje 20:22.
3. Hebrejve 5:8.
4. Shih Nenet e Besimit 1:3.
5. Gjoni 14:15.
6. Lluca 18:22.
7. Mosia 5:8.
8. Mateu 26:39; shih edhe vargjet 42, 44.
9. Mateu 3:17; shih edhe 3 Nefi 11:7.
10. Mateu 25:21
11. “Bëj Ç’Është e Drejtë”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 34.
12. Moisiu 5:13.
13. Doktrina e Besëlidhje 59:6.
14. Doktrina e Besëlidhje 71:7–11.
15. Joseph Fielding Smith, *Essentials në Church History* (1922), f. 65; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 3.
16. Numrat 12:8.
17. Doktrina e Besëlidhje 28:3.
18. Doktrina e Besëlidhje 28:2.
19. Doktrina e Besëlidhje 130:21; shih edhe vargun 20.
20. Alma 37:35.
21. Alma 7:22–23.
22. Mosia 27:31.



Nga Plaku Klaudio D. Zivic,
i Të Shtatëdhjetëve

Le të Mos Marrim Udhën e Gabuar

Lutem që të mos ia ndajmë sytë udhës, kështu që të jemi gjithmonë të lidhur me qiejt.

Një djalë i vogël po ushtronte pianon dhe një shitës, duke e parë atë nga dritarja, e pyeti: “A e ke mamin në shtëpi?”

Së cilës, fëmija iu përgjigj: “Po ja . . . si mendon ti?”

Pesë fëmijët tanë të dashur i bien pianos, falë nxitjes së bashkëshortes sime! Kur mësuesja mbërrinte në shtëpinë tonë, djali ynë Adriani vraponte dhe fshihej me qëllim që t’i shpëtonte mësimin. Por një ditë, ndodhi diçka e jashtëzakonshme! Ai filloi ta donte kaq shumë muzikën sa që vazhdoi të ushtrohej vetë.

Nëse ne do të mund ta arrinim atë pikë në procesin e kthimit tonë në besim, do të ishte mahnitëse. Do të ishte e mrekullueshme të kishim një dëshirë thellë në zemrat tona për t’i mbajtur urdhërimet pa pasur dikë që të na kujtojë vazhdimisht dhe një bindje të fortë se, nëse ndjekim shtegun e drejtë, ne do t’i kemi bekimet e premtuara në shkrimet e shenja.

Disa vite më parë, unë shkova në Parkun Kombëtar të Harqeve me bashkëshorten time; vajzën tonë, Evelinën, dhe një mikeshë të familjes. Njëri prej harqeve më të rëndësishëm atje quhet Harku Delikat. Ne vendosëm të ecnim

rreth 2 km, duke iu ngjitur malit me qëllim që të arrinim harkun.

E filluam rrugën tonë me entuziazëm të madh por, pasi përshkuam një distancë të shkurtër, të tjerët kishin nevojë të pushonin. Për shkak të dëshirës sime për të arritur atje, vendosa të vazhdoja i vetëm. Pa i kushtuar vëmendje shtegut që duhet të merrja, ndoqa një burrë që ishte para meje, i cili dukej se po ecte përpara me siguri

të madhe. Shtegu u bë gjithmonë e më i vështirë dhe m’u desh të hidhesha nga një shkëmb në tjetrin. Për shkak të vështirësisë, isha i sigurt se gratë në grupin tim nuk do t’ia dilnin kurrë mbanë. Papritur pashë Harkun Delikat, por për habinë time të madhe, pashë se ishte në një zonë të paarrishme për mua.

Me zhgënjim të madh, vendosa të kthehesha. Prita me padurim derisa ne u takuam sërish. Pyetja ime e menjëhershme ishte: “A e arritët Harkun Delikat?” Ato më thanë me gëzim se e kishin arritur. Ato më shpjeguan se kishin ndjekur shenjat që tregonin rrugën, dhe me kujdes e përpjekje, e kishin arritur pikëmbërritjen e tyre.

Fatkeqësisht, unë kisha marrë shtegun e gabuar. Çfarë mësimi të madh mora atë ditë!

Sa herë bëjmë gabime rreth udhës së drejtë, duke e lënë veten të udhëhiqemi nga prirjet e botës? Ne duhet ta pyesim vazhdimisht veten nëse jemi bërës të fjalëve të Jezu Krishtit.

Një mësim i mrekullueshëm gjendet në librin e Gjonit:





“Qëndroni në mua dhe unë do të qëndroj në ju; sikurse shermendi nuk mund të japë fryt nga vetja, po qe se nuk qëndron në hardhi, ashtu as ju, nëse nuk qëndroni në mua.

Unë jam hardhia, ju jeni shermen-det; kush qëndron në mua dhe unë në të, jep shumë fryt, sepse pa mua nuk mund të bëni asgjë” (Gjoni 15:4–5).

Duke përdorur këtë analogji, ne mund të shohim marrëdhënien shumë të afërt, të jashtëzakonshme që ekziston me Jezun Krishtin dhe rëndësinë që Ai i jep secilit prej nesh. Ai është rrënja dhe trunghi që i drejton ujërat e gjalla për te ne, limfa që do të na mundësojë të ushqehemi, në mënyrë që të mund të prodhojmë shumë fryt. Jezun Krishti na mësoi në një mënyrë të atillë që si degë – ose qenie që varemi prej Tij – ne kurrë nuk do ta nënvlerësojmë vlerën e mësimëve të Tij.

Ka disa gabime që mund të jenë të rënda dhe, nëse nuk i korrigjojmë në kohë, ato mund të na largojnë përfundimisht nga udha e drejtë.

Nëse pendohemi dhe pranojmë korrigjim, këto përvoja do të na lejojnë ta përuhim veten tonë, t’i ndryshojmë veprimet tona dhe të afrohemi edhe një herë më shumë me Atin tonë Qiellor.

Dua t’ju jap një shembull të këtij koncepti duke iu drejtuar një prej çasteve më dramatike që përjetoi Profeti Jozef Smith. Nëpërmjet kësaj përvoje, Shpëtimtari na ka dhënë mësim të paçmueshme në lidhje me parime që duhet t’i mbajmë në mendje gjatë gjithë jetës sonë. Ajo ndodhi kur Martin Harris humbi 116 faqet e përkthyer të pjesës së parë të Librit të Mormonit.

Pas pendesës për mosndjekjen e këshillës së Perëndisë, Profeti mori zbuluesën që gjendet te seksioni 3 në Doktrina e Besëlidhje (shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* [2007], f. 73–75). Nga ajo që është shkruar në vargjet 1 deri në 10, dëshiroj të theksoj tri parime që duhet t’i mbajmë mend gjithmonë:

1. Veprat dhe qëllimet e Perëndisë nuk mund të pengohen.
2. Ne nuk duhet ta kemi frikë njeriun më shumë se Perëndinë.
3. Ka nevojë për pendim të vazhdueshëm.

Në vargun 13, Zoti na mëson katër veprime që ne nuk duhet t’i bëjmë kurrë:

1. Të përçmojmë këshillat e Perëndisë.
2. Të thyejmë premtimet më të shenjta të bëra përpara Perëndisë.
3. Të mbështetemi vetëm në gjykimin tonë.
4. Të mburremi me urtësinë tonë.

Lutem që ne të mos ia ndajmë sytë udhës, kështu që të jemi gjithmonë të lidhur me qiejt, kështu që rrymat e botës të mos na marrin me vete.

Nëse ndonjëri prej jush e arrin pikën e braktisjes së udhës së Zotit – në çfarëdo pike përgjatë udhës – me brejtje të madhe ndërgjegjeje ju do të

ndieni hidhësinë e përçmimit të këshillës së Perëndisë, e thyerjes së premtimeve më të shenjta të bëra përpara Perëndisë, e mirëbesimit në gjykimin tuaj, ose e mburrjes me urtësinë tuaj.

Nëse është kështu, unë ju këshilloj të pendoheni dhe të ktheheni në udhën e drejtë.

Një herë, një nip, mori në telefon gjyshin e tij për t'i uruar "Gëzuar Ditëlindjen". E pyeti se sa vjeç ishte. Ai i tha se kishte mbushur 70 vjeç. Nipi i tij u mendua për një çast dhe më pas e pyeti: "Gjyshi, a ia ke nisur vërtet që nga 1-shi?"

Gjatë fëmijërisë dhe rinisë, njerëzit mendojnë se nuk do të plaken kurrë; ideja e vdekjes nuk zë kurrë rrënjë – ajo është për njerëzit që janë shumë, shumë pleq – dhe arritja e asaj pike është ende një përjetësi larg. Ndërsa koha kalon, muajt dhe vitet ikin, derisa rrudhat fillojnë të shfaqen, energjia pakësohet, nevoja për vizita te doktori bëhet më e shpeshtë, e kështu me radhë.

Do të vijë dita në të cilën ne do të takohemi sërish me Shëlbuesin dhe Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin. Lutem që në atë rast të shenjtë dhe madhështor, ne të mund ta njohim Atë për shkak të njohurisë që kemi për Të dhe për shkak se i kemi ndjekur mësimet e Tij. Ai do të na tregojë shenjat në duart e këmbët e Tij dhe ne do të bashkohemi së bashku në një përçafim pa mbarim, duke qarë nga gëzimi që kemi ndjekur udhën e Tij.

Unë u dëshmoj katër skajeve të tokës se Jezu Krishti jeton. Ai na këshillon: "Vini vesh, O ju, kombe të dheut, dhe dëgjoni fjalët e atij Perëndie që ju bëri" (DeB 43:23). Paçim aftësinë për ta rrokur, për t'ia vënë veshin, për ta kuptuar dhe interpretuar saktësisht mesazhin e "atij Perëndie që [na] bëri", që të mos largohemi nga udha e Tij, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku W. Krejg Zuik,
i Të Shtatëdhjetëve

Çfarë Po Mendon Ti?

Unë ju përgjerohem që të ushtroheni të bëni këtë pyetje, me konsideratë të dhimbsur për përvojën e dikujt tjetër: "Çfarë po mendon ti?"

Dyzet e një vite më parë hipa në ndenjësen e shoferit të një kamioni transporti me bashkëshorten time të bukur, Xhenin, dhe djalin tonë të mitur, Skotin. Ne po mbartnim një ngarkesë të rëndë me materiale ndërtimi përmes disa shteteve.

Asokohe nuk kishte detyrime për mbajtjen e rripit të sigurimit apo ndenjës makine për foshnjat. Gruaja ime e mbante djalin tonë të çmuar në krahët e saj. Komenti i saj: "Vërtet që po fluturojmë", duhet të më kishte përçarur një të dhënë rreth ndjenjave të saj të merakut.

Teksa ia zbritëm të tatëpjetës përtej qafës historike të Donerit, një pjesë e rrëpirët e autostradës, kabina e kamionit papritur e papandehur u mbush me tymnajë të dendur. Ishte e vështirë të shihje dhe ne mezi po merrnim frymë.

Në një kamion të rëndë, vetëm frenat nuk janë të mjaftueshme për ta ulur shpejtësinë aty për aty. Duke përdorur frenat e motorit dhe duke ulur marshet, me furi unë u orvata të ndaloja.

Pikërisht sa po dilja në anë të rrugës, por përpara se të kishim ndalur plotësisht, gruaja ime hapi derën e kabinës dhe kërceu jashtë me foshnjën tonë në krahët e saj. Pashë i pashpresë tekta u përplasën në pluhur.

Sapo e bëra kamionin të ndalte, u turra jashtë kabinës gjithë tym. Me adrenalinën në vena, vrapova përmes shkëmbinjve e barërave të egra dhe i mbajta ata në krahët e mi. Parakrahët dhe bërrylat e Xhenit ishin dërrmuar dhe po rridhnin gjak, por fatmirësisht ajo dhe djali ynë, të dy, ishin gjallë. Thjesht i mbajta pranë tekta pluhuri u ul atje në anë të autostradës.

Ndërsa rrahjet e zemrës m'u qetësuan dhe arrita të marr frymë, nxora pa menduar fjalët: "Po çfarë të shkretën po mendoje kështu? A e di se sa e rrezikshme ishte ajo? Mund të kishe vdekur!"

Ajo, me lotët që i rridhnin në faqet e nxira nga tymi, e ktheu shikimin nga unë dhe tha diçka që më theri në zemër dhe ende më kumbon në veshë: "Thjesht po përpiqesha të shpëtoja djalin tonë".

E kuptova në atë çast se ajo mendoi që motori kishte marrë flakë, duke u frikësuar se kamioni do të shpërthente dhe ne do të vdisnim. Unë, gjithsesi, e dija se ishte një avari elektrike – e rrezikshme, por jo vdekjeprurëse. E pashë gruan time të çmuar, duke ledhatuar butësisht kokën e djalit tonë të mitur, dhe pyeta veten se çfarë lloj gruaje do të bënte diçka kaq të guximshme.



Kjo situatë mund të kishte qenë po aq e rrezikshme emocionalisht sa edhe avaria e vërtetë e motorit tonë. Me mirënjohje, pasi duruam qëndrimet tona të heshtura për njëfarë kohe të arsyeshme, secili nga ne duke besuar se personi tjetër ishte fajtor, shprehëm më në fund emocionet që gëlonin nën shpërthimet tona të nxe-hura. Ndjenjat e shprehura të dashurisë dhe frikës për sigurinë e tjetrit nuk e lejuan incidentin e rrezikshëm të përfundonte vdekjeprurës për martesën tonë të dashur.

Pali paralajmëroi: “Asnjë fjalë e keqe le të mos dalë nga goja juaj, por [vetëm] ajo që është e mirë [dhe] ndër[uese], . . . që t’u japë hir atyre që dëgjojnë” (Efesianëve 4:29). Fjalët e tij përçojnë një masë dëlirësie.

Çfarë do të thotë për ju fraza “asnjë fjalë e keqe”? Ne vazhdimisht përjetojmë ndjenja mjaft të ngarkuara me zemërim – vetë ndjenjat tona dhe të tjerëve. Ne kemi parë zemërim të pakontrolluar të vërshojë në vende publike. E kemi përjetuar atë si një lloj “shkarkese elektrike” emocionale në ngjarjet sportive, në arenën politike dhe madje në vetë shtëpitë tona.

Fëmijët ndonjëherë u flasin prindërve të dashur me gjuhë po aq të mprehta sa tehu i shpatës. Bashkëshortët e bashkëshortet, që kanë ndarë disa prej përvojave më të pasura dhe më të dhembshura të jetës, e humbasin largpamësinë dhe durimin me njëri-tjetrin dhe i ngrenë zërat e tyre. Të gjithë ne, edhe pse fëmijë të besëlidhjes së një Ati të dashur Qiellor, kemi ndier keqardhje që, duke i dhënë të drejtë vetes, jemi sulur me vrik për t’i gjykuar të tjerët dhe kemi folur me fjalë gërryese përpara se ta kuptonim situatën nga këndvështrimi i dikujt tjetër. Ne të gjithë kemi pasur mundësi të mësojmë se si fjalët shkatërrimtare mund ta kthejnë një situatë nga të rrezikshme në vdekjeprurëse.

Një letër e kohëve të fundit nga Presidenca e Parë deklaroi qartazi: “Ungjilli i Jezu Krishtit na mëson t’i duam dhe t’i trajtojmë të gjithë njerëzit me mirësi dhe qytetari – edhe kur nuk jemi dakord” (First Presidency letter [Letër e Presidencës së Parë], 10 janar 2014). Çfarë kujtuesi mjeshtëror, që ne mundemi dhe ne duhet të marrim pjesë në vazhdimin e dialogut qytetar,

veçanërisht kur e shohim botën nga këndvështrime të ndryshme.

Shkruesi i Fjalëve të Urta këshillon: “Përgjigja e ëmbël e fashit zemërimin, por fjala therëse e nxit zemërimin” (Fjalët e Urta 15:1). Një “përgjigje] e ëmbël” përbëhet nga një reagim i arsyeshëm – fjalë të shtruara nga një zemër e përlur. Kjo nuk do të thotë që ne kurrë nuk shprehemi drejtpërdrejt apo që ne bëjmë lëshim për të vërtetat doktrinale. Fjalët që mund të jenë të prera në informacion, mund të jenë të buta në shpirt.

Libri i Mormonit përmban një shembull të goditur të të folurit pohues të dhënë gjithashtu në rrethanat e një mosmarrëveshjeje martesore. Bijtë e Sarias dhe Lehit ishin dërguar sërish në Jerusalem për të marrë fletët prej tunxhi dhe nuk ishin kthyer. Saria besonte se bijtë e saj ishin në rrezik dhe ajo u mbush me zemërim dhe i duhej dikush për ta fajësuar.

Dëgjojeni historinë nga këndvështrimi i birit të saj, Nefit: “Pasi [nëna ime] kishte kujtuar se kishim mbaruar në vendin e shkretë; dhe gjithashtu ishte ankuar kundër atit tim, duke i thënë se ai ishte një njeri vegimtar, duke thënë: Vër re, ti na nxore nga toka e trashëgimit tonë dhe bijtë e mi nuk janë më dhe ne mbarojmë në vendin e shkretë” (1 Nefi 5:2).

Tani, le të marrim parasysh se çfarë mund të ishte duke menduar Saria. Ajo ishte e mbushur me ankth për kthimin e bijve të saj grindavecë në vendin ku të shoqit i ishte kërcënuar jeta. Ajo i kishte këmbyer shtëpinë dhe miqtë e saj të dashur për një çadër në një vend të shkretë, të izoluar, ndërsa ishte ende në moshën që mund të lindte fëmijë. E çuar në pikën që nuk mbante më nga frika e saj, Saria duket se është hedhur në mënyrë heroike, edhe pse të paarsyeshme, nga lartësia e një kamioni jashtë kontrollit në

përpjekje për të mbrojtur familjen e saj. Ajo i shprehu të shoqit shqetësime të logjikshme në një gjuhë zemërimi dhe dyshimi e fajësimi – gjuhë në të cilën e gjithë raca njerëzore duket të jetë çuditërisht mjaft e aftë.

Profeti Lehi e dëgjoi frikën që përforconte zemërimin e së shoqes. Pastaj ai dha një përgjigje të shtruar në gjuhën e dhembshurisë. Së pari, ai e pranoi të vërtetën lidhur me mënyrën se si dukeshin gjërat nga këndvështrimi i saj: “Dhe . . . ati im i foli asaj, duke thënë: Unë e di se jam një njeri vegimtar, . . . por [po] të kisha qëndruar në Jeruzalem [ne] do të kish[im] mbaruar me vëllezërit e mi” (1 Nefi 5:4).

Më pas bashkëshorti i saj iu drejtua frikës së saj lidhur me mirëqenien e bijve të tyre, teksa Fryma e Shenjtë i dëshmoi pa dyshim atij, duke thënë:

“Por vër re, unë mora një tokë të premtimit, në gjërat e së cilës unë gëzohem; po, dhe e di se Zoti do t’i shpëtojë djemtë e mi nga duart e Labanit. . . .

Dhe me këtë gjuhë, ati im, Lehi, e ngushëlloi nënën time . . . në lidhje me ne” (1 Nefi 5:5–6).

Sot ekziston një nevojë e madhe që burrat dhe gratë të kultivojnë respekt



për njëri-tjetrin përtej diferencave të mëdha të besimit e të sjelljes dhe përtej hendeqeve të thella të qëllimeve kontradiktore. Është e pamundur të dish gjithçka që hyn në mendjet e zemrat tona, apo edhe të kuptosh rrethanat e sprovave dhe të zgjedhjeve që has secili nga ne.

Sidoqoftë, çfarë do të ndodhte me “fjalë[n] e keqe” për të cilën foli Pali, nëse vetë pozicioni ynë do të përfshinte së pari ndjeshmëri për përvojën e tjetrit? Duke i pranuar plotësisht kufijtë e vetë papërsosurive dhe dobësive të mia, unë ju përgjerohem që të ushtroheni të bëni këtë pyetje, me konsideratë të dhimbsur për përvojën e tjetrit: “Çfarë po mendon ti?”


Ju kujtohet kur Zoti i befasoji Samuelin dhe Saulin duke zgjedhur një djalë

të vogël bari, Davidin e Bethlehemit, si mbretin e Izraelit? Zoti i tha profetit të Tij: “Sepse Zoti nuk shikon si shikon njeriu, njeriu shikon pamjen, kurse Zoti shikon zemrën” (1 Samuelit 16:7).

Kur kabina e kamionit tonë u mbush me tym, gruaja ime veptoi në mënyrën më të guximshme që mund të mendonte, për ta mbrojtur djalin tonë. Edhe unë veptova si mbrojtës, kur e vura në dyshim zgjedhjen e saj. Si për çudi, nuk kishte rëndësi se cili kishte më shumë të drejtë. Ajo që kishte rëndësi, ishte që ta dëgjonim njëri-tjetrin dhe të kuptonim pikëpamjen e tjetrit.

Gatishmëria për të parë me sytë e njëri-tjetrit do ta shndërrojë “fjalë[n] e keqe” në “[dhënie] hir[il]”. Apostulli Pal e kuptoi këtë dhe secili nga ne mund ta përjetojë gjithashtu atë në njëfarë mase. Kjo mund të mos e ndryshojë apo zgjidhë problemin, por mundësia më e rëndësishme mund të jetë nëse dhënia e hirit mund të na ndryshojë ne.

Unë jap dëshmi të përlulur se ne mund të “jap[im] hir” nëpërmjet gjuhës së dhembshur, kur dhurata e kultivuar e Frymës së Shenjtë i përshkon zemrat tona me ndjeshmëri për ndjenjat dhe rrethanat e të tjerëve. Ajo na mundëson t’i shndërrojmë situatat e rrezikshme në vende të shenjta. Unë dëshmoj për Shpëtimtarin e dashur, i cili “shikon zemrën [tonë]” dhe merakoset për atë çfarë po mendojmë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■





Nga Plaku Kuentin L. Kuk,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Rrënjët dhe Degët

Përsheptimi i historisë familjare dhe i punës në tempull në kohën tonë është thelbësor për shpëtimin dhe ekzaltimin e familjeve.

Pikërisht para vdekjes së tij nga kanceri në vitin 1981, shkrimtari polemizues, Uilliam Sarojan, u tha gazetarëve: “Kushdo duhet të vdesë, por unë gjithmonë mendova se do të bëhej përjashtim në rastin tim. Po tani?”¹

Fraza “po tani” në përballjen me vdekjen në këtë jetë dhe fraza “po tani” në soditjen e jetës pas vdekjes janë në qendër të pyetjeve të shpirtit, të cilave ungjilli i rivendosur i Jezu Krishtit u përgjigjet kaq bukur në planin e Atit për lumturinë.

Në këtë jetë ne qeshim, ne qajmë, ne punojmë, ne luajmë, ne jetojmë dhe më pas ne vdesim. Jobi bën pyetjen e përmbledhur: “Në qoftë se njeriu vdes, a mund të kthehet përsëri në jetë?”² Përgjigjja është një po kumbuese, për shkak të sakrificës shlyese të Shpëtimtarit. Një pjesë e shpjegimit paraqitës të larmishëm të Jobit për pyetjen është tërheqëse: “Njeriu i lindur nga një grua jeton pak ditë. . . Mbin si një lule, pastaj pritet. . . Për drurin ka shpresë; në rast se pritet, rritet përsëri dhe vazhdon të mugullojë [dhe ajo degë e njomë nuk do] të vdesë . . . dhe lëshon degë si një bimë.”³

Plani i Atit tonë është rreth familjeve. Disa prej shkrimeve tona të shenjta më prekëse e përdorin konceptin e

pemës me rrënjët dhe degët e saj si analogji.

Në kapitullin përfundimtar të Dhiatës së Vjetër, Malakia, në përshkrimin e Ardhes së Dytë të Shpëtimtarit, e përdor plot gjallëri këtë analogji. Duke folur për krenarët dhe të ligjtë, ai shënon se ata do të digjen si kallamishte dhe “që [nuk do t’u] mbetet as rrënja as dega”⁴. Malakia e mbyll këtë kapitull me premtimin siguridhënës të Zotit:

“Ja, unë do t’ju dërgoj Elian, profetin, para se të vijë dita e madhe dhe e llahtarshme e Zotit.



Ai do të bëjë që zemra e etërve t’u kthehet bijve dhe zemra e bijve etërve, me qëllim që vendi të mos goditet nga një shfarosje e plotë.”⁵

Në agimin e Ringjalljes, Moroni e ritheksoi këtë mesazh në udhëzimin e tij fillestar dhënë të riut Jozef Smith në vitin 1823.⁶

Të krishterët dhe judenjtë në mbarë botën e pranojnë rrefimin e Dhiatës së Vjetër për Elijan.⁷ Ai ishte profeti i fundit që mbajti fuqinë vulosëse të Priftërisë Melkizedeke përpara kohës së Jezu Krishtit.⁸

Elija Rivendos Çelësat

Kthimi i Elijas ndodhi në Tempullin e Kirtlandit më 3 prill 1836. Ai shpalli se po përmbushte premtimin e Malakias. Ai dorëzoi çelësat e priftërisë për vulosjen e familjeve në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore.⁹ Misioni i Elijas lehtësohet me anë të asaj që nganjëherë quhet shpirti i Elijas, i cili, sikurse na ka mësuar Plaku Rasëll M. Nelson, është “një shfaqje e Frymës së Shenjtë që jep dëshmi për natyrën hyjnore të familjes”¹⁰.

Shpëtimtari foli me forcë rreth domosdoshmërisë së pagëzimit. Ai na mësoi: “Kush nuk ka lindur nga uji dhe nga Fryma, nuk mund të hyjë në mbretërinë e Perëndisë”¹¹. Shpëtimtari vetë u pagëzua për të dhënë shembullin. Por çfarë ndodh me të vdekurit që nuk janë pagëzuar?

Doktrina e Tempullit dhe Puna për Historinë Familjare

Më 11 tetor 1840, në Nauvu, Vajlet Kimball i shkroi një letër burrit të saj, Plakut Hibër C. Kimball, i cili, me anëtarë të tjerë të Të Dymbëdhjetëve, po shërbente në një mision në Britaninë e Madhe. Konferenca e përgjithshme e tetorit ishte mbajtur pak ditë më parë.

Unë po citoj nga disa pjesë të letrës personale të Vajletës: “Ne patëm

konferencën më të madhe dhe më interesante që ka qenë ndonjëherë që kur u organizua Kisha. . . . Presidenti [Jozef] Smith ka folur për një çështje të re dhe të lavdishme. . . . Ajo është, bërja e pagëzimit për të vdekurit. Pali flet për të, në letrën e parë drejtuar Korintasve, kapitulli i 15-të, vargu i 29-të. Jozefi ka marrë një shpjegim më të plotë për të me anë të zbulesës. Ai thotë se është privilegji i [anëtarëve të] kësaj Kise për t'u pagëzuar për të gjithë të afërmit e tyre që kanë vdekur para se të dilte në dritë ky ungjill. . . . Duke e bërë këtë, ne veprojmë si përfaqësues për ta dhe u japim atyre privilegjin për t'u ngritur në Ringjalljen e Parë. Ai thotë se atyre do t'u predikohet ungjilli në burg.”

Vajleta shtoi: “Dua të pagëzohem për nënën time. . . . A s’është kjo një doktrinë e lavdishme?”¹²

Doktrina thelbësore e bashkimit të familjeve doli në dritë rresht pas rreshti e parim pas parimi. Ordinancat mëkëmbëse janë në qendër të lidhjes së bashku të familjeve të përjetshme, duke bashkuar rrënjët me degët.

Doktrina e familjes në lidhje me historinë familjare dhe punën e tempullit është e qartë. Zoti në udhëzimet e zbulesës fillestare iu drejtua “pagëzimi[t] për të vdekurit *tuaj*”¹³. Detyrimi ynë doktrinor është kundrejt vetë paraardhësve tanë. Kjo është nga që organizimi çelestial i qiellit bazohet tek familjet.¹⁴ Presidenca e Parë i ka nxitur anëtarët, veçanërisht rininë dhe të rinjtë në moshë madhore beqarë, që ta theksojnë punën për historinë familjare dhe ordinancat për emrat e vetë familjeve të tyre ose për emrat e paraardhësve të anëtarëve të lagjeve dhe kunjeve të tyre.¹⁵ Ne kemi nevojë të lidhemi si me rrënjët dhe me degët. Mendimi i të qenit të shoqëruar në mbretërimin e përjetshëm është me të vërtetë i lavdishëm.



Tempujt

Uillford Udraf tregoi se Profeti Jozef Smith jetoi aq sa të mjaftonte për të ngritur themelin për punë në tempull. Herën më të fundit që ai, Jozef Smithi, u takua me Kuorumin e Të Dymbëdhjetëve, ai u dha atyre indaumentet e tyre.¹⁶

Pas martirizimit të Profetit, shenjtoret e përfunduan Tempullin e

Nauvusë dhe fuqia vulosëse u përdor për të bekuar mijëra e anëtarëve besnikë përpara eksodit drejt Maleve Shkëmbore. Tridhjetë vjet më vonë, në përfundimin e Tempullit të Seint-Xhorxhit, Presidenti Brigam Jang shpjegoi rëndësinë e përjetshme të ordinancave shpëtuese që më së fundi ishin të disponueshme si për të gjallët dhe për të vdekurit.¹⁷



Kjo thuhet në mënyrë të thjeshtë nga Presidenti Uillford Udraf: “Vështirë se ka ndonjë parim që Zoti e ka zbuluar, për të cilin jam gëzuar më shumë sesa për shëlbimin e të vdekurve tanë; që ne vërtet do t’i kemi etërit tanë, nënat tona, bashkëshortet tona dhe fëmijët tanë me vete në organizatën e familjes, në mëngjesin e ringjalljes së parë dhe në Mbretërinë Çelestiale. Këto janë parime të madhërishtme. Ia vlejnjë çdo sakrificë.”¹⁸

Ç’kohë e mrekullueshme për të qenë gjallë. Kjo është periudha e fundit e kujdestarisë ungjillore dhe ne mund ta ndiejmë përshpejtimin e punës për shpëtimin në çdo fushë ku përfshihet një ordinancë shpëtuese.¹⁹ Tani kemi tempuj përmes pjesës më të madhe të botës për t’i siguruar këto ordinanca shpëtuese. Vajtja në tempull për ripërtëritje shpirtërore, paqe, siguri dhe drejtim në jetën tonë është gjithashtu një bekim i madh.²⁰

Më pak se një vit pasi Presidenti Tomas S. Monson u thirr si Apostull, ai përkushtoi Bibliotekën Gjenealogjike të Tempullit të Los-Anxhelesit. Ai foli për paraardhës të vdekur “duke pritur [për] ditën kur ju dhe unë do të bëjmë kërkimin që nevojitet për të hapur udhën . . . [dhe] po ashtu për të shkuar në shtëpinë e Perëndisë dhe për ta kryer atë punë . . . që ata . . . nuk mund ta kryejnë”²¹.

Kur Plaku Monson i atëhershëm i tha ato fjalë përkushtuese më 20 qershor 1964, kishte vetëm 12 tempuj në funksionim. Gjatë periudhës që Presidenti Monson ka shërbyer në këshillat drejtues të Kishës, 130 nga 142 prej tempujve në funksionim kanë pasur përkushtimin e tyre fillestar. S’është gjë tjetër veçse një mrekulli të shohësh përshpejtimin e punës së shpëtimit në kohën tonë. Njëzet e tetë tempuj të tjerë janë shpallur dhe janë në faza të ndryshme të përfundimit. Tetëdhjetë e pesë përqind e anëtarëve të Kishës jetojnë tani brenda një largësie prej 320 km nga një tempull.

Teknologjia për Historinë Familjare

Edhe teknologjia për historinë familjare ka përparuar jashtëzakonisht. Presidenti Hauard W. Hanter shpalli në nëntor të vitit 1994: “Ne kemi filluar të përdorim teknologjinë informatike për të përshpejtuar punën e shenjtë të sigurimit të ordinancave për të vdekurit. Roli i teknologjisë . . . është nxitur me të shpejtë nga Zoti vetë. . . . Megjithatë, ne qëndrojmë vetëm te pragu i asaj që mund të bëjmë me këto mjete.”²²

Në 19 vitet që nga kjo thënie profesionale, nxitja me të shpejtë e teknologjisë është pothuajse e pabesueshme. Një nënë 36-vjeçare, me fëmijë të vegjël, kohët e fundit më tha plot hare: “Thjesht mendoni ne kemi shkuar nga

lexuesit e mikrofilmave në qendrat e përkushtuara për historinë familjare, tek ulja në tavolinën e kuzhinës me kompjuterin tim duke bërë histori familjare pasi fëmijët e mi i ka zënë gjumi më së fundi”. Vëllezër e motra, qendrat e historisë familjare janë tashmë në shtëpitë tona.

Puna në tempull dhe për historinë familjare nuk është thjesht rreth nesh. Mendoni për ata në anën tjetër të velit duke pritur për ordinancat shpëtuese që do t’i çlirojnë nga robëria e burgut shpirtëror. *Burgu* përcaktohet si “një gjendje izolimi ose robërie”²³. Ata që janë në robëri, mund të jenë duke bërë pyetjen e Uilliam Sarojanit: “Po tani?”

Një motër besnike tregoi një përvojë të veçantë shpirtërore në Tempullin e Solt-Lejkut. Ndërsa ndodhej në dhomën e konfirmimit, pasi u thanë fjalët e një ordinance mëkëmbëse të konfirmimit, ajo dëgjoi: “Dhe e burgosura do të lirohet!” Ajo pati një ndjenjë të madhe ngutjeje për ata që po prisnin për punën e tyre të pagëzimit dhe të konfirmimit. Pasi u kthye në shtëpi, kërkoi në shkrimet e shenjta për frazën që kishte dëgjuar. Ajo gjeti shpalljen e Jozef Smithit në seksionin 128 të Doktrinës e Besëlidhjeve: “Zemrat tuaja duhet të ngazëlleshin dhe të jenë tepër të gëzuara. Toka duhet të shpërthejë në këngë. Të vdekurit duhet t’i thonë këngë përlehtësi të përjetshëm mbretit Emanuel, që ka shuguruar, përpara se bota të ishte, atë që do të na bëjë të aftë për t’i shëlbuar ata nga burgu i tyre; sepse të burgosurit do të lirohen.”²⁴

Pyetja është, çfarë kemi nevojë të bëjmë? Këshilla e Profetit Jozef ishte që t’i paraqisim në tempull “analet e të vdekurve tanë, të cilët do të jenë të denjë për t’u pranuar plotësisht”²⁵.

Udhëheqja e Kishës i ka drejtuar një thirrje të qartë brezit të ri që të jetë pararoja në përdorimin e teknologjisë për të përjetuar shpirtin e Elias, për t’i

kërkuar paraardhësit e tyre dhe për të kryer ordinanca në tempull për ta.²⁶ Shumica e punës së rëndë në përsheptimin e punës së shpëtimit si për të gjallët dhe të vdekurit do të bëhet nga ju të rinj.²⁷

Nëse të rinjtë në secilën lagje jo vetëm që do të shkojnë në tempull dhe do të bëjnë pagëzime për të vdekurit e tyre, por edhe do të punojnë me familjet e tyre dhe anëtarë të tjerë të lagjeve për të siguruar emrat e familjeve për punën e ordinancave që kryejnë, si ata dhe Kisha do të bekohen tej mase. Mos e nënvleftësoni ndikimin e të vdekurve për t'ju ndihmuar në përpjekjet tuaja dhe gëzimin e takimit më së fundi me ata të cilëve u shërbeni. Bekimi përjetësish të rëndësishëm i bashkimit të vetë familjeve tona është thujtje përtej aftësisë sonë për ta kuptuar.²⁸

Në anëtarësinë mbarëbotërore të Kishës, tashmë pesëdhjetë e një përqind e të rriturve nuk i kanë që të dy prindërit në pjesën Family Tree [Pema Familjare] të faqes së Internetit FamilySearch [Kërkimi i Familjes] të Kishës. Gjashtëdhjetë e pesë përqind e të rriturve nuk i kanë të renditur që të katër gjyshërit.²⁹ Mbani mend, ne pa rrënjët dhe degët tona nuk mund të shpëtohem. Anëtarët e Kishës kanë nevojë ta gjejnë dhe ta vendosin këtë informacion jetik.

Më së fundi ne kemi doktrinën, tempujt dhe teknologjinë që familjet ta përmbushin këtë punë të lavdishme të shpëtimit. Unë sugjeroj një mënyrë që mund të bëhet kjo. Familjet mund të mbajnë një "Mbledhje për Family Tree [Pemën Familjare]". Kjo duhet të jetë një përpjekje e përhershme. Kushdo do të sillte histori, ngjarje dhe fotografi ekzistuese familjare, duke përfshirë zotërime të dashura të gjyshërve dhe prindërve. Të rinjtë tanë janë plot dëshirë që të mësojnë rreth jetës së pjesëtarëve të familjes – nga erdhën dhe si jetuan ata. Shumë

i kanë pasur zemrat e tyre të kthyer tek etërit. Ata i duan historitë dhe fotografitë, dhe e kanë ekspertizën teknologjike për t'i skanuar dhe ngarkuar këto histori e fotografi në rrjet në Family Tree [Pemën Familjare] dhe për t'i lidhur dokumentat burimore me paraardhësit që ato të ruhen për tërë kohën. Sigurisht, synimi kryesor është që të përcaktoni cilat ordinanca janë ende të nevojshme për t'u bërë dhe të caktoni detyra për punën thelbësore në tempull. Broshura *My Family* [Familja Ime] mund të përdoret për të ndihmuar që të shënohet informacioni i familjes, historitë dhe fotografitë që më pas të mund të ngarkohen në rrjet në Family Tree [Pemën Familjare].

Zotimet dhe qëllimet që prieten nga familja, duhet të jenë ndër

përparësitë tona kryesore për ta mbrojtur vendmbërritjen tonë hyjnore. Për ata që po kërkojnë përdorim më të frytshëm të ditës së Shabatit për tërë familjen së bashku, përsheptimi i kësaj pune është një veprimtari mjaft e dobishme. Një nënë plot krenari tregon se si djali i saj 17-vjeçar futet në kompjuter pas kishës të dielën për të bërë punën e historisë familjare dhe djali i saj 10-vjeçar ka shumë dëshirë t'i dëgjojë historitë dhe t'i shohë fotografitë e paraardhësve të tij. Kjo gjë e ka bekuar tërë familjen e tyre që të përjetojnë shpirtin e Elijas. Rrënjët dhe degët tona të çmuara duhet të ushqehen.

Jezu Krishti dha jetën e Tij si një shlyerje mëkëmbëse. Ai i dha zgjidhje





pyetjes përfundimtare të ngritur nga Jobi. Ai e mposhti vdekjen për mbarë njerëzimin, gjë të cilën ne nuk mund ta bënim për veten tonë. Ne, megjithatë, mund të kryejmë ordianca mëkëmbëse dhe të bëhemi me të vërtetë shpëtimtarë në Malin e Sionit³⁰ për vetë familjet tona me qëllim që ne, së bashku me ta, të mund të ekzaltohemi, si edhe të shpëtohemi.

Unë jap dëshmi për flijimin shlyes të Shpëtimtarit dhe për sigurinë e planit të Atit për ne dhe familjet tona. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. William Saroyan, në Henry Allen, "Raging against Aging", *Wall Street Journal*, 31 dhjetor 2011–1 janar 2012, C9.
2. Jobit 14:14.
3. Jobit 14:1, 2, 7, 9.
4. Malakia 4:1. Kohët e fundit disa artikuj gazete kanë raportuar që një numër gjithnjë e në rritje njerëzish po zgjedhin të mos bëjnë fëmijë me qëllim që të përmirësojnë standardin e tyre të të jetuarit (shih Abby Ellin, "The Childless Plan for Their Fading Days", *New York Times*, 15 shkurt 2014, B4). Shumë vende po pakësohen në popullsi si rrjedhim i këtyre zgjedhjeve individuale. Kësaj nganjëherë i drejtohen si "dimri demografik" (shih *The New Economic Reality: Demographic Winter* [dokumentar], byutv.org/shows).
5. Malakia 4:5–6.
6. Shih *History of the Church*, 1:12; Doktrina e Besëlidhje 2.
7. Judenjët kanë qenë duke pritur për kthimin e Elijas për 2.400 vjet. Deri më sot, në Sederet e Pashkës ose darkat

e tyre vjetore, ata caktojnë një vend për të dhe shkojnë te dera duke shpresuar se ai ka ardhur për të lajmëruar ardhjen e Mesias.

8. Shih Udhëzuesi për Shkrimet e Shenjta, "Elija", f. 40.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 110:14–16; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 2.
10. Russell M. Nelson, "A New Harvest Time", *Ensign*, maj 1998, f. 34.
11. Gjoni 3:5.
12. Vilate M. Kimball për Heber C. Kimball, 11 tetor 1840, letrat e Vilate M. Kimball-it, Biblioteka Historike e Kishës; shkrimi dhe shkronjat e mëdha të standardizuara.
13. Doktrina e Besëlidhje 127:5; theksimi i shtuar.
14. Shih *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Filding Smith* (2013), f. 70.
15. Shih letër e Presidencës së Parë, 8 tetor 2012.
16. Shih *The Discourses of Wilford Woodruff*, përzgji. G. Homer Durham (1946), f. 147.
17. Brigam Jangu tha: "Gjithë çfarë dua është ta shoh këtë popull që t'ia përkushtojë mjetet dhe interesat e tij ndërtimit të mbretërisë së Perëndisë, duke ngritur tempuj dhe në to duke kryer punë për të gjallët dhe të vdekurit . . . që ata të mund të kurorëzohen bij dhe bija të të Plotfuqishmit" (*Deseret News*, 6 shtator 1876, f. 498). Pagëzimet për të vdekurit filluan (në tempullin e Seint-Xhorxhit) më 9 janar 1877 dhe indaumentet për të vdekurit u kryen dy vjet më vonë. Gëzimi për këto ordianca u shpreh nga Lusi B. Jang, e cila tha se "zemra e saj u mbush me mirënjohje për mundësinë e të qenit e pritur nga [të afërmët e saj të vdekur] me mall të madh, siç do të pritëshin të gjithë prej atyre që nuk mund ta bënin punën për veten e tyre" (në Richard E. Bennett, "Which Is the Wisest Course? The Transformation in Mormon Temple

Consciousness, 1870–1898", *BYU Studies Quarterly*, vëll. 52, nr. 2 [2013], f. 22).

18. *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* (2004), f. 192–93.
19. Presidenti Uillford Udraf (që njihet se ishte për të gjallët një nga misionarët më të mëdhenj të të gjithë kohës), duke folur për punën për të vdekurit, tha: "Unë e shoh këtë pjesë të shërbesës sonë si një mision me po aq rëndësi sa predikimi për të gjallët; të vdekurit do ta dëgjojnë zërin e shërbëtorëve të Perëndisë në botën e shpirtave dhe ata nuk mund të ngrihen në mëngjesin e ringjalljes [së parë], në qoftë se ordianca të caktuara nuk kryhen për [ta]". Ai gjithashtu tha: "Duhet po aq për të shpëtuar një njeri të vdekur . . . sa duhet për një të gjallë" (*Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff*, f. 188).
20. Presidenti Hauard W. Hanter i ftoi anëtarët e Kishës që të shkonin në tempull shpesh "për bekimin vetjak të adhurimit në tempull, për shenjtërinë dhe sigurinë që jepet brenda atyre mureve të shenjtëruar e të përkushtuar. . . . Ai është i shenjtë për Zotin. Ai duhet të jetë i shenjtë për ne" ("The Great Symbol of Our Membership", *Tambuli*, nëntor 1994, f. 6).
21. "Messages of Inspiration from President Thomas S. Monson", *Church News*, 29 dhjetor 2013, f. 2.
22. Howard W. Hunter, "We Have a Work to Do", *Ensign*, mars 1995, f. 65.
23. *Merriam-Webster's Collegiate Dictionary*, bot. i 11-të (2003), "prison [burg]".
24. Doktrina e Besëlidhje 128:22; shih edhe Doktrina e Besëlidhje 138:42. "Përpara se të ishte bota, Zoti shguroi atë që i bën të aftë shpirtat në [burg] që të shëlbepen" (index to the triple combination, "Prison").
25. Doktrina e Besëlidhje 128:24.
26. Shih Letër e Presidencës së Parë, 8 tetor 2012; shih edhe Dejvid A. Bednar, "Zemrat e Fëmijëve Do të Kthehen", *Liahona*, nëntor 2011, f. 24–27; R. Scott Lloyd, "Find Our Cousins': Apostle [Neil L. Andersen] Counsels LDS Youth at RootsTech Conference", *Church News*, 16 shkurt 2014, f. 8–9.
27. Një studim i kohës së fundit tregoi se një theksim kryesor për këtë brez është të jetuarit e një jete plot domethënie ku ata "u japin të tjerëve ose e drejtojnë vetveten te një qëllim më i madh" (Emily Esfahani Smith dhe Jennifer L. Aaker, "Millennial Searchers", *New York Times Sunday Review*, 1 dhjetor 2013, f. 6).
28. Shih Howard W. Hunter, "A Temple-Motivated People", *Liahona*, maj 1995, f. 2–7.
29. Statistika të dhëna nga Departamenti i Historisë Familjare.
30. Shih Abdia 1:21.



Nga Plaku Dallin H. Oaks,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë

Çelësat e priftërisë drejtojnë gratë, ashtu sikurse burrat dhe ordinancat e priftërisë dhe autoriteti i priftërisë u përkasin grave, ashtu sikurse burrave.

I.

Në këtë konferencë ne kemi parë lirim nga detyra të disa vëllezërve besnikë dhe kemi mbështetur thirrjet e të tjerëve. Në këtë cikël ndryshimi të thirrjeve – kaq të njohur në Kishë – ne nuk “zbresim më poshtë” kur lirohemi dhe as nuk “ngjitemi më lart” kur marrim një thirrje. Nuk ka “lart ose poshtë” në shërbimin e Zotit. Ka vetëm “përpara ose prapa” dhe ai dallim varet nga mënyra se si i pranojmë e veprojmë me lirimet tona dhe me thirrjet tona. Dikur kryesova në lirimin e një presidenti kunji të ri në moshë, i cili kishte dhënë shërbim të mirë për nëntë vjet dhe tani po gëzohej me lirimin e tij dhe me thirrjen e re që ai dhe gruaja e tij sapo kishin marrë. Ata u thirrën të ishin udhëheqësit e çerdhes në lagjen e tyre. Vetëm në këtë Kishë do të shihej ajo si thirrje po aq e nderuar!

II.

Ndërsa i fliste një konference grash, presidentja e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, Linda K. Barton tha: “Ne

shpresojmë të rrënjosisim brenda secilës prej nesh një dëshirë më të madhe për ta kuptuar më mirë priftërinë”¹. Ajo nevojë zbatohet tek të gjithë ne dhe unë do ta vazhdoj atë duke iu folur për çelësat dhe autoritetin e priftërisë. Përderisa këto tema janë të një shqetësimi të barabartë si për burrat



dhe për gratë, jam i gëzuar që këto punime të konferencës transmetohen dhe botohen për të gjithë anëtarët e Kishës. Fuqia e priftërisë na bekon ne të gjithëve. Çelësat e priftërisë drejtojnë gratë, ashtu sikurse burrat dhe ordinancat e priftërisë dhe autoriteti i priftërisë u përkasin grave, ashtu sikurse burrave.

III.

Presidenti Jozef F. Smith e përshkroi priftërinë si “fuqia e Perëndisë dhënë njeriut përmes së cilës njeriu mund të veprojë në tokë për shpëtimin e familjes njerëzore”². Udhëheqës të tjerë na kanë mësuar se priftëria “është fuqia më e lartë në këtë tokë. Ajo është fuqia me të cilën u krijua toka.”³ Shkrimet e shenjta na mësojnë se “kjo Priftëri, që ishte në fillim, do të jetë edhe në fund të botës” (Moisiu 6:7). Prandaj, priftëria është fuqia me anë të së cilës ne vërtet do të ringjallemi dhe përparojmë drejt jetës së përvetshme.

Të kuptuarit që kërkojmë, fillon me një të kuptuar të çelësave të priftërisë. “Çelësat e priftërisë janë autoriteti që Perëndia u ka dhënë [mbajtësve] të priftërisë për të drejtuar, kontrolluar dhe qeverisur përdorimin e priftërisë së Tij në tokë”⁴. Çdo veprim ose ordinancë e kryer në Kishë bëhet nën autorizimin e drejtpërdrejtë ose jo të drejtpërdrejtë të personit që mban çelësat për atë funksion. Sikurse ka shpjeguar Plaku M. Rasëll Ballard: “[Ata që i kanë] çelësat e priftërisë . . . [bëjnë] të mundur me kuptimin e plotë të fjalës, për të gjithë që shërbejnë besnikërisht nën drejtimin e tyre, që ta ushtrojnë autoritetin e priftërisë dhe të kenë mundësi ta përdorin fuqinë e priftërisë”⁵.

Në kontrollin e ushtrimit të autoritetit të priftërisë, funksioni i çelësve të priftërisë zgjeron, si edhe kufizon. Ai zgjeron duke bërë të mundur që



autoriteti dhe bekimet e priftërisë të jenë të disponueshme për të gjithë fëmijët e Perëndisë. Ai kufizon duke udhëzuar se kujt do t'i jepet autoriteti i priftërisë, kush do t'i mbajë detyrat e saj dhe se si do të jepen të drejtat dhe fuqitë e saj. Për shembull, një njeri që mban priftërinë, nuk është në gjendje t'ia japë dikujt tjetër detyrën ose autoritetin e tij, në qoftë se nuk autorizohet nga dikush që i mban çelësat. Pa atë autorizim, shugurimi do të ishte i pavlefshëm. Kjo shpjegon përse një mbajtës i priftërisë – pavarësisht nga detyra – nuk mund të shugurojë një anëtar të familjes së tij ose nuk mund ta administrojë sakramentin në shtëpinë e vet pa autorizim nga ai person i cili mban çelësat e duhur.

Me përjashtimin e punës së shenjtë që motrat bëjnë në tempull me anë të autoritetit të çelësave të mbajtur nga presidenti i tempullit, gjë që do ta përshkruaj më vonë, vetëm një njeri i cili mban një detyrë të priftërisë, mund të veprojë në një ordinancë të priftërisë.

Dhe të gjitha ordinancat e autorizuara të priftërisë shënohen në analet e Kishës.

Së fundi, të gjithë çelësat e priftërisë mbahen nga Zoti Jezu Krisht, priftëria e të cilit është ajo. Ai është personi që vendos cilët çelësa u jepen njerëzve të vdekshëm dhe mënyrën se si do të përdoren ata çelësa. Ne jemi mësuar të mendojmë se të gjithë çelësat e priftërisë iu dhanë Jozef Smithit në Tempullin e Kirtland-it, por shkrimi i shenjtë thotë se gjithë çfarë u dha atje ishin “çelësat e kësaj periudhe të kujdestarisë” (DeB 110:16). Në konferencën e përgjithshme shumë vite më parë, Presidenti Spenser W. Kimball na kujtoi se ka çelësa të tjerë të priftërisë që nuk i janë dhënë njeriut në tokë, përfshirë çelësat e krijimit dhe të ringjalljes.⁶

Natyra hyjnore e kufizimeve të vendosura mbi ushtrimin e çelësave të priftërisë shpjegon një dallim thelbësor midis vendimeve mbi çështje të administrimit të Kishës dhe vendimeve që e ndikojnë priftërinë. Presidenca e

Parë dhe Këshilli i Presidencës së Parë e i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, të cilët kryesojnë mbi Kishën, autorizohen për të marrë shumë vendime që i ndikojnë rregulloret dhe procedurat e Kishës – çështje të tilla si vendndodhja e ndërtesave të Kishës dhe moshat për shërbimin misionar. Por edhe pse këta autoritete kryesues mbajnë dhe ushtrojnë të gjithë çelësat të dhëna njerëzve në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore, ata nuk e kanë lirinë ta ndryshojnë modelin e shpalluar në mënyrë hyjnore se vetëm meshkujt do të mbajnë detyra në priftëri.

IV.

Tani vij tek tema e autoritetit të priftërisë. Po filloj me tri parime të sapodiskutuara: 1) priftëria është fuqia e Perëndisë dhënë njeriut që të veprojë për shpëtimin e familjes njerëzore, 2) autoriteti i priftërisë qeveriset nga mbajtës të priftërisë, të cilët mbajnë çelësat e priftërisë, dhe 3) përderisa shkrimet e shenja thonë se “gjithë autoritetet [dhe] detyrat e tjera në kishë janë shtesa të kësaj priftërie [Melkizedekel]” (DeB 107:5), gjithçka që bëhet nën drejtimin e atyre çelësve të priftërisë, bëhet me autoritetin e priftërisë.

Si zbatohet kjo për gratë? Në një fjalim drejtuar Shoqatës së Ndhmës, Presidenti Jozef Filding Smith, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha këtë: “Ndërsa motrave nuk iu është dhënë Priftëria, nuk iu është caktuar atyre, kjo nuk do të thotë se Zoti nuk u ka dhënë atyre autoritet. . . . Një njeri mund të ketë autoritet të dhënë atij, ose një motër të dhënë asaj, për të bërë gjëra të caktuara në Kishë, të cilat janë lidhëse dhe tërësisht të nevojshme për shpëtimin tonë, siç është puna që motrat tona bëjnë në Shtëpinë e Zotit. Ato kanë autoritet të dhënë atyre për të bërë

disa gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, të shenjta për Zotin dhe lidhëse, në mënyrë po aq tërësore sa ç'janë bekimet që jepen nga burrat që mbajnë Priftërinë.”⁷

Në atë fjalim të shquar, Presidenti Smith tha në mënyrë të përsëritur se grave u është dhënë autoritet. Grave ai u tha: “Ju mund të flisni me autoritet, sepse Zoti ka vendosur autoritet mbi ju”. Ai gjithashtu tha se Shoqatës së Ndihmës i “[është] dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë shumë gjëra të madhërishtme. Puna që ato bëjnë, bëhet nëpërmjet autoritetit hyjnor”. Dhe, sigurisht, puna e Kishës, e bërë nga burra ose gra, qoftë në tempull apo në lagjet ose degët, bëhet nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësa të priftërisë. Kështu, duke folur për Shoqatën e Ndihmës, Presidenti Smith shpjegoi: “[Zoti] ua ka dhënë atyre këtë organizatë të madhërishtme ku ato kanë autoritet për të shërbyer nën drejtimin e peshkopëve të lagjeve . . . , duke u kujdesur për interesin e njerëzve tanë si shpirtërisht ashtu dhe materialisht”⁸.

Prandaj, thuhet me të vërtetë se për gratë, Shoqata e Ndihmës nuk është thjesht një orë mësimore, por diçka së cilës i përkasin – një shtesë e priftërisë, e krijuar në mënyrë hyjnore.⁹

Ne nuk e kemi zakon të flasim për gratë që të kenë autoritetin e priftërisë në thirrjet e tyre në Kishë, por çfarë autoriteti tjetër mund të jetë ai? Kur një grua – e re apo e moshuar – veçohet për të predikuar ungjillin si një misionare kohëplotë, asaj i jepet autoritet priftërie për të kryer një funksion priftërie. E njëjta gjë është e vërtetë kur një grua veçohet për të vepruar si nëpunëse ose mësuese në një organizatë të Kishës, nën drejtimin e një personi që mban çelësat e priftërisë. Kushdo që vepron në një detyrë ose thirrje të marrë nga një njeri që mban çelësat e priftërisë, ushtron autoritet priftërie



në kryerjen e detyrave të caktuara atij ose asaj.

Cilëtdo që ushtrojnë autoritet priftërie, duhet t'i harrojnë të drejtat e tyre dhe të përqendrohen te përgjegjësitë e tyre. Ky është një parim që nevojitet për mbarë shoqërinë. Shkrimtari i famshëm rus, Aleksandër Solzhenicin, citohet se tha: “Është koha . . . për të mos i mbrojtur kaq shumë të drejtat njerëzore, por për të mbrojtur detyrimet njerëzore”¹⁰. Shenjtorët e ditëve të mëvonshme sigurisht e dinë se cilësimi për ekzaltim nuk është një çështje e kërkimit të të drejtave, por një çështje e plotësimit të përgjegjësisë.



V.

Zoti ka udhëzuar se vetëm burrat do të shugurohen në detyra në priftëri. Por, siç e kanë theksuar udhëheqës të ndryshëm të Kishës, burrat nuk janë “priftëria”¹¹. Burrat e mbajnë priftërinë, me një detyrë të shenjtë për ta përdorur atë për bekimin e gjithë fëmijëve të Perëndisë.

Fuqia më e madhe që Perëndia u ka dhënë bijve të Tij, nuk mund të ushtrohet pa shoqërinë e një prej bijave të Tij, sepse vetëm bijave të Tij u ka dhënë Perëndia fuqinë “për të qenë një krijuese e trupave . . . kështu që synimi dhe Plani i Madh i Perëndisë të mund të arrijnë plotësim”¹². Këto janë fjalët e Presidentit J. Ruben Klark.

Ai vazhdoi: “Ky është vendi i bashkëshorteve tona dhe i nënave tona në Planin e Përrjetshëm. Ato nuk janë mbajtëse të Priftërisë; ato nuk ngarkohen me kryerjen e detyrave dhe të funksioneve të Priftërisë; as nuk u lihet atyre barra e përgjegjësisë të saj; ato janë krijuese dhe organizuese nën fuqinë e saj dhe pjesëmarrëse të bekimeve të saj, duke zotëruar mbështetjen e fuqive të Priftërisë dhe duke zotëruar një funksion të thirrur në po atë mënyrë hyjnore, po aq të rëndësishëm përjetësisht në vendin e tij, sa dhe vetë Priftëria.”¹³

Në ato fjalë të frymëzuara, Presidenti Klark po fliste mbi familjen. Sikurse thuhet në proklamaten për familjen, ati kryeson në familje dhe ai dhe nëna kanë përgjegjësi të ndara, por ata “kanë detyrim të ndihmojnë njëri-tjetrin si partnerë të barabartë”¹⁴.



Disa vite përpara proklamatës për familjen, Presidenti Spenser W. Kimball dha këtë shpjegim të frymëzuar: “Kur flasim për martesën si një bashkëpjesëmarrje, le të flasim për martesën si një bashkëpjesëmarrje të plotë. Ne nuk duam që gratë tona SHDM të jenë bashkëpjesëmarrëse të heshtura ose bashkëpjesëmarrëse të kufizuara në atë detyrë të përjetshme! Ju lutem të jini një bashkëpjesëmarrëse e frytshme dhe me të drejta të plota.”¹⁵

Në sytë e Perëndisë, qoftë në Kishë apo në familje, gratë dhe burrat janë të barabartë, por kanë përgjegjësi të ndryshme.

Po e mbyll me disa të vërteta rreth bekimeve të priftërisë. Ndryshe nga çelësat e priftërisë dhe nga ordinancat e priftërisë, bekimet e priftërisë janë të disponueshme për gratë dhe për burrat me kushte të barabarta. Dhuratat e Frymës së Shenjtë dhe bekimet e tempullit janë shembuj të njohur të kësaj së vërtete.

Në bisedën e tij të madhërishe në Javën Arsimore të UBJ-së verën e kaluar, Plaku M. Rasëll Ballard dha këto mësimë:

“Doktrina e Kishës sonë i vendos gratë të barabarta dhe prapëseprapë të ndryshme nga burrat. Perëndia nuk e konsideron asnjërin nga gjinitë më

të mirë apo më të rëndësishme se tjetra. . . .

Kur burrat dhe gratë shkojnë në tempull, ata e marrin indaumentin të dy nga e njëjta fuqi, që është fuqia e priftërisë. . . . Mundësia e përdorimit të fuqisë dhe të bekimeve të priftërisë është në dispozicion të të gjithë fëmijëve të Perëndisë.”¹⁶

Unë dëshmoj për fuqinë dhe bekimet e priftërisë së Perëndisë, në dispozicion të njëjtë të bijve dhe bijave të Tij. Unë dëshmoj për autoritetin e priftërisë, që funksionon përmes të gjitha detyrave dhe veprimtarive të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Unë dëshmoj për funksionin e drejtuar në mënyrë hyjnore të çelësave të priftërisë, të mbajtur dhe të ushtruar në plotësinë e tyre nga profeti/presidenti ynë, Tomas S. Monson. Së fundi dhe më e rëndësishmja, unë dëshmoj për Zotin dhe Shpëtimtarin tonë, Jezu Krishtin, priftëria e të cilit është kjo dhe shërbëtorët e të cilit jemi ne, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Linda K. Barton, “Priesthood: A Sacred Trust to Be Used for the Benefit of Men, Women, and Children” (Fjalim nga Konferenca e Grave e Universitetit Brigham Jang, 3 maj 2013), f. 1; ce.byu.edu/cw/womensconference/transcripts.php.

2. Joseph F. Smith, *Gospel Doctrine*, bot. i 5-të (1939), f. 139.
3. Boyd K. Packer, “Priesthood Power in the Home”, (worldwide leadership training meeting [mbledhja e trajnimit për udhëheqjen mbarëbotërore], shkurt 2012; lds.org/broadcasts; shih edhe James E. Faust, “Power in the Priesthood”, *Ensign*, maj 1997, f. 41–43.
4. *Handbook 2 [Manuali 2]: Administrimi i Kishës* (2010), 2.1.1.
5. M. Russell Ballard, “Burrat dhe Gratë në Punën e Zotit”, *Liahona*, prill 2014, f. 48; shih edhe *Daughters in My Kingdom: The History and Work of Relief Society* (2011), f. 138.
6. Shih Spencer W. Kimball, “Our Great Potential”, *Ensign*, maj 1977, f. 49.
7. Joseph Fielding Smith, “Relief Society – an Aid to the Priesthood”, *Revista e Shoqatës së Ndihmës*, janar 1959, f. 4.
8. Joseph Fielding Smith, “Relief Society – an Aid to the Priesthood”, f. 4, 5; shih edhe *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Filding Smith* (2013), f. 309.
9. Shih Boyd K. Packer, “The Relief Society”, *Ensign*, maj 1998, f. 72; shih edhe *Daughters in My Kingdom*, f. 138.
10. Aleksandr Solzhenitsyn, “A World Split Apart” (fjalimi i hyrjes i mbajtur në Universitetin e Harvardit, 8 qershor 1978); shih edhe Patricia T. Holland, “A Woman’s Perspective on the Priesthood”, *Ensign*, korrik 1980, f. 25; *Tambuli*, qershor 1982, f. 23; Dallin H. Oaks, “Rights and Responsibilities”, *Mercer Law Review*, vëll. 36, nr. 2 (dimër 1985), f. 427–442.
11. Shih James E. Faust, “You Are All Heaven Sent”, *Liahona*, nëntor 2002, f. 113; M. Rasëll Ballard, “Kjo Është Vepra dhe Lavdia Ime”, *Liahona*, maj 2013, f. 19; Dallin H. Oaks, “Priesthood Authority in the Family and the Church”, *Liahona*, nëntor 2005, f. 26. Ne nganjëherë themi se Shoqata e Ndihmës është një “bashkëpjesëmarrëse me priftërinë”. Do të ishte më e saktë të thuhej se në punën e Zotit Shoqata e Ndihmës dhe gratë e Kishës janë “bashkëpjesëmarrëse me mbajtësit e priftërisë”.
12. J. Reuben Clark Jr., “Our Wives and Our Mothers in the Eternal Plan”, *Revista e Shoqatës së Ndihmës*, dhjetor 1946, f. 800.
13. J. Reuben Clark Jr., “Our Wives and Our Mothers”, f. 801.
14. “Familja: Një Proklamata drejtuar Botës”, *Liahona*, nëntor 2010, f. 129.
15. Spencer W. Kimball, “Privileges and Responsibilities of Sisters”, *Ensign*, nëntor 1978, f. 106.
16. M. Russell Ballard, *Liahona*, prill 2014, f. 48; shih edhe Sheri L. Dew, *Women and the Priesthood* (2013), veçanërisht kapitullin 6, për një shpjegim të vlefshëm të doktrinave të thëna këtu.



Nga Plaku Donald L. Hallstrom,
i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve

Çfarë Lloj Njerëzish?

Çfarë ndryshimesh kërkohen nga ne që të bëhemi lloji i njerëzve që duhet të jemi?

Teksa e përfytyrojmë këtë mbledhje mbarëbotërore, na kujtohet se nuk ka asgjë të krahasueshme me këtë mbledhje – asgjëkundi. Qëllimi i sesionit të priftërisë të konferencës së përgjithshme, është që t'i mësojë mbajtësit e priftërisë se çfarë lloj njerëzish ne duhet të jemi (shih 3 Nefi 27:27) dhe të na frymëzojë që ta arrijmë atë model të përkryer.

Në vitet e mia në Priftërinë Aarone në Havai gjysmë shekulli më parë dhe si misionar në Angli, ne do të

mblidheshim në godinat e kishave dhe (me përpjekje të vëmendshme) do të dëgjonim sesionin e priftërisë duke përdorur një lidhje telefonike. Në vitet e mëvonshme, satelitët lejuan transmetime për vendndodhje të përzgjedhura të Kishës me disa saçe marrës gjigandë, me qëllim që ne të mund të dëgjonim dhe të shihnim punimet e konferencave. Ne ishim të mahnitur prej asaj teknologjie! Pak mund ta kishin përfytyruar botën e sotme, ku çdonjëri që ka mundësi të përdorë

internetin me një telefon smart, tabletë apo kompjuter, mund t'i marrë mesazhet e kësaj mbledhjeje.

Megjithatë, kjo mundësi e zgjeruar së tepërmi për t'i dëgjuar zërat e shërbëtorëve të Zotit, që janë njësoj si të ishte zëri i vetë Zotit (shih DeB 1:38), ka pak vlerë nëse ne nuk jemi të gatshëm për ta fituar fjalën (shih DeB 11:21) dhe më pas për ta ndjekur atë. E thënë thjesht, qëllimi i konferencës së përgjithshme dhe i këtij sesioni të priftërisë përmbushet vetëm nëse ne jemi të gatshëm të veprojmë – nëse jemi të gatshëm të ndryshojmë.

Disa dekada më parë, po shërbeja si peshkop. Për një kohë të gjatë, u takova me një burrë në lagjen tonë, i cili ishte shumë më i madh në moshë se unë. Ky vëlla kishte një marrëdhënie plot probleme me gruan e tij dhe nuk fliste me fëmijët që kishin së bashku. Ai nuk arrinte të qëndronte i punësuar, nuk kishte miq të afërt dhe e kishte kaq të vështirë të ndërvepronte me anëtarët e lagjes sa më së fundi nuk ishte i gatshëm të shërbente në Kishë. Gjatë një diskutimi të zjarrtë rreth sfidave në jetën e tij, ai u përkuul drejt meje – si të ishte përfundimi i tij për bisedat tona të shumta – dhe tha: “Peshkop, unë jam gjaknxehtë dhe kjo është thjesht mënyra se si jam!”

Ajo thënie më shushati atë natë dhe më ka shqetësuar që nga ajo kohë. Sapo ky burrë vendosi – sapo secili prej nesh arrin në përfundimin – “Kjo është thjesht mënyra se si jam”, ne heqim dorë nga aftësia jonë për të ndryshuar. Prandaj mund të ngremë flamurin e bardhë, t'i dorëzojmë armët, ta pranojmë humbjen e betejës dhe thjesht të heqim dorë – çfarëdo dëshirë për fitore humbet. Ndërkohë që disa prej nesh mund të mendojnë se kjo nuk na përshkruan ne, ndoshta secili prej nesh vë në dukje, me të paktën një ose dy





zakone të këqija, shprehjen “Kjo është thjesht mënyra se si jam”.

Por, ne takohemi në këtë mbledhje të priftërisë, sepse cilët jemi, nuk është cilët mund të bëhemi. Ne mblidhemi këtu sonte në emrin e Jezu Krishtit. Ne mblidhemi me vetëbesimin që Shlyerja e Tij i jep secilit prej nesh – pavarësisht nga dobësitë tona, brishtësitë tona, varësitë tona – aftësinë për të ndryshuar. Ne mblidhemi me shpresën se e ardhmja jonë, pavarësisht nga historia jonë, mund të jetë më e mirë.

Kur marrim pjesë në këtë mbledhje me “qëllim të vërtetë” për të ndryshuar (Moroni 10:4), Shpirti ka lejm të plotë për t’i arritur zemrat dhe mendjet tona. Sikurse Zoti i zbuloi Profetit Jozef Smith: “Dhe do të ndodhë që, për aq sa . . . ushtrojnë besim në mua” – kujtoni, besimi është një parim fuqie dhe veprimi – “unë do ta derdh Shpirtin tim mbi ta në ditën që ata të mblidhen së bashku” (DeB 44:2). Kjo do të thotë sonte!

Nëse mendoni se sfidat tuaja janë të pakapërcyeshme, më lejoni t’ju tregoj për një burrë që e takuam në një fshat të vogël në rrethinat e Hajderabadit, në Indi, në vitin 2006. Ky burrë u bë shembulli i gatishmërisë për të ndryshuar. Apa Rao Nulu u lind në një zonë fshatare të Indisë. Kur ishte tre vjeç, ai kaloi sëmundjen e poliomielitit dhe mbeti i gjymtuar fizikisht. Rendi shoqëror i mësoi atij se potenciali i tij ishte tej mase i kufizuar. Megjithatë, kur ishte i ri në moshë madhore, u takua me misionarët tanë. Ata i mësuam për një potencial më të madh, si në këtë jetë, ashtu edhe në përjetësinë që do të vijë. Ai u pagëzua dhe u konfirmua një anëtar i Kishës. Me një këndvështrim tepër të zgjeruar, ai i caktoi vetes synim që të merrte Priftërinë Melkizedeke dhe të shërbente një mision kohëplotë. Në vitin 1986 ai u shugurua plak dhe u thirr të shërbente në Indi. Ecja nuk ishte e lehtë – ai bëri ç’ishte e mundur, duke përdorur nga

një bastun në secilën dorë, dhe u rrëzua shpesh – por heqja dorë nuk ishte kurrë një mundësi. Ai bëri një zotim, që të shërbente me nder e përkushtim në mision, dhe e mbajti atë.

Kur u takuam me Vëllanë Nulu, rreth 20 vjet pas misionit të tij, ai plot ngazëllim na përshëndeti atje ku mbaronte rruga dhe na zbriti nëpër një shteg të pashtuar plot pluhur drejt shtëpisë me dy dhoma, ku jetonte me gruan dhe tre fëmijët e tij. Ishte një ditë jashtëzakonisht e nxehtë dhe e parehatshme. Ai ende ecte me shumë vështirësi, por nuk kishte aspak keqardhje për veten. Nëpërmjet zellit vetjak, ai është bërë mësues, duke siguruar shkollim për fëmijët e fshatit. Kur hymë në shtëpinë e tij të thjeshtë, ai menjëherë më çoi te një cep dhe nxori një kuti që përmbante gjërat e tij më të rëndësishme. Donte që unë të shihja një fletë letre. Ajo lexonte: “Me urime të mira dhe bekime për Plakun Nulu, një misionar kurajoz dhe i lumtur; [data] 25 qershor 1987; [nënshkruar] Bojd K. Paker”. Në atë rast, kur Plaku Paker i atëhershëm vizitoi Indinë dhe u foli një grupi misionarësh, ai ia pohoi Plakut Nulu potencialin e tij. Në thelb, ajo që Vëllai Nulu po më tregonte atë ditë në vitin 2006, ishte se ungjilli e kishte ndryshuar atë – njëherë e mirë!

Në këtë vizitë të shtëpia e familjes Nulu, ne u shoqëruam nga presidenti i misionit. Ai ishte atje për të intervistuar Vëllanë Nulu, gruan e tij dhe fëmijët e tij – që prindërit të merrnin indaumentet e tyre dhe të vuloseshin së bashku dhe që fëmijët të vuloseshin me prindërit e tyre. Ne gjithashtu i paraqitëm familjes përgatitjet e bëra për ta që të udhëtonin për këto ordianca për në Tempullin e Hong-Kongut në Kinë. Ata derdhën lot gëzimi ngaqë ëndrra e tyre e shumëpritur do të bëhej realitet.

Çfarë pritet nga një mbajtës i priftërisë së Perëndisë? Çfarë ndryshimesh



kërkohen nga ne që të bëhemi lloji i njerëzve që duhet të jemi? Unë bëj tre sugjerime:

1. Ne kemi nevojë të jemi burra të priftërisë! Qofshim të rinj që mbajmë Priftërinë Aarone apo burra që mbajmë Priftërinë Melkizedeke, ne kemi nevojë të jemi burra të priftërisë, duke treguar pjekuri shpirtërore ngaqë i kemi bërë besëlidhjet. Siç tha Pali: “Kur isha fëmijë, flisja si fëmijë, mendoja si fëmijë, arsyetoja si fëmijë, kur u bëra burrë, i flaka gjërat femënore” (1 Korintasve 13:11). Ne duhet të jemi të ndryshëm, sepse mbajmë priftërinë – s’duhet të jemi mendjemëdhenj ose krenarë apo mospërfillës, por të jemi të përlurur, të mësueshëm dhe zemërbutë. Marrja e priftërisë dhe e detyrave të ndryshme të saj duhet të ketë njëfarë kuptimi për ne. Nuk duhet të jetë një “rit” i përciptë “i kalimit” që ndodh automatikisht në mosha të caktuara, por një veprim i shenjtë i besëlidhjes së bërë plot mendim. Ne duhet të ndihemi kaq të privilegjuar dhe kaq mirënjohës sa çdo veprim që bëjmë, e tregon atë. Nëse mendojmë rrallë rreth priftërisë, ne kemi nevojë të ndryshojmë.
2. Ne kemi nevojë të shërbejmë! Thelbi i mbajtjes së priftërisë është

ta lartësojmë thirrjen tonë (shih DeB 84:33) duke u shërbyer të tjerëve. Shmangia e detyrës sonë më të rëndësishme për t’u shërbyer bashkëshorteve tona dhe fëmijëve tanë, mospranimi i thirrjeve ose përmëshja e tyre me plogështi në Kishë, ose moskujdesja për të tjerët nëse nuk është e volitshme, nuk është lloji i njeriut që duhet të jemi. Shpëtimtari shpalli: “Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde” (Mateu 22:37) dhe më pas shtoi: “Nëse më do, duhet të më shërbesh” (DeB 42:29). Egoizmi është antiteza e përgjegjesisë së priftërisë dhe nëse ai është një tipar i karakterit tonë, ne kemi nevojë të ndryshojmë.

3. Ne kemi nevojë të jemi të denjë! Unë mund të mos kem aftësinë e Plakut Xhefri R. Holland kur ai foli në një sesion të priftërisë, pak vite më parë, për të “qëndr[uar] . . . pranë jush, kokë më kokë me shumë [zjarr sa t’ju përcëlloj vetullat]” (“Ne Jemi të Gjithë të Rekrutuar”, *Liahona*, nëntor 2011, f. 45); por, vëllezër të dashur, ne kemi nevojë të zgjohejmë nga mënyra se si praktika të pranuarra gjerësisht në botë e mbytin fuqinë tonë në priftëri. Nëse mendojmë se madje mund të

flirtojmë me pornografinë ose me shkelje të dëlirësisë apo pandershmeri të ndonjë lloji forme dhe kjo nuk do të ndikojë për keq te ne dhe familjet tona, ne mashtrohemi. Moroni shpalli: “Shikoni që të bëni të gjitha gjërat në mënyrë të denjë” (Mormoni 9:29). Zoti fuqishëm na udhëzoi: “Dhe unë tani ju jap një urdhërim të hapni sytë për veten tuaj, t’u vini veshin me zell fjalëve të jetës së përjetshme” (DeB 84:43). Nëse kemi ndonjë mëkat për të cilin s’jemi penduar, që e pengon denjësinë tonë, ne kemi nevojë të ndryshojmë.

E vetmja përgjigje e plotë ndaj pyetjes së ngritur nga Jezu Krishti: “Çfarë lloji njerëzish duhet të jeni?” është ajo që dha Ai në mënyrë të përmbledhur dhe të thellë: “Madje siç jam unë” (3 Nefi 27:27). Ftesa “ejani te Krishti dhe përsosuni në të” (Moroni 10:32) kërkon ndryshim, si edhe shpreson për të. Zemërgjerësisht, Ai nuk na ka lënë vetëm. “Dhe në qoftë se njerëzit vijnë tek unë, unë do t’u tregoj atyre dobësinë e tyre. . . . Atëherë unë do të bëj që gjërat e dobëta, të bëhen të forta” (Ethëri 12:27). Duke u mbështetur te Shlyerja e Shpëtimtarit, ne mund të ndryshojmë. Për këtë jam i sigurt. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Rendëll L. Rid,

Këshilltar i Dytë në Presidencën e Përgjithshme të Të Rinjve

Brezi i Zgjedhjeve

Ju u zgjodhët për të marrë pjesë në punën e Tij në këtë kohë, sepse Ai ka besim se ju do të bëni zgjedhjet e duhura.


Të rinj, ju ndoshta e keni dëgjuar më parë se jeni një “brez i zgjedhur”, që do të thotë se Perëndia ju zgjodhi dhe ju përgatiti që të vini në tokë në këtë kohë për një qëllim të madhërishëm. E di se kjo është e vërtetë. Por, këtë mbrëmje, do të doja t’ju drejtohesha juve si “brezi i zgjedhjeve”, sepse kurrë më parë në histori nuk janë bekuar individët me kaq shumë zgjedhje. Më tepër zgjedhje do të thotë më tepër mundësi; më tepër mundësi do të thotë më tepër potencial për të bërë mirë dhe, fatkeqësisht, për të bërë keq. Unë besoj se Perëndia ju dërgoi këtu në këtë kohë sepse Ai ka mirëbesim se ju do t’ia dilni mbanë të bëni dallimin mes zgjedhjeve mendjeshtrydhëse që ju gjenden.

Në vitin 1974, Presidenti Spenser W. Kimball tha: “Besoj se Zoti mezi pret që t’i vërë në duart tona shpikjet, të cilat ne njerëzit joprofesionistë si zor t’i kemi parë me sy” (“When the World Will Be Converted”, *Ensign*, tetor 1974, f. 10).

Dhe Ai i ka vënë! Ju po rriteni me një nga mjetet më të shkëlqyera për mirë në historinë e njeriut: internetin. Me të vjen një larmi e hollësishme zgjedhjesh. Ky bollëk zgjedhjesh, sidoqoftë, mban me vete një pjesë të barabartë përgjegjshmërie. Ai e lehtëson qasjen tuaj si te vetë e mira dhe te vetë e keqja që bota ka për të

ofruar. Me të ju mund të arrini gjëra të mëdha në një periudhë të shkurtër kohe, ose mund të gjendeni të zënë në pusitë e pafundme të kotësisë që jua çon kohën dem dhe e pakësojnë potencialin tuaj. Me shtypjen e një butoni, ju mund të hyni te çfarëdo gjë që t’ju dëshirojë zemra. Ky është çelësi – çfarë dëshiron zemra juaj? Çfarë gjërash ju tërheqin? Ku do t’ju çojnë dëshirat tuaja?

Mbani mend se Perëndia “u jep njerëzve sipas dëshirës së tyre” (Alma 29:4) dhe se Ai “do t’i gjykoj[ë] të gjithë njerëzit sipas punëve të tyre, sipas



dëshirës së zemrave të tyre” (DeB 137:9; shih edhe Alma 41:3).

Plaku Brus R. Mek-Konki tha: “Në një kuptim të vërtetë edhe pse figurativ, *libri i jetës* është regjistri i veprave të njerëzve siç ai regjistër shënohet në vetë trupat e tyre. . . . Kjo do të thotë se çdo mendim, fjalë e vepër ka një [efekt] te trupi njerëzor; të gjitha këto i lënë shenjat e tyre, shenja që mund të lexohen nga Ai që është i Përjetshëm me po aq lehtësi sa mund të lexohen fjalët në një libër” (*Mormon Doctrine*, bot. i 2-të [1966], f. 97).

Edhe interneti i regjistron dëshirat tuaja, të shprehura në formën e kërkimeve dhe klikimeve. Ka një mizëri burimesh që presin t’i plotësojnë ato dëshira. Ndërsa lundroni në internet, ju lini gjurmë – ato që komunikoni, vendin ku keni qenë, për sa kohë keni qenë atje dhe llojet e gjërave që ju interesojnë. Në këtë mënyrë, interneti krijon një profil virtual për ju – në një kuptim “librin virtual të jetës” suaj. Sikurse në jetë, interneti do t’ju japë gjithnjë e më tepër nga ajo që kërkoni. Nëse dëshirat tuaja janë të pastra, interneti mund t’i lartësojë ato, duke e bërë përherë e më të lehtë angazhimin në përçapje të denja. Por e kundërta është gjithashtu e vërtetë.

Plaku Nil A. Maksuell e shprehu në këtë mënyrë:

“Ajo që dëshirojmë me ngulmim, me kalimin e kohës, është ajo që vërtet do të bëhemi më së fundi dhe ajo që vërtet do të marrim në përjetësi. . . .

. . . Vetëm duke i edukuar dhe duke i ushtruar dëshirat tona, ato mund të bëhen aleatet tona në vend që të jenë armiket tona!” (“According to the Desire of [Our] Hearts,” *Ensign*, nëntor 1996, f. 21, 22).

Vëllezërit e mi të rinj, nëse nuk jeni energjikë në edukimin e dëshirave tuaja, bota do ta bëjë atë në vendin tuaj. Çdo ditë, bota kërkon të

ndikojë te dëshirat tuaja, duke ju joshur të blini diçka, të klikoni te diçka, të luani me diçka, të lexoni apo të shikoni diçka. Në fund fare, zgjedhja është e juaja. Ju keni lirinë e zgjedhjes. Ajo është fuqia jo vetëm për të vepruar sipas dëshirave tuaja, por edhe për t'i përmirësuar, pastruar dhe për t'i lartësuar dëshirat tuaja. Liria e zgjedhjes është fuqia juaj për t'u bërë ai që doni. Çdo zgjedhje mund t'ju çojë më pranë ose më larg nga ajo që jeni paracaktuar të bëheni; çdo klikim ka një domethënie. Pyeteni gjithmonë veten: "Ku do të më çojë kjo zgjedhje?" Zhvillojeni aftësinë për të parë përtej çastit.

Satani dëshiron të ketë kontroll mbi lirinë tuaj të zgjedhjes që ai të mund të ketë kontroll mbi atë që ju do të bëheni. Ai e di se një nga mënyrat më të mira për ta bërë këtë është duke ju zënë në kurth me sjellje varësuese. Zgjedhjet tuaja përcaktojnë faktin nëse teknologjia do t'ju fuqizojë apo do t'ju skllavërojë.

Më lejoni t'ju ofroj katër parime për t'ju ndihmuar juve, brezin e zgjedhjeve, që t'i edukoni dëshirat tuaja dhe që të udhëhiqni përdorimin e teknologjisë nga ana juaj.

Së pari: Dijenia se Cilët Jeni në të Vërtetë i Bën më të Lehta Vendimet

Kam një mik që e mësoi këtë të vërtetë në një mënyrë shumë vetjake. Djali i tij u rrit në ungjill, por dukej se po sorollatej shpirtërisht. Ai i refuzonte vazhdimisht mundësitë për ta ushtruar priftërinë. Prindërit e tij u zhgënjyen kur ai shpalli se kishte vendosur të mos shërbente në një mision. Miku im u lut me zell për të birin, duke shpresuar se ai do të pësonte një ndryshim të zemrës. Këto shpresa morën fund kur i biri njoftoi se qe fejuar e do të martohej. I ati iu lut të birin që të merrte bekimin e tij patriarkal. I biri pranoi



më në fund, por këmbënguli që të shkonte vetëm te patriarku.

Kur u kthye pas bekimit, ai ishte shumë i prekur emocionalisht. Ai e mori të dashurën jashtë, ku mund të fliste me të vetëm për vetëm. I ati hidhte sytë vjedhurazi nga dritarja për ta parë çiftin e ri duke i fshirë lotët njëri-tjetrit.

Më vonë, djali i tregoi të atit se çfarë kishte ndodhur. Me emocion të madh, ai shpjegoi se, gjatë bekimit, ai kishte kuptuar pakëz se kush kishte qenë në botën paratokësore. Ai pa sa i guximshëm ishte dhe sa ndikim kishte për t'i bindur të tjerët ta ndiqnin Krishtin. Duke e ditur se kush ishte në të vërtetë, si mund të mos shërbente ai në një mision?

Të rinj, kujtoni se cilët jeni në të vërtetë. Kujtoni se ju mbani priftërinë e shenjtë. Kjo do t'ju frymëzojë të bëni zgjedhje të duhura teksa përdorni internetin dhe gjatë gjithë jetës suaj.

Së dyti: Vëreni Vetën në Prizë të Burimi i Energjisë

Pikërisht në pëllëmbën e dorës suaj, ju keni urtësinë e epokave – më e rëndësishmja, fjalët e profetëve, nga kohët e Dhiatës së Vjetër deri në kohën e Presidentit Tomas S. Monson. Por nëse nuk e karikoni rregullisht telefonin tuaj celular, ai është i

papërdorshëm dhe ju ndiheni të humbur dhe jashtë çdo komunikimi. Nuk do të mendonit kurrë që të kalonte një ditë pa e karikuar baterinë tuaj.

Aq e rëndësishme sa është që të dilni nga shtëpia çdo ditë me karikim të plotë të telefonit tuaj celular, akoma më e rëndësishme është të jesh plotësisht i karikuar shpirtërisht. Sa herë që e vini në prizë telefonin tuaj, përdoreni atë si një kujtues për ta pyetur veten a e keni vënë veten në prizën e burimit më të rëndësishëm të energjisë shpirtërore – të lutjes dhe studimit të shkrimeve të shenjta, që do t'ju karikojnë me frymëzim nga Fryma e Shenjtë (shih DeB 11:12–14). Do t'ju ndihmojë ta dini mendjen dhe vullnetin e Zotit për të bërë zgjedhjet e vogla, por të rëndësishme dhe të përditshme që përcaktojnë drejtimin tuaj. Shumë prej nesh, e ndalin menjëherë çfarëdo që po bëjnë për të lexuar një mesazh në celular – a nuk duhet t'iu kushtojmë më shumë rëndësi mesazheve nga Zoti? Shpërfilla ndaj lidhjes me këtë energji duhet të jetë e pamendueshme për ne (shih 2 Nefi 32:3).

Së treti: Zotërimi i një Telefoni Smart [Të Zgjuar] Nuk ju Bën Të Zgjuar; por Përdorimi i Tij me Mençuri Mund t'ju Bëjë

Të rinj, mos bëni gjëra të pamendueshme me telefonin tuaj smart. Ju e dini

të gjithë se për çfarë e kam fjalën (shih Mosia 4:29). Ka mënyra të panumërta se si teknologjia mund t'ju shpërqendrojë nga ajo që është më e rëndësishmja. Zbatoni fjalën e urtë: “Aty ku vete, merre kokën me vete”. Kur jeni duke ngarë makinën, ngitni makinën. Kur jeni në mësim, përqendrohuni te mësimi. Kur jeni me shokë, jepuni atyre vëmendjen tuaj si dhuratë. Truri juaj nuk mund të përqendrohet në dy gjëra njëkohësisht. Bërja e shumë detyrave njëkohësisht do të thotë ta zhvendosni përqendrimin tuaj me shpejtësi nga një gjë te tjetra. Një fjalë e urtë e vjetër thotë: “Nuk mund të mbash dy kunguj në një sqetull”.

Së katërti: Zoti e Siguron Teknologjinë për të Përbushur Qëllimet e Tij

Qëllimi hyjnor i teknologjisë është që të përshpejtojë punën e shpëtimit. Si anëtarë të një brezi zgjedhesh, ju e kuptoni teknologjinë. Përdoreni atë për të fituar shpejtësi në përparimin tuaj drejt përsosurisë. Sepse shumë ju është dhënë, edhe ju duhet të jepni (shih “Because I Have Been Given Much [Sepse Shumë më Është Dhënë]”, *Hymns*, nr. 219). Zoti pret nga ju që t'i përdorni këto mjete të mrekullueshme për ta ngritur punën e Tij në një nivel më të lartë, për ta ndarë ungjillin në mënyra që janë përtej përfytyrimit më të shfrenuar të brezit tim. Ndërkohë që brezat e kaluar kanë ndikuar te fqinjët dhe te qyteti i tyre, ju keni fuqinë të arrini përtej kufijve dhe të ndikoni te një botë e tërë përmes internetit dhe medias shoqërore.

Unë dëshmoj se kjo është Kisha e Zotit. Ju u zgjodhët për të marrë pjesë në punën e Tij në këtë kohë, sepse Ai ka besim se ju do të bëni zgjedhjet e duhura. Ju jeni brezi i zgjedhjeve. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

A Po Flini Gjatë Rivendosjes?

Ka shumë që vihet në rrezik për ne si individë, si familje dhe si Kisha e Krishtit po t'i japim vetëm një shërbim me gjysmë zemër kësaj pune të shenjtë.

Rreth 200 vjet më parë, novela e shkurtër amerikane “Rip van Uinkël” u bë menjëherë një veper klasike. Personazhi kryesor, Ripi, është një burrë pa ambicie, i cili është shumë i mirë për t'iu shmangur dy gjërave: punës dhe gruas së tij.

Një ditë, duke u endur nëpër male me qenin e tij, ai zbulon një grup burrash të veshur në mënyrë të çuditshme duke pirë dhe duke luajtur lojëra. Pasi pranon ca nga pija e tyre, Ripi përgjumet dhe i mbyll sytë për një çast. Kur i hap sytë përsëri, ai habitet të mësojë se qeni nuk është më, pushka e tij ka zënë ndryshk dhe ai tashmë ka një mjekër të gjatë.

Ripi bën rrugën e kthimit drejt fshatit të tij vetëm që të zbulojë se gjithçka

ka ndryshuar. Gruaja e tij ka vdekur, miqtë e tij nuk janë më dhe portreti i mbretit Xhorxh III në tavernë është zëvendësuar nga një portret i dikujt që ai nuk e njeh – nga gjenerali Xhorxh Uashington.

Rip van Uinkëli kishte qenë duke fjetur për 20 vjet! Dhe gjatë asaj kohe, kishte humbur një nga periudhat më emocionuese në historinë e atdheut të tij – ai kishte fjetur gjatë Revolucionit Amerikan.

Në maj të vitit 1966, Dr. Martin Luter King i Riu e përdori këtë histori si ilustrim për fjalimin e tij “Mos Fli Gjatë Revolucionit”¹.

Sot, unë dua të përdor të njëjtën temë dhe të ngre një pyetje për të gjithë ata që mbajnë priftërinë e Perëndisë: a po flini gjatë Rivendosjes?





Ne Po Jetojmë në Kohën e Rivendosjes

Ndonjëherë ne mendojmë për Rivendosjen e ungjillit si diçka të përfunduar, tashmë të lënë pas – Jozef Smithi e përktheu Librin e Mormonit, ai i mori çelësat e priftërisë, Kisha u organizua. Në të vërtetë, Rivendosja është një proces i vazhdueshëm; ne po jetojmë në të pikërisht tani. Ajo përfshin “gjithçka që Perëndia ka zbuluar, gjithçka që Ai zbulon tani” dhe “shumë gjëra të mëdha dhe të rëndësishme” që “Ai ende do të zbulojë”.² Vëllezër, zhvillimet emocionuese të së sotmes janë pjesë e asaj periudhe të përgatitjes, të parashikuar prej kohësh, që do ta arrijë kulmin në Ardhjen e Dytë të lavdishme të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit.

Kjo është një nga periudhat më mbresëlënëse të historisë së botës! Profetët e lashtë kishin mall ta shihnin ditën tonë.

Kur koha jonë në vdekshmëri të përfundojë, për cilat përvoja do të jemi vërtet në gjendje të tregojmë rreth vetë ndihmesës sonë në këtë periudhë domethënëse të jetës sonë dhe në çuarjen më tej të punës së Zotit? A do të jemi në gjendje të themi se i përveshëm mëngët dhe punuam me gjithë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën tonë? Apo do të duhet të pohojmë se roli ynë ishte kryesisht ai i një vëzhguesi?

Mendoj se ka një larmi arsyesh përse është e lehtë të bëhemi paksa të përgjumur lidhur me ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë. Më lini t’ju përmend tri arsye kryesore. Ndërsa flas, ju ftoj të përsiatni nëse ndonjëra mund të gjejë zbatim. Nëse ka vend për përmirësim, ju kërkoj që të merrni parasysh se çfarë mund të bëhet që të ndryshoni për më mirë.

Egoizmi

Së pari, egoizmi.

Ata që janë egoistë, kërkojnë interesat dhe kënaqësinë e tyre mbi gjithçka tjetër. Pyetja qendrore për njeriun egoist është “Ç’përfitim kam unë nga kjo?”

Vëllezër, jam i sigurt që mund ta kuptoni se kjo sjellje është qartësisht në kundërshtim me shpirtin e kërkuar për të ndërtuar mbretërinë e Perëndisë.

Kur kërkojmë shërbimin ndaj vetes kundrejt shërbimit pa menduar për vetveten, përparësitë tona bëhen të përqendruara te bërja të njohur dhe vetëkënaqësia jonë.

Brezat e shkuar i patën ndeshjet e tyre me forma të ndryshme të egoizmit dhe narcizmit, por mendoj se sot ne po u bëjmë atyre goxha konkurrencë. Nuk është e rastit që Oxford Dictionary kohët e fundit shpalli “self-n [foton e vetvetes]” si fjalën e vitit.³

Në mënyrë të natyrshme, ne të gjithë kemi dëshirë që të na njihet

vlera dhe nuk ka asgjë të keqe me çlodhjen dhe kënaqjen e vetvetes. Por kur të kërkuarit që të “marrim fitime dhe të keqmi] lëvdata nga bota”⁴, është një pjesë thelbësore e shtysës sonë, ne vërtet do të humbasim përvojat shëlbuese dhe gëzuese që vijnë, kur japim bujarisht nga vetja për punën e Zotit.

Cili është shërimi?

Përgjigjja, si gjithmonë, gjendet në fjalët e Krishtit:

“Kushdo që don të vijë pas meje, të mohojë vetveten, të marrë kryqin e vet dhe të më ndjekë.

Sepse ai që don të shpëtojë jetën e vet, do ta humbasë; por ai që do të humbasë jetën e vet për hirin tim e për ungjillin, do të shpëtojë.”⁵

Ata, të cilët me gjithë zemër ia dorëzojnë jetën e tyre Shpëtimtarit tonë dhe u shërbejnë Perëndisë e bashkënjerezve, zbulojnë një pasuri dhe plotësi të jetës që njeriu egoist apo vetëmburrës nuk do ta përjetojë kurrë. Njerëzit vetëmohues japin nga vetja. Këto mund të jenë dhurata të vogla të dashurisë hyjnore, të cilat kanë një ndikim të madh për mirë: një buzëqeshje, një shtrëngim dore, një përqafim, kohë e harxhuar duke dëguar, një fjalë e butë inkurajimi apo një gjest përkujdesjeje. Të gjitha këto veprime mirësie mund të ndryshojnë zemra dhe jetë. Kur i shfrytëzojmë mundësitë e pakufizuara për t’i dashur



bashkënjëzitet tanë dhe për t'u shërbyer atyre, përfshirë bashkëshorten dhe familjen tonë, aftësia jonë për ta dashur Perëndinë dhe për t'u shërbyer të tjerëve do të rritet tej mase.

Ata që u shërbejnë të tjerëve, nuk do të flenë gjatë Rivendosjes.

Varësitë

Një diçka tjetër që mund të na shkaktojë të ecim përgjumësh gjatë kësaj stine të rëndësishme të botës, është varësia.

Varësitë shpesh fillojnë në mënyrë tinëzore. Varësitë janë fije të holla të veprimtimit të përsëritur, të cilat thuren në lidhjet e forta të zakonit. Zakonet e këqija kanë aftësinë për t'u bërë varësi shkatërruese.

Këta zinxhirë lidhës të varësisë mund të kenë forma të ndryshme si pornografia, alkooli, seksi, drogat, duhani, kumari, ushqimi, puna, interneti ose realiteti virtual. Satani, armiku ynë i përbashkët, ka shumë mjete të parapëlqyera të cilat i përdor që të na e vjedhë potencialin tonë hyjnor për

ta plotësuar misionin tonë në mbretërinë e Zotit.

Ati ynë Qiellor trishtohet kur sheh se sa me gatishmëri disa prej bijve të Tij fisnikë i shtrijnë kyçet e duarve për të pranuar prangat e varësive shkatërruese.

Vëllezër, ne mbajmë priftërinë e përjetshme të Perëndisë së Plotfuqishëm. Ne jemi me të vërtetë bijtë e Më të Lartit dhe na është dhuruar një potencial i papërshkrueshëm. Ne jemi projektuar që të fluturojmë lirisht përmes qiejve. Ne nuk u krijuam që të lidheshim me vargonj pas tokës, të burgosur brenda këmbishave të forcës që i kemi bërë vetë.

Cili është shërimi?

Gjëja e parë që duhet të kuptojmë, është se varësitë janë shumë më të lehta për t'u parandaluar sesa për t'u kuruar. Me fjalët e Shpëtimtarit: "Mos lejoni asnjë prej këtyre gjërave të hyjnë në zemrën tuaj"⁶.

Disa vite më parë, Presidentit Tomas S. Monson dhe, mua na u dha mundësia për të vizituar Air Force One

[Forca Ajrore Një] – avionin magjepsës që transporton presidentin e Shteteve të Bashkuara. Pati kontrolle skrupuloze të sigurimit nga Shërbimi Sekret dhe unë buzëqesha pak ndërkohë që agjentët e kontrolluan profetin tonë të dashur përpara se të hipnim në avion.

Më pas piloti kryesues më ftoi të ulesha në vendin e kapitenit. Ishte një përvojë mbresëlënëse që të ulesha përsëri në kabinën e një makine fluturuese të mahnitshme, si ato që kisha drejtuar për kaq shumë vite. Kujtimet e fluturimeve përmes oqeanëve dhe kontinenteve ma mbushën mendjen dhe zemrën. Përfytyrova ngritje dhe ulje emocionuese të avionëve në aeroporte kudo në mbarë botën.

Pothuajse në mënyrë të pandërgjegjshme, i vendosa duart e mia në katër levat e 747-s. Pikërisht atëherë, një zë i dashur dhe i pagabueshëm erdhi nga pas – zëri i Tomas S. Monsonit.

"Diter", tha ai, "as mos të të shkojë në mendje".

Nuk po pranoj ndonjë gjë, por ndoshta Presidenti Monson e kuptoi ç'kisha në mendje.

Kur tundohemi të bëjmë gjëra që nuk duhet t'i bëjmë, le të dëgjojmë paralajmërimin e dashur të familjes dhe të miqve të besuar, të profetit tonë të dashur dhe gjithmonë të Shpëtimtarit.

Mbrojtja më e mirë ndaj varësisë është të mos fillohet kurrë.

Por çfarë të bëjnë ata njerëz që gjenden nën shtrëngimin e varësisë?

Ju lutemi, ta dini, para së gjithash, se ka shpresë. Kërkoni ndihmë prej njerëzve të dashur, udhëheqësve të Kishës dhe këshilluesve të specializuar. Kisha siguron ndihmë për shërimin nga varësitë nëpërmjet udhëheqësve vendorë të Kishës, internetit⁷ dhe, në disa zona, nëpërmjet LDS Family Services [Shërbimeve Familjare SHDM].

Gjithmonë kujtoni, me ndihmën e Shpëtimtarit, ju mund të çliroheni prej varësisë. Mund të jetë një shteg i gjatë, i vështirë, por Zoti nuk do të heqë dorë prej jush. Ai ju do. Jezu Krishti vuajti Shlyerjen që t'ju ndihmojë të ndryshoni, të çliroheni nga robëria e mëkatit.

Gjëja më e rëndësishme është që të vazhdoni të përpiqeni – nganjëherë duhen disa përpjekje përpara se njerëzit t'ia dalin me sukses. Prandaj mos hiqni dorë. Mos e humbisni besimin. Mbajeni zemrën pranë Zotit dhe Ai do t'ju japë fuqinë e çlirimit. Ai do t'ju bëjë të lirë.

Vëllezërit e mi të dashur, gjithmonë qëndroni larg prej zakoneve që mund të çojnë drejt varësisë. Ata që bëjnë kështu, do të jenë në gjendje t'ia përkushtojnë zemrën, fuqinë, mendjen dhe forcën e tyre shërbimit të Perëndisë.

Ata nuk do të flenë gjatë Rivendosjes.

Përparësitë Konkurruese

Një pengesë e tretë që nuk na lejon të përfshihemi tërësisht në këtë punë, janë përparësitë e shumta konkurruese që hasim. Disa prej nesh janë kaq të zënë sa ne ndihemi si një karrocë e tërhequr nga një duzinë kafshësh pune – secila duke tërhequr fort në një drejtim të ndryshëm. Shumë energji shpenzohet, por karroca nuk shkon gjëkund.

Shpesh ne i përkushtojmë përpjekjet tona më të mira që të ndjekim një hobi, një sport, interesa profesionale dhe çështje të komunitetit apo çështje politike. Të gjitha këto gjëra mund të jenë të mira dhe të respektuara, por a po na lenë kohë dhe energji për ato që duhet të jenë përparësitë tona më të larta?

Cili është shërimi?

Edhe njëherë, ai vjen nga fjalët e Shpëtimtarit:

“Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde’.

Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi.

Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsivetveten’.”⁸

Gjithçka tjetër në jetë duhet të jetë dytësore ndaj këtyre dy përparësive të mëdha.

Edhe në shërbimin në Kishë, është e lehtë të harxhohet shumë kohë thjesht duke shkuar përmes lëvizjeve pa pasur zemrën ose thelbin e të qenit dishepull.

Vëllezër, ne, si mbajtës të priftërisë, jemi zotuar që të jemi njerëz që e duam Perëndinë dhe të afërmin tonë dhe që jemi të gatshëm ta tregojmë atë dashuri nëpërmjet fjalës dhe veprës. Ky është thelbi se cilët jemi ne si dishepuj të Jezu Krishtit.

Ata që jetojnë sipas këtyre parimeve, nuk do të flenë gjatë Rivendosjes.

Një Thirrje për t'u Zgjuar

Apostulli Pal shkroi: “Zgjuhu, ti që fle, dhe ringjallu prej së vdekurish, dhe Krishti do të shndrisë mbi ty”⁹.

Miqtë e mi të dashur, dijeni se ju jeni bij të dritës.

Mos e lejoni egoizmin! Mos i lejoni zakonet që mund të çojnë drejt varësisë! Mos i lejoni përparësitë konkurruese t'ju nanurisin drejt moskokëçarjes ose shkëputjes nga të qenit të bekuar si dishepuj dhe nga shërbimi fisnikëruës në priftëri!

Ka shumë që vihet në rrezik për ne si individë, si familje dhe si Kisha e Krishtit po t'i japim vetëm një shërbim me gjysmë zemër kësaj pune të shenjtë.

Të qenit një dishepull i Jezu Krishtit nuk është një përpjekje që bëhet një herë në javë ose një herë në ditë. Është një përpjekje që bëhet njëherë dhe përgjithmonë.

Premtimi i Zotit ndaj mbajtësve të Tij të vërtetë të priftërisë është pothuajse tej mase i madhërisëm për t'u kuptuar.



Ata që janë besnikë ndaj Priftërive Aarone e Melkizedeke dhe i lartësojnë thirrjet e tyre, “shenjtërohen me anë të Shpirtit në ripërtëritjen e trupave të tyre”. Si rrjedhim, gjithçka që Ati ynë ka, do t’u jepet atyre.¹⁰

Unë dëshmoj se fuqia dëlirësuese e Shlyerjes së Jezu Krishtit dhe fuqia ndryshuese e Frymës së Shenjtë mund ta shërojnë e shpëtojnë njerëzimin. Është privilegj ynë, detyra jonë e shenjtë dhe gëzimi ynë që t’ia vëmë veshin thirrjes së Shpëtimtarit për ta ndjekur Atë me një mendje të vullnetshme dhe me qëllim të plotë të zemrës. Le të “flak[im] tej zinxhirët me të cilët je[m] lidhur dhe [të dalim] nga errësira dhe [të] ngrih[emi] nga pluhuri”¹¹.

Le të jemi të zgjuar dhe të mos lodhemi duke bërë mirë, sepse ne “po ngr[emë] themelin e një vepre të madhe”¹², madje po përgatitemi për kthimin e Shpëtimtarit. Vëllezër, kur e shtojmë dritën e shembullit tonë si një dëshmi të bukurisë dhe fuqisë së të vërtetës së rivendosur, ne nuk do të flemë gjatë Rivendosjes. Për këtë unë dëshmoj dhe ju lë bekimin tim, në emrin e shenjtë të Mësuesit tonë, madje Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Martin Luther King Jr., “Don’t Sleep Through the Revolution” (1966 Ware Lecture, Unitarian Universalist Association General Assembly, Hollivud, Florida, 18 maj 1966).
2. Nenet e Besimit 1:9.
3. Shih blog.oxforddictionaries.com/press-releases/oxford-dictionaries-word-of-the-year-2013.
4. 2 Nefi 26:29.
5. Marku 8:34–35.
6. 3 Nefi 12:29.
7. Shih, për shembull, lds.org/topics/addiction.
8. Mateu 22:37–39.
9. Efesianëve 5:14.
10. Shih Doktrina e Besëlidhje 84:33, 38.
11. 2 Nefi 1:23.
12. Shih Doktrina e Besëlidhje 64:33.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Burri i Priftërisë

Ju mund të jeni një model i shkëlqyer, një model mesatar ose një model i keq. Mund të mendoni se nuk ka rëndësi për ju, por ja që ka rëndësi për Zotin.

Ne të gjithë kemi heronj, veçanërisht kur jemi të vegjël. Unë u lindi dhe u rrita në Prinston të Nju-Xhërsit në Shtetet e Bashkuara. Ekipet më të famshme të sportit atje ku jetoja unë, ishin vendosur në qytetin e Nju-Jorkut. Ai ishte shtëpia e tre ekipeve profesioniste të bejsbollit në ato ditë të largëta: Doxhërsat e Bruklinit, Xhajënsat e Nju-Jorkut dhe Jenkit e Nju-Jorkut. Filadelfia ishte akoma më afër shtëpisë sonë dhe ishte shtëpia e ekipeve të bejsbollit Atletiks dhe Fillis. Kishte shumë heronj të mundshëm bejsbolli për mua në ato ekipe.

Xho DiMazhio, i cili luante për Jenkis të Nju-Jorkut, u bë heroi im i bejsbollit. Kur vëllezërit dhe shokët e mi luanin bejsboll në rrethinat e shkollës ngjitur me shtëpinë tonë,

unë përpiqesha ta vërtitja shkopin e bejsbollit siç mendoja se e bënte Xho DiMazhio. Kjo ishte para kohës së televizionit (ky është një tregim i lashtë), ndaj unë kisha në përdorim vetëm fotografi nga gazetatat për ta kopjuar vërtitjen e tij të shkopit.

Kur po rritesha, babai më çoi me makinë në Stadiumin Jenki. Ajo ishte e vetmja herë që e pashë Xho DiMazhion të luante. Sikur të isha ende atje, unë mund ta shoh me sytë e mendjes tek e lëkund shkopin dhe e shoh topin e bardhë të fluturojë drejt dhe te karriget e shikuesve përtej pjesës qendrore të fushës.

Tani, aftësitë e mia të bejsbollit nuk iu përafrauan kurrë atyre të heroit tim të fëmijërisë. Por ato pak herë kur e godita mirë një top bejsbolli, unë e





kopjova me aq sa munda mënyrën e vërtitjes së tij të fuqishme të shkopit.

Kur zgjedhim heronj, ne fillojmë të kopjojmë, me ose pa vetëdije, ato që çmojmë më shumë tek ata.

Për fat të mirë, prindërit e mi të mençur vunë heronj të shkëlqyer në shtegun tim kur isha fëmijë. Babai më çoi në Stadiumin Jenki vetëm një herë për ta vëzhguar heroin tim të bejsbollit teksa luante, por çdo të diel ai më lejonte të vëzhgoja një burrë të priftërisë që u bë hero. Ai hero i dha trajtë jetës sime. Im atë ishte presidenti i degës së vogël që takohej në shtëpinë tonë. Me që ra fjala, nëse zbrisje në katin e parë të dielën në mëngjes, ishe në kishë. Dega jonë nuk kishte kurrë më tepër se 30 njerëz që merrnin pjesë.

Atje ishte një i ri që e sillte të ëmën me makinë në shtëpinë tonë për mbledhjet, por nuk hynte kurrë në shtëpi. Ai nuk ishte anëtar. Ishte babai im që ia doli mbanë duke shkuar jashtë, atje ku ai kishte parkuar makinën dhe duke e ftuar atë në shtëpinë tonë. Ai u pagëzua dhe u bë udhëheqësi im i parë e i vetëm i Priftërisë Aarone. Ai u bë heroi im i priftërisë. Ende e kujtoj statujën e drunjë që më dha si shpërblim, pasi kishim përfunduar

një projekt për të prerë dru për një vejushë. Jam përpjekur të jem si ai sa herë që bëj lavdërime të merituar për një shërbëtor të Perëndisë.

Zgjodha një hero tjetër në atë degë të vogël të Kishës. Ai ishte një Marins i Shteteve të Bashkuara që vinte në mbledhjet tona i veshur me uniformën e tij të gjelbër të marinsit. Ishte kohë luftime ndaj, thjesht kjo, e bëri atë heroin tim. Ai ishte dërguar në Universitetin Princeton nga marina që ta çonte më tej arsimimin e tij. Por përveç admirimit të uniformës së tij ushtarake, unë e pashë atë të luante në Stadiumin Palmer si kapiten i ekipit të futbollit amerikan të Universitetit Princeton. E pashë atë të luante në ekipin e basketbollit të universitetit dhe e pashë gjithashtu të luante si pritësi më i mirë i topit në ekipin e tyre të bejsbollit.

Por, për më tepër, ai erdhi në shtëpinë time gjatë javës për të më treguar si ta hidhja një top basketbolli si me dorën e majtë, edhe me të djathtën. Ai më tha se do të më nevojitej ajo aftësi, sepse një ditë do të luaja basketboll me ekipe të mira. Nuk e kuptova këtë atëherë, por për vite me radhë, ai për mua ishte modeli i një burri të vërtetë të priftërisë.

Secili prej jush do të jetë model i një burri të priftërisë, nëse e dëshironi apo jo. Ju u bëtë një qiri i ndezur kur e pranuat priftërinë. Zoti ju vendosi mbi shandan që t'ia ndriçoni udhën çdokujt që ju rrethon. Kjo është veçanërisht e vërtetë për ata që janë në kuorumin tuaj të priftërisë. Ju mund të jeni një model i shkëlqyer, një model mesatar ose një model i keq. Mund të mendoni se nuk ka rëndësi për ju, por ja që ka rëndësi për Zotin. Ai e shprehu në këtë mënyrë:

“Ju jeni drita e botës; një qytet i ngritur në majë të malit nuk mund të fshihet.

Po ashtu nuk ndizet një qiri për ta vënë nën babunë, por për ta vënë mbi shandan, dhe t'u bëjë dritë të gjithë atyre që janë në shtëpi.

Ashtu le të shndritë drita juaj para njerëzve, që të shohin veprat tuaja të mira dhe ta lëvdojnë Atin tuaj që është në qiej.”¹

Unë jam bekuar nga shembujt e mbajtësve të shkëlqyer të priftërisë në kuorimet ku kam pasur fatin të shërbej. Ju mund të bëni atë që ata kanë bërë për mua, duke qenë një shembull për t'u ndjekur nga të tjerët.

Kam vrojtuar tri karakteristika të përbashkëta të mbajtësve të priftërisë

që janë heronjtë e mi. Njëra është modeli i lutjes, e dyta është zakoni i shërbimit dhe e treta është një vendim i fortë si shkëmbi për të qenë të ndershëm.

Ne të gjithë lutemi, por mbajtësi i priftërisë që ju dëshironi të jeni, lutet shpesh dhe me qëllim të vërtetë. Në mbremje ju do të uleni në gjunjë dhe ta falënderoni Perëndinë për bekimet e ditës. Ju do ta falënderoni Atë për prindërit, për mësuesit dhe për shembujt e shkëlqyer për t'u ndjekur. Ju do të përshkruani me hollësi në lutjet tuaja se kush dhe si jua ka bekuar jetën gjatë asaj dite. Për këtë do të duhen më shumë se pak minuta dhe më shumë se pak mendim. Kjo do t'ju befasojë e do t'ju ndryshojë.

Teksa luteni për falje, do ta gjeni veten duke i falur të tjerët. Teksa e falënderoni Perëndinë për mirësinë e Tij, ju do të mendoni për të tjerë që kanë nevojë për mirësinë tuaj. Përsëri, kjo përvojë do t'ju befasojë çdo ditë dhe, me kalimin e kohës, do t'ju ndryshojë.

Jua premtoj se, një mënyrë se si do të ndryshoheni nga një lutje e tillë e zjarrtë, është që do të ndieni se jeni vërtet një fëmijë i Perëndisë. Kur e dini se jeni fëmijë i Perëndisë, do të dini gjithashtu se Ai pret shumë nga ju. Për shkak se jeni fëmija i Tij, Ai do të presë nga ju që t'i zbatoni mësimet e Tij dhe mësimet e Birit të Tij të dashur, Jezu Krishtit. Ai do të presë që ju të jeni zemërgjerë e të sjellshëm me të tjerët. Ai do të zhgënjehet nëse jeni krenarë dhe vetëdashës. Ai do t'ju bekojë që të keni dëshirë për t'i vënë interesat e të tjerëve mbi tuajat.

Disa prej jush janë tashmë modele të shërbimit vetëmohues të priftërisë. Në tempujt përqark botës, mbajtësit e priftërisë mbërrijnë para lindjes së dillit. Dhe disa shërbejnë edhe shumë kohë pas përfundimit. Nuk ka vlerësim



ose brohoritje publike në këtë botë për atë sakrificë kohe dhe përpjekjeje. Unë kam shkuar me të rinjtë teksa u shërbejnë atyre që ndodhen në botën e shpirtave, të cilët nuk patën mundësi t'i merrnin bekimet e tempullit për veten e tyre.

Ndërsa shoh lumturi në vend të lodhjes në fytyrat e atyre që shërbejnë atje herët dhe vonë, e di se ka shpërblime të mëdha në këtë jetë për atë lloj shërbimi vetëmohues të priftërisë, por ato janë vetëm një simbol i gëzimit që do të ndajnë me ata, të cilëve u shërbyen në botën e shpirtave.

E kam parë po të njëjtën lumturi, në fytyrat e atyre që u flasin të tjerëve rreth bekimeve që vijnë nga të qenit pjesë e mbretërisë së Perëndisë. Di për një president dege që u çon misionarëve thuajse përditë njerëz për t'iu dhënë mësim. Vetëm pak muaj më parë, ai nuk ishte ende anëtar i Kishës. Tani ka misionarë duke dhënë mësim dhe një degë që po rritet në numër dhe në forcë për shkak të tij. Por më tepër se kaq, ai është një dritë për të tjerët që do ta hapin gojën dhe kështu do ta përshpejtojnë mbledhjen e Zotit për fëmijët e Atit Qiellor.

Teksa luteni dhe u shërbeni të tjerëve, njohuria juaj se jeni fëmijë

i Perëndisë dhe ndjenjat tuaja për Të do të rriten. Ju do të bëheni më të vetëdijshëm që Ai trishtohet nëse ju tregoheni të pandershëm në ndonjë mënyrë. Ju do të jeni më të vendosur për ta mbajtur fjalën që i keni dhënë Perëndisë dhe të tjerëve. Ju do të jeni më të ndërgjegjshëm për të mos marrë ndonjë gjë që nuk ju përket. Ju do të jeni më të ndershëm me punëdhënësit tuaj. Ju do të jeni më të vendosur të jeni në orar e ta kryeni çdo detyrë që ju jepet nga Zoti, të cilën e keni pranuar ta bëni.

Në vend që të pyesin veten a do të vijë mësuesit e shtëpisë, fëmijët në familjet të cilave jeni thirrur t'u jepni mësim, do ta presin me padurim vizitën tuaj. Fëmijët e mi e kanë marrë atë bekim. Teksa rriteshin, ata kishin heronj të priftërisë që i ndihmuan të përcaktonin drejtimit e tyre vetjake në shërbim të Zotit. Ai shembull i bekuar tani po kalon në brezin e tretë.

Mesazhi im është gjithashtu një mesazh falënderimi.

Ju falënderoj për lutjet tuaja. Ju falënderoj që gjunjëzoheni duke e pranuar faktin se nuk i keni të gjitha përgjigjet. Ju i luteni Perëndisë së qiellit për të shprehur mirënjohjen tuaj dhe për të ftuar bekimet e Tij në jetën tuaj e në familjet tuaja. Ju falënderoj për shërbimin tuaj ndaj të tjerëve dhe për rastet kur nuk ndiet nevojë për mirënjohje nga të tjerët për shërbimin tuaj.

Ne e kemi pranuar paralajmërimin e Zotit se, nëse kërkojmë merita në këtë botë për shërbimin tonë, ne mund të humbasim bekime më të mëdha. Ju do t'i mbani mend këto fjalë:

“Mos e jepni lëmshën tuaj para njerëzve, me qëllim që ata t'ju admirojnë; përndryshe nuk do të shpërbleheni te Ati juaj, që është në qiej.

Kur do të japësh lëmshë, pra, mos i bjer borisë para teje, ashtu siç bëjnë hipokritët në sinagoga dhe në rrugët,



për të qenë të nderuar nga njerëzit; në të vërtetë ju them, se ata tashmë e kanë marrë shpërblimin e tyre.

Madje kur jep lëmoshë, e majta jote të mos dijë ç'bën e djathta, që lëmosha jote të jepet fshehurazi; dhe Ati yt, që shikon në fshehtësi, do të ta shpërblejë haptas”².

Ata që kanë qenë modelet e mia të mbajtësve të shkëlqyer të priftërisë, nuk e dallojnë lehtë se zotërojnë cilësi heroike. Në fakt, ata duket se kanë vështirësi t'i shikojnë ato gjëra që unë i çmoj aq shumë tek ata. E përmenda se babai im ishte president besnik i një dege të vockël të Kishës në Nju-Xhërsi. Ai më vonë, ishte anëtar i bordit të përgjithshëm të Kishës për Shkollën e së Dielës. Prapëseprapë, unë jam i kujdesshëm sot që të flas me thjeshtësi për shërbimin e tij të priftërisë, ngaqë ai ishte njeri i thjeshtë.

E njëjta gjë vlen edhe për anëtarin e marinsave që ishte heroi i fëmijërisë time. Ai nuk më foli kurrë për shërbimin e tij të priftërisë apo për arritjet e tij. Ai thjesht bëri shërbim. Unë mësova për besnikërinë e tij nga të tjerët. Nuk mund të thoja, nëse edhe ai arrinte t'i shihte te vetja karakteristikat që unë çmoja.

Ndaj, këshilla ime për ju që dëshironi t'i bekonit të tjerët me priftërinë tuaj, ka të bëjë me jetën tuaj që është e fshehtë për të gjithë përveçse për Perëndinë.

Lutjuni Atij. Falënderojeni Atë për gjithçka të mirë në jetën tuaj. Kërkojini Atij të dini se cilët individë Ai i ka vënë në udhën tuaj që ju t'u shërbeni. Përgjehrohuni që Ai t'ju ndihmojë ta bëni atë shërbim. Lutuni që të mund të falni dhe që ju të mund të faleni. Pastaj shërbejuni atyre, duajini ata dhe falini ata.

Mbi të gjitha, kujtoni se nga të gjitha shërbimet që bëni, asnjëri nuk është më i madhërisëm sesa t'i ndihmoni njerëzit të zgjedhin të kualifikohen për jetën e përjetshme. Perëndia na e ka dhënë atë drejtim gjithëpërfshirës mbi mënyrën se si ta përdorim priftërinë tonë. Ai është shembulli i përsosur i kësaj. Ky është shembulli që e shohim në një pjesë të vogël të më të mirët e shërbëtorëve të Tij në vdekshmëri:

“Dhe Zoti Perëndi i foli Moisiut, duke thënë: ‘Qiejt, ata janë shumë dhe nuk mund të numërohen prej njeriut; por ata numërohen prej meje, sepse janë të mitë.

Dhe ndërsa një tokë do të shkatërron dhe qiejt e saj, madje kështu

do të vijë një tjetër; dhe nuk ka fund për veprat e mia, as për fjalët e mia.

Sepse, vër re, kjo është vepra ime dhe lavdia ime – të bëj të ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut.”³

Ne duhet të ndihmojmë në atë punë. Secili prej nesh mund të sjellë një ndryshim. Ne jemi përgatitur për kohën dhe vendin tonë në ditët e fundit të asaj pune të shenjtë. Çdonjëri prej nesh është bekuar me shembuj të atyre që e kanë bërë atë punë, qëllimin kryesor të kohës së tyre në tokë.

Unë lutem që ne të mund ta ndihmojmë njëri-tjetrin për ta shfrytëzuar atë mundësi.

Perëndia, Ati, jeton dhe do t'iu përgjigjet lutjeve tuaja për ndihmën që ju nevojitet për t'i shërbyer mirë Atij. Jezu Krishti është Zoti i ringjallur. Kjo është Kisha e Tij. Priftëria që mbani, është fuqia për të vepruar në emrin e Tij, në veprën e Tij për t'u shërbyer fëmijëve të Perëndisë. Teksa i jepeni me gjithë zemër kësaj pune, Ai do t'ju lartësojë. Unë e premtoj këtë, në emrin e Jezu Krishtit, Shpëtimtarit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 5:14–16.
2. Mateu 6:1–4.
3. Moisiu 1:37–39.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Ji i Fortë dhe Guximtar

Paçim – ne të gjithë – guximin për t’iu kundërvënë mendimit të përgjithshëm, guximin për ta mbrojtur parimin.

Vëllezërit e mi të dashur, sa mirë është që të jem me ju edhe një herë. Lutem për ndihmë qiellore ndërsa shfrytëzoj mundësinë që t’ju drejtohem juve.

Përtej kësaj Qendre Konferencash janë mijëra të tjerë, të mbledhur në godina kishash dhe në mjedise të tjera nëpër shumicën e botës. Një fill i përgjithshëm na lidh të gjithëve së bashku, sepse neve na është besuar që të mbajmë priftërinë e Perëndisë.

Ne jemi këtu në tokë në një periudhë mbresëlënëse të historisë së

saj. Mundësitë tona janë pothuajse të pafundme dhe prapëseprapë ne përballemi edhe me një mori sfidash, disa prej tyre tepër të veçanta për kohën tonë.

Ne jetojmë në një botë ku vlerat morale, në masë të madhe, janë flakur mënjandë, ku mëkati vihet në dukje në mënyrë të hapur dhe ku na rrethojnë tundimet për t’u larguar nga shtegu i ngushtë dhe i ngushtuar. Ne përballemi me trysni të vazhdueshme dhe ndikime tinëzare që po e shkatërrojnë atë që është e denjë dhe po përpiqen ta

zëvendësojnë me filozofitë dhe praktikatat e cekëta të një shoqërie laike.

Për shkak të këtyre sfidave dhe të tjerave, ndodhen gjithnjë përpara nesh vendime, të cilat mund të përcaktojnë fatin tonë. Me qëllim që ne të marrim vendimet e duhura, nevojitet guxim – guxim për të thënë jo kur duhet ta themi atë, guxim për të thënë po kur është e duhur, guxim për ta bërë gjënë e drejtë ngaqë është e drejtë.


Meqenëse prirja në shoqëri sot po lëviz me të shpejtë larg prej vlerave dhe parimeve që na ka dhënë Zoti, ne pothuajse në mënyrë të sigurt do të thirremi për të mbrojtur atë që besojmë. A do ta kemi guximin për ta bërë këtë?

Tha Presidenti J. Ruben Klark i Riu, i cili për shumë vite ishte anëtar i Presidencës së Parë: “Nuk janë të panjohura rastet kur [ata] që mendojnë se kishin besim, . . . e kanë ndër se, ngaqë po ta pohonin besimin e tyre të plotë, mund të sillnin mbi vetvetë përqeshjen e bashkëpunëtorëve të tyre mosbesues, ata duhet ose ta ndryshojnë ose ta shpjegojnë besimin e tyre apo ta hollojnë atë shkatërrimisht, apo edhe të bëjnë sikur e kanë hedhur tej atë. Njerëz të tillë janë hipokritë.”¹ Askush prej nesh nuk do të donte ta mbante një tabelë të tillë dhe, prapëseprapë, a jemi ngurrues që ta shpallim besimin tonë në disa rrethana?

Ne mund ta ndihmojmë vetveten lidhur me dëshirën tonë për të bërë atë që është e drejtë, në qoftë se e vendosim veten tonë në vende dhe marrim pjesë në veprimtari, ku mendimet tona ndikohen për mirë dhe ku Shpirti i Zotit do të jetë i patrazuar.

Më kujtohet që lexova ca kohë më parë këshillën e një babai dhënë birit të tij kur ai u largua për të shkuar në shkollë: “Nëse e gjen veten ndonjëherë në një vend ku nuk duhet të jesh, largohu!” Unë i ofroj secilit prej jush





të njëjtën këshillë: “Nëse e gjen veten ndonjëherë në një vend ku nuk duhet të jesh, largohu!”

Thirrja për guxim i vjen vazhdimisht secilit prej nesh. Në çdo ditë të jetës sonë nevojitet guxim – jo vetëm për ngjarjet madhështore, por shumë më shpesh kur ne marrim vendime ose reagojmë ndaj rrethanave përreth nesh. Poeti dhe romancieri skocez Robert Luis Stivenson tha: “Guximi i përditshëm ka pak dëshmitarë. Por [guximi] juaj nuk është më pak fisnik ngaqë daullet nuk bien për ju dhe turmat nuk e thërrasin emrin tuaj.”²

Guximi vjen në shumë forma. Autori i krishterë Çarls Suindoll shkroi: “Guximi nuk kufizohet në fushën e betejës . . . ose në kapjen me trimëri të një vjedhësi në shtëpinë tuaj. Provat e vërteta të guximit janë shumë më të heshtura. Ato janë prova të brendshme, si të qëndruarit besnikë kur askush nuk po vështron, . . . si të qëndruarit i vetëm kur jeni keqkuptuar.”³ Unë do të shtoja se ky guxim i brendshëm gjithashtu përfshin bërjen e asaj

që duhet edhe pse mund të kemi frikë, mbrojtjen e bindjeve tona përballë rrezikut të përqeshjes dhe ruajtjen e atyre bindjeve edhe kur kërcënohemi me humbjen e miqve ose të gjendjes shoqërore. Ai, i cili mbron vendosmërisht atë që është e drejtë, duhet të rrezikojë që me raste të kundërshtohet dhe të bëhet i papëlqyeshëm.

Teksa shërbeja në Flotën Detare të Shteteve të Bashkuara në Luftën II Botërore, mësova për veprime të guximshme, raste trimërie dhe shembuj guximi. Një rast, të cilin nuk do ta harroj kurrë, ishte guximi i heshtur i një detari 18-vjeçar – jo i fesë sonë – i cili nuk ishte tepër krenar për t’u lutur. Nga 250 burra në kompani, ai ishte i vetmi që çdo natë binte në gjunjë pranë shtratit të tij, nganjëherë në mes të talljeve të kërcënuesve dhe përqeshjeve të mosbesuesve. Me kokë të ulur, ai i lutej Perëndisë. Kurrë nuk u lëkund. Kurrë nuk u ligështua. Ai kishte guxim.

Dëgjova jo shumë kohë më parë për një shembull të dikujt që sigurisht

dukej se i mungonte ky guxim i brendshëm. Një mikeshë më tregoi për një mbledhje sakramenti shpirtërore dhe besimforcuese, që ajo dhe burri i saj kishin qenë të pranishëm në lagjen e tyre. Një i ri që mbante detyrën e priftit në Priftërinë Aarone, ua preku zemrën të gjithë të pranishmëve kur foli për të vërtetat e ungjillit dhe për gëzimet e mbajtjes së urdhërimeve. Ai dha një dëshmi të zjarrtë, prekëse, ndërsa qëndronte te foltoja, në pamje të pastër e të rregullt, i veshur me këmishën e tij të bardhë dhe kollare.

Më vonë, po atë ditë, teksa kjo grua dhe burri i saj po ngisnin makinën në lagjen e tyre, ata panë po atë të ri që i kishte frymëzuar vetëm pak orë më parë. Tani, megjithatë, ai paraqiti një pamje tërësisht të ndryshme, ndërsa ecte në trotuar, i veshur me rroba që i vareshin – dhe duke pirë një cigare. Mikesha ime dhe burri i saj jo vetëm që u zhgënjyen e u trishtuan shumë, por ishin edhe të hutuar se si ai në mënyrë aq bindëse mund të dukej se ishte një njeri në mbledhjen



e sakramentit dhe më pas aq shpejt të dukej se ishte një njeri krejtësisht tjetër.

Vëllezër, a jeni i njëjti njeri kudo që jeni dhe në çdo gjë që po bëni – njeriu që Ati ynë Qiellor dëshiron që ju të jeni dhe njeriu që e dini se duhet të jeni?

Në një intervistë të botuar në një revistë kombëtare, lojtarit të mirënjohur të basketbollit të kolegjeve amerikane, Xhabari Parkër, anëtar i Kishës, iu bë pyetja që të tregonte këshillën më të mirë që kishte marrë nga babai i tij. Xhabari u përgjigj: “[Babai im] tha: ‘Thjesht të jesh në errësirë i njëjti njeri që je në dritë’”⁴. Këshillë e rëndësishme, vëllezër, për ne të gjithë.

Shkrimet tona të shenja janë të mbushura me shembuj të llojeve të

guximit që i nevojitet secilit prej nesh sot. Profeti Daniel tregoi guxim të jashtëzakonshëm duke mbrojtur atë që e dinte se ishte e drejtë dhe duke treguar guximin e tij për t’u lutur, edhe pse iu kërcënua jeta po ta bënte këtë.⁵

Guximi ishte tipar i jetës së Abinadit, siç tregohet nga gatishmëria e tij për të dhënë jetën e vet në vend që të mohonte të vërtetën.⁶

Kush mund të mos frymëzohet nga jeta e 2.000 bijve të rinj të Helamanit, të cilët e mësuuan dhe e treguan nevojën për guxim në ndjekjen e mësimëve të prindërve, tek të qenit të dëlirë dhe të pastër?⁷

Ndoshta secili prej këtyre rrëfimeve të shkrimeve të shenja kurorëzohet nga shembulli i Moronit, i cili pati

guximin të duronte me drejtësi deri në fund të jetës së tij.⁸

Gjatë gjithë jetës së tij, Profeti Jozef Smith dha shembuj të panumërt të guximit. Një nga shembujt më dramatikë ndodhi kur ai dhe vëllezër të tjerë u lidhën së bashku – imaginoni, me zinxhirë – dhe u mbajtën në një kasolle të pambaruar pranë gjykatës së Riçmondit në Mizuri. Parli P. Prat, i cili ishte mes atyre të mbajtur në burg, shkroi për një natë të veçantë: “Ishim shtrirë sikur të ishim në gjumë derisa pati kaluar ora e mesnatës dhe veshët e zemrat na dhembnin, ndërkohë që kishim dëgjuar për orë talljet e pahijshme, betimet e lemerishme, blasfemitë e llahtarshme dhe gjuhën e ndyrë të rojeve tona”.

Plaku Prat vazhdoi:

“Kisha dëgjuar derisa u bëra kaq i neveritur, i habitur, i lemeritur dhe i mbushur kaq shumë me shpirtin e drejtësisë së zemëruar sa që mezi munda të përmbahem që të mos ngrihesha në këmbë dhe t’i qortoja rojet; por nuk i pata thënë asgjë Jozefit, ose ndonjë tjetri, edhe pse ndodhesha i shtrirë pranë tij dhe e dija që ishte i zgjuar. Befas ai u ngrit në këmbë dhe foli me një zë bubullime, apo si të luanit ulëritës, duke shqiptuar, me aq sa mund të kujtoj, fjalët e mëposhtme:

“**QETËSI. . . Në emrin e Jezu Krishtit unë ju qortoj dhe ju urdhëroj të heshtni; nuk do të jetoj asnjë minutë tjetër dhe të dëgjoj fjalë të tilla. Ndërpriteni këtë të folur ose unë o ju do të vdesim KËTË ÇAST!’**”

Jozefi “qëndronte drejt në këmbë me një madhështi tmerruese”, siç u përshkrua nga Plaku Prat. Ai ishte i lidhur me zinxhirë, pa armë, dhe përsëri ishte i qetë e madhështor. Hodhi vështrimin mbi rojet e trembura, të cilët po zmbropseshin në një qoshe ose po strukeshin te këmbët e tij. Këta burra, në pamje të



pakorrigjueshëm, lypën faljen e tij dhe ndenjën të heshtur.⁹

Jo të gjitha veprimet e guximit sjellin përfundime kaq mbresëlënëse apo të menjëhershme dhe, prapëse-prapë, të gjitha ato vërtet sjellin paqe të mendjes dhe njohuri se e drejta dhe e vërteta janë mbrojtur.

Është e pamundur të qëndrohet drejt në këmbë, kur një njeri i vendos rrënjët e tij në rërat lëvizëse të mendimit dhe miratimit të mirëpritur nga njerëzit. Nevojitet guximi i një Danieli, një Abinadi, një Moroni ose një Jozef Smithi me qëllim që ne të qëndrojmë të fortë dhe të sigurt për atë që e dimë se është e drejtë. Ata patën guximin të bënin jo atë që ishte e lehtë, por atë që ishte e drejtë.

Ne të gjithë do të hasim frikë, do të përjetojmë tallje dhe do të ndeshemi me kundërshtim. Paçim – ne të gjithë – guximin për t’iu kundërvënë mendimit të përgjithshëm, guximin për ta mbrojtur parimin. Guximi, jo kompromisi, e sjell buzëqeshjen dhe miratimin e Perëndisë. Guximi bëhet një virtut i gjallë dhe tërheqës kur mbahet parasysh jo vetëm si një gatishmëri për të vdekur si burrë, por si vendosmëria për të jetuar denjësisht. Ndërsa ecim përpara, duke u përpjekur që të jetojmë siç duhet, ne sigurisht do të marrim ndihmë nga Zoti dhe mund të gjejmë ngushëllim në fjalët e Tij. Mua më pëlqen shumë premtimi i Tij i shënuar në librin e Jozueut:

“Nuk do të të lë, as nuk do të të braktis. . . .

. . . Ji i fortë dhe trim; mos ki frikë, mos ki frikë dhe mos u thyej, sepse Zoti, Perëndia yt, është me ty kudo që të shkosh.”¹⁰

Vëllezërit e mi të dashur, me guximin e bindjeve tona, deklarofshim me Apostullin Pal: “Unë nuk kam turp për ungjillin e Krishtit”¹¹. Dhe atëherë, me po të njëjtën kurajë, ndjekshim këshillën e Palit: “Bëhu shembull për besimtarët në fjalë, në sjellje, në dashuri, në Frymë, në besim dhe dëlirësi”¹².


Konflikte shkatërrimtare vijnë e shkojnë, por lufta që zhvillohet për

shpirtrat e njerëzve vazhdon pa u pakësuar. Si thirrje kumbuese vjen fjala e Zotit për ju, për mua dhe për mbajtësit e priftërisë kudo: “Si rrjedhim, tani çdo njeri duhet ta mësojë detyrën e tij dhe të veprojë në thirrjen që është caktuar, gjithë zell”¹³. Atëherë ne do të jemi, sikurse shpalli Apostulli Pjetër, madje një “priftëri mbretërore”¹⁴, të bashkuar në qëllim dhe të dhuruar me fuqi nga lart.¹⁵

Çdonjëri u largoftë nga kjo mbledhje sonte me vendosmërinë dhe guximin që të thotë, me Jobin e lashtë: “Deri sa të ketë një frymë jete tek unë . . . , nuk do të heq dorë nga ndershmeria ime”¹⁶. Qoftë kjo kështu, është lutja ime e përlur në emrin e Jezu Krishtit, Zotit tonë, amen. ■

SHËNIME

1. J. Reuben Clark Jr., *The Charted Course of the Church in Education*, bot i redakt. (1994), f. 7.
2. Robert Louis Stevenson, në Hal Urban, *Choices That Change Lives* (2006), f. 122.
3. Charles Swindoll, në Urban, *Choices That Change Lives*, f. 122.
4. Jabari Parker, në “10 Questions”, *Time*, 17 mars 2014, f. 76.
5. Shih Daniel 6.
6. Shih Mosia 11:20; 17:20.
7. Shih Alma 53:20–21; 56.
8. Shih Moroni 1–10.
9. Shih *Autobiography of Parley P. Pratt*, bot. Parley P. Pratt Jr. (1938), f. 210–211.
10. Jozueut 1:5, 9.
11. Romakëve 1:16.
12. 1 Timoteut 4:12.
13. Doktrina e Besëlidhje 107:99.
14. 1 Pjetër 2:9.
15. Shih Doktrina e Besëlidhje 105:11.
16. Jobi 27:3, 5.





Nga Presidenti Diter F. Uhtdorf,
Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë

Mirënjohës në të Gjitha Rrethanat

A nuk kemi arsye të mbushemi me mirënjohje, pavarësisht nga rrethanat në të cilat gjendemi?

Me kalimin e viteve, unë kam pasur mundësinë e shenjtë që të takohem me shumë njerëz, hidhërimet e të cilëve duket se arrijnë deri në vetë thellësitë e shpirtit të tyre. Në ato çaste, i kam dëgjuar vëllezërit dhe motrat e mia të dashura dhe jam pikëlluar me ta lidhur me barrët e tyre. Kam përsiatuar se çfarë t'u them dhe jam përpjekur të di se si t'i ngushëlloj e përkrah ata gjatë sprovave të tyre.

Shpesh, pikëllimi i tyre shkaktohet nga ajo që u duket atyre si një mbarim. Disa po përballen me mbarimin e një marrëdhënieje shumë të dashur, të tillë si vdekja e një njeriu të dashur apo ftohja me një pjesëtar të familjes. Njerëz të tjerë ndiejnë se po përballen me mbarimin e shpresës – shpresës që të martohen apo të kenë fëmijë, ose që të mposhtin një sëmundje. Të tjerë mund të përballen me mbarimin e besimit të tyre, ndërkohë që zëra hutues e ngatërrues në botë i tundojnë që të vënë në dyshim, madje të braktisin, atë që dikur e dinin se ishte e vërtetë.

Herët a vonë, besoj se ne të gjithë përjetojmë kohë kur vetë pëlhura e

botës sonë shqepet tek tegelat qepës, duke na lënë të ndihemi të vetmuar, të zhgënjyer dhe në mëshirë të fatit.

Mund t'i ndodhë kujtdo. Askush nuk është i paprekshëm.

Ne Mund të Jemi Mirënjohës

Situata e çdo njeriu është e ndryshme dhe hollësitë e secilës jetë janë të pashoqe. Megjithatë, kam mësuar se ka diçka që do ta largonte hidhësinë që mund të hyjë në jetën tonë. Ka një gjë që mund të bëjmë për ta bërë jetën më të ëmbël, më të gëzueshme, madje të lavdishme.

Ne mund të jemi mirënjohës!

Mund të duket në kundërshtim me urtësinë e botës të sugjeroj që dikush, i cili është i rënduar me hidhërim, duhet t'i japë falënderime Perëndisë. Por ata që e lënë mënjane shishen e hidhësisë dhe në vend të saj ngrenë kupën e mirënjohjes, mund të gjejnë një pije dëlirësuese të shërimit, paqes dhe kuptueshmërisë.

Si dishepuj të Krishtit, ne urdhërohemi ta “falënderoj[më] Zotin, Perëndinë [tonë], në gjithçka”¹, t'i “këndoj[më] Zotit me falenderim”² dhe ta “le[më] të

jetë zemra [jonë] plot falënderime ndaj Perëndisë”³.

Përse na urdhëron Perëndia që të jemi mirënjohës?

Të gjitha urdhërimet e Tij jepen për të na i bërë bekimet të disponueshme. Urdhërimet janë mundësi për ta ushtruar lirinë tonë të zgjedhjes dhe për të marrë bekime. Ati ynë i dashur Qiellor e di se zgjedhja për të zhvilluar një shpirt mirënjohjeje do të na sjellë gëzim të vërtetë dhe lumturi të madhe.

Të Qenit Mirënjohës për Gjërat

Por disa mund të thonë: “Çfarë kam për të qenë mirënjohës, kur bota ime po copëtohet?”

Ndoshta përqendrimi te gjërat për të cilat jemi mirënjohës, është drejtimi i gabuar. Është e vështirë të zhvillojmë një shpirt mirënjohjeje nëse falënderimet tona janë vetëm në përpjesëtim të drejtë me numrin e bekimeve që mund të numërojmë. Vërtet, është e rëndësishme që shpesh t'i “numërojmë bekimet tona” – dhe kushdo që është përpjekur ta bëjë këtë, e di se janë të shumta – por unë nuk besoj se Zoti pret që ne të jemi në kohët e sprovës më pak mirënjohës se sa në kohët





Autoritetet e Përgjithshme dhe Drejtuesit e Përgjithshëm të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme

PRESIDENCA E PARË



Henri B. Ajting
Këshilltar i Parë



Tomas S. Monson
President



Dieter F. Uchtdorf
Këshilltar i Dytë

KUORUMI I DYMBËDHJETË APOSTOJVE



Boyd K. Packer



L. Tom Perri



Rasëll M. Nelson



Dallin H. Oaks



M. Rasëll Ballard



Rîçard G. Skot




Robert D. Hejls



Xhefiri R. Holland



Dejvid A. Bednar



Kuentin L. Kuk



D. Tod Kristoferson



Nil L. Andersen

PRESIDENCA E TË SHTATËDHJETËVE



Ronald A. Rasband



L. Òim Këjton



Donald L. Hidkison



Rîçard J. Ìvënis



Kreg C. Kristensen



Uliss Svanesh



Lin G. Robins

KUORUMI I PARË I TË SHITATËDHJETËVE

(sipas rendit alfabetik në anglishti)



Markos A. Adakakis




Hove L. Alonso



Carlos H. Amado



Jon S. Arderm



Merwin B. Arnold



David S. Bakster



Steven M. Bowen



Kreg A. Cantlon



Jun Huan Chi



Don R. Clark



Karl B. Kuk



Lorenz E. Korbinich



Ulfjord W. Andersen



Kiong Auogigi



Randall K. Benet



Bus A. Carlson



Klaudio R. M. Costa



Ledrana R. Kuris i Iku



Benjamin De Hoos



Eduard Dubi



Kevin R. Dunkon



Len J. Eto Houk



David F. Evans



Enrique R. Falabella



Eduardo Gnanet



Robert C. Gai



Carlos A. Godia



J. Devin Kormanik



Timothy J. Drakis



Brett D. Foster



Rendi D. Frank



Kristofel Golden



Geert W. Gong



Ulther F. Gonzales



C. Skot Grou



Xheims J. Hamuda



Daniel L. Xhanson



Patrick Kieran



Erik W. Kopschke



Jorg Klasingar



Xhozef W. Skoti



Markus B. Nish



S. Gifford Nilsen



O. Vinsent Hialek



Kerin S. Hamilton



Leni S. Keizer



Leni R. Lorenz



Brian H. Nelson



Alan F. Parker




Kevin W. Pison



Entoni D. Prekiris



Pol B. Pajper



Rafael E. Pino



Bus D. Porter



Dej G. Pleshind



Miquel T. Ringud



Xhozef W. Skoti



Shven E. Siao



Miquel Xhon U. Teh



Per G. Mohm



Hugo E. Morthez



Xhejms B. Marinho



Janio Macaragati



Zheza A. Ioshiano



Ham A. Ucedo



Anulo Vidarozola



Francisco J. Vripis



William R. Uolker



Siot D. Ushing



Qi Hong (Sam) Uung



Kazuhiko Jameshito



Hugo F. Zebalos



Nando D. Zivic



W. Krag Zok

PESHKOPATA KRYEJUSE



Zhenqi Keq
Keshilltar i Pare



Geni E. Sjuvanson
Peshkopi Kryesues



Din M. Dejves
Keshilltar i Dyte



Anulo Vidarozola



Ulliam R. Uolker



Siot D. Ushing



Qi Hong (Sam) Uung



Kazuhiko Jameshito



Hugo F. Zebalos




Nando D. Zivic



W. Krag Zok



Miquel Xhon U. Teh



Per G. Mohm



Hugo E. Morthez



Xhejms B. Marinho



Janio Macaragati

SHKOLLJA E SË DIELËS



Xhon S. Toner
Keshilltar i Pare



Ted R. Keshler
President



Devin G. Durmont
Keshilltar i Dyte

TË REJAT



Kara F. Mlek-Kontic
Keshilltare e Pare



Boni L. Oskanson
Presidente



Jill E. Manop
Keshilltare e Dyte



Karol M. Shivers
Keshilltare e Pare



Linda K. Barton
Presidente



Lirja S. Rios
Keshilltare e Dyte

FILLORIA



Xhin A. Shivers
Keshilltare e Pare



Rozniqi M. Ullsom
Presidente



Sheri A. Espin
Keshilltare e Dyte

TË RINJË



Leri M. Gibson
Keshilltar i Pare



Dejvid L. Bek
President

KUORUMI I DYTË I TË SHITATËDHJETËVE

(sipas rendit alfabetik në anglishti)



O. Vinsent Hialek



Kerin S. Hamilton



Leni S. Keizer



Leni R. Lorenz



J. Devin Kormanik



Timothy J. Drakis



Brett D. Foster



Rendi D. Frank



S. Gifford Nilsen



Markus B. Nish



Miquel Xhon U. Teh



Per G. Mohm



Hugo E. Morthez



Xhejms B. Marinho



Janio Macaragati



Janio Macaragati



Adrian O'Qua



Kent E. Ricards



Gregori A. Shiner




Taens M. Vinson



Leni Y. Ullsom



Shenjtoret e ditëve të mëvonshme anekënd botës mbledhen për Konferencën e Përgjithshme Vjetore të 184-t. Te fotografitë sipas drejtimit të akrepave të orës nga e majta lart janë anëtarë të Kishës dhe misionarë në Vienë, Austri; San-Paolo, Brazil; Meksiko-Siti, Meksikë; Ulan-Bator, Mongoli; Hajlends Renç, Kolorado, SHBA; Sidnei, Australi; Shën-Petersburg, Rusi; dhe Norkros, Xhorxhia, SHBA.





e begatisë dhe të rehatisë. Në fakt, shumica e referencave nga shkrimet e shenjta nuk flasin për mirënjohje *për* gjëra, por përkundrazi sugjerojnë një shpirt ose një sjellje të përgjithshme të mirënjohjes.

Është e lehtë të jemi mirënjohës *për* gjëra kur jeta duket se po shkon ashtu siç e duam. Por çfarë ndodh në ato kohë kur ajo që dëshirojmë duket të jetë shumë e paarrtshme?

A mund të sugjeroj që ne ta shohim mirënjohjen si një prirje, një mënyrë jete, e cila qëndron e pavarur nga situata jonë e tanishme? Me fjalë të tjera, po sugjeroj që në vend që të jemi mirënjohës *për* gjëra, të përqendrohemi tek të qenit mirënjohës *në* rrethanat tona – cilatdo qofshin ato.

Tregohet një histori e vjetër e një kamerieri që e pyeti një klient nëse i kishite pëlqyer ushqimi. Klienti u përgjigj se gjithçka ishte mirë, por do të kishte qenë edhe më mirë nëse do të kishin shërbyer më shumë bukë. Të nesërmen, kur burri erdhi përsëri, kamerieri e dyfishoi sasinë e bukës, duke i dhënë atij katër copa në vend të dy copave të bukës, por burri ende nuk ishte i lumtur. Të nesërmen, kamerieri ia dyfishoi bukën sërish, pa asnjë sukses.

Në ditën e katërt, kamerieri kishte vendosur me të vërtetë ta bënte burrin të lumtur. Dhe kështu, ai mori një bukë të gjatë gati tre metra, e preu përgjysmë dhe, me një buzëqeshje, ia shërbeu të tërën klientit. Kamerieri mezi po priste reagimin e burrit.

Pas ngrënies, burri ngriti sytë dhe tha: “E mirë si gjithmonë. Por e shoh se keni filluar prapë të mos jepni më shumë se dy copa buke.”

Të Qenit Mirënjohës në Rrethanat Tona

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, zgjedhja është e jona. Ne mund të zgjedhim që ta kufizojmë mirënjohjen tonë, bazuar në bekimet që e ndiejmë se na mungojnë. Ose ne mund të zgjedhim që të jemi si Nefi, zemra mirënjohëse e të cilit nuk u ligështua kurrë. Kur vëllezërit e tij e lidhën në anije – të cilën ai e kishte ndërtuar që t’i çonte drejt tokës së premtuar – kyçet e duarve dhe të këmbëve të tij i dhanë dhembje kaq të madhe ngaqë “ato ishin enjtur jashtëzakonisht” dhe një stuhi e dhunshme e kërcënoi ta përpinte në thellësitë e detit. “Megjithatë”, tha Nefi, “unë pashë te Perëndia im dhe e lavdërova atë gjatë gjithë ditës; dhe

unë nuk mëmërita kundër Zotit për shkak të vuajtjeve të mia”⁴.

Ne mund të zgjedhim të jemi si Jobi, i cili dukej se kishte gjithçka, por më pas e humbi të gjithën. Prapëseprapë Jobi u përgjigj duke thënë: “Lakuriq dola nga barku i nënës sime dhe lakuriq do të kthehem. Zoti ka dhënë dhe Zoti ka marrë. Qoftë i bekuar emri i Zotit.”⁵

Ne mund të zgjedhim që të jemi si pionierët mormonë, të cilët e ruajtën shpirtin e mirënjohjes gjatë udhës së tyre të ngadaltë dhe të mundimshme drejt Solt-Lejkut të Madh, madje duke kënduar e vallëzuar dhe duke përlëvdur mirësinë e Perëndisë.⁶ Shumë prej nesh do të ishin prirur që të tërhiqeshin, ankoheshin dhe ndienin ankth për vështirësinë e udhëtimit.

Ne mund të zgjedhim të jemi si Profeti Jozef Smith, i cili, ndërsa ishte i burgosur në kushte të mjeruara në Burgun e Libertisë, shkroi këto fjalë të frymëzuara: “Vëllezër shumë të dashur, le të bëjmë me gëzim të gjitha gjërat që janë në fuqinë tonë; dhe atëherë qëndroshim të patundur, me sigurinë më të madhe, për të parë shpëtimin e Perëndisë dhe që krahu i tij të zbulohet”⁷.

Ne mund të zgjedhim që të jemi mirënjohës, pavarësisht nga gjithçka.

Kjo lloj mirënjohjeje e lë pas gjithçka që po ndodh përreth nesh. E kapërcen çdo zhgënjim, shkurajim dhe dëshpërim. Lulëzon me po aq bukur në një peizazh të akullt dimri, siç lulëzon në ngrohtësinë e këndshme të verës.

Kur i jemi mirënjohës Perëndisë në rrethanat tona, ne mund të përjetojmë paqe të ëmbël në mes të mundimit. Në pikëllim, ne ende mund t'i lartësojmë zemrat tona në lavdërim. Në dhembje, ne mund të ngazëllemi me Shlyerjen e Krishtit. Në të ftohjetin e trishtimit të hidhur, ne mund të përjetojmë afërsinë dhe ngrohtësinë e përqafimit të qiellit.

Ne nganjëherë mendojmë se të qenit mirënjohës është ajo që bëjmë pasi zgjidhen problemet tona, por sa tmerrësisht dritëshkurtër është kjo. Sa shumë humbasim nga jeta duke pritur që të shohim ylberin, përpara se ta falënderojmë Perëndinë për shiun që bie?



Të qenit mirënjohës në kohët e vuajtjes *nuk* do të thotë që ne kënaqemi me rrethanat tona. Kjo *vërtet* do të thotë që, nëpërmjet syve të besimit, ne shohim përtej sfidave tona të së sotmes.

Kjo nuk është një mirënjohje e shprehur me buzë, por e shpirtit. Është një mirënjohje që e shëron zemrën dhe e zgjeron mendjen.

Mirënjohja si një Vepër e Besimit

Të qenit mirënjohës në rrethanat tona është një vepër e besimit te Perëndia. Kërkon që ne të mirëbesojmë te Perëndia dhe të shpresojmë për gjëra që mund të mos shihen, por të cilat janë të vërteta.⁸ Duke qenë mirënjohës, ne ndjekim shembullin e Shpëtimtarit tonë të dashur, i cili tha: “Mos u bëftë vullneti im, por yt!”⁹

Mirënjohja e vërtetë është një shprehje e shpresës dhe dëshmisë. Ajo vjen nga të pranuarit se ne nuk i kuptojmë gjithmonë sprovat e jetës, por mirëbesojmë se një ditë vërtet do t'i kuptojmë.

Në çfarëdo rrethane, ndjenja jonë e mirënjohjes ushqehet nga të vërtetat e shumta dhe të shenjta që ne vërtet i dimë: se Ati ynë u ka dhënë fëmijëve të Tij planin e madhërishtë të lumturisë; se nëpërmjet Shlyerjes së Birit të

Tij, Jezu Krishtit, ne mund të jetojmë përgjithmonë me njerëzit tanë të dashur; se, në përfundim, ne vërtet do të kemi trupa të lavdishëm, të përsosur e të pavdekshëm, të parënduar nga sëmundja apo paaftësia; dhe se lotët tanë të trishtimit dhe të humbjes do të zëvendësohen me një begati të lumturisë dhe gëzimit, “një masë [të] mirë, [të] ngjeshur, [të] tundur, gufuese”¹⁰.

Duhet të ketë qenë një lloj i tillë dëshmie që i shndërroi Apostujt e Shpëtimtarit nga burra të frikësuar, dyshues, në të dërguar të patrembur, gëzimplotë të Mësuesit. Në orët që pasuan Kryqëzimin e Tij, ata u pushtuan nga dëshpërimi e pikëllimi, të pazotë për të kuptuar atë që sapo kishte ndodhur. Por një ngjarje e ndryshoi gjithçka. Zoti iu shfaq atyre dhe u shpalli: “Shikoni duart e mia dhe këmbët e mia, sepse unë jam”¹¹.

Kur Apostujt e njohën Krishtin e ringjallur – kur përjetuan Ringjalljen e lavdishme të Shpëtimtarit të tyre të dashur – ata u bënë njerëz të ndryshëm. Asgjë nuk mund t'i largonte nga pëmbushja e misionit të tyre. Ata e pranuan me kurajë dhe vendosmëri torturën, poshtërimin dhe madje vdekjen, të cilat do t'u vinin për shkak të dëshmisë së tyre.¹² Ata nuk u frenuan kundrejt përlëvdimit të Zotit të tyre



Raimond, Alberta, Kanada

dhe shërbimit Atij. Ata e ndryshuan jetën e njerëzve kudo. Ata e ndryshuan botën.

Ju nuk keni nevojë ta shihni Shpëtimtarin, siç bënë Apostujt, për të përjetuar të njëjtin shndërrim. Dëshmia juaj për Krishtin, e lindur nga Fryma e Shenjtë, mund t'ju ndihmojë ta hidhni vështrimin përtej mbarimeve zhgënjyese në vdekshmëri dhe të shihni të ardhmen e shndritshme që ka përgatitur Shëlbuesi i botës.

Ne Nuk Jemi Bërë për Mbarime

Në dritën e asaj që dimë rreth vendmbërritjes sonë të përjetshme, a është çudi që kurdoherë që përballimi me mbarime të hidhura të jetës, ato na duken të papranueshme? Duket se ka diçka brenda nesh që i kundërshton mbarimet.

Pse ndodh kjo? Sepse ne jemi bërë nga lënda e përjetësisë. Ne jemi qenie të përjetshme, fëmijë të Perëndisë së Amshuar, emri i të cilit është i Pafundëm¹³ dhe i cili premton bekime të përjetshme të panumërta. Mbarimet nuk janë vendmbërritja jonë.

Sa më shumë që mësojmë rreth ungjillit të Jezu Krishtit, aq më shumë

kuptojmë se mbarimet këtu në vdekshmëri nuk janë aspak mbarime. Ato janë thjesht ndërprerje – ndalesa të përkohshme që një ditë do të duken të vogla në krahasim me gëzimin e përjetshëm që i pret njerëzit besnikë.

Sa mirënjohës i jam Atit tim Qiellor që në planin e Tij nuk ka mbarime të vërteta, vetëm fillime të pambarueshme.


Ata që Janë Mirënjohës do të Bëhen të Lavdishëm

Vëllezër e motra, a nuk kemi arsye të mbushemi me mirënjohje, pavarësisht nga rrethanat në të cilat gjendemi?

A kemi nevojë për ndonjë arsye më të madhe që ta lejojmë “të jetë zemra [jonë] plot falënderime ndaj Perëndisë”¹⁴?

“A nuk kemi shkak të madh të gëzohemi?”¹⁵

Sa të bekuar jemi nëse e dallojmë dorën e Perëndisë në tapicerinë magjepsëse të jetës. Mirënjohja ndaj Atit tonë në Qiell e zgjeron këndvështrimin tonë dhe e qartëson të kuptuarin tonë. Ajo frymëzon përlulesi dhe nxit dashamirësi kundrejt bashkëqenieve tona dhe gjithë krijesave të Perëndisë.



Mirënjohja është një përshpejtues i të gjitha tipareve të ngjashme me Krishtin! Një zemër falënderuese është prindi i të gjitha virtyteve.¹⁶

Zoti na ka dhënë premtimin e Tij se ata “që i [marrin] të gjitha gjërat me falënderim, do të bëhe[n] të *lavdishëm*; dhe gjërat e kësaj toke do t'[u] shtohen at[yre]”¹⁷.

Jetofshim “çdo ditë me falënderime”¹⁸ – veçanërisht gjatë mbarimeve në dukje të pashpjegueshme që janë pjesë e vdekshmërisë. I lejofshim shpirtat tanë të zgjerohen në mirënjohje ndaj Atit tonë të mëshirshëm Qiellor. I ngritshim përherë dhe vazhdimisht zërat tanë dhe e tregofshim me fjalë e vepra mirënjohjen tonë ndaj Atit tonë në Qiell dhe Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit. Për këtë lutem dhe ju lë dëshminë dhe bekimin tim, në emrin e Mësuesit tonë, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 59:7; shih edhe Efesianëve 5:20; 1 Thesalonikasve 5:18; Mosia 26:39; Alma 7:23; Doktrina e Besëlidhje 98:1.
2. Psalmeve 147:7.
3. Alma 37:37.
4. Shih 1 Nefi 18:10–16.
5. Jobit 1:21.
6. Për shembuj të pionierëve që ruajtën një qëndrim të gëzueshëm pavarësisht nga vështirësitë e mëdha, shih Andrew D. Olsen, *The Price We Paid: The Extraordinary Story of the Willie and Martin Handcart Pioneers* (2006), f. 10, 366–367.
7. Doktrina e Besëlidhje 123:17.
8. Shih Alma 32:21.
9. Lluca 22:42.
10. Lluca 6:38.
11. Lluca 24:39.
12. Shih Romakëve 5:3; 2 Korintasve 4:17; 12:10.
13. Shih Moisiu 1:3.
14. Alma 37:37.
15. Alma 26:13.
16. Shih Marcus Tullius Cicero, *Oratio Pro Cnaeo Plancio*, XXXIII, seksioni 80; cituar në Joseph B. Wirthlin, “Live in Thanksgiving Daily”, *Ensign*, shtator 2001, f. 8.
17. Doktrina e Besëlidhje 78:19; theksimi i shtuar.
18. Alma 34:38.



Nga Plaku M. Rasëll Ballard,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ndjekja e Ecurisë

Ne të gjithë mund të përfshihemi vazhdimisht në punën misionare duke e zëvendësuar frikën tonë me besim të vërtetë.

Në shtator do të bëhen gjashtëdhjetë e katër vjet që kurse u ktheva në shtëpi nga misioni im në Angli. Tri ditë pas kthimit, me një mikun tim, mora pjesë në një mbrëmje vallëzimi të quajtur Dita e Përhëndetjes tek Universiteti i Jutës. Ai më tregoi për një vajzë të bukur në vit të dytë, të quajtur Barbara Bouen, të cilën mendoi se duhej ta takoja. Ai e solli tek unë e na prezantoi, dhe ne filluam të kërcenim.

Fatkeqësisht, kjo ishte ajo që ne e quanim “kërcim me prekje në sup”, që nënkuptonte se mund të kërcëje me vajzën vetëm derisa dikush tjetër të të prekte në sup. Barbara ishte e shkathët dhe mjaft e njohur, kështu që kërcëva me të për më pak se një minutë përpara se një djalë tjetër të më prekte në sup.

Kjo ishte thjesht e papranueshme për mua. Ngaqë e kisha mësuar rëndësinë e ndjekjes së ecurisë në mision, mora numrin e saj të telefonit dhe i telefonova të nesërmen, për t’i kërkuar një takim, por ajo ishte e zënë me shkollën dhe detyrime shoqërore. Fatmirësisht, misioni më mësoi të isha këmbëngulës edhe përballë shkurajimit dhe, përfundimisht, munda të lija një takim. Dhe ai takim çoi në takime të tjera. Në njëfarë mënyre, gjatë atyre takimeve, unë

munda ta bindja atë se isha i vetmi misionar i kthyer nga misioni, i vërtetë dhe i gjallë – të paktën, për aq sa i përkiste asaj. Tani, 64 vjet më vonë, kemi shtatë fëmijë dhe shumë nipër e mbesa dhe stërnipër e stërmbesa, të cilët qëndrojnë si provë e së vërtetës domethënëse se, pavarësisht se sa i mirë është mesazhi yt, ju mund të mos kini mundësi për ta dhënë atë pa një ndjekje ecurie të vazhdueshme dhe këmbëngulëse.

Kjo mund të jetë arsyeja përse e kam ndier mbresën e qartë që sot të ndjek ecurinë e dy prej mesazheve të mia të mëparshme të konferencës së përgjithshme.

Në konferencën e tetorit të vitit 2011, unë ju nxita që të kujtonim këto fjalë të rëndësishme nga Zoti: “Sepse kështu do të quhet kisha ime në ditët e fundit, madje Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme”¹.

Me këto fjalë, Zoti e bën të qartë se ky nuk është vetëm një titull zyrtar, por edhe emri me anë të të cilit duhet të quhet Kisha e Tij. Për shkak të deklaratës së Tij të qartë, ne nuk duhet t’i drejtohem Kishës me ndonjë emër tjetër, të tillë si “Kisha Mormone” ose “Kisha SHDM”.

Fjala *Mormon* mund të përdoret në mënyrë të përshtatshme në disa kuptime, për t’ju drejtuar anëtarëve të Kishës, të tillë si pionierëve mormonë, ose institucioneve, të tilla si Kori Mormon i Tabernakullit. Anëtarët e Kishës njihen gjerësisht si mormonë dhe në ndërveprime me ata që nuk janë të besimit tonë, ne me vend mund t’i drejtohem vetes sonë si mormonë, me kusht që ta ndërthurim këtë me emrin e plotë të Kishës.

Nëse anëtarët mësojnë ta përdorin emrin e saktë të Kishës në lidhje me fjalën *Mormon*, kjo do të theksojë se ne jemi të krishterë, anëtarë të Kishës së Shpëtimtarit.



Vëllezër e motra, le ta ndjekim ecurinë dhe të zhvillojmë zakonet e bërjes përherë të qartë se ne i përkasim Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Mesazhi i dytë për të cilin ndiej se duhet të ndjek ecurinë, u dha pikërisht në konferencën e fundit të përgjithshme, kur i nxita anëtarët që të luteshin për t'u udhëhequr tek të paktën një individ, të cilit ata mund t'i jepnin një ftesë për të mësuar rreth ungjillit të rivendosur përpara Krishtlindjes. Shumë anëtarë kanë ndarë me mua disa përvoja të veçanta si pasojë e kërkesës që i bënë Zotit për mundësi misionare.

Një misionar i kthyer nga misioni, për shembull, u lut veçanërisht që të drejtohej tek "individi" të cilin ai mund ta ndihmonte. I erdhi në mendje emri i një ish-shoqeje klase në kolegji. Ai e gjeti atë në Facebook dhe mësoi se ajo kishte qenë duke u lutur për qëllim e kuptim në jetën e saj. Ai e ndoqi ecurinë pikërisht në kohën që ajo po kërkonte për të vërtetën, dhe në dhjetor ajo u pagëzua.

Shumë ftesa të ngjashme më janë raportuar, por vetëm pak njerëz kanë ndjekur ecurinë siç bëri ky vëlla.

Unë besoj shumë në parimin e ndjekjes së ecurisë. Siç thuhet në udhëzuesin e misionarit *Predikoni Ungjillin Tim*, "dhënia e një ftese pa e ndjekur atë është si të fillosh një udhëtim pa e mbaruar atë ose të blesh një biletë për një koncert pa shkuar në teatër. Pa veprimin e përfunduar, zotimi është i kotë."²

Predikoni Ungjillin Tim e mëson gjithsecilin se si jo vetëm të ftojë, por edhe të ndjekë ecurinë për ftesat e tij. Qëllimi i punës misionare përcaktohet si ftesë që "të tjerët të vijnë te Krishti duke i ndihmuar të marrin ungjillin e rivendosur me anë të besimit te Jezu Krishti dhe Shlyerja e Tij, pendimit, pagëzimit, marrjes së



dhuratës së Frymës së Shenjtë dhe durimit deri në fund"³.

Ftesa është sigurisht pjesë e procesit. Por vini re, ka shumë më tepër në punën misionare për anëtarët sesa thjesht bërja e ftesës që njerëzit të dëgjojnë misionarët. Ajo përfshin gjithashtu ndjekjen e ecurisë me misionarët në kultivimin e besimit, nxitjen për pendim, përgatitjen për të bërë besëlidhje dhe durimin deri në fund.

Ky parim i ndjekjes së ecurisë ilustron te libri *Veprat e Apostujve*:

"Por Pjetri dhe Gjoni po ngjiteshin bashkë për në tempull. . . .

Dhe aty ishte një njeri i çalë që prej lindjes, të cilin e sillnin çdo ditë dhe e linin afër derës së tempullit, e quajtur E bukura, për t'u kërkuar lëmoshë atyre që hynin në tempull.

Ai, kur pa se Pjetri dhe Gjoni po hynin në tempull, u kërkoi lëmoshë.

Atëherë Pjetri, me Gjoni duke i ngulur sytë mbi të, i tha: Na shiko.

Dhe ai po i shikonte me kujdes, duke shpresuar se do të merrte ndonjë gjë prej tyre.

Por Pjetri tha: 'Unë nuk kam as argjend, as ar, por atë që kam po ta jap: në emër të Jezu Krishtit Nazarenas, çohu dhe ec!'

Kjo është një ftesë e fuqishme nga një shërbëtor i Zotit, apo jo? Por Pjetri nuk u mjaftua me ftesën. Tregimi i shkrimit të shenjtë më pas na thotë se ai "*e kapi nga dora e djathtë, e ngriti në këmbë*: dhe në atë çast iu forcuan këmbët dhe nyjet.

Dhe me një të hovur, u ngrit në këmbë dhe filloi të ecë; dhe *hyri me ta në tempull*, duke ecur, duke u hedhur dhe duke lavdëruar Perëndinë."⁴

Me fjalë të tjera, Pjetri jo thjesht përdori autoritetin e tij të priftërisë dhe e ftoi burrin të ngrihej e të ecte. Ai gjithashtu ndoqi ecurinë e ftesës së tij duke iu afruar njeriut, duke e marrë nga dora e djathtë, duke e ngritur atë dhe, më pas, duke ecur me të për në tempull.

Në frymën e shembullit të Pjetrit, më lejoni të sugjeroj që ne të gjithë mund të përfshihemi vazhdimisht në punën misionare, duke e zëvendësuar frikën tonë me besim të vërtetë, duke e ftuar dikë të paktën një herë në tre muaj – ose katër herë në vit – për t'u mësuar nga misionarët kohëplotë. Ata janë të përgatitur për të dhënë mesim me anë të Shpirtit, me frymëzim të sinqertë dhe të përzemërt nga Zoti. Së bashku ne mund ta ndjekim ecurinë

e ftesave tona, t'i marrim të tjerët nga dora, t'i lartësojmë dhe të ecim me ta në udhëtimin e tyre shpirtëror.

Për t'ju ndihmuar me këtë proces, unë i ftoj të gjithë anëtarët, pavarësisht nga thirrja juaj e tanishme ose nga niveli i aktivizimit në Kishë, që të merrni një kopje të udhëzuesit *Predikoni Ungjillin Tim*. Ai është i disponueshëm nëpërmjet qendrave tona të shpërndarjes dhe gjithashtu në internet. Varianti në internet mund të lexohet ose shkarkohet falas. Ai është një udhëzues për punën misionare – që do të thotë se është një udhëzues për të gjithë ne. Lexojeni atë, studiojeni atë dhe më pas vëreni në jetë atë që mësoni, për t'ju ndihmuar të kuptoni se si të sillni shpirta te Krishti nëpërmjet ftesës dhe ndjekjes së ecurisë. Siç ka thënë Presidenti Tomas S. Monson: “Tani është koha për anëtarët dhe misionarët që të bashkohen së bashku, të veprojnë së bashku, të punojnë së bashku në vreshtin e Zotit për t'i sjellë shpirta Atij”⁵.



Jezu Krishti u mësoi dishepujve të Tij:

“E korra është me të vërtetë e madhe, por punëtorët janë pak.

Lutjuni, pra, Zotit të të korrave të dërgojë punëtorë në të korrat e tij.”⁶

Zoti i është përgjigjur asaj lutjeje në kohën tonë me numrin më të madh të misionarëve kohëplotë në historinë e botës. Me këtë valë të re të punëtorëve besnikë, Zoti na ka dhënë një mundësi tjetër për ta ndihmuar Atë në këtë korrje të madhe të shpirtave.

Ka mënyra praktike për anëtarët që t'i ndihmojnë e mbështetin misionarët tanë të mrekullueshëm. Për shembull, ju mund t'u thoni misionarëve se po studioni *Predikoni Ungjillin Tim* dhe kërkojuni atyre t'ju tregojnë atë që po mësojnë në studimet e tyre. Ndërsa ju i tregoni njëri-tjetrit, me siguri do të zhvillohet besim më i madh midis anëtarëve dhe misionarëve kohëplotë, ashtu siç urdhëroi Zoti:

“Por që çdo [burrë dhe grua] të mund të flasë në emër të Perëndisë, Zotit, madje Shpëtimtarit të botës”⁷.

Dhe: “Vini re, unë ju dërgoj që t'u dëshmoni njerëzve e t'i paralajmëroni ata dhe të bëhet që, kushdo që është paralajmëruar, të paralajmërojë të afërmin e tij”⁸.

Vëllezër e motra, a mund ta përfytyroni ndikimin nëse familja dhe miqtë do të përfshinin gjëra që janë duke i mësuar nga studimi i tyre vetjak i udhëzuesit *Predikoni Ungjillin Tim* në letrat e tyre dhe postën elektronike për misionarët e tyre kohëplotë? A mund t'i përfytyroni bekimet që do

t'u vijnë familjeve kur ta kuptojnë më mirë atë që bijtë dhe bijat e tyre do të studiojnë dhe japin mësim në misionet e tyre? A mund të filloni ta matni thellësinë e derdhjes së jashtëzakonshme të hirit shëlbues që do të jetë yni, individualisht dhe kolektivisht, sipas premtimit të Shpëtimtarit për të gjithë ata që japin dëshmi në procesin e të ftuarit të shpirtave për të ardhur tek Ai – dhe më pas në ndjekjen e ecurisë për ato ftesa?

“Ju jeni të bekuar”, tha Zoti nëpërmjet Profetit Jozef Smith, sepse “dëshmia që ju keni dhënë, shënohet në qiell, që engjëjt ta vështrojnë; dhe ata gëzohen për ju dhe mëkatet tuaja ju janë falur”⁹.

“Sepse unë do t'jua fal të gjitha mëkatet me këtë urdhërim – që ju të mbeteni të qëndrueshëm . . . në dhënien e dëshmisë për gjithë botën për ato gjëra që ju janë komunikuar.”¹⁰

Nëse ndjekim ecurinë, Zoti nuk do të na zhgënjëjë. Unë e kam parë gëzimin e papërshkrueshëm që shoqëron ftesën e nxitur nga dëshmia dhe ndjekjen e ecurisë në mënyrë besnike midis anëtarëve të Kishës në mbarë botën. Ndërsa isha në Argjentinë kohët e fundit, unë i nxita anëtarët të ftonin dikë në kishë përpara kësaj konference të përgjithshme. Një djalë tetëvjeçar, me emrin Xhoshua, dëgjoi dhe e ftoi mikun e tij më të mirë dhe familjen e mikut të tij te një shtëpi e hapur në lagjen e tyre në Buenos-Ajres. Më lejoni të lexoj nga një letër që sapo mora, që shpjegoi ftesën e Xhoshuas dhe ndjekjen e tij të ecurisë në mënyrë besnike:

“Çdo pak minuta [Xhoshua] do të vraponte te porta për të parë nëse po vinin. Ai tha që e dinte se ata do të [vinin].

Mbrëmja erdhi dhe miku i Xhoshuas nuk erdhi, por Xhoshua nuk u dorëzua. Ai kontrolloi besnikërisht portën kryesore çdo pak minuta. Ishte koha që të fillonim t’i hiqnim gjërat kur Xhoshua filloi të hidhej lart e poshtë duke lajmëruar: ‘Ata janë këtu! Ata janë këtu!’ Hodha sytë dhe pashë një familje të tërë që po i afrohej kishës. Xhoshua vrapoi jashtë për t’i përshëndetur dhe përqafoi mikun e tij. Ata hynë të gjithë brenda dhe dukej se po kënaqeshin shumë në shtëpinë e hapur. Ata morën disa broshura dhe kaluan shumë kohë duke u njohur me disa miq të rinj. Ishte e madhërishtme të shihje besimin e këtij djali të vogël dhe të dije se edhe fëmijët e Fillores mund të jenë misionarë.”¹¹

Është dëshmia ime se ndërsa punojmë së bashku, duke e kërkuar atë individ, duke e ftuar dhe duke e ndjekur ecurinë me mirëbesim dhe besim, Zoti do të na buzëqeshë dhe qindra mijëra prej fëmijëve të Perëndisë do të gjejnë qëllim dhe paqe në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Zoti na bekoftë të gjithëve në përpjekjet tona për ta përshpejtuar punën e shpëtimit, unë lutem përlulisht në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 115:4.
2. *Predikoni Ungjillin Tim: Një Udhëzues për Shërbimin Misionar* (2005), f. 208.
3. *Predikoni Ungjillin Tim*, f. 1.
4. Veprat e Apostujve 3:1–8; theksimi i shtuar.
5. Tomas S. Monson, “Mirësevini në Konferencë”, *Liahona*, nëntor 2013, f. 4.
6. Mateu 9:37–38.
7. Doktrina e Besëlidhje 1:20.
8. Doktrina e Besëlidhje 88:81.
9. Doktrina e Besëlidhje 62:3.
10. Doktrina e Besëlidhje 84:61.
11. Letër personale, 10 mars 2014.



Nga Xhin A. Stevens,

Këshilltare e Parë në Presidencën e Përgjithshme të Fillores

“Mos Ki Frikë, Sepse Unë Jam me Ty”

Kur zhvillojmë besim dhe mirëbesim më të madh te Zoti, ne mund të kemi të drejtën për fuqinë e Tij për të na bekuar dhe shpëtuar.

Pak ndjenja krahasohen me ndjenjat e dhembshura të bërjes prind. Nuk ka asgjë më të ëmbël se marrja e një fëmije të çmuar, drejtpërdrejt nga qielli. Një nga vëllezërit e mi e ka përjetuar këtë ndjenjë në një mënyrë veçanërisht prekëse. Djali i tij i parë, i vogël lindi para kohe dhe peshonte vetëm 1.3 kg. Hanteri i kaloi dy muajt e tij të parë të jetës në njësinë e kujdesit intensiv për të porsalindurit në spital. Ata muaj ishin një kohë mallëngjyese për të gjithë familjen, ndërsa shpresuam dhe i kërkuam Zotit për ndihmën e Tij.

Hanteri i vogël ishte aq i varur [nga aparaturat]. Ai luftoi për të fituar forcën e nevojshme për të jetuar. Dora e fortë e babait të tij të dashur shpesh kapi dorën e vogël të të birit për ta inkurajuar fëmijën e tij të vogël, të dobët.

Dhe po kështu është për të gjithë fëmijët e Perëndisë. Ati ynë në Qiell zgjat dorën drejt secilit prej nesh me dashurinë e Tij të pafundme. Ai ka fuqi mbi të gjitha gjërat dhe dëshiron të na ndihmojë të mësojmë, të rritemi dhe të kthehemi tek Ai. Kjo përkufizon qëllimin e Atit tonë: “Të bëj[ë] të

ndodhë pavdekësia dhe jeta e përjetshme e njeriut”¹.

Kur zhvillojmë besim dhe mirëbesim më të madh te Zoti, ne mund të kemi të drejtën për fuqinë e Tij për të na bekuar e shpëtuar.

Libri i Mormonit e ndërthur në të gjitha faqet e tij këtë temë të bukur të fuqisë së Zotit për të shpëtuar fëmijët e Tij. Nefi e paraqet atë që në kapitullin e parë të librit. Në vargun 20, ne lexojmë: “Por vini re, unë, Nefi, do t’ju tregoj se mëshirat e dhembshura të Zotit janë mbi të gjithë ata që ai ka zgjedhur, për shkak të besimit të tyre, për t’i bërë ata të pushtetshëm madje deri në fuqinë e çlirimit”².

Shumë vite më parë arrita t’i kuptoj në një mënyrë shumë vetjake të vërtetat e shprehura në këtë varg. Unë arrita të kuptoj pikërisht se sa pranë është Ati ynë në Qiell dhe pikërisht se sa shumë Ai dëshiron të na ndihmojë.

Një mbrëmje ndërsa ishte duke rënë nata, po udhëtoja në makinë me fëmijët e mi kur vura re një djalë që po ecte përgjatë një rruge të shkretë. Pasi e kaluam atë, unë pata një përshlyetje të qartë që duhej të kthehesha dhe ta ndihmoja. Por e shqetësuar se

mund të trembej nga një e huaj që ndalonte pranë tij natën, vazhdova duke ngarë makinën. Përshtypja e fortë erdhi përsëri me fjalët në mendjen time: “Shko ndihmoje atë djalë!”

E ktheva makinën mbrapsht për tek ai dhe e pyeta: “A ke nevojë për ndihmë? Pata një ndjenjë që duhet të të ndihmoja.”

Ai u kthye drejt nesh dhe me lot që i rridhnin nëpër faqe tha: “A do të më ndihmonit? Unë isha duke u lutur që dikush të më ndihmonte.”

Lutja e tij për ndihmë mori përgjigje me frymëzim që erdhi tek unë. Kjo përvojë e marrjes së një udhëzimi kaq të qartë nga Shpirti la një gjurmë të paharrueshme që qëndron ende në zemrën time.

Dhe tani, pas 25 vitesh, dhe nëpërmjet një mëshire të dhembshur, unë u lidha sërish me këtë djalë për herë të parë vetëm pak muaj më parë. Unë zbulova se përvoja nuk është thjesht historia ime – ajo është historia e tij gjithashtu. Derik Nenci tani është një baba me një familje të vetën. Edhe ai nuk e ka harruar kurrë këtë përvojë. Ajo na ndihmoi të hidhnim një themel besimi, që Perëndia i dëgjon dhe u përgjigjet lutjeve tona. Të dy e kemi përdorur atë për t’u mësuar fëmijëve tanë që Perëndia kujdeset për ne. Ne nuk jemi vetëm.

Atë natë, Deriku kishte qëndruar pas shkollës për një aktivitet dhe e kishte humbur autobusin e fundit. Si një adoleshent i ri, ai u ndje i sigurt se mund t’ia dilte të shkonte në shtëpi, kështu që filloi të ecte.

Një orë e gjysmë kishte kaluar ndërsa po ecte në rrugën vetmuar. Ende kilometra larg shtëpisë dhe pa asnjë shtëpi përreth, ai u frikësua. Në dëshpërim, ai shkoi prapa një pirgu zhavorri, u ul në gjunjë dhe i kërkoi Atit Qiellor për ndihmë. Vetëm pak minuta pasi Deriku u kthye në rrugë,



unë ndalova për të dhënë ndihmën për të cilën u lut ai.

Dhe tani, kaq shumë vite më vonë, Deriku reflekton: “Zoti u kujtua për mua, një djalë të dobët, dritëshkurtër. Dhe pavarësisht nga çdo gjë tjetër që po ndodhte në botë, Ai ishte në dijeni të situatës sime dhe më donte mjaftueshëm për të më dërguar ndihmë. Zoti u është përgjigjur lutjeve të mia shumë herë që nga ajo rrugë e braktisur. Përgjigjet e Tij nuk janë gjithmonë aq të menjëhershme dhe të qarta, por vëmendja e Tij ndaj meje është po aq e qartë sot sikurse ishte atë natë të vetmuar. Sa herë që hijet e errëta të jetës mbulojnë botën time, unë e di që Ai gjithmonë ka një plan për t’u kujdesur që të më shohë sërish të sigurt në shtëpi.”

Ashtu si u shpreh Deriku, jo çdo lutje merr përgjigje në mënyrë kaq të shpejtë. Por me të vërtetë, Ati ynë na njeh dhe i dëgjon lutjet e zemrave tona. Ai i përmbush mrekullitë e Tij duke iu përgjigjur lutjeve një e nga një, njerëzve një e nga një.

Ne mund të besojmë se Ai do të na ndihmojë, jo domosdoshmërisht në mënyrën që ne duam, por në mënyrën që do të na ndihmojë më mirë që të rritemi. Nënshtrimi i vullnetit tonë ndaj vullnetit të Tij mund të jetë i vështirë, por është thelbësor për t’u

bërë si Ai dhe për të gjetur paqen që na ofron Ai.

Ne mund të arrijmë të ndihemi, ashtu si K. S. Ljuis përshkroi: “Unë lutem, sepse nuk mund ta ndihmoj veten time. . . . Unë lutem, sepse e ndiej nevojën të rrjedhë nga brenda meje gjithë kohës, zgjuar apo fjetur. Ajo nuk e ndryshon Perëndinë. Ajo më ndryshon mua.”³

Ka shumë rrëfime në shkrimet e shenjta të atyre që e kanë vënë besimin e tyre te Zoti dhe të cilët janë ndihmuar dhe shpëtuar nga Ai. Mendoni për Davidin e ri, i cili i shpëtoi vdekjes së sigurt në duart e Goliathit të fuqishëm duke u mbështetur te Zoti. Merrni parasysh Nefin, lutjet e të cilit drejtuar Perëndisë me besim, i sollën çlirim nga vëllezërit e tij që u përpoqën t’i merrnin jetën. Kujtoni të rinë Jozef Smith, i cili me lutje kërkoi ndihmën e Zotit. Ai u çlirua nga fuqia e errësirës dhe mori një përgjigje të mrekullueshme. Secili prej tyre u përball me sfida të vërteta dhe të vështira. Secili veprroi me besim dhe e vendosi mirëbesimin e vet te Zoti. Secili e mori ndihmën e Tij. Dhe ende në ditët tona, fuqia dhe dashuria e Perëndisë janë të dukshme në jetën e fëmijëve të Tij.

Unë e kam parë atë kohët e fundit në jetën e shenjtorëve plot besim në Zimbabve dhe Botsvana. Në një mbledhje agjërimi dhe dëshmish në një degë të vogël, unë u përula dhe u frymëzova nga dëshmitë e dhëna prej shumë njerëzve – fëmijë, të rinj dhe të rritur njëloj. Secili përçoi një shprehje të fuqishme të besimit te Zoti Jezu Krisht. Me sfidat dhe rrethanat e vështira që i rrethojnë, ata jetojnë çdo ditë duke e vënë besimin e tyre te Perëndia. Ata e pranojnë dorën e Tij në jetën e tyre dhe shpesh e shprehin atë me thënien: “Unë i jam kaq shumë mirënjohës Perëndisë”.

Disa vite më parë, një familje besnike u bë shembull i po atij besimi



te Zoti për anëtarët e lagjes sonë. Arn dhe Venita Gatrell po bënin një jetë të lumtur kur Arni u diagnostikua me një kancer agresiv. Prognoza ishte shkatërruese – ai kishte vetëm disa javë jetë. Familja dëshironte të ishte së bashku një herë të fundit. Kështu që, të gjithë fëmijët u mblodhën, disa prej tyre nga vende të largëta. Ata kishin vetëm 48 orë të çmuara për të kaluar së bashku. Familja Gatrell zgjodhi me kujdes çfarë kishte më shumë rëndësi për ta – një fotografi familjare, një darkë familjare dhe një sesion në Tempullin e Solt-Lejkut. Venita tha: “Kur dolëm jashtë dyerve të tempullit, ishte hera e fundit që ne do të ishim ndonjëherë së bashku në këtë jetë”.


Por ata u larguan me sigurinë se ka shumë më tepër për ta sesa thjesht kjo jetë. Për shkak të besëlidhjeve të shenjta të tempullit, ata kanë shpresë te premtimet e Perëndisë. Ata mund të jenë së bashku përgjithmonë.

Dy muajt pasues u mbushën me bekime tepër të shumta për t’u treguar. Besimi dhe mirëbesimi i Arnit dhe Venitës te Zoti ishin duke u rritur, siç dëshmohet në fjalët e Venitës: “Unë pata mbështetje. Mësova se mund të ndieni paqe mes shqetësimit. E dija se Zoti po kujdesej për ne. Në qoftë se besoni te Zoti, me të vërtetë ju mund të kapërceni çfarëdo sfide të jetës.”

Një nga bijat e tyre shtoi: “Ne vëzhguam prindërit tanë dhe pamë shembullin e tyre. E pamë besimin e tyre dhe se si e përdorën atë. Unë kurrë

nuk do ta kisha kërkuar këtë sprovë, por unë kurrë nuk do të hiqja dorë prej saj. Ne u rrethuam nga dashuria e Perëndisë.”

Sigurisht, vdekja e Arnit nuk ishte përfundimi për të cilën kishte shpresuar familja Gatrell. Por kriza e tyre nuk ishte një krizë besimi. Ungjilli i Jezu Krishtit nuk është një listë e gjërave për t’u bërë; përkundrazi, ai jeton në zemrat tona. Ungjilli “nuk është barrë; ai është krahë”⁴. Ai na mbështet. Ai e mbështeti familjen Gatrell. Ata ndien paqe në mes të stuhisë. Ata u kapën fort pas njëri-tjetrit dhe besëlidhjeve të tempullit që kishin bërë dhe mbajtur.



Ata u rritën në aftësinë e tyre për të besuar te Zoti dhe u forcuan prej besimit të tyre te Jezu Krishti dhe te fuqia e Tij shlyese.

Kudo që e gjejmë veten nëpër shtegun e të qenit dishepull, çfarëdo qofshin shqetësimet dhe sfidat tona, ne nuk jemi vetëm. Ju nuk jeni të harruar. Ashtu si Deriku, shenjtorët e Afrikës dhe familja Gatrell, ne mund të zgjedhim të arrijmë dorën e Perëndisë kur kemi nevojë. Ne mund të përballemi me sfidat tona me lutje dhe besim te Zoti. Dhe gjatë kësaj ne bëhemi më shumë si Ai.

Duk i folur secilit prej nesh, Zoti thotë: “Mos . . . ki frikë, . . . Unë jam me ty; mos e humb; sepse unë jam Perëndia yt: Unë të forcoj; . . . të ndihmoj dhe të mbaj me dorën e djathtë të drejtësisë sime”⁵.

Unë jap dëshminë time të përlurur, por të sigurt, që Perëndia, Ati ynë na njeh personalisht dhe afrohet që të na ndihmojë. Nëpërmjet Birit të Tij të Dashur, Jezu Krishtit, ne mund t’i mposhtim sfidat e kësaj bote dhe të çohemi të sigurt në shtëpi. Paçim besim për t’i mirëbesuar Atij, unë lutem në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moisiu 1:39.
2. 1 Nefi 1:20.
3. Thënë nga personazhi i C. S. Lewis siç portretizohet në veprën e William Nicholson, *Shadowlands* (1989), f. 103.
4. Harry Emerson Fosdick, *Twelve Tests of Character* (1923), f. 88.
5. Isaia 41:10.



Nga Peshkopi Geri E. Stivenson
Peshkopi Kryesues

Katër Minutat Tuaja

Mrekullia e Shlyerjes mund të plotësojë për papërsosuritë në të vepruarin tonë.

Lojërat e fundit Olimpikë Dimërore e magjepsën botën, ndërsa atletë përfaqësues të 89 vendeve morën pjesë në 98 gara të ndryshme. Në mënyrë mbresëlënëse, 10 prej këtyre atletëve ishin anëtarë të Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme, 3 prej të cilëve fituan medalje, për të cilët u shkrua kohët e fundit në gazetën *Church News [Lajme të Kishës]*: Kristofer Fogt, Noell Pajkës-Peis dhe Tora Brajt.¹ Ne u japim urimet tona të gjithë atletëve që konkurruan. Ju lumtë!


Flas për këto lojëra këtë mëngjes duke i çuar mendimet e mia tek të rinjtë, të rejtat dhe të rinjtë në moshë madhore beqarë – ju që jeni në vitet tuaja më vendimtare të cilat përcaktojnë drejtimin e jetës suaj. Unë kam një ndjesi të fortë ngutjeje për t’ju folur juve.

Që ta ndieni atë ngutje, po tregoj së pari historinë e Noell Pajkës-Peisit, një prej këtyre atletëve shenjtorë të ditëve të mëvonshme. Në garën e Noellës, rrëshqitjen me slitë skeleton, atletët fitojnë shpejtësi ndërsa vrapojnë me vrull dhe pastaj shtrihen me kokën përpara në një slitë të vogël. Me fytyrat e tyre vetëm disa centimetra mbi tokë, ata turren teposhtë një piste të akullit, me dredha, me shpejtësira që i kalojnë 145 km në orë.

Si për habi, vitet e përgatitjes do të konsideroheshin ose sukses ose zhgënjim, bazuar tek ajo çfarë ndodhi në hapësirën e katër rrëshqitjeve të vrullshme prej 60-sekondash secila.

Ëndrrat Olimpikë të mëparshme të Noellës në vitin 2006 u rrënuan kur një aksident i tmerrshëm e la atë me këmbën të thyer. Në Lojërat Olimpikë të 2010-s ëndrrat e saj dështuan sërish kur vetëm një e dhjeta e sekondës e pengoi të hipte në podiumin e medaljeve.²

A mund ta përfytyroni ankthin që ndjeu ajo, ndërsa priste të fillonte rrëshqitjen e saj të parë në Lojërat



Olimpikë të 2014-s? Vitet e përgatitjes do të arrinin kulmin në vetëm pak kohë. Katër minuta gjithsej. Ajo kaloi vite duke u përgatitur për ato katër minuta dhe do të kalonte një jetë të tërë më pas duke reflektuar për to.

Rrëshqitjet finale të Noellës ishin tërësisht pa gabime! Ne nuk do ta harrojmë kurrë kërcimin e saj te ndenjset për të përqaftuar familjen e saj pas kalimit të vijës fundore, duke thirrur: “Ja dolëm!” Vitet e përgatitjes kishin dhënë fryt. Ne e pamë medaljonin e saj të Të Rejave varur në qafë kur iu vendos medalja e argjendit atje pranë atij.³

Mund të duket e padrejtë që të gjitha ëndrrat Olimpikë të Noellës vareshin nga ajo çfarë bëri gjatë vetëm katër minutave të shkurtra. Por ajo e dinte atë dhe kjo është arsyeja përse u përgatit me aq zell. Ajo e ndiente peshën, ngutjen e katër minutave të saj dhe se çfarë kuptimi do të kishin ato për pjesën tjetër të jetës së saj.

Ne gjithashtu kujtojmë Kristofer Fogtin, anëtar i skuadrës që fitoi medaljen e bronzit në garën me katër veta me slitë bobsled. Ndonëse mund të kishte hequr dorë pas një përplasjeje rrënuese në Lojërat Olimpikë të 2010-s, ai zgjodhi të këmbëngulte. Pas një gare fantastike, shpërblyese, ai fitoi çmimin që e synoi me aq zell.⁴

Tani, merrni parasysh se si udha juaj për te jeta e përjetshme është e ngjashme me “arritjen sportive katër-minuteshe” të këtyre atletëve. Ju jeni një qenie e përjetshme. Përpara se të lindeshit, ju ekzistuat si një shpirt. Në praninë e një Ati të dashur Qiellor, ju u stërvitët dhe u përgatitët për të ardhur në tokë për një çast të shkurtër dhe, sigurisht, për të vepruar. Kjo jetë përbën katër minutat tuaja. Ndërkohe që jeni këtu, veprimet tuaja do të përcaktojnë nëse e fitoni çmimin e jetës së përjetshme. Profeti Amuleki



përshkroi: “Kjo jetë është koha . . . që të përgatiten[i] të takohen[i] me Perëndinë; po, vini re, dita e kësaj jete është dita . . . që të kryef[ni] punët [tuaja]”⁵.

Në një kuptim, katër minutat tuaja kanë filluar tashmë. Koha po kalon. Fjalët e Apostullit Pal duken kaq të përshtatshme: që të vraponi në garë, në mënyrë që ta merrni çmimin⁶.

Në të njëjtën mënyrë si disa hapa janë thelbësore në paraqitjen fare të shkurtër sportive të një atleti olimpik – kërcimet apo manovrat për skiatorët dhe rrëshqitësit e snoubordit në akull, marrja e kthesave në garën me slita bobsledit ose përshkimi i shpejtë i portave në një shteg zbritës për ski sllallom – po kështu është në jetën tonë, ku disa gjëra janë absolutisht thelbësore – pika kontrolli që na çojnë përpara gjatë paraqitjes sonë shpirtërore në tokë. Këta shenjues shpirtërorë janë ordinancat thelbësore të ungjillit, të dhëna nga Perëndia: pagëzimi, marrja e dhuratës së Frymës së Shenjtë, shugurimet në priftëri, ordinancat e tempullit dhe marrja e sakramentit çdo javë.

“Në [këto] ordinanca . . . , fuqia e perëndishmërisë manifestohet.”⁷

Dhe në të njëjtën mënyrë si disiplina e stërvitjes e përgatit një atlet që t’i plotësojë në shkallën më të lartë elementet në sportin e vet, mbajtja e urdhërimeve do t’ju kualifikojë t’i merrni këto ordinanca shpëtuese.

A e ndieni ngutjen?

Miqqtë e mi të rinj, kudo që jeni në “paraqitjen tuaj katërminutëshe”, ju nxit të përsiatni: “Çfarë duhet të bëj në vijim që të siguroj medaljen time?” Ndoshta gjatë kësaj konference, Shpirti ju ka pëshpëritur se çfarë mund të jetë ajo: të përgatiteni më me maturi për një ordinancë në të ardhmen tuaj apo të merrni një ordinancë që duhet ta kishit marrë shumë kohë më parë. Çfarëdo qoftë, bëjeni atë tani. Mos prisni. Katër minutat tuaja do të kalojnë me shpejtësi dhe ju do të keni përjetësinë për të menduar rreth asaj që bëtë në këtë jetë.⁸

Vetëdisiplinimi është i nevojshëm. Lutja e përditshme, studimi i përditshëm i shkrimeve të shenjta dhe pjesëmarrja në kishë duhet të jenë baza e stërvitjes tuaj. Kërkohej një zakon i qëndrueshëm i bindjes ndaj urdhërimeve, mbajtja e besëlidhjeve

që keni bërë dhe zbatimi i standardeve të Zotit të gjendura te broshura *Për Forcën e Rinisë*.

Ndoshta ju jeni të vetëdijshëm për gjëra në jetën tuaj që po kërcënojnë të ngadalësojnë ose ndalojnë përparimin tuaj shpirtëror. Nëse është kështu, ndiqni këtë këshillë shpirtërore: “[Le të] hedh[im] tej çdo barrë dhe mëkatin që na qarkon vazhdimisht duke na joshur, dhe le të rendim me durim në udhën që është përpara nesh”⁹.

Nuk është ende tepër vonë për t’u penduar. Por shpejt mund të jetë vonë, pasi asnjë nuk e di në të vërtetë se kur do të mbarojnë katër minutat tona.

Tani, ju mund të jeni duke menduar me vete: “Unë tashmë e kam katranosur. Katër minutat e mia janë tanimë katastrofë. Mund edhe të heq dorë.” Nëse është kështu, ndaloni së menduari atë dhe mos e mendoni më kurrë. Mrekullia e Shlyerjes mund të plotësojë për papërsosuritë në të vepruarin tonë. Siç dha mësim Plaku Xhefri R. Holland:

“Atyre prej jush . . . që ende mund të ngurrojnë . . . unë [u] dëshmoj për fuqinë përtëritëse të dashurisë së

Perëndisë dhe për mrekullinë e hirit të Tij. . . .

. . . Nuk është *kurrë* tepër vonë për aq kohë sa Pronari . . . thotë se ka kohë. . . . Mos u vononi.”¹⁰

Mbani mend, ju nuk jeni vetëm. Shpëtimtari ka premtuar se nuk do t’ju lërë bonjakë.¹¹ Ju keni gjithashtu familje, miq dhe udhëheqës që po ju nxitin.

Ndonëse fjalimi im i është drejtuar rinisë së Kishës, për prindërit dhe gjyshërit, unë përcjell sa vijon:

Kohët e fundit, Plaku Dejvid A. Bednar përshkroi një mënyrë të thjeshtë për të kryer një vlerësim të familjes për të parë përparimin në shtegun e besëlidhjes nëpërmjet ordinancave thelbësore. Gjithçka që duhet, është një copë letër me dy kolona: “emri” dhe “plani për ordinancën tjetër ose ordinancën e nevojshme”. E bëra këtë kohët e fundit, duke e renditur secilin anëtar të familjes. Mes tyre, vura re një nip të porsalindur, i cili do të bekohej së shpejti; një nip gjashtë vjeç, përgatitja e të cilit për pagëzim ishte thelbësore; dhe një djalë që do të mbushte 18 vjeç, përgatitja e të cilit për priftërinë dhe indaumentin e tempullit ishin të pashmangshme. Gjithësecili në listë kishte nevojë për ordinancën e sakramentit. Ky ushtrim i thjeshtë na ndihmoi mua dhe Lesën të përmbushnim rolin tonë për ta ndihmuar secilin anëtar të familjes sonë nëpër shtegun e besëlidhjes, me një plan veprimi për çdonjërin prej tyre. Ndoshta kjo është një ide për ju, e cila do të çojë në diskutime familjare, mësim të mbrëmjes familjare, përgatitje dhe madje ftesa për ordinancë thelbësore në familjen tuaj.¹²

Si skiator dhe rrëshqitës snouborderi vetë, më la mbresa të thella paraqitja sportive “katërminutëshe” prej fitueseje të medaljes së argjendtë e atletes dhe rrëshqitëses me snoubord australiane SHDM, Tora Brajt, në



garën në gjysmë-rampë. Ajo e verboi botën kur përmbylli një garë tërësisht pa gabime që arriti kulmin me një manovër rodeo me kurriz 720-gradëshe. Sidoqoftë, edhe më mbresëlënëse dhe më e habitshme ishte mënyra se si ajo iu afrua dhe u shfaq dashuri si të Krishtit konkurrentëve të saj. Ajo vuri re që rrëshqitësja amerikane e snouborderit, Keli Klark, e cila pati një rezultat të keq në rrëshqitjen e parë të raundit të fundit dukej të ishte nervoze për rrëshqitjen e saj të dytë. “Ajo më përqafoi”, kujton Klark. “Ajo thjesht më shtrëngoi derisa vërtet u qetësova mjaftueshëm dhe e ngadalësova frymëmarrjen time. Sa mirë të merrje një përqaftim nga një shoqe.” Keli Klark më vonë do t’i bashkohej Toras në podiumin e fitueseve si fituese e medaljes së bronzit.

Kur e pyetën për këtë veprim të pazakontë mirësie kundrejt kundërshtares së saj, e cila mund t’ia kishte rrezikuar fitoren e medaljes së saj të argjendtë, Tora thjesht tha: “Unë jam një konkurrente – dua të jap maksimumin tim – por dëshiroj që edhe bashkëkonkurrentët e mi të japin maksimumin e tyre”¹³.

Me këtë në mendje, a ka ndonjë person që ka nevojë për përkrahjen tuaj? një pjesëtar i familjes? një mik? një shok klase ose një bashkanëtar në kuorumin tuaj? Si mund t’i ndihmoni ata me katër minutat e tyre?

Të dashur miq, ju jeni në mes të një udhëtimi gjallërues. Në disa

mënyra, ju jeni duke rrëshqitur teposhtë gjysmë-rampës ose pistës për slita, dhe mund të jetë sprovuese ta plotësoni secilin element ose të merrni secilën kthesë përgjatë udhës. Por kujtoni, ju jeni përgatitur për këtë gjatë mijëvjeçarëve. Ky është çasti juaj për të vepruar. Kjo përbën katër minutat tuaja. Tani është koha!

Unë shpreh besimin tim më të madh në aftësitë tuaja. Ju keni Shpëtimtarin e botës në anën tuaj. Nëse kërkonti ndihmën e Tij dhe ndiqni udhëzimet e Tij, si mund të dështoni?

E mbyll me dëshminë time për bekimin që kemi në saje të profetit të gjallë, Presidentit Tomas S. Monson; dhe me dëshminë për Jezu Krishtin dhe rolin e Tij si Shpëtimtari dhe Shëlbuesi ynë, në emrin e Tij të shenjtë, Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Christine Rappleye, “Mormons in the Olympics: 3 Medals for LDS Athletes at the Winter Games”, deseretnews.com/article/865597546/Mormons-in-the-Olympics-3-medals-for-LDS-athletes-at-the-Winter-Games.html.
2. Shih Christine Rappleye, “Mormons in the Olympics”.
3. Shih Sarah Petersen, “Noelle Pikus-Pace Wears LDS Young Women Necklace throughout Olympics”, deseretnews.com/article/865596771/Noelle-Pikus-Pace-wears-LDS-Young-Women-necklace-throughout-Olympics.html.
4. Shih Amy Donaldson, “Army, Faith Helped Push Mormon Bobsledder Chris Fogt to Olympic Success”, deseretnews.com/article/865597390/Army-faith-helped-push-Mormon-bobsledder-Chris-Fogt-to-Olympic-success.html.
5. Alma 34:32.
6. Shih 1 Korintasve 9:24.
7. Doktrina e Besëlidhje 84:20.
8. Shih Alma 34:31–33.
9. Hebrejve 12:1.
10. Xhefri R. Holland, “Punëtorët në Vresht”, *Liahona*, maj 2012, f. 33.
11. Shih Gjoni 14:18.
12. Dejvid A. Bednar, bisedë me autorin.
13. Vidya Rao, “Snowboarder Kelly Clark: Hug from Competitor Helped Me Win Bronze”, today.com/sochi/snowboarder-kelly-clark-hug-competitor-helped-me-win-bronze-2D12108132.



Nga Plaku Dejvid A. Bednar,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

I Duronin Barrët e Tyre me Lehtësi

Barrët e veçanta, në jetën e secilit prej nesh, na ndihmojnë që të mbështetemi te meritat, mëshira dhe hiri i Mesias së Shenjtë.

Unë kam një mik të dashur të cilit, në vitet e para të martesës së tij, iu mbush mendja se ai dhe familja e tij kishin nevojë për një kamionçinë fuoristradë me katër rrota aktive. Gruaja e tij ishte e sigurt se ai nuk kishte nevojë, por thjesht e dëshironte makinën e re. Një bashkëbisedim plot shaka, midis këtij burri dhe kësaj gruaje, nxiti marrjen parasysht të anëve pozitive dhe negative të një blerjeje të tillë.

“E dashur, na nevojitet një automjet me rrota aktive.”

Ajo pyeti: “Përse mendon se na nevojitet një makinë e re?”

Ai iu përgjigj pyetjes së saj me atë që besonte se ishte përgjigja e përsosur: “Po sikur të na duhej qumësht për fëmijët tanë në një stuhi të tmerrshme dhe e vetmja mënyrë se si mund të shkoja në dyqan të ishte me një kamionçinë?”

Gruaja e tij iu përgjigj me buzëqeshje: “Nëse blejmë një makinë të re, ne s’do të kemi para për qumësht – prandaj përse të shqetësohesh për vajtjen në dyqan në një rast urgjent!”

Me kalimin e kohës ata vazhduan të këshilloheshin së bashku dhe më

së fundi vendosën ta blinin makinën. Pak kohë pasi e bëri pronë të vetën automjetin e ri, miku im dëshironte të vinte në dukje përdorimin e makinës dhe të vërtetonte arsyet e tij përse dëshironte ta blinte atë. Prandaj vendosi se do të priste dhe mbarnte një ngarkesë me drurë për shtëpinë e tyre. Ishte në stinën e vjeshtës atë vit dhe dëborë tashmë kishte rënë në malet ku ai kishte ndërmend t’i gjente drurët. Ndërsa ngiste makinën duke iu ngjitur malit, dëborë pak nga pak u bë gjithnjë e më e shumtë. Miku im e dalloj se kushtet rrëshqitëse të rrugës paraqisnin rrezik, por me mirëbesim të madh tek automjeti i ri, ai vazhdoi rrugën.

Trishtueshëm, miku im shkoi shumë larg nëpër rrugën plot dëborë. Teksa e drejtoi makinën jashtë rrugës, drejt një vendi ku kishte vendosur të priste drurët, ajo ngeli në vend. Që të katër rrotat e makinës së re rrotulloheshin në dëborë. Me të shpejtë e kuptoi se nuk dinte se çfarë të bënte që ta çlironte veten nga kjo gjendje e rrezikshme. E ndjeu veten ngushtë dhe të shqetësuar.

Miku im vendosi: “Epo, s’do të rri thjesht këtu”. Zbriti nga makina dhe

filloi të priste drurë. E mbushi tërësisht pjesën e pasme të makinës me barrën e rëndë. Dhe më pas miku im vendosi se do të përpiquej edhe një herë që ta ngiste makinën jashtë dëborës. Ndërsa vendosi marshin dhe i ushtroi fuqi gazit, ai lëvizi disa centimetra përpara. Dalëngadalë makina doli jashtë dëborës dhe u kthye përsëri në rrugë. Përfundimisht ai ishte i lirë për t’u kthyer në shtëpi, një burrë i lumtur dhe i përlur.

Barra Jonë Vetjake

Unë lutem për ndihmën e Frymës së Shenjtë, ndërkohë që theksoj mësimet jetike, të cilat mund të mësohen nga kjo histori rreth mikut tim, automjetit dhe drurëve. Ishte barra. Ishte barra e drurëve që siguroi forcën lëvizëse, të nevojshme për ta nxjerrë





atë nga dëbora, për ta kthyer në rrugë dhe për ta lëvizur më tej. Ishte ngarkesa që e mundësoi kthimin te familja e tij dhe te shtëpia e tij.

Secili prej nesh gjithashtu mbart një barrë. Barra jonë vetjake përbëhet nga kërkesa e mundësi, detyrime e privilegje, brenga e bekime, si dhe zgjedhje e shtrëngime. Dy pyetje udhëzuese mund të jenë të dobishme kur e vlerësojmë barrën tonë herë pas here dhe plot lutje: “A po prodhon barra që unë mbart, forcën lëvizëse shpirtërore që do të më bëjë të shtyhem përpara me besim te Krishti në shtegun e ngushtë dhe të ngushtuar e t’i shmangem ngeljes në vend? A po krijon barra që po mbart, forcë shpirtërore të mjaftueshme për lëvizje, që më së fundi të mund të kthehem në shtëpi tek Ati Qiellor?”

Ndonjëherë gabimisht ne mund të besojmë se lumturia është mungesa e një barre. Por mbajtja e një barre është një pjesë e domosdoshme dhe thelbësore e planit të lumturisë. Ngaqë barra jonë vetjake nevojitet që të prodhojë forcë lëvizëse shpirtërore, ne duhet të jemi të kujdesshëm që të mos mbartim rreth e rrotull në jetën tonë kaq shumë gjëra të këndshme, por të

panevojshme, sa ne shpëputemi dhe largohemi nga gjërat që me të vërtetë janë të rëndësishme.

Fuqia Forcuere e Shlyerjes

Shpëtimtari tha:

“Ejani tek unë, o ju të gjithë të munduar dhe të rënduar, dhe unë do t’ju jap çlodhje.

Merrni mbi vete zgjedhën time dhe mësoni nga unë, sepse unë jam zemërbutë dhe i përlurur nga zemra; dhe ju do të gjeni prehje për shpirtat tuaj.

Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë” (Mateu 11:28–30).

Zgjedha është një binar prej druri, e përdorur zakonisht midis një pende qesh ose kafshësh të tjera, e cila bën të mundur që ato së bashku ta tërheqin një barrë. Një zgjedhë i vendos kafshët krah për krah, që të mund të lëvizin së bashku me qëllim që ta përmbushin një detyrë.

Merrni parasysh ftesën veçanërisht individuale të Zotit për të “[marrë] mbi vete zgjedhën time”. Bëra dhe mbajtja e besëlidhjeve të shenjta na lidh te Zoti Jezu Krisht dhe na bashkon me Të. Në thelb, Shpëtimtari po na bën thirrje që të mbështetemi tek Ai dhe të tërheqim

së bashku me Të, edhe pse përpjekjet tona më të mira nuk janë të barabarta dhe as që mund të krahasohen me përpjekjet e Tij. Kur i mirëbesojmë Atij dhe e tërheqim barrën tonë me Të gjatë udhëtimit të vdekshmërisë, me të vërtetë zgjedha e Tij është e ëmbël dhe barra e Tij është e lehtë.

Ne nuk jemi dhe kurrë nuk na duhet të jemi vetëm. Ne mund të shtyhem përpara në jetën tonë të përditshme me ndihmën qiellore. Nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit ne mund të marrim aftësi dhe “forcë përtej vetes” (“Lord, I Would Follow Thee”, *Hymns*, nr. 220). Siç shpalli Zoti: “Si rrjedhim, vazhdojeni udhëtimin tuaj dhe zemrat tuaja duhet të ngazëlleshin; sepse, vini re dhe shihni, unë jam me ju madje deri në fund” (DeB 100:12).

Merrni parasysh shembullin në Librin e Mormonit, ndërkohë që Amuloni përndiqte Almën dhe popullin e tij. Zëri i Zotit erdhi te këta dishepuj në brengat e tyre: “Ngrini kokat tuaja dhe ngushëllohuni, pasi unë e di besëlidhjen që ju keni bërë me mua; dhe unë do të bëj besëlidhje me popullin tim dhe do ta çliroj nga robëria” (Mosia 24:13).

Vini re vendin qendror të besëlidhjeve në premtimin e çlirimit.

Besëlidhjet, të marra e të mbajtura me integritet moral, dhe ordinancat, të kryera nga autoriteti i duhur i priftërisë, janë të domosdoshme për t'i marrë të gjitha bekimet, të bëra të mundshme nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit. Sepse në ordinancat e priftërisë, fuqia e perëndishmërisë u manifestohet burrave dhe grave në mish, duke përfshirë bekimet e Shlyerjes (shih DeB 84:20–21).

Kujtoni thënien e Shpëtimtarit: “Sepse zgjedha ime është e ëmbël dhe barra ime është e lehtë” (Mateu 11:30), teksa marrim parasysh vargun pasues në rrëfimin e Almës dhe të popullit të tij.

“Dhe unë do t’ju lehtësoj gjithashtu barrat që ju janë vënë mbi shpatulla, që ju të mos i ndjeni në shpinat tuaja” (Mosia 24:14).

Shumë prej nesh mund të nënkuptojnë se ky shkrim i shenjtë po sugjeron që një barrë do të hiqet në mënyrë të papritur dhe të përhershme. Vargu pasues, megjithatë, përshkruan se si barra u lehtësua.

“Dhe tani ndodhi që barrat që iu vunë Almës dhe vëllezërve të tij u lehtësuan; po, *Zoti i forcoi ata* që të mund të duronin barrat e tyre me lehtësi dhe ata iu nënshtruan me gëzim dhe me durim gjithë vullnetit të Zotit” (Mosia 24:15; theksimi i shtuar).

Sfidat dhe vështirësitë nuk u hoqën menjëherë nga njerëzit. Por Alma dhe pasuesit e tij u forcuan dhe aftësia e tyre e shtuar i bëri barrët më të lehta. Këta njerëz të mirë u fuqizuan nëpërmjet Shlyerjes për të *vepruar* si vetëveprues (shih DeB 58:26–29) dhe për të *vepruar* mbi rrethanat e tyre. Dhe “në fuqinë e Zotit” (Fjalët e Mormonit 1:14; Mosia 9:17; 10:10; Alma 20:4), Alma dhe njerëzit e tij u drejtuan të sigurt për në tokën e Zarahemlës.

Jo vetëm që Shlyerja e Jezu Krishtit vërtet i mposht ndikimet e Rënies së Adamit dhe bën të mundur heqjen e mëkateve dhe të shkëlqeve tona vetjake, por Shlyerja e Tij gjithashtu na mundëson që të bëjmë mirë dhe të bëhemi më të mirë në mënyra që shtrihen edhe më përtej aftësive tona



në vdekshmëri. Shumica prej nesh e dinë se kur i bëjmë gjërat gabim dhe kemi nevojë për ndihmë që t'i mposhtim pasojat e mëkatit në jetën tonë, Shpëtimtari ka bërë të mundur për ne që të bëhemi të dëlirë nëpërmjet fuqisë së Tij shëlbuese. Por a e kuptojmë gjithashtu se Shlyerja është për burra e gra besnike, që janë të bindur, të denjë e të ndërgjegjshëm dhe që po përpiqen për t'u bërë më të mirë dhe për të shërbyer me më shumë besim? Pyes veten nëse nuk arrijmë ta kuptojmë tërësisht këtë drejtim forcues të Shlyerjes në jetën tonë dhe gabimisht besojmë se duhet ta mbartim barrën tonë tërësisht të vetëm – përmes qendrës tërësore, forcës së vullnetit dhe disiplinës e me aftësitë tona qartësisht të kufizuara.

Është një gjë që të dimë se Jezu Krishti erdhi në tokë për të *vdekur* për ne. Por ne gjithashtu duhet të vlerësojmë se Zoti dëshiron, nëpërmjet Shlyerjes së Tij dhe me anë të fuqisë së Frymës së Shenjtë, të na *japë gjallëri* – jo vetëm të na drejtojë, por edhe të na forcojë e shërojë.

Shpëtimtari i Vjen në Ndhimë Popullit të Tij

Alma shpjegon përse dhe si Shpëtimtari mund të na bëjë të aftë:

“Dhe ai do të shkojë përpara, duke vuajtur dhimbje dhe hidhërim dhe tundime të çdo lloji; dhe kjo, që të plotësohet fjala që thotë se ai do të marrë përsipër dhembjet dhe sëmundjet e popullit të tij.





Dhe ai do të marrë përsipër vdekjen që ai të mund të zgjidhë rripat e vdekjes, që e lidhin popullin e tij; dhe ai do të marrë përsipër dobësitë e tyre, që zemra e tij të mund të mbushet me mëshirë, sipas mishit, që ai të mund të dijë, sipas mishit, se si të ndihmojë popullin e tij sipas dobësive të tyre” (Alma 7:11–12).

Prandaj, Shpëtimtari ka vuajtur jo thjesht për mëkatet dhe paudhësitë tona – por edhe për dhembjet fizike dhe ankthet tona, dobësitë dhe të metat tona, frikën dhe mërztjet tona, zhgënjimet dhe shkurajimet tona, keqardhjet dhe brejtjet tona të ndërgjegjes, dëshpërimin dhe pikëllimin tonë, padrejtësitë dhe pandershmeritë që provojmë dhe mundimet emocionale që na shqetësojnë.

Nuk ka dhembje fizike, as plagë shpirtërore, as ankth të shpirtit apo të zemrës, as dobësi apo lëngatë që ju ose unë do të hasim ndonjëherë në vdekshmëri, të cilën Shpëtimtari nuk e përjetoi fillimisht. Në një çast dobësie ju mund të thërrisni: “Askush s’e di si është. Askush s’e kupton.” Por Biri i Perëndisë di dhe kupton në mënyrë të përsosur, sepse Ai i ka ndier dhe i ka mbajtur barrët tona vetjake. Dhe për shkak të flijimit të Tij të pafund dhe të përjetshëm (shih Alma 34:14), Ai ka dhembshuri të përsosur dhe mund të na e shtrijë krahun e Tij të mëshirës. Ai mund të na arrijë, prekë, ndihmojë, shërojë e forcojë që të jemi më shumë sesa mund të ishim ndonjëherë dhe që të na ndihmojë të bëjmë atë që nuk mund ta bënim kurrë duke u mbështetur vetëm mbi vetë fuqinë tonë. Me të vërtetë, zgjedha e Tij është e ëmbël dhe barra e Tij është e lehtë.

Një Ftesë, një Premtim dhe një Dëshmi

Unë ju ftoj të studioni, luteni, përsiatni dhe përpiqeni të mësoni më shumë rreth Shlyerjes së Shpëtimtarit,

ndërkohë që e vlerësoni barrën tuaj vetjake. Shumë gjëra rreth Shlyerjes ne thjesht nuk mund t’i kuptojmë me mendjen tonë të vdekshme. Por shumë aspekte të Shlyerjes ne mund dhe kemi nevojë t’i kuptojmë.

Për mikun tim, barra e drurëve siguroi forcën lëvizëse jetëshpëtuese. Automjeti i zbrazët nuk mund të lëvizte nëpër dëborë, edhe pse i pajisur me katër rrota aktive. Një barrë e rëndë ishte e domosdoshme për të prodhuar forcë lëvizëse.

Ishte barra. Ishte barra që siguroi forcën lëvizëse, e cila e bëri mikun tim të aftë që të mos ngelej në vend, që të kthehej përsëri në rrugë, që të ecte përpara dhe të kthehej tek familja e tij.

Barrët e veçanta në jetën e secilit prej nesh na ndihmojnë që të mbështetemi te meritat, mëshira dhe hiri i Mesias së Shenjtë (shih 2 Nefi 2:8). Unë dëshmoj dhe premtoj se Shpëtimtari do të na ndihmojë për t’i mbajtur me lehtësi barrët tona (shih Mosia 24:15). Ndërsa lidhemi së bashku me Të nëpërmjet besëlidhjeve të shenjtë dhe marrim fuqinë aftësuese të Shlyerjes së Tij në jetën tonë, ne vërtet do të kërkojmë gjithnjë e më shumë ta kuptojmë vullnetin e Tij dhe të jetojmë sipas atij. Ne gjithashtu do të lutemi për forcën që të mësojmë nga rrethanat tona, t’i ndryshojmë apo t’i

pranojmë ato, në vend të lutjes pa mbarim që Perëndia të na i ndryshojë rrethanat tona në përputhje me vullnetin tonë. Ne vërtet do të bëhemi njerëz që veprojnë në vend që të bëhemi objekte që pësojnë (shih 2 Nefi 2:14). Ne vërtet do të bekohemi me fuqi lëvizëse shpirtërore.

Veproftë më mirë secili prej nesh dhe u bëfshim më të mirë nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit. Sot është data 6 prill. Ne e dimë me anë të zbulësës se sot është data e vërtetë dhe e saktë e lindjes së Shpëtimtarit. 6 prilli është dita në të cilën u organizua Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. (Shih DeB 20:1; Harold B. Lee, “Strengthen the Stakes of Zion”, *Ensign*, korrik 1973, f. 2; Spencer W. Kimball, “Why Call Me Lord, Lord, and Do Not the Things Which I Say?” *Ensign*, maj 1975, f. 4; Spencer W. Kimball, “Remarks and Dedication of the Fayette, New York, Buildings”, *Ensign*, maj 1980, f. 54; *Discourses of President Gordon B. Hinckley, Vëllimi 1: 1995–1999* [2005], f. 409.) Në këtë ditë të veçantë dhe të shenjtë Shabati, unë shpall dëshminë time se Jezusi, Krishti, është Shëlbuesi ynë. Ai jeton dhe do të na pastrojë, shërojë, udhëzojë, mbrojë e forcojë. Për këto gjëra unë dëshmoj plot gëzim, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Dashuria – Thelbi i Ungjillit

Ne nuk mund ta duam me të vërtetë Perëndinë, në qoftë se nuk i duam bashkudhëtarët tanë në këtë udhëtim në vdekshmëri.

Vëllezërit dhe motrat e mia të dashura, kur Shpëtimtari ynë shërbeu mes njerëzve, Atë e pyeti një mësues kureshtar i ligjit: “Mësues, cili është urdhërimi i madh i ligjit?”

Mateu shënon se Jezusi u përgjigj: “Duaje Zotin, Perëndinë tënde me gjithë zemrën tënde, me gjithë shpirtin tënd dhe me gjithë mendjen tënde’.

Ky është urdhërimi i parë dhe i madhi.

Dhe i dyti, i ngjashëm me këtë, është: ‘Duaje të afërmin tënd porsivetveten.’¹

Marku e mbyll rrëfimin me thënien e Shpëtimtarit: “Nuk ka urdhërim tjetër më të madh se këta”².

Ne nuk mund ta duam me të vërtetë Perëndinë, në qoftë se nuk i duam bashkudhëtarët tanë në këtë udhëtim në vdekshmëri. Po njësoj, ne nuk mund t’i duam plotësisht bashkëqeniet tona në qoftë se nuk e duam Perëndinë, Atin e ne të gjithëve. Apostulli Gjon na thotë: “Ky është urdhërimi që kemi marrë nga ai: ai që do Perëndinë, të dojë edhe vëllanë e vet”³. Ne jemi të gjithë fëmijë shpirtërorë të Atit tonë Qiellor dhe, si të tillë, jemi vëllezër e motra. Kur e mbajmë këtë të vërtetë

në mendje, dashuria ndaj gjithë fëmijëve të Perëndisë do të bëhet më e lehtë.

Në të vërtetë, dashuria është pikërisht thelbi i ungjillit dhe Jezu Krishti është Shembulli ynë. Jeta e Tij është një trashëgimi dashurie. Të sëmurin Ai e shëroi; të shtypurin Ai e ngriti; mëkatarin Ai e shpëtoi. Më së fundi turma e zemëruar ia mori jetën Atij. Dhe prapëseprapë kumbojnë nga kodra e Golgotës fjalët: “Atë, fali ata sepse nuk dinë ç’bëjnë”⁴ – një shprehje kurorëzuese në vdekshmëri e dashamirësisë dhe e dashurisë.

Ka shumë tipare që janë shfaqje të dashurisë, të tilla si mirësia, durimi, vetëmohimi, kuptueshmëria dhe falja. Në të gjitha shoqërimet tona, këto tipare dhe të tjera si ato do të ndihmojnë për ta vënë në dukje dashurinë e zemrës sonë.

Zakonisht dashuria jonë do të tregohet në ndërveprimet tona të përditshme njëri me tjetrin. Tërësisht e rëndësishme do të jetë aftësia jonë për ta dalluar nevojën e dikujt dhe më pas për të vepruar. Gjithmonë më ka pëlqyer ndjenja e shprehur në vjerëshën e shkurtër:

*Me lot natën kam qarë
Ngaqë sytë s’më kanë parë
Që dikush nevojë për mua pati;
Por aspak keqardhje
Nuk kam ndier ende
Që atij i dhashë pak mirësi.⁵*

Kohët e fundit mësova për një shembull prekës të dashurisë së përzemërt – një shembull që pati përfundime të paparashikuara. Ishte viti 1933 kur, për shkak të Depresionit të Madh, mundësitë për punësim ishin të pakta. Vendndodhja ishte në pjesën lindore të Shteteve të Bashkuara. Arlin Bisekër sapo kishte mbaruar shkollën e mesme. Pas një kërkimi të gjatë për punësim, ajo, më së fundi, pati mundësinë të gjente punë në një punishte veshjesh si rrobaqepëse. Punëtorët e punishtes paguheshin çdo ditë vetëm për secilën copë të përfunduar saktësisht që ato qepnin së bashku. Sa më shumë copa që prodhoni, aq më shumë paguheshin.

Një ditë, pak kohë pasi kishte filluar në punishte, Arlina u ndesh me një mënyrë qepjeje që e hutoi dhe e zemëroi. Ajo u ul te makina qepëse duke u përpjekur që ta shqepte orvatjen e saj të pasuksesshme për ta përfunduar copën me të cilën po punonte. Dukej se nuk gjendej askush që ta ndihmonte, pasi të gjitha rrobaqepëset e tjera po nxitonin për të mbaruar sa më shumë copa që mundeshin. Arlina u ndje e pafuqishme dhe e pashpresë. Në heshtje, ajo filloi të qante.

Nga ana përballë Arlinës ulej Bernis Rok. Ajo ishte më e madhe në moshë dhe më me përvojë si rrobaqepëse. Duke e parë ankthin e Arlinës, Bernisa e la punën e saj dhe shkoi pranë Arlinës, gjithë mirësi duke i dhënë udhëzim dhe ndihmë. Ajo qëndroi derisa Arlina fitoi vetëbesim dhe ishte në gjendje ta mbaronte copën me sukses.

Bernisa atëherë u kthye te makina e saj, por e kishte humbur mundësinë për të mbaruar aq shumë copa që do të kishte mundur, sikur të mos kishte dhënë ndihmë.

Me këtë veprim të vetëm të dashurisë së përzemërt, Bernisa dhe Arlina u bënë shoqe përjetë. Secila, më së fundi, u martua dhe pati fëmijë. Diku rreth viteve 1950, Bernisa, e cila ishte anëtare e Kishës, i dha Arlinës dhe familjes së saj një kopje të Librit të Mormonit. Në vitin 1960, Arlina e bashkëshorti dhe fëmijët e saj u pagëzuan anëtarë të Kishës. Më vonë ata u vulosën në një tempull të shenjtë të Perëndisë.

Si rrjedhim i dashamirësisë së treguar nga Bernisa, që bëri ç'mundi për të ndihmuar dikë që nuk e njihje, por e cila ishte në ankth dhe kishte nevojë për ndihmë, individë të panumërt, si të gjallë dhe të vdekur, tani gëzojnë ordinancat shpëtuese të ungjillit.

Çdo ditë të jetës sonë na jepen mundësi për të treguar dashuri dhe dashamirësi ndaj njerëzve përreth nesh. Tha Presidenti Spenser W. Kimball: “Ne duhet të kujtojmë se ata njerëz që i takojmë në parkime, zyra, ashensorë dhe gjetkë, janë ajo pjesë e njerëzimit që Perëndia na e ka dhënë që ta duam dhe t'i shërbejmë. Do të na vliente pak të flisnim për vëllazërinë e përgjithshme të njerëzimit, në qoftë se nuk mund t'i shohim ata që janë kudo përreth nesh si vëllazërit dhe motrat tona.”⁶

Shpesh mundësitë tona për ta treguar dashurinë tonë vijnë papritur. Një shembull i një mundësie të tillë u shfaq në një artikull gazete në tetor të vitit 1981. Kaq mbresëlënëse ishte për mua dashuria dhe dashamirësia që shprehej në të, sa e kam mbajtur artikullin në dosjet e mia për më shumë se 30 vjet.

Artikulli tregon se një fluturim pa ndalesë i Linjës Ajrore të Alaskës nga



Enkërixh në Alaska drejt Siatëllit në Uashington – një fluturim me 150 pasagjerë – u kthye drejt një qyteze të izoluar në Alaskë me qëllim që të transportonte një fëmijë të dëmtuar rëndë. Një djalë dyvjeçar kishte prerë një arterie në krahun e tij kur ra mbi një copë xhami, ndërsa po luante pranë shtëpisë së tij. Qyteza ishte 725 km në jug të Enkërixhit dhe sigurisht nuk ishte në rrugën e avionit. Megjithatë, mjekët e ndihmës së shpejtë që ishin atje, kishin dërguar një kërkesë tepër të shqetësuar për ndihmë dhe prandaj avioni e ndryshoi drejtimin që të merrte fëmijën dhe ta çonte atë në Siatëll, që ai të mund të kurohej në spital.

Kur avioni zbriti pranë qytezës së izoluar, mjekët e njoftuan pilotin se djali po humbiste aq shumë gjak sa mund të mos jetonte derisa të mbërrinin në Siatëll. U mor vendimi që të fluturonin edhe 320 km të tjera, që nuk ishin në rrugën e tyre, drejt Xhunos në Alaska, qytetit më të afërt me një spital.

Pasi e çuan djalin në Xhuno, avioni u nis drejt Siatëllit, tashmë shumë orë pas orarit të caktuar. Asnjë nga pasagjerët nuk u ankua, edhe pse shumica e tyre do t'i humbisnin takimet dhe fluturimet me avionë të tjerë. Në fakt,

ndërsa minutat dhe orët kalonin, ata mblodhën para, duke grumbulluar një shumë të konsiderueshme për djalin dhe familjen e tij.

Teksa avioni po zbriste në Siatëll, pasagjerët shpërthyen në britma gëzimi kur piloti shpalli se kishte marrë lajm me radio që djali do të bëhej mirë.⁷

Në mendje më vijnë fjalët e shkrimit të shenjtë: “Dashuria hyjnore është dashuria e pastër e Krishtit . . . dhe kushdo që gjendet i zotëruar prej saj në ditën e fundit, do të jetë mirë me të”⁸.

Vëllezër e motra, disa nga mundësitë tona më të mëdha për ta shprehur dashurinë tonë do të jenë brenda mureve të vetë shtëpive tona. Dashuria duhet të jetë pjesa më e rëndësishme e jetës familjare dhe, prapëseprapë, ndonjëherë ajo nuk është. Mund të ketë tepër padurim, tepër grindje, tepër zënka, tepër lot. Pyeti me keqardhje Presidenti Gordon B. Hinkli: “Pse ndodh që [ata] që i duam [më shumë], bëhen kaq shpesh objektet e fjalëve tona të ashpra? Pse ndodh që [ne] nganjëherë flasim sikur të kishim thika që shpojnë deri në palcë?”⁹ Përgjigjet e këtyre pyetjeve mund të ndryshojnë për secilin prej nesh dhe, prapëseprapë, e vërteta është që arsyet nuk kanë rëndësi. Nëse do ta zbatonim urdhërimin për të dashur njëri-tjetrin, ne duhet ta trajtojmë njëri-tjetrin me mirësi dhe respekt.

Sigurisht do të ketë raste kur disiplina nevojitet të jetë në masën e duhur. Le të kujtojmë, megjithatë, këshillën që gjendet në Doktrina e Besëlidhje – domethënë që, kur është e domosdoshme për ne që ta qortojmë dikë, më pas të tregojmë një rritje të dashurisë.¹⁰

Do të shpresoja që ne do të përpiqeshim gjithmonë që të jemi të vëmendshëm dhe të ndjeshëm ndaj



mendimeve, ndjenjave dhe rrethana-
nave të njerëzve përreth nesh. Le të
mos poshtërojmë ose nënvlerësojmë.
Përkundrazi, le të jemi dashamirës
dhe inkurajues. Ne duhet të jemi
të kujdesshëm që të mos e shkatër-
rojmë vetëbesimin e dikujt tjetër
me anë të fjalëve ose veprimeve të
pakujdesshme.

Falja duhet të shkojë krahu për
krahu me dashurinë. Në familjet tona,
si edhe me miqtë tanë, mund të ketë
ndjenja të lënduara dhe mosmarrë-
veshje. Përsëri, në të vërtetë nuk ka
rëndësi sesa e vogël ishte çështja. Nuk
mund dhe nuk duhet të lihet që të

gërryëjë, acarojë dhe më së fundi të
shkatërrojë. Fajësimi i mban plagët të
hapura. Vetëm falja shëron.

Një zonjë e dashur, e cila tashmë
ka vdekur, më vizitoi një ditë dhe
papritmas më tregoi për disa gjëra për
të cilat ndiente keqardhje. Ajo foli për
një ngjarje që kishte ndodhur shumë
vite më parë dhe kishte lidhje me një
fermer fqinj, dikur një mik i mirë, por
me të cilin ajo dhe burri i saj kishin
pasur mosmarrëveshje në shumë
raste. Një ditë fermeri kishte pyetur
nëse mund të kalonte përmes pronës
së tyre që t'i binte shkurt për tek toka
e tij. Në atë çast ajo ndaloi në tregimin

e saj dhe, me një dridhje të zërit, tha:
“Vëllai Monson, nuk e lashë të kalonte
përmes tokës sonë atëherë ose kurrë
ndonjëherë, por atij iu desh të bënte
rrugën e gjatë, duke i rënë përreth më
këmbë, që të arrinte tek toka e tij. E
kisha gabim dhe më vjen keq. Ai ka
vdekur tashmë, por o, sikur të mund
t'i thoja atij: ‘Më vjen shumë keq’. Sa
do të doja të kisha një mundësi të
dytë që të sillesha mirë.”

Ndërsa e dëgjoja, më erdhi në
mendje vërejtja e brengosur e Xhon
Grinlif Uitërit: “Prej gjithë fjalëve të
trishtuara, të dala nga gjuhë e penë,
më të trishtuarat janë këto: ‘*Sikur të
kishte qenë!*’”¹¹ Vëllezër e motra, kur
i trajtojmë të tjerët me dashuri dhe vë-
mendje dashamirëse, ne vërtet do t’iu
shmangemi keqardhjeve të tilla.

Dashuria shprehet në shumë më-
nyra të dallueshme: një buzëqeshje,
një përshëndetje me dorë, një fjalë e
mirë, një kompliment. Shprehje të tjera
mund të jenë më të menduara, të tilla
si të treguarit e interesit për veprimta-
ritë e dikujt, mësimdhënia e një parimi
me mirësi dhe durim, të vizituarit e
dikujt që është i sëmurë ose që nuk
del nga shtëpia. Këto fjalë e veprime
si dhe shumë të tjera mund të përçoj-
në dashuri.

Dejll Karnigi, një autor dhe lektor
i mirënjohur amerikan, besonte se çdo
njeri ka brenda vetes së tij ose të saj



Vienë, Austri



Nga Presidenti Bojd K. Paker,
President i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

“fuqinë për ta shtuar sasinë e përgjithshme të lumturisë së botës . . . duke i thënë disa fjalë vlerësimi të sinqertë dikujt që është i vetmuar ose pa kurajë”. Tha ai: “Ndoshta ju do t’i harroni nesër fjalët e mira që thoni sot, por dëgjuesi mund të gëzohet prej tyre për tërë jetën”¹².

Ju mund të filloni tani, pikërisht sot, të shprehni dashuri për gjithë fëmijët e Perëndisë, qofshin ata pjesëtarët e familjeve tona, miqtë tanë, thjesht të njohur apo krejtësisht të panjohur. Kur ngrihemi çdo mëngjes, ne duhet të marrim vendim që t’i përgjigjemi me dashuri dhe mirësi çfarëdo gjëje që mund të na ndodhë.

Përtej aftësisë për ta kuptuar, vëllëzër dhe motra të mia, është dashuria e Perëndisë për ne. Për shkak të kësaj dashurie, Ai dërgoi Birin e Tij, i cili na desh i aq sa të jepte jetën e Tij për ne, që ne të mund të kemi jetë të përjetshme. Kur arrijmë ta kuptojmë këtë dhuratë të pakrahasueshme, zemrat tona do të mbushen me dashuri për Atin tonë të Amshuar, për Shpëtimtarin tonë dhe për mbarë njerëzimin. Qoftë kështu është lutja ime më e zellshme, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Mateu 22:36–39.
2. Marku 12:31.
3. 1 Gjoni 4:21.
4. Lluka 23:34.
5. Autor i panjohur, në Richard L. Evans, “The Quality of Kindness”, *Improvement Era*, maj 1960, f. 340.
6. *The Teachings of Spencer W. Kimball*, bot. Edward L. Kimball (1982), f. 483.
7. Shih “Injured Boy Flown to Safety”, *Daily Sitka Sentinel* (Alaska), 22 tetor 1981.
8. Moroni 7:47.
9. Gordon B. Hinckley, “Let Love Be the Lodestar of Your Life”, *Ensign*, maj 1989, f. 67.
10. Shih Doktrina e Besëlidhje 121:43.
11. “Maud Muller”, në *The Complete Poetical Works of Whittier* (1878), f. 206, theksimi i shtuar.
12. Dale Carnegie, në, për shembull, Larry Chang, *Wisdom for the Soul* (2006), f. 54.

Dëshmia

Dëshiroj t’ju tregoj ato të vërteta që janë më me vlerë për t’u ditur.

Kohët e luftës ose të pasigurisë kanë një mënyrë për ta mpëhur përqendrimin tonë te gjërat që kanë vërtet rëndësi.

Lufta II Botërore ishte një kohë me trazirë të madhe shpirtërore për mua. Isha larguar nga shtëpia ime në Brigam-Siti të Jutës, vetëm me hijen e një dëshmie dhe ndjeva nevojën për diçka më shumë. E gjithë matura jonë ishte thuajse rrugës për në zonën e luftës për punë javësh. Ndërkohë që isha vendosur në ishullin e Ie Shimës, pikërisht në veri të Okinavës në Japoni, u mundova me dyshim e pasiguri. Dëshiroja një dëshmi vetjake për ungjillin. Dëshiroja të *dija!*

Gjatë një nate pa gjumë, u largova nga tenda ime dhe hyra në një bunker që ishte formuar nga rreshtimi i fuçive 190-litërshe të lëndëve djegëse të mbushura me rërë e të vendosura njëra mbi tjetrën për të krijuar një vend të rrethuar. Nuk kishte çati dhe kështu u futa brenda këmbadoras, pashë drejt qiellit të mbushur me yje dhe u gjuhëzova për t’u lutur.

Thuajse në gjysmë të fjalëve të lutjes ajo ndodhi. Nuk do të mundesha t’jua përshkruaja se çfarë ndodhi edhe sikur të isha i vendosur ta bëja këtë. Është përtej fuqisë sime për t’u

shprehur, por është po aq e qartë sot, sa ishte atë natë mbi 65 vite më parë. E dija se ishte një shfaqje shumë vetjake, shumë individuale. Më në fund unë e dija vetë. E *dija* me siguri, sepse ajo më ishte dhënë. Pas njëfarë kohe, dola këmbadoras nga ai bunker dhe eca, ose fluturova nga lumturia e u ktheva në shtrat. E kalova pjesën e mbetur të natës me një ndjenjë gëzimi e nderimi.

Duke mos menduar kurrësi se isha një njeri i veçantë, mendova se, nëse një gjë e tillë më erdhi mua, atëherë ajo mund t’i vinte kujtdo. Ende e besoj atë. Në vitet që kanë pasuar, kam arritur ta kuptoj se një përvojë e tillë është njëherësh një dritë për t’u ndjekur e një barrë për t’u mbajtur.

Dua t’jua tregoj ato të vërteta që janë më me vlerë për t’u ditur, gjërat që i kam mësuar dhe përjetuar në afro 90 vjet jetë dhe mbi 50 vjet si Autoritet i Përgjithshëm. Pjesa më e madhe e asaj që kam arritur të di, i përket kategorisë së gjërave që nuk mund të jepën mësim, por mund të mësohen.

Si shumica e gjërave me vlerë të madhe, dija që është me vlerë të përjetshme, vjen vetëm nëpërmjet lutjes dhe përsiatjes vetjake. Këto, së bashku me agjërimit dhe studimin



e shkrimeve të shenjta, do të ftojnë mbresa e zbulosa dhe pëshpëritjet e Shpirtit të Shenjtë. Kjo na siguron udhëzim nga lart teksa mësojmë parim pas parimi.

Zbulesat premtojnë se “çfarëdo parimi inteligjence që fitojmë në këtë jetë, do të ngrihet me ne në ringjallje” dhe se “dij[a] dhe inteligjenc[a] [fitohen] . . . nëpërmjet zellit dhe bindjes” (DeB 130:18–19).

Një e vërtetë e përjetshme që kam arritur të di, është se Perëndia jeton. Ai është Ati ynë. Ne jemi fëmijët e Tij. “Ne besojmë në Perëndinë, Atin e Përjetshëm, dhe në Birin e Tij, Jezu

Krishtin, dhe në Frymën e Shenjtë” (Nenet e Besimit 1:1).

Nga të gjithë titujt e tjerë që mund të kishte përdorur, Ai zgjodhi të quhej “Atë”. Shpëtimtari urdhëroi: “Ju, pra, lutuni kështu: ‘Ati ynë që je në qiej’” (3 Nefi 13:9; shih edhe Mateu 6:9). Përdorimi i emrit “Atë” prej Tij është një mësim për të gjithë teksta arrijmë të kuptojmë se çfarë ka më tepër rëndësi në këtë jetë.

Prindërimi është një privilegj i shenjtë dhe, në varësi të besnikërisë, mund të jetë një bekim i përjetshëm. Qëllimi përfundimtar i gjithë aktivizimit në Kishë është që një burrë e

bashkëshortja e tij dhe fëmijët e tyre të mund të jenë të lumtur në shtëpi.

Ata që nuk martohen ose ata që nuk mund të kenë fëmijë, nuk janë të përjashtuar nga bekimet e përjetshme që ata kërkojnë, por të cilat, për momentin, mbeten përtej mundësive të tyre. Ne nuk e dimë gjithnjë se si ose kur do të shfaqen bekimet, por premtimi i përparimit të përjetshëm nuk do t’i mohohet asnjë individi besnik që i bën dhe i mban besëlidhjet e shenjta.

Dëshirat tuaja të zjarra e të fshehta dhe përgjërimet me lot do ta prekin zemrën edhe të Atit edhe të Birit. Do t’ju jepet një siguri vetjake prej Tyre se jeta juaj do të jetë e plotë dhe se asnjë bekim që është thelbësor, nuk do të humbasë për ju.

Si një shërbëtor i Zotit, duke vepruar në detyrën ku jam shuguruar, u bëj një premtim atyre që janë në rrethana të tilla, se nuk do të ketë asgjë thelbësore për shpëtimin dhe ekzaltimin tuaj që nuk do të prehet mbi ju kur të vijë koha. Krahët që tani janë bosh, do të mbushen dhe zemrat që tani lëngojnë nga ëndrrat dhe dëshirat e zjarra e të thyera, do të shërohen.

Një e vërtetë tjetër që kam arritur të di, është se Fryma e Shenjtë është e vërtetë. Ai është anëtari i tretë i Kreut-Perëndi. Misioni i Tij është të dëshmojë për të vërtetën dhe drejtësinë. Ai e shpalos Vetën në shumë mënyra, përfshirë ndjenjat e paqes dhe sigurimit. Ai mund të sjellë edhe ngushëllim, udhërrëfim dhe korrigjim kur nevojitet. Shoqërimi i Frymës së Shenjtë mbahet gjatë gjithë jetës sonë me anë të të jetuarit të drejtë.

Dhurata e Frymës së Shenjtë jepet nëpërmjet një ordinance të ungjillit. Një burrë me autoritet vendos duart e tij mbi kokën e një anëtari të ri të Kishës dhe thotë fjalë të tilla si këto: “Merre Frymën e Shenjtë”.



Meksiko-Siti, Meksikë

Vetëm kjo ordinancë nuk na ndryshon në një mënyrë të dallueshme por, nëse i dëgjojmë dhe i ndjekim shtysat, ne do të marrim bekimin e Frymës së Shenjtë. Çdo bir apo bijë e Atit tonë Qiellor mund të arrijë ta dijë vërtetësinë e premtimit të Moronit: “Nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë, ju mund të dini të vërtetën e të gjitha gjërave” (Moroni 10:5; theksimi i shtuar).

Një e vërtetë hyjnore që kam fituar në jetën time, është dëshmia ime për Zotin Jezu Krisht.

Në krye dhe në mbështetje të gjithçkaje që bëjmë, me spirancë të hedhur nëpër zbulosa, është emri i Zotit, që është autoriteti me anë të të cilit ne veprojmë në Kishë. Çdo lutje e dhënë, madje edhe nga fëmijët e vegjël, mbyllet me emrin e Jezu Krishtit. Çdo bekim, çdo ordinancë, çdo shugurim, çdo veprim zyrtar bëhet në emrin e Jezu Krishtit. Kjo është Kisha e Tij dhe ka emrin e Tij – Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme (shih DeB 115:4).

Ka një ndodhi të madhërishe në Librin e Mormonit ku nefitët “po i luteshin Atit në emrin e [Zotit]”. Zoti u shfaq dhe pyeti:

“Çfarë doni që t’ju jap?

Dhe ata i thanë atij: Zot, ne do të donim që ti të na tregosh emrin me të cilin ta quajmë këtë kishë; pasi ka debate mes njerëzve në lidhje me këtë çështje.

Dhe Zoti u tha atyre: Në të vërtetë, në të vërtetë, unë ju them juve, përse njerëzit duhet të mëmëritin dhe të bëjnë debat për këtë gjë?

A nuk i kanë lexuar shkrimet e shenjta të cilat thonë që ju duhet të merrni mbi vete emrin e Krishtit, që është emri im? Pasi, me këtë emër, ju do të thirrreni në ditën e fundit;

Dhe kushdo që merr mbi vete emrin tim dhe duron deri në fund, po ai do të shpëtohet në ditën e fundit. . . .

Prandaj, çdo gjë që do të bëni, do ta bëni në emrin tim; prandaj ju do ta quani kishën në emrin tim; dhe do t’i thërrisni Atit në emrin tim, që ta bekojë kishën për hirin tim” (3 Nefi 27:2–7).

Është në emrin e Tij, Jezu Krishtit, “sepse nuk ka asnjë emër tjetër nën qiell që u është dhënë njerëzve dhe me anë të të cilit duhet të shpëtohemi” (Veprat e Apostujve 4:12).

Në Kishë ne e dimë se cili është Ai: Jezu Krishti, Biri i Perëndisë. Ai është i Vetëmlinduri i Atit. Ai është Ai që u vra dhe Ai që jetoi përsëri. Ai është Avokati ynë me Atin. “Mbani mend, mbani mend se është mbi shkëmbin e Shëlbuesit tonë që është Krishti, biri i Perëndisë, që ju duhet të ndërtoni themelin tuaj” (Helamani 5:12). Ai është spiranca që na mban e na mbron ne dhe familjet tona gjatë stuhive të jetës.

Çdo të diel nëpër botë ku mblidhen bashkësitë e çdo kombësie apo gjuhe, sakramenti bekohet me të njëjtat fjalë. Ne marrim mbi vete emrin e Krishtit dhe e kujtojmë gjithmonë Atë. Kjo na ngulitet.

Profeti Nefi shpalli: “Ne flasim për Krishtin, ne gëzohemi në Krishtin, ne predikojmë për Krishtin, ne profetizojmë mbi Krishtin dhe shkruajmë sipas profecive tona, që fëmijët tanë të mund të dinë se cilit burim t’i drejtohen për heqjen e mëkateve të tyre” (2 Nefi 25:26).

Secili prej nesh duhet të arrijë të ketë dëshminë e vet vetjake për Zotin Jezu Krisht. Ne më pas e ndajmë atë dëshmi me familjen tonë dhe të tjerë.

Në të gjithë këtë, le të mbajmë mend se ekziston një kundërshtar i cili kërkon vetë që ta përçajë punën e Zotit. Ne duhet të zgjedhim se kë do të ndjekim. Mbrojtja jonë është aq e thjeshtë sa marrja e vendimit vetjak që ta ndjekim Shpëtimtarin, duke u siguruar që të qëndrojmë me besnikëri në anën e Tij.

Në Dhiatën e Re, Gjoni shënoi se ishin disa njerëz që nuk qenë në gjendje t’i zotoheshin Shpëtimtarit dhe mësimëve të Tij dhe “që nga ai moment shumë nga dishepujt e vet u tërhoqën dhe nuk shkuan më me të.

Atëherë Jezusi u tha të dymbëdhjetëve: 'A doni edhe ju të largoheni?'

Dhe Simon Pjetri iu përgjigj: 'Zot, te kush të shkojmë? Ti ke fjalë jete të përjetshme.'

Ne kemi besuar dhe kemi njohur se ti je Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë" (Gjoni 6:66-69).

Pjetri kishte fituar atë që mund të mësohet nga çdo ndjekës i Shpëtimtarit. Që të jemi të përkushtuar me besnikëri ndaj Jezu Krishtit, ne e pranojmë Atë si Shëlbuesin tonë dhe bëjmë gjithçka që është brenda fuqive tona për t'i jetuar mësimet e Tij.

Pas gjithë viteve që kam jetuar dhe dhënë mësim e shërbyer, pas miliona kilometrash që kam udhëtuar rreth botës, me gjithçka që kam përjetuar, ka një të vërtetë të madhërishtme që dua të shpreh. Ajo është dëshmia ime për Shpëtimtarin Jezu Krisht.

Jozef Smithi dhe Sidni Rigdoni shënuan sa vijon pas një përvoje të shenjtë:

"Dhe tani, pas shumë dëshmiave që janë dhënë për të, kjo është dëshmia, e fundit e të gjithave, që ne japim për të: Se ai jeton!

Sepse ne e pamë atë" (DeB 76:22-23).

Fjalët e tyre janë fjalët e mia.

Unë e besoj dhe *unë* jam i sigurt se Jezusi është Krishti, Biri i Perëndisë së gjallë. Ai është i Vetëmlinduri i Atit dhe "se nëpërmjet tij dhe prej tij, dhe përmes tij, botët janë e u krijuan dhe banorët e tyre janë bij e bija të lindura të Perëndisë" (DeB 76:24).

Jap dëshminë time se Shpëtimtari jeton. Unë e njoh Zotin. Unë jam dëshmitari i Tij. Unë e njoh sakrificën e madhërishtme dhe dashurinë e Tij të përjetshme për të gjithë fëmijët e Atit Qiellor. E jap dëshminë time të veçantë me të gjithë përlulësinë, por me siguri të plotë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Uilliam R. Uolker,
i Të Shtatëdhjetëve

Jeto i Vërtetë ndaj Besimit

Secili prej nesh do të bekohet shumë nëse i njohim historitë e besimit dhe të sakrificës që i bënë paraardhësit tanë të bashkoheshin me Kishën e Zotit.

Unë e pëlqej shumë historinë e Kishës. Ndoshta si shumë prej jush, vetë besimi im forcohet kur mësoj për përkushtimin e jashtëzakonshëm të paraardhësve tanë, të cilët e pranuan ungjillin dhe jetuan të vërtetë ndaj besimit.

Një muaj më parë, 12.000 të rinj të mrekullueshëm nga Distrikti i Tempullit të Gilbertit në Arizonë, festuan përfundimin e tempullit të tyre të ri me një shfaqje frymëzuese, duke treguar zotimin e tyre për të jetuar me drejtësi. Tema e festimit të tyre ishte "Jeto i Vërtetë ndaj Besimit".

Ashtu siç kanë bërë ata të rinj besnikë të Arizonës, çdo shenjtori i ditëve të mëvonshme duhet të zotohet që të "jetojë i vërtetë ndaj besimit".

Fjalët e himnit thonë, "T'vërtet' ndaj besimit të prindërve tan'" ("True to the Faith", *Hymns*, nr. 254).

Ne mund të shtojmë, "T'vërtet' ndaj besimit të gjyshërve tan'".

Pyes veten nëse secili prej atyre të rinjve entuziastë nga Arizona, e njëjtte historinë e tyre vetjake të Kishës – nëse e njihnin historinë se si familjet e tyre u bënë anëtarë të Kishës. Do të ishte një gjë e mrekullueshme nëse

çdo shenjtori i ditëve të mëvonshme do t'i njëjtte historitë e kthimit në besim të paraardhësve të tyre.

Nëse jeni apo jo pasardhës i pionierëve, trashëgimia e besimit dhe sakrificës së pionierëve mormonë është trashëgimia juaj. Ajo është trashëgimia fisnike e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme.

Një prej kapitujve më të mrekullueshëm në historinë e Kishës ndodhi kur Uilford Udraf, një Apostull i Zotit, po e jepte mësim ungjillin e rivendosur të Jezu Krishtit anembanë Britanisë së Madhe, në vitin 1840 – vetëm 10 vjet pas themelimit të Kishës.

Uilford Udraf dhe Apostujt të tjerë e kishin përqendruar punën e tyre në zonën e Liverpulit dhe të Prestonit në Angli, me sukses mjaft të madh. Plaku Udraf, i cili më vonë u bë President i Kishës, po i lutej vazhdimisht Perëndisë që ta udhëhiqte atë në këtë punë shumë të rëndësishme. Lutjet e tij çuan në frymëzimin për të shkuar në një vend të ndryshëm për të dhënë mësim ungjillin.

Presidenti Monson na ka mësuar se kur ne marrim frymëzim nga qielli për të bërë diçka, ne e bëjmë në çast – ne

nuk e shtyjme. Kjo është saktësisht ajo që bëri Uilford Udraf. Me drejtim të qartë nga Shpirti për të “shkuar në jug”, Plaku Udraf u largua pothuaj menjëherë dhe udhëtoi për në një zonë të Anglisë të quajtur Hërfordshajër – vend bujqësor në jug të Anglisë. Këtu ai takoi një fermer të suksesshëm, të quajtur Xhon Benbou, ku ai u prit me “zemra të gëzuara dhe falënderime” (Wilford Woodruff, në Matthias F. Cowley, *Wilford Woodruff: History of His Life and Labors as Recorded in His Daily Journals* [1909], f. 117).

Një grup prej mbi 600 njerëzish, të cilët e quanin veten e tyre Vëllezërit e Bashkuar, ishin “lutur për dritë dhe të vërtetë” (Wilford Woodruff, në *Teachings of Presidents of the Church: Wilford Woodruff* [2004], f. 91). Zoti e

dërgoi Uilford Udraf si përgjigje të lutjeve të tyre.

Mësimdhënia e Plakut Udraf dha menjëherë fryte dhe shumë u pagëzuan. Brigam Jangu dhe Uillard Riçards iu bashkuan atij në Hërfordshajër, dhe të tre Apostujt patën një sukses të jashtëzakonshëm.

Në vetëm pak muaj, ata organizuan 33 degë për të 541 anëtarët që i ishin bashkuar Kishës. Puna e tyre e jashtëzakonshme vazhdoi dhe, në fund, pothuaj gjithsecili prej anëtarëve të Vëllezërve të Bashkuar u pagëzua në Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtërovetë Ditëve të Mëvonshme.

Stër-stërgjyshja ime, Hana Maria Igëlls Harris, ishte një nga njerëzit e parë që e dëgjoi Uilford Udraf. Ajo e vuri në dijeni bashkëshortin e saj,

Robert Harrisin të Riun, se ajo kishte dëgjuar fjalën e Perëndisë dhe se kish-te ndër mend të pagëzohej. Roberti nuk ishte i kënaqur kur dëgjoi njoftimin e bashkëshortes së tij. Ai i tha asaj se do ta shoqëronte në predikimin e ardhshëm dhënë nga misionari mor-mon dhe se do ta korrigjonte atë.

Duke u ulur pothuaj në krye të asamblesë, me një vendosmëri të prerë për të mos u ndikuar dhe ndoshta për ta mërztur me pyetje predikuesin vizitor, Roberti u prek menjëherë nga Shpirti, ashtu siç ishte prekur bashkëshortja e tij. Ai e dinte se mesazhi i Rivendosjes ishte i vërtetë, dhe ai e bashkëshortja e tij u pagëzuan.

Historia e tyre e besimit dhe e përkushtimit është e ngjashme me mijëra të tjera: kur e dëgjuan mesazhin e ungjillit, ata e dinin se ishte i vërtetë!

Siç thotë Zoti: “Delet e mia e dëgjojnë zërin tim, unë i njoh dhe ato më ndjekin” (Gjoni 10:27).

Duke e dëgjuar zërin e Bariut, ata e përkushtuan plotësisht jetën e tyre për ta jetuar ungjillin dhe për të ndjekur drejtimin e profetit të Zotit. Duke iu përgjigjur thirrjes për t’u mbledhur në Sion, ata e lanë pas shtëpinë e tyre në Angli, kaluan Atlantikun dhe u mblodhën me shenjtoret në Navu të Illinoisit.

Ata e përqafuluan ungjillin me gjithë zemër. Ndërsa po përpiqeshin të vendoseshin në vendin e tyre të ri, ata ndihmuan në ndërtimin e Tempullit të Navusë duke dhënë si të dhjetë punën e tyre – duke e shpenzuar çdo ditë të 10-të në ndërtimin e tempullit.

Atyre iu thye zemra nga lajmi i vdekjes së profetit të tyre të dashur, Jozef Smithit dhe vëllait të tij, Hajrëm. Por ata vazhduan përpara! Ata qëndruan të vërtetë ndaj besimit.

Kur shenjtoret u përndoqën dhe u dëbuan nga Navuja, Roberti dhe Maria u ndien shumë të bekuar kur morën



indaumentin e tyre në tempull, pak përpara se të kalonin lumin Misisipi dhe të drejtoheshin për në perëndim. Megjithëse ishin të pasigurt për atë që do të sillte e ardhmja, ata ishin të sigurt për besimin e dëshmitë e tyre.

Me gjashtë fëmijë, ata marshuan me shumë vështirësi mes baltës, ndërsa kaluan Ajouën, rrugës për në perëndim. Ata ndërtuan për veten e tyre një strehë me prik, në anë të lumit Misisipi, në atë që u bë e njohur si Lagjet Dimërore.

Këta pionierë syptrembur, po prisnin drejtimin apostullor për mënyrën dhe kohën kur do të niseshin për më tej në perëndim. Planet e çdokujt u ndryshuan kur Brigam Jangu, Presidenti i Kuorumit të Të Dymbëdhjetëve, lëshoi një thirrje që burrat të dilnin vullnetarë për të shërbyer në Ushtrinë e Shteteve të Bashkuara, në atë që u bë i njohur si Batalioni Mormon.

Robert Harris, i Riu, ishte një prej 500 pionierëve mormonë që iu përgjigjën asaj thirrjeje nga Brigam Jangu. Ai u rekrutua, edhe pse kjo nënkuptonte se do të linte prapa bashkëshorten e tij shtatzënë dhe gjashtë fëmijë të vegjël.

Përse do ta bënin një gjë të tillë ai dhe burrat e tjerë?

Përgjigjja mund të jepet me vetë fjalët e stër-stërgjyshit tim. Në një letër që ai i shkroi bashkëshortes së tij kur batalioni po shkonte në Santa Fe, ai shkroi: “Besimi im është më i fortë se kurrë [dhe kur mendoj për gjërat që Brigam Jangu na tha], unë i besoj ato njësoj sikur Perëndia i Madhërishëm të m’i kishte thënë”.

Shkurt, ai e dinte se po dëgjonte një profet të Perëndisë, ashtu siç e dinin dhe burrat e tjerë. Ja arsyeja përse e bënë! Ata e dinin se udhëhiqeshin nga një profet i Perëndisë.

Në po të njëjtën letër, ai shprehu ndjenjat e tij të dhembshura për bashkëshorten e fëmijët e tij dhe tregoi për



lutjet e tij të vazhdueshme që ajo dhe fëmijët të bekoheshin.

Më poshtë në letër, ai bëri këtë deklaratë të fuqishme: “Ne nuk duhet të harrojmë gjërat që unë dhe ju dëgjuam dhe [përjetuam] në Tempullin e Zotit.”

Ndërthurur me dëshminë e tij të mëparshme se “ne udhëhiqemi nga një Profet i Perëndisë”, këto dy këshilla të shenjta janë bërë si shkrime të shenjta për mua.

Tetëmbëdhjetë muaj pas nisjes me batalionin, Robert Harris u bashkua i sigurt me Marien e tij të dashur. Ata qëndruan të vërtetë dhe besnikë ndaj ungjillit të rivendosur gjatë gjithë jetës së tyre. Ata patën 15 fëmijë, 13 prej të cilëve jetuan deri në moshë të rritur. Gjyshja ime Fani Uolker, nga Rajmondi, në Alberta të Kanadasë, ishte një prej 136 nipërve e mbesave të tyre.

Gjyshja Uolker ishte krenare për faktin se gjyshi *i saj* kishte shërbyer në Batalionin Mormon dhe dëshironte që të gjithë nipërit e mbesat e saj ta dinin. Tani që jam gjysh, e kuptoj përse ishte

kaq e rëndësishme për të. Ajo donte t’ua kthente zemrat e fëmijëve etërve. Ajo donte që nipërit e mbesat e saj të dinin për trashëgiminë e tyre të drejtë – sepse e dinte se do ta bekonte jetën e tyre.

Sa më shumë që ndihemi të lidhur me paraardhësit tanë të drejtë, aq më shumë gjasa ka që do të bëjmë zgjedhje të mençura e të drejta.

Dhe kështu ndodh. Secili prej nesh do të bekohet shumë nëse i njohim historitë e besimit dhe të sakrificës që i bënë paraardhësit tanë të bashkoheshin me Kishën e Zotit.

Që nga hera e parë që Roberti dhe Maria e dëgjuan Uilford Udrafën të jepte mësim dhe të dëshmonte për Rivendosjen e ungjillit, ata e dinin se ungjilli ishte i vërtetë.

Ata gjithashtu e dinin se pavarësisht sprovave apo vështirësive që do t’u vinin, ata do të bekoheshin sepse qëndruan të vërtetë ndaj besimit. Duket sikur ata i kishin dëgjuar fjalët e profetit tonë sot, i cili tha: “Nuk ka sakrificë tepër të madhe . . . me qëllim

që të marrin ato bekime [të tempullit]" (Tomas S. Monson, "Tempulli i Shenjtë – Një Fener për Botën", *Liahona*, maj 2011, f. 92).

Monedha dy-paundëshe e Mbretërisë së Bashkuar, ka të gdhendur në anë të saj, "Duke Qëndruar mbi Shpatullat e Gjigantëve". Kur mendoj për paraardhësit tanë të mrekullueshëm pionierë, ndiej se *të gjithë* ne jemi duke qëndruar mbi shpatullat e gjigantëve.

Megjithëse këshilla erdhi nga një letër e Robert Harrisit, unë besoj se paraardhës të panumërt do t'i dërgonin të njëjtin mesazh fëmijëve dhe nipërve e mbesave të tyre: Së pari, ne nuk duhet t'i harrojmë përvojat që kemi pasur në tempull dhe nuk duhet të harrojmë premtimet dhe bekimet që i vijnë secilit prej nesh për shkak të tempullit. Së dyti, nuk duhet të harrojmë se udhëhiqemi nga një profet i Perëndisë.

Dëshmoj se ne udhëhiqemi *vërtet* nga një profet i Perëndisë. Zoti e rivendosi Kishën e Tij në ditët e mëvonshme nëpërmjet Profetit Jozef Smith dhe ne nuk duhet të harrojmë se jemi udhëhequr nga një zinxhir i pashkëputur i profetëve të Perëndisë, që nga Jozefi deri te Brigami dhe përmes çdo Presidenti pasues të Kishës deri te profeti ynë sot – Tomas S. Monsoni. E njoh atë, e nderoj atë dhe e dua atë. Unë dëshmoj se ai është profeti i Zotit në tokë sot.

Është dëshira e zemrës sime që, së bashku me fëmijët dhe nipërit e mbesat e mia, ne do ta nderojmë trashëgiminë e paraardhësve tanë të drejtë – ata pionierë mormonë besnikë që ishin të gatshëm për ta vendosur çdo gjë në altar, për të sakrifikuar dhe për të mbrojtur Perëndinë e tyre dhe besimin e tyre. Lutem që secili prej nesh do të jetojë i vërtetë ndaj besimit që prindërit tanë e kanë dashur fort. Në emrin e shenjtë dhe të shenjtëruar të Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku L. Tom Peri,
i Kuorunit të Dymbëdhjetë Apostujve

Bindje nëpërmjet Besnikërisë Sonë

Bindja është një simbol i besimit tonë në urtësinë dhe fuqinë e autoritetit më të lartë, madje Perëndisë.

Mbrëmjeve familjare që kemi organizuar unë dhe motra Peri çdo të hënë, u është rritur papritmas numri i pjesëmarrësve. Vëllai im, vajza e tij, vëllai i Barbarës dhe një mbesë e bashkëshorti i saj janë shpërngulur në bllokun e godinave pranë apartamentit tonë. Është e vetmja kohë që jam bekuar duke e pasur familjen me banim pranë meje, që kur isha i vogël. Asokohe familja ime jetonte në të njëjtin bllok godinash me disa pjesëtarë të farefisit të nënës sime. Shtëpia e gjyshit Soni ishte ngjitur në anën veriore dhe shtëpia e teze Emës ishte ngjitur, në anën jugore të shtëpisë sonë. Në anën jugore të bllokut të godinave, jetonte teze Jozefina dhe në anën lindore ishte vendi ku jetonte dajë Alma.

Gjatë djalërisë sime, ne ndërvepionim me pjesëtarët e farefisit tonë çdo ditë dhe kalonim së bashku çaste pune, loje dhe vizitash së bashku. Ne nuk mund të bënim ndonjë çapkëllëk të madh pa u shkuar në vesh një raport nënave tona. Bota jonë është ndryshe tani – pjesëtarët e shumicës së familjeve janë të shpërndarë. Edhe nëse jetojnë në njëfarë mase afër njëri-tjetrit, ata shpesh nuk jetojnë ngjitur

me njëri-tjetrin. Prapëseprapë, duhet të besoj se djalëria ime dhe situata ime e tanishme janë paksa si qielli, me pjesëtarë të dashur të familjes që jetojnë pranë njëri-tjetrit. Kjo më shërben si një kujtues i vazhdueshëm i natyrës së përjetshme të njësisë familjare.

Gjatë kohës që po rritesha, unë pata një marrëdhënie të veçantë me gjyshin tim. Isha djali më i madh në familje. Unë hiqja dëborën nga shëtitoret në dimër dhe kujdesesha për livadhin e shtëpisë sonë, të shtëpisë së gjyshit tim e të shtëpive të dy tezeve të mia. Gjyshi, zakonisht, ulej në verandën e përparme teksa i kositja livadhin. Kur mbaroja, ulesha para këmbëve të tij dhe bisodoja me të. Ato çaste janë kujtime të çmuara për mua.

Një ditë, e pyeta gjyshin se si do ta dija nëse po bëja gjithnjë gjënë e drejtë, duke qenë se jeta të paraqet kaq shumë zgjedhje. Sikurse bënte zakonisht gjyshi im, ai u përgjigj me një përvojë nga jeta në fermë.

Ai më mësoi rreth stërvitjes së një grupi kuajsh që ata të punonin së bashku. Ai shpjegoi se një grup kuajsh duhet ta dijë gjithmonë se kush urdhëron. Një nga çelësat për marrjen e kontrollit dhe drejtimit të një kali janë



pajimet dhe frerët. Nëse një pjesëtar i grupit mendon ndonjëherë se nuk ka nevojë t'i bindet vullnetit të drejtuesit, grupi nuk do të tërheqë e punojë kurrë së bashku për ta rritur në maksimum aftësinë e tij.

Tani le ta këqyrim mësimin që më dha gjyshi duke përdorur këtë shembull. Cili është drejtuesi i grupit të kuajve? Gjyshi im besonte se është Zoti. Ai është personi me një qëllim e një plan. Ai është gjithashtu stërvitësi dhe mbështetësi i grupit të kuajve dhe, me radhë, i çdonjërit prej kuajve. Drejtuesi i di gjërat më mirë dhe e vetmja mënyrë që një kalë ta dijë se po bën gjënë e drejtë, është të jetë i bindur e të ndjekë udhëheqjen e drejtuesit.

Me çfarë po i përqaste gjyshi im pajimet dhe frerët? E besova atëherë, sikurse e besoj tani, se gjyshi im po më mëson të ndiqja shtysat e Frymës së Shenjtë. Me sytë e mendjes së tij, pajimet dhe frerët ishin shpirtërorë. Një kalë i bindur, që është pjesë e një grupi kuajsh të stërvitur mirë, ka nevojë për më tepër se një tërheqje

të butë freri nga drejtuesi për të bërë saktësisht atë që ai do që të bëjë. Kjo tërheqje e butë freri është e barasvlerëshme me zërin e qetë e të vogël me të cilin Zoti na flet neve. Prej respektit për lirinë tonë të zgjedhjes, ajo nuk është kurrë një tërheqje e fortë, e dhunshme.

Burrat dhe gratë që i shpërfillin shtysat e buta të Shpirtit, shpesh do të mësojnë, sikurse mësoi djali plangprishës, nëpërmjet pasojave të natyrshme të mosbindjes dhe të jetesës së shthurur. Qe vetëm pasi pasojat e natyrshme e përlulën djalin prangprishës që ai "erdhi në vete" dhe i dëgjoi pëshpëritjet e Shpirtit t'i thonin të kthehej në shtëpinë e të atit (shih Lluca 15:11-32).

Ndaj, mësimi që më dha gjyshi im, ishte që të isha gjithnjë gati për ta pranuar tërheqjen e butë të frerit nga Shpirti. Ai më mësoi se do ta merrja gjithmonë një shtysë të tillë, nëse do të ndryshoja ndonjëherë drejtim. Dhe nuk do të isha kurrë fajtor për keq-bërje më të rënda, nëse do ta lejoja

Shpirtin t'i udhërrëfente vendimet e mia në jetë.

Sikurse pohon Jakobi [Bibël] 3:3: "Ja, u vëmë fre në gojë kuajve, që të na binden, dhe ta drejtojmë kështu gjithë trupin e tyre".

Ne duhet të jemi të ndjeshëm ndaj frerëve tanë shpirtërorë. Edhe me tërheqjen më të vogël të frerit nga Mësuesi, ne duhet të jemi të gatshëm që ta ndryshojmë tërësisht drejtimin tonë. Për t'ia dalë mbanë në jetë, ne duhet t'i mësojmë shpirtit dhe trupit tonë që të punojnë së bashku në bindje ndaj urdhërimeve të Perëndisë. Nëse ua vëmë veshin shtysave të buta të Frymës së Shenjtë, kjo mund t'i bashkojë shpirtat dhe trupat tanë në një qëllim që do të na udhërrëfej drejt kthimit në shtëpinë tonë të përjetshme që të jetojmë me Atin tonë në Qiell.

Neni ynë i tretë i besimit, na mëson rëndësinë e bindjes: "Ne besojmë se nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, i gjithë njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinarncave të Ungjillit".



Lloji i bindjes që përshkroi gjyshi im në shembullin e tij me grupin e kuajve, kërkon edhe një mirëbesim të veçantë – që është, një besim të plotë te drejtuesi i grupit. Prandaj, mësimi që më dha gjyshi, përmendte tërthorazi edhe parimin e parë të ungjillit – besimin te Jezu Krishti.

Apostulli Pal na mësoi: “Dhe besimi është siguria e gjërave që shpresohen, tregim i gjërave që nuk shihen” (Hebrenjve 11:1). Pastaj Pali përdori shembujt e Abelit, Enokut, Noeut dhe Abrahamit për të dhënë mësim mbi besimin. Ai u përqendrua te historia e Abrahamit, pasi Abrahami është ati i besnikëve:

“Me anë të besimit Abrahami, kur u thirr, u bind të shkojë në atë vend që do të merrte për trashëgim; dhe u nis pa ditur se ku po shkonte.

Me anë të besimit Abrahami banoi në tokën e premtuar, si në një dhe të huaj. . . .

Me anë të besimit edhe vetë Sara, ndonëse e kishte kaluar moshën, mori fuqi të bëhet me barrë dhe të lindë, sepse e konsideroi besnik atë që i kishte bërë premtimin” (Hebrenjve 11: 8–9, 11).

Ne e dimë se nëpërmjet birit të Abrahamit dhe Sarës, Isakut, Abrahamit dhe Sarës iu dha një premtim – premtimi i pasardhësve “të shumtë sa yjet e qiellit dhe si rëra që është në breg të detit dhe që nuk numërohet dot” (shih vargun 12; shih edhe Zanafilla 17:15–16). Dhe pastaj besimi i Abrahamit u vu në provë në një mënyrë që shumë prej nesh do ta quanin të papërfytyrueshme.

E kam përsiatuar në shumë raste historinë e Abrahamit dhe të Isakut dhe ende nuk besoj se e kuptoj plotësisht besnikërinë dhe bindjen e Abrahamit. Ndoshta mund ta përfytyroj duke mbledhur plaçkat për t’u nisur herët një mëngjes, por si i hodhi ai të gjithë ato hapa në krah të djalit të tij, Isakut, në një udhëtim treditör nga fundi i malit Moriah? Si i mbajtën ata drutë për zjarr deri lart në mal? Si e ndërtoi ai altarin? Si e lidhi ai Isakun dhe e shtriu mbi altar? Si ia shpjegoi djalit se ai do të ishte flijimi? Dhe si e pati ai forcën ta ngrinte thikën për të vrarë të birin? Besimi i Abrahamit e fuqizoi atë për ta ndjekur udhëheqjen e Perëndisë me saktësi, deri në çastin e mrekullueshëm, kur një engjëll i

thërriti nga qielli dhe i njoftoi Abrahamit se ai e kishte kaluar provën e tij të ankthshme. Dhe më pas, engjëlli i Zotit përsëriti premtimet e besëlidhjes me Abrahamin.

E pranoj se sfidat që lidhen me të pasurin e besimit te Jezu Krishti dhe me bindjen, do të jenë më të vështira për disa njerëz se për disa të tjerë. Kam mjaft vite përvojë për ta ditur se personaliteti i kuajve mund të jetë shumë i ndryshëm dhe, prandaj, disa kuaj mund të jenë më të lehtë apo më të vështirë për t’u stërvitur dhe se larmia e njerëzve është tej mase më e madhe. Çdonjëri prej nesh, është një bir apo bijë e Perëndisë dhe ne kemi një histori të pashoqe paratokësore e tokësore. Sipas rrethanave, ka shumë pak zgjidhje që u shkojnë për shtat të gjithëve. Dhe kështu, unë e pranoj natyrën e jetës me përpjekje dhe gabime dhe, më e rëndësishmja, nevojën e vazhdueshme për parimin e dytë të ungjillit, madje pendimin.

Është gjithashtu e vërtetë se koha gjatë së cilës jetoi gjyshi im, ishte një kohë më e thjeshtë, veçanërisht për sa u përket zgjedhjeve midis të drejtës e të gabuarës. Ndërkohë që disa njerëz shumë të zgjuar dhe të mprehtë mund të besojnë se kohët tona më të ndërlikuara duan zgjidhje gjithnjë e më të ndërlikuara, unë jam shumë larg bindjes se ata kanë të drejtë. Përkundrazi, unë jam i mendimit se ndërlikimi i sotëm do thjeshtësi më të madhe, si përgjigjja që gjyshi im i dha pyetjes sime të sinqertë rreth mënyrës se si ta bëja dallimin midis të drejtës e të gabuarës. E di se ajo që kam për të ofruar sot është një formulë e thjeshtë, por mund të dëshmoj për mënyrën se sa mirë ka funksionuar për mua. Jua rekomandoj dhe madje ju sfidoj, që t’i vini në provë fjalët e mia dhe, nëse e bëni, ju premtoj se ato do t’ju çojnë në qartësi të zgjedhjes kur të jeni të

bombarduar me zgjedhje e përgjigje të thjeshta për pyetje që i pësjtjellojnë në të diturit dhe ata që mendojnë se janë të mençur.

Shumë shpesh, ne mendojmë për bindjen si ndjekje pësore e pa u menduar të urdhrave apo diktateve të një autoriteti më të lartë. Faktikisht, në më të mirën e saj, bindja është një simbol i besimit tonë në urtësinë dhe fuqinë e autoritetit më të lartë, madje Perëndisë. Kur Abrahami tregoi besnikëri dhe bindje të palëkundur ndaj Perëndisë, madje edhe kur u urdhërua ta flijonte të birin, Perëndia e shpëtoi atë. Në mënyrë të ngjashme, kur ne e tregojmë besnikërinë tonë nëpërmjet bindjes, Perëndia përfundimisht do të na shpëtojë.

Ata që mbështeten vetëm te vetja dhe ndjekin vetëm dëshirat dhe prirjet e tyre vetjake, janë shumë të kufizuar kur krahasohen me ata që e ndjekin Perëndinë dhe ecin me trokun e mprehtësisë, fuqisë dhe dhuratave të Tij. Është thënë se ai që vetëm për vete mendon, është si një pemë që frutë nuk lëshon. Bindja e fortë dhe e gjallë është gjithçka përveçse e dobët apo pësore. Ajo është mjeti, me anë të të cilit, ne e shpallim besimin tonë te Perëndia dhe e cilësojmë veten për të marrë fuqitë e qiellit. Bindja është një zgjedhje. Ajo është zgjedhja midis njohurisë e fuqisë sonë të kufizuar dhe mençurisë e plotfuqisë së pakufizuar të Perëndisë. Sipas mësimit që më dha gjyshi im, të ndierit e frerit shpirtëror në gojën tonë dhe ndjekja e udhëheqjes së drejtuesit, është një zgjedhje.

Qofshim trashëgimtarë të besëlidhjes dhe farës së Abrahamit nëpërmjet besnikërisë dhe me anë të marrjes së ordinancave të ungjillit të rivendosur. Ju premtoj se bekimet e jetës së përjetshme janë në dispozicion të gjithkujt që është besnik e i bindur. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■



Nga Plaku Lorens E. Korbrich,
i Të Shtatëdhjetëve

Profeti Jozef Smith

Zbulesat e derdhura mbi Jozef Smithin vërtetojnë se ai ishte një profet i Perëndisë.

Vegimi i Parë

Një djalosh lexon Biblën dhe sytë i ndalen te një fragment i vetëm i shkriimit të shenjtë. Ky është një çast që do të ndryshojë botën.

Ai pret me ankth të dijë se cila kishë mund ta çojë atë tek e vërteta dhe shpëtimi. Ai ka provuar pothuajse çdo gjë tjetër dhe tani i kthehet Biblës e lexon këto fjalë: “Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t’i jepet”¹.



Ai i përsiat ato në mënyrë të përsëritur. Shkëndija e parë e dritës përshkon errësirën. A është kjo përgjigja, rrugëdalja nga ngatërresa dhe errësira? A mund të jetë kaq e thjeshtë? Kërkoji Perëndisë dhe Ai do të përgjigjet? Me kalimin e kohës ai vendos se, ose duhej t’i kërkojë Perëndisë ose përgjithmonë të mbetet në errësirë dhe ngatërresë.

Dhe prapëseprapë, sado në ankth që është, ai nuk vrapon në një cep të qetë dhe bën shpejt e shpejt një lutje të ngutur. Ai është vetëm 14 vjeç, por në nxitimin e tij për të marrë dituri, ai nuk është i nxituar. Kjo nuk do të jetë thjesht një lutje çfarëdo. Ai vendos ku të shkojë dhe kur ta bëjë përpjekjen. Përgatitet të flasë me Perëndinë.

Dhe më pas dita vjen. Është “mëngjesi i një dite të bukur, të kthjellët, në fillim të pranverës së vitit [1820]”². Ai ecën i vetëm në qetësinë e pyllit aty pranë, nën pemët që lartësohen mbi të. Arrin te vendi ku vendosi më përpara për të shkuar. Gjunjëzohet dhe tregon dëshirat e zemrës së tij.

Duke përshkruar atë çfarë ndodh më pas, ai thotë:

“Unë pashë një shtyllë drite tamam mbi kokën time, më e shkëlqyeshme se dielli, e cila zbriti gradualisht derisa ra mbi mua.



. . . Kur drita pushoi mbi mua, unë pashë dy Personazhe, shkëlqimi dhe lavdia e të cilëve i kapërcejnë të gjitha përshkrimet, duke qëndruar mbi mua në ajër. Një prej tyre më foli, duke më thirrur në emër dhe tha, duke treguar tjetrin: [Jozef,] *Ky është Biri Im i Dashur. Dëgjoje Atë!*³

Vetëm 24 vite më vonë, Jozef Smithi dhe vëllai i tij, Hajrëmi, do të vdesin për shkak të asaj që filloi këtu.

Kundërshtimi

Jozefi tha se kur ishte 17 vjeç, një engjëll i tregoi se “emri [i tij] do të mbahej për mirë e për keq mes të gjitha kombeve, . . . mes gjithë popujve”⁴. Kjo profeci po vazhdon të përmbushet sot, ndërsa Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme është përhapur anembanë botës.

Kundërshtimi, kritika dhe armiqësia janë shoqërues të së vërtetës. Kurdoherë që zbulohet e vërteta lidhur me qëllimin dhe fatin e njeriut, do të ketë gjithmonë një forcë për ta kundërshtuar atë. Duke filluar me

Adamin dhe Evën në Kopshtin e Edenit, deri te shërbesa e Krishtit dhe më tej deri në ditën tonë, gjithmonë ka pasur dhe përherë do të ketë një përpjekje për të mashtuar rreth planit të jetës, për ta prishur, kundërshtuar dhe penguar atë.

Kërkoni renë më të madhe të pluhurit të ngritur mbi dheun më të shumtë që i hidhet Atij që u kundërshtua më shumë, u sprovua dhe u mohua, u rrah, u braktis e u kryqëzua, Atij që zbriti nën të gjitha gjërat, dhe aty do ta gjeni të vërtetën, Birin e Perëndisë, Shpëtimtarin e të gjithë njerëzimit. Përse nuk e lanë të qetë?

Përse? Sepse Ai është e vërteta; dhe e vërteta gjithmonë do të kundërshtohet.

Dhe pastaj kërkoni atë që solli një dëshmi tjetër të Jezu Krishtit dhe një shkrim tjetër të shenjtë, kërkoni atë që ishte mjete me anë të të cilit u rivendosën plotësia e ungjillit dhe Kisha e Jezu Krishtit në tokë, kërkoni atë dhe prisni të gjeni njerëz duke i hedhur baltë. Përse të mos e lënë të qetë atë?

Përse? Sepse Ai na mësoi të vërtetën dhe e vërteta gjithmonë do të kundërshtohet.

Vërshimi i Zbulesave

Zbulesat e derdhura mbi Jozef Smithin vërtetojnë se ai ishte një profet i Perëndisë. Le të shohim disa prej tyre – thjesht të shohim një pjesë të dritës dhe të vërtetës së zbuluar nëpërmjet tij, që ndriçon në kontrast të plotë me bindjet e përgjithshme fetare të kohës së tij dhe të kohës sonë:

- Perëndia është një qenie e mëvetësishme, e ekzaltuar, një Atë i Amshuar. Ai është Ati ynë.
- Perëndia, Ati, Jezu Krishti dhe Fryma e Shenjtë janë qenie të veçanta.⁵
- Ju jeni më shumë se njerëzor. Ju jeni fëmijë i Perëndisë, Atit të Amshuar, dhe mund të bëheni si Ai⁶ nëse do të keni besim te Biri i Tij, do të pendoheni, merrni ordinarcat, merrni Frymën e Shenjtë dhe duroni deri në fund.⁷
- Kisha e Jezu Krishtit sot është në themel e njëjta Kishë që Ai e


organizoi gjatë shërbesës së Tij në vdekshmëri, me profetë e apostuj, me Priftëritë Melkizedeke dhe Levitike, me pleq, priftërinj të lartë, dhjakë, mësues, peshkopë dhe të shtatëdhjetë, të gjithë siç përshkruhen në Bibël.

- Autoriteti i priftërisë u tërhoq nga toka në vijim të vdekjeve të Shpëtimtarit dhe të Apostujve të Tij dhe u rivendos përsëri në kohën tonë.
- Zbulesa nuk ka reshtur dhe qiejt nuk janë mbyllur. Perëndia u flet profetëve sot dhe Ai do t'ju flasë juve dhe mua gjithashtu.⁸
- Ka më shumë pas kësaj jete sesa vetëm parajsë dhe ferr. Ka tri shkallë të lavdisë dhe ka tej mase rëndësi se çfarë bëjmë në këtë jetë.⁹
- Më shumë sesa të pasurit e një besimi thjesht joveprues të Krishti, ne duhet të “sh[ohim] tek [Ai] në çdo mendim”¹⁰, “të bëljmë] gjithçka që bëljmë], në emër të Birit”¹¹, “gjithmonë ta kujtoj[më] atë e të zbatoj[më] urdhërimet . . . që të mund të ke[m]i gjithmonë Shpirtin e tij me [ne]”¹².
- Miliardat e njerëzve që jetojnë e vdesin pa ungjillin dhe ordinancat e nevojshme për shpëtim, nuk janë të humbur. “Nëpërmjet Shlyerjes së Krishtit, i gjithë njerëzimi mund të shpëtohet, me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të Ungjillit”¹³, të administruara si për të gjallët edhe për të vdekurit.¹⁴
- Gjithçka nuk filloi me lindjen. Ju jetuat më parë në praninë e Perëndisë si biri apo bija e Tij dhe u përgatitët për këtë jetë të vdekshme.¹⁵
- Martesa dhe familja nuk janë tradita të njerëzve derisa vetëm vdekja të na ndajë. Ato kanë si qëllim të jenë të përjetshme nëpërmjet besëlidhjeve që bëjmë me Perëndinë. Familja është modeli i qiellit.¹⁶

Dhe kjo është vetëm një pjesë e vërshimit të zbulesave të derdhura mbi Jozef Smithin. Nga erdhi kjo e gjitha, këto zbulesa të cilat i japin dritë errësirës, qartësi dyshimit dhe të cilat kanë frymëzuar, bekuar dhe përmirësuar miliona njerëz? Cila ka më të ngjarë, që ai e ëndërroi të gjithën vetë apo që ai pati ndihmën e qiellit? A tingëllojnë shkrimet e shenjta që ai dha, si fjalët e njeriut apo si fjalët e Perëndisë?

Përfundim

Nuk ka asnjë debat rreth asaj që përbushit Jozef Smithi, vetëm rreth mënyrës se si e bëri atë që bëri dhe përse e bëri. Dhe nuk ka shumë mundësi zgjedhjeje. Ai ishte ose njeri i shtirur ose profet. Ose e bëri atë që bëri i vetëm, ose pati ndihmën e qiellit. Shihni faktet, por i shihni të gjitha faktet, tërë mozaikun e jetës së tij, jo ndonjë pjesë të vetme. Më e



rëndësishmja, veproni si Jozefi i ri dhe “kërkoj[ini] . . . Perëndisë, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe do [t’]ju jepet”¹⁷. Kjo nuk është vetëm mënyra se si mund të mësoni të vërtetën rreth Librit të Mormonit dhe Jozef Smithit, është edhe modeli për të ditur të vërtetën e të gjitha gjërave.¹⁸

Jozef Smithi ishte një profet i Perëndisë, ashtu siç është sot Tomas S. Monsoni. Nëpërmjet Jozef Smithit, “çelësat e mbretërisë së Perëndisë [përsëri] i jepen njeriut në tokë dhe . . . do të përhapet ungjilli . . . ashtu si guri që shkëputet pa duar nga mali . . . , derisa të ketë mbushur tërë tokën”¹⁹.

Perëndia është Ati ynë i Amshuar dhe Jezusi është Krishti. Ne i adhurim Ata. Asgjë nuk krahasohet me krijimet e Tyre, planin e shpëtimit dhe sakrificën shlyese të Qengjit të Perëndisë. Në këtë periudhë të kujdestarisë ungjillore, ne e përbushim planin e Atit dhe marrim nga frytet e Shlyerjes vetëm me anë të bindjes ndaj ligjeve dhe ordinancave të ungjillit, të rivendosura nëpërmjet Profetit Jozef Smith. Unë jap dëshmi për Ta – Perëndinë, Atin e Amshuar, dhe Jezu Krishtin, Shpëtimtarin e botës. Dhe unë e bëj këtë në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Jakobit [Bibël] 1:5.
2. Joseph Smith – Historia 1:14.
3. Joseph Smith – Historia 1:16–17.
4. Joseph Smith – Historia 1:33.
5. Shih Doktrina e Besëlidhje 130:22.
6. Shih Doktrina e Besëlidhje 50:24.
7. Shih 2 Nefi 31; 3 Nefi 27.
8. See Moroni 10:3–5.
9. Shih Doktrina e Besëlidhje 76.
10. Doktrina e Besëlidhje 6:36.
11. Moisiu 5:8.
12. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
13. Nenet e Besimit 1:3.
14. Shih Doktrina e Besëlidhje 76; 128; 138.
15. Shih Doktrina e Besëlidhje 49:17; 138; Moisiu 3:5; 6:36.
16. Shih Doktrina e Besëlidhje 131:1–2; 132:5–33.
17. Jakobit [Bibël] 1:5.
18. Shih Moroni 10:3–5.
19. Doktrina e Besëlidhje 65:2.



Nga Plaku Majkëll Xhon U. Teh,
i Të Shtatëdhjetëve

Ku Është Thesari Juaj

Nëse nuk jemi të kujdesshëm, ne do të fillojmë të rendim pas gjërave tokësore më shumë se pas atyre shpirtërore.

Pak pas konferencës së përgjithshme në tetor të vitit 2007, një nga vëllezërit e mi më tha se do të kalonin rreth shtatë vjet përpara se ta përjetoja sërish këtë përvojë të vështirë. U qetësova dhe i thashë se do t'i konsideroja ato "shtatë vitet e mia të bollëku[t]". Pra, ja ku jam; shtatë viteve të mia të bollëkut u ka ardhur fundi.

Janarin e kaluar, unë dhe e dashura e zemrës sime, Greisi, morëm një detyrë për të vizituar anëtarët në Filipine, të cilët ishin shkretuar nga një tërmet i madh dhe një tajfun shumë i fuqishëm. Ne u gëzuam sepse detyra ishte përgjigje e lutjeve tona dhe një dëshmi e mëshirës dhe e mirësisë së një Ati të dashur në Qiell. Ajo i dha përmbushje dëshirës sonë të madhe për t'ua shprehur vetë atyre dashurinë dhe shqetësimin tonë.

Pjesa më e madhe e anëtarëve që takuam, po jetonin ende në streha të përkohshme si çadra, qendra komuniteti dhe shtëpi mbledhjesh të Kishës. Shtëpitë që vizituam, ose kishin çati të pjesshme ose nuk kishin fare çati. Njerëzit nuk kishin shumë zotërimi që më parë dhe ajo pak që kishin, [tashmë] ishte zhdukur. Kishte baltë dhe gërmadha gjithandej. Megjithatë, ata ishin plot mirënjohje për atë pak ndihmë që morën dhe ishin të gëzuar e në humor të mirë, pavarësisht rrethanave të tyre

shumë të vështira. Kur i pyetëm se si po i përballonin, gjithsecili u përgjigj me një fjali kumbuese, "Ne jemi mirë". Duket qartë se besimi i tyre te Jezu Krishti u dha shpresë se në fund çdo gjë do të kishte zgjidhje. Shtëpi pas

shtëpie, çadër pas çadre, unë dhe Motra Teh po merrnim mësim nga këta shenjtorë besnikë.

Në kohët e fatkeqësisë ose të tragjedisë, Zoti ka një mënyrë për të ndryshuar përqendrimin dhe përparësitë tona. Krejt papritur, të gjitha gjërat materiale për të cilat kemi punuar kaq shumë që t'i sigurojmë, nuk kanë rëndësi. Gjithçka që ka vërtet rëndësi, është familja jonë dhe marrëdhëniet tona me të tjerët. Një motër e mirë e shprehu në këtë mënyrë: "Pasi uji u tërhoq dhe ishte koha për të filluar pastrimin, pashë rreth shtëpisë sime dhe mendova, 'Ua, paskam grumbulluar shumë mbeturina gjatë këtyre viteve'".

Mendoj se kjo motër ka fituar një këndvështrim më të mirë dhe si



rrjedhë, do të jetë shumë e kujdeshme kur të vendosë se cilat janë gjërat e nevojshme dhe cilat janë ato pa të cilat në të vërtetë mund të jetojë.

Duke punuar me shumë anëtarë përgjatë viteve, ne kemi pasur kënaqësinë të vëzhgojmë një bollëk të forcës shpirtërore. Ne gjithashtu, kemi parë një bollëk dhe një mungesë të zotërimave materiale midis këtyre anëtarëve besnikë.

Për shkak të nevojës, pjesa jonë më e madhe, janë përfshirë në fitimin e parave dhe sigurimin e disa të mirave të botës për të qenë në gjendje t'i mbajmë familjet tona. Kjo kërkon një pjesë të mirë të kohës dhe vëmendjes sonë. Nuk ka fund të asaj që bota ka për të dhënë, prandaj është vendimtare që ne të mësojmë ta pranojmë kur kemi mjaftueshëm. Nëse nuk jemi të kujdesshëm, ne do të fillojmë të rendim pas gjërave tokësore më shumë se pas atyre shpirtërore. Kërkimi ynë për shpirtëroren dhe të përjetshmen do të ketë një përparësi më të vogël, në vend që të jetë e kundërta. Është për të ardhur keq, por duket se ekziston një prirje për të marrë gjithmonë e më shumë dhe për të zotëruar atë që është më e fundit dhe më mondanë.

Si mund të sigurohemi që të mos tërhiqemi në këtë shteg? Jakobi dha këtë këshillë: "Prandaj, mos shpenzoni para për atë që nuk ka vlerë, as punën tuaj për atë që nuk mund të japë kënaqësi. Më dëgjoni me zell dhe mbani mend fjalët që ju kam thënë; dhe e jani tek i Shenjti i Izraelit dhe merrni sa të mundni nga ajo që nuk mbaron, as që nuk mund të korruptohet dhe e lini shpirtin tuaj të kënaqet në bollëk."¹

Shpresoj që asnjë nga ne të mos shpenzojë para për atë që nuk ka vlerë, as punën tuaj për atë që nuk mund të japë kënaqësi.

Shpëtimtari u mësoi sa vijon si judenjtë edhe nefitëve:



"Mos mblidhni për vete thesare mbi tokë, ku i brejnë tenja dhe ndryshku, dhe ku vjedhësit shpërthejnë dhe vjedhin:

përkundrazi mblidhni për vete thesare në qiell, ku as tenja as ndryshku nuk prishin dhe ku vjedhësit nuk shpërthejnë dhe nuk vjedhin:

Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj."²

Në një rrethanë tjetër, Shpëtimtari dha këtë shembëlltje:

"Tokat e një pasaniku dhanë të korra të bollshme;

dhe ai arsyetonte me vete duke thënë: 'Ç'të bëj, sepse nuk kam vend ku t'i shtie të korrat e mia?'

Dhe tha: 'Këtë do të bëj: do të shemb hambarët e mia dhe do t'i bëj më të mëdhenj, ku do të shtie të gjitha të korrat dhe pasuritë e tjera,

dhe pastaj do t'i them shpirtit tim: Shpirt, ti ke pasuri të shumta të shtëna për shumë vjet; pusho, ha, pi dhe gëzo'.

Por Perëndia i tha: 'O i pamend, po atë natë shpirtin tënd do të ta kërkojnë dhe ato që përgatite të kujt do të jenë?'

Kështu i ndodh atij që grumbullon thesare për vete dhe nuk është i pasur ndaj Perëndisë."³

Presidenti Diter F. Uhtdorf dha këshillën vijuese, jo shumë kohë më parë:

"Ati ynë Qiellor e sheh potencialin tonë të vërtetë. Ai di rreth nesh gjëra që

as vetë nuk i dimë. Ai na nxit gjatë jetës sonë që të plotësojmë qëllimin e krijimit tonë, që të bëjmë një jetë të drejtë dhe të rikthehemi në praninë e Tij.

Përse, atëherë, u kushtojmë kaq shumë nga koha dhe energjia jonë gjërave që janë kaq të përkohshme, kaq të paqëndrueshme dhe kaq sipërfaqësore? A kundërshtojmë të shohim marrëzinë të ndjekja e të parëndësishmes dhe të përkohshmes?"⁴

Ne të gjithë e dimë se lista jonë e thesareve tokësore përbëhet nga krenaria, pasuria, gjërat materiale, pushteti dhe nderimet e njerëzve. Ato nuk meritojnë më shumë kohë e vëmendje, prandaj, në vend të kësaj, unë do të përqendrohem te gjërat që do të përbëjnë thesaret tona në qiell.

Cilat janë disa thesare në qiell që mund të mbledhim për veten tonë? Për ta filluar, do të ishte mirë që ne të fitojmë vetitë si të Krishtit, të besimit, shpresës, përlësisë dhe dashurisë hyjnore. Ne jemi këshilluar në mënyrë të përsëritur që ta "zhvesh[im] njeriun e natyrshëm dhe . . . [të bëhemi] si një fëmijë"⁵. Këshilla e Shpëtimtarit është që ne të përpiqemi të jemi të përkryer si Ai dhe Ati ynë Qiellor.⁶

Së dyti, ne duhet të japim më shumë kohë cilësore dhe përpjekje në forcimin e marrëdhënieve familjare. Mbi të gjitha, "familja shugurohet nga Perëndia. Ajo është njësia më e rëndësishme në kohë dhe në përjetësi"⁷.

Së treti, shërbimi ndaj të tjerëve është shenjë dalluese e një ndjekësi të vërtetë të Krishtit. Ai tha: "Sa herë ia keni bërë këtë ndonjërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, këtë ma bëtë mua"⁸.

Së katërti, të kuptuarit e doktrinës së Krishtit dhe forcimi i dëshmimeve tona është një punë që do të sjellë gëzim e kënaqësi të vërtetë. Ne duhet t'i studiojmë vazhdimisht fjalët e Krishtit, siç gjenden në shkrimet e shenjta dhe në

fjalët e profetëve të gjallë. “Pasi, vini re, fjalët e Krishtit do t’ju tregojnë të gjitha gjërat që ju duhet të bëni.”⁹

Më lejoni ta mbyll me historinë e një të veje 73-vjeçare, të cilën e takuam gjatë udhëtimit tonë në Filipine:

Kur tërmeti goditi ishullin Bohol, shtëpia që ajo dhe bashkëshorti i saj i ndërte kishin punuar kaq shumë për ta ndërtuar, u shemb përtokë, duke vrarë vajzën dhe nipin e saj. Tashmë e vetmuar, ajo duhej të punojë për të mbajtur vetveten. Ajo ka filluar të lajë rroba (të cilën e bën me dorë) dhe duhet të shkojë lart e poshtë një kodre të madhe, disa herë në ditë, për të mbushur ujë. Kur ne e vizituam, ajo po jetonte ende në një çadër.

Këto janë fjalët e saj: “Eldër [Plak], e pranoj çdo gjë që Zoti më ka kërkuar të kaloj. Nuk kam hatërmbetje. E ruaj si thesar rekomandimin tim të tempullit dhe e mbaj nën jastëk. Ju lutem, dijeni se paguaj një të dhjetë të plotë nga të ardhurat e mia të pakta nga larja e rrobave. Çfarëdo që të ndodhë, unë gjithmonë do ta paguaj të dhjetën.”

Unë ju dëshmoj se përparësitë, prirjet, parapëlqimet, dëshirat, orekset e pasionet tona do të kenë një ndikim të drejtpërdrejtë në gjendjen tonë të ardhshme. Le t’i kujtojmë gjithmonë fjalët e Shpëtimtarit: “Sepse ku është thesari juaj do të jetë edhe zemra juaj”. Qoftë zemra jonë në vendin e duhur, është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. 2 Nefi 9:51.
2. Mateu 6:19–21; shih edhe 3 Nefi 13:19–21.
3. Lluca 12:16–21.
4. Diter F. Uhtdorf, “Lidhur me Keqardhjet dhe Vendimet”, *Liahona*, nëntor 2012, f. 22–23.
5. Mosiah 3:19.
6. Shih 3 Nefi 12:48.
7. *Handbook 2 [Manuali 2]: Administëring the Church [Administrimi i Kishës]* (2010), 1.1.1.
8. Mateu 25:40
9. 2 Nefi 32:3



Nga Plaku Markos A. Aidukaitis,
i Të Shtatëdhjetëve

Në Qoftë Se Ju Mungon Urtia

Perëndia do t’ua zbulojë të vërtetën atyre që e kërkojnë atë sipas udhëzimeve në shkrimet e shenjtja.

Para ca kohësh, djali im 10-vjeçar po studioje në internet rreth trurit të njeriut. Ai do që një ditë të bëhet kirurg. Nuk është e vështirë të vërehet se ai është shumë më i zgjuar se unë.

Neve na pëlqen interneti. Në shtëpi, ne komunikojmë me familjen dhe miqtë nëpërmjet mjeteve të komunikimit shoqëror, me anë të postës elektronike dhe në mënyra të tjera. Fëmijët e mi e bëjnë pjesën më të madhe të detyrave të shkollës nëpërmjet internetit.

Cilado që të jetë pyetja, nëse kemi nevojë për më shumë informacion, ne e kërkojmë atë në internet. Në pak sekonda ne gjejmë shumë material. Kjo është e mrekullueshme.

Interneti na siguron shumë mundësi për të mësuar. Megjithatë, Satani do që ne të jemi të mjeruar dhe ai e shtrembëron qëllimin e vërtetë të gjërave. Ai e përdor këtë mjet të mrekullueshëm për të nxitur dyshimin e frikën dhe për të shkatërruar besimin e shpresën.

Me kaq shumë [informacion] të disponueshëm në internet, ne duhet ta marrim në shqyrtim me kujdes se ku t’i përqendrojmë përpjekjet tona.

Satani mund të na mbajë të zënë, të shpërqendruar dhe të papastër duke shoshitur përmes informacionit shumë prej asaj që mund të jetë thjesht mbeturinë.

Një njeri nuk duhet të endet nëpër mbeturina.

Vërimi veshin këtij udhëzimi të dhënë nga shkrimet e shenjtja: “Shpirti i Krishtit i jepet çdo njeriu, që ai të dallojë të mirën nga e keqja; prandaj, unë do t’ju tregoj mënyrën sesi të gjykoni; pasi çdo gjë që ju fton të bëni mirë dhe t’ju bindë të besoni në Krisht, është dërguar nëpërmjet fuqisë dhe dhuratës së Krishtit; prandaj ju mund të dini . . . se është nga Perëndia”¹.

Në kuptimin e vërtetë, ne hasim të njëjtën mëdyshje që ndeshi Jozef Smihti në rininë e tij. Shumë shpesh zbulojmë se vetë neve na mungon urtia.

Në mbretërinë e Perëndisë, kërkimi për të vërtetën vlerësohet, nxitet dhe në asnjë mënyrë nuk shtypet ose frikësohet. Anëtarët e kishës këshillohen fuqishëm nga Zoti Vetë që të kërkojnë njohuri.² Ai tha: “Kërkoni me zell . . . ; po, kërkoni nga librat më të mirë fjalët e urtësisë; kërkoni të mësoni, madje me anë të studimit dhe gjithashtu me anë të besimit”³. Megjithatë, si mund

ta njohim të vërtetën në një botë që është gjithnjë e më shumë më e drejt-përdrejtë në sulmet e saj ndaj gjërave që i përkasin Perëndisë?

Shkrimet e shenjta na mësojnë:

Së pari, ne mund ta njohim të vërtetën duke vëzhguar frytet e saj.

Gjatë Predikimit të Tij të mrekullueshëm në Mal, Zoti tha:

“Kështu çdo dru i mirë jep fryte të mira; por druri i keq prodhon fryte të këqija . . .

Ju, pra, do t’i njihni profetët nga frytet e tyre.”⁴

Profeti Mormoni dha mësim të njëjtin parim kur tha: “Ju do t’i njihni ata nga punët e tyre; pasi në qoftë se punët e tyre janë të mira, atëherë ata gjithashtu janë të mirë”⁵.

Ne i ftojmë të gjithë të studiojnë frytet dhe veprat e kësaj Kisha.

Ata që interesohen për të vërtetën, do të jenë në gjendje ta njohin ndryshimin që Kisha dhe anëtarët e saj sjellin në komunitetet ku ata janë vendosur. Ata gjithashtu do të vënë re një përmirësim në jetën e atyre që i ndjekin mësimet e saj. Ata që i shqyrtojnë këto fryte do të zbulojnë se frytet e Kishës së Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme janë të shijshme dhe të dëshirueshme.

Së dyti, ne mund ta gjejmë të vërtetën duke e vënë vetë në provë fjalën.

Profeti Alma dha mësim:

“Ne do ta krahasojmë fjalën me një farë. . . . Në qoftë se bëni vend që një farë të mund të mbillet në zemrën tuaj, vini re, po të jetë një farë e vërtetë, [dhe] . . . në qoftë se ju nuk e hidhni tej me mosbesimin tuaj, . . . vini re, ajo do të fillojë të fryhet në kraharorin tuaj; dhe . . . ju do të filloni të thoni me veten tuaj – Kjo duhet të jetë një farë e mirë, . . . pasi po fillon të zmadhohë shpirtin tim; po, po fillon të ndriçojë kuptimin tim, po, po fillon të jetë e këndshme për mua . . .

. . . Dhe tani, . . . a nuk do ta forcojë besimin tuaj? Po, ajo do ta forcojë besimin tuaj . . .

. . . Meqë çdo farë prodhon, sikurse veten e saj.”⁶

Çfarë ftese madhështore nga një profet i Zotit! Kjo mund të krahasohet me një eksperiment shkencor. Ne ftohemi ta vëmë në provë fjalën, na janë dhënë parametra dhe na është treguar rezultati i provës, nëse i ndjekim udhëzimet.

Pra, shkrimet e shenjta na mësojnë se ne mund ta njohim të vërtetën duke vëzhguar frytet e saj ose duke eksperimentuar me të vetë, duke bërë vend për fjalën në zemrën tonë dhe duke e kultivuar atë, ashtu si edhe një farë.

Megjithatë, ka ende një mënyrë të tretë për ta ditur të vërtetën dhe kjo është me anë të zbulesës vetjake.

Seksioni 8 në Doktrina e Besëlidhje na mëson se zbulesa është dituri – “dituri për çfarëdolloj gjërash që [ne] do të kërkojmë] me besim, me një zemër të ndershme, duke besuar se [ne] do të marr[im] dituri”⁷.

Dhe Zoti na thotë se si do ta marrim këtë zbulesë. Ai thotë: “Unë do të të them në mendjen tënde dhe në zemrën tënde, me anë të Frymës së Shenjtë, që do të vijë mbi ty dhe që do të banojë në zemrën tënde”⁸.

Pra, neve na është mësuar se zbulesa mund të merret duke kërkuar me besim, me një zemër të ndershme dhe duke besuar se do ta marrim.

Por vini re se Zoti e bëri shumë të qartë kur paralajmëroi: “Kujto se pa besim ti s’mund të bësh asgjë; prandaj kërko me besim”⁹. Besimi kërkon vepra të tilla si ta studiosh atë





Plezënt Grouv, Juta, SHBA

në mendjen tënde, pastaj të kërkosh në lutje nëse është e drejtë.

Zoti tha:

“Nëse është e drejtë, unë do të bëj që kraharori yt do të digjet përbrenda; si rrjedhim, do ta ndiesh që është e drejtë.

Por nëse nuk është e drejtë, ti nuk do të kesh ndjenja të tilla, por do të kesh një mpirje të mendimit që do të të bëjë ta harrosh gjënë që është e gabuar.”¹⁰

Besimi pa vepra është i vdekur.¹¹ Pra, “kërko[ni] me besim, pa dyshuar”¹².

Kam një mik, jo të besimit tonë, i cili më tregoi se ai nuk është një individ shpirtëror. Ai nuk i studion shkrimet e shenjta ose nuk lutet, sepse thotë që nuk mund t’i kuptojë fjalët e Perëndisë, as nuk është i sigurt se Perëndia ekziston. Ky qëndrim shpjegon mungesën e anës së tij shpirtërore dhe do të çojë në anën e kundërt të zbulësës, siç u shpjegua nga Alma. Ai tha: “Dhe prandaj, ai që do të ngurtësojë zemrën e tij, po, ai do të marrë pjesën më të vogël të fjalës”.

Por Alma shtoi, “ai që nuk do ta ngurtësojë zemrën, atij i jepet pjesa më e madhe e fjalës, derisa t’i jepet të dijë misteret e Perëndisë, derisa t’i dijë plotësisht”¹³.

Alma dhe bijtë e Mosias janë shembuj të parimit se besimi kërkon vepra. Në Librin e Mormonit, ne lexojmë:

“[Ata] kishin kërkuar me zell shkrimet e shenjta, që ata të mund të dinin fjalën e Perëndisë.

Por kjo nuk është e gjitha; ata ishin dhënë pas lutjeve të shumta dhe agjërimit; prandaj ata kishin shpirtin e profecisë dhe shpirtin e zbulësës.”¹⁴

Në këtë proces, të kërkuarit me një zemër të ndershme është po aq i rëndësishëm. Nëse po e kërkojmë me sinqeritet të vërtetën, ne do bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë, gjë që mund të përfshijë leximin e shkrimeve të shenjta, vajtjen në kishë dhe bërjen e maksimumit tonë për t’i mbajtur urdhërimet e Perëndisë. Kjo do të thotë gjithashtu se ne jemi të gatshëm ta bëjmë vullnetin e Perëndisë kur e zbulojmë atë.

Veprimet e Jozef Smithit, kur po kërkonte urti, janë një shembull i përkryer se çfarë do të thotë të kesh një zemër të ndershme. Ai tha se donte të dinte se cili nga sektet ishte i vërtetë, kështu që “[ai] të mund të di[n]te me cilin të bashkohe[sh]”¹⁵. Edhe para se të lutej, ai ishte i gatshëm të vepronte mbi përgjigjen që do të merrte.

Ne duhet të kërkojmë me besim dhe me një zemër të ndershme. Por

ajo nuk është e gjitha. Ne duhet të besojmë gjithashtu se do të marrim zbulësë. Ne duhet t’i mirëbesojmë Zotit dhe të kemi shpresë në premtimet e Tij. Mbani mend se çfarë është shkruar: “Por në qoftë se ndonjërit nga ju i mungon urtia, le të kërkojë nga Perëndia, që u jep të gjithëve pa kursim, pa qortuar, dhe atij do t’i jepet”¹⁶. Çfarë premtimi i mrekullueshëm!

Unë i ftoj të gjithë njerëzit që ta kërkojnë të vërtetën nga secila prej këtyre metodave, por veçanërisht nga Perëndia, nëpërmjet zbulësës vetjake. Perëndia do t’ua zbulojë të vërtetën atyre që e kërkojnë atë sipas udhëzimeve në shkrimet e shenjta. Ajo kërkon më shumë përpjekje sesa thjesht kërkim në internet, por ia vlen.

Unë jap dëshminë time se kjo është Kisha e vërtetë e Jezu Krishtit. I kam parë frytet e saj në komunitete dhe në jetën e mijëra njerëzve, përfshirë anëtarët e familjes; pra, e di se është e vërtetë. E kam provuar gjithashtu fjalën në jetën time për shumë vite dhe i kam ndier ndikimet e saj në shpirtin tim; pra, e di se është e vërtetë. Por më e rëndësishmja, unë e kam mësuar vërtetësinë e saj për veten time me anë të zbulësës, nëpërmjet fuqisë së Frymës së Shenjtë; pra, e di se është e vërtetë. Ju ftoj të gjithëve të bëni të njëjtën gjë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Moroni 7:16.
2. Shih Doktrina e Besëlidhje 88:78.
3. Doktrina e Besëlidhje 88:118.
4. Mateu 7:17, 20.
5. Moroni 7:5
6. Alma 32:28, 30–31.
7. Doktrina e Besëlidhje 8:1.
8. Doktrina e Besëlidhje 8:2.
9. Doktrina e Besëlidhje 8:10.
10. Doktrina e Besëlidhje 9:8–9.
11. Shih Jakobi [Bibël] 2:17.
12. Jakobit [Bibël] 1:6.
13. Alma 12:10.
14. Alma 17:2–3.
15. Joseph Smith – Historia 1:18.
16. Jakobit [Bibël] 1:5.



Nga Plaku D. Tod Kristoferson,
i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve

Ringjallja e Jezu Krishtit

Jezusi i Nazaretit është Shëlbuesi i ringjallur dhe dëshmoj për gjithçka që rrjedh nga fakti i Ringjalljes së Tij.

Një ndjesi dërrmuese disfate e dëshpërimi i kaploi dishepujt e Tij teksa Jezusi vuajti dhe vdiq në kryq dhe trupi i Tij i pajetë u vendos në varr. Pavarësisht nga ajo që Shpëtimtari kishte thënë në mënyrë të përsëritur për vdekjen dhe ngritjen e Tij pasuese sërish, ata nuk e kishin kuptuar. Pasditja e errët e Kryqëzimit të Tij, sidoqoftë, u ndoq shpejt nga mëngjesi i gëzueshëm i Ringjalljes së Tij. Por ai gëzim erdhi vetëm kur dishepujt u bënë dëshmitarë okularë të Ringjalljes, pasi edhe shpallja e engjëjve që Ai ishte ngritur, ishte në fillim e pakuptueshme – ishte diçka kaq tërësisht e pandodhur më parë.

Maria Magdalena dhe disa gra të tjera besnike shkuan herët në varrin e Shpëtimtarit atë të diel në mëngjes, duke sjellë erëza dhe vajra për të përfunduar vajosjen e filluar kur trupi i Zotit u shtri me ngut në varr përpara se të vinte Shabati. Në këtë mëngjes mbi mëngjeset, ato i priti një varr i hapur, guri që mbulonte hyrjen që rrokullisur tutje dhe dy engjëj që shpallën:

“Pse e kërkoni të gjallin midis të vdekurve?”

Ai nuk është këtu, por është ringjallur; kujtohuni si ju foli, kur ishte ende në Galile,

duke thënë se Biri i njeriut duhej të dorëzohej në duar të njerëzve

mëkatarë, duhej kryqëzuar dhe do të ringjallej ditën e tretë.”¹

“Ejani, shikoni vendin ku që vënë Zoti.


Shkoni shpejt t’u thoni dishepujve të tij se ai u ringjall së vdekuri.”²

Siç u urdhërua nga engjëjt, Maria Magdalena pa te varri, por duket se gjithçka që u regjistrua në mendjen e saj, ishte që trupi i Zotit ishte zhdukur. Ajo nxitoi për t’ua raportuar Apostujve dhe pasi gjeti Pjetrin dhe Gjonin, u tha atyre: “E kanë hequr Zotin nga

varri dhe nuk e dimë ku e vunë”³.

Pjetri dhe Gjoni vrapuan për te vendi dhe verifikuan a ishte me të vërtetë i zbrazët varri, duke parë “pëlhurat prej liri që ishin . . . dhe rizën, që që vënë mbi kokën e Jezusit . . . e palosur në një vend, veç”⁴. Gjoni me sa duket ishte i pari që e kuptoi mesazhin madhështor të ringjalljes. Ai shkruan se “pa dhe besoi”, ndonëse të tjerët deri në atë pikë “nuk e kishin kuptuar ende Shkrimin, sipas të cilit [Jezusi] duhet të ringjallej së vdekurish”⁵.

Pjetri dhe Gjoni u larguan, por Maria qëndroi prapa, ende duke vajtuar. Gjatë kësaj kohe, engjëjt ishin kthyer dhe e pyetën atë me dhimbsuri: “O grua, pse po qan?” Ajo iu përgjigj atyre: ‘Sepse e kanë hequr Zotin tim, dhe nuk e di ku e kanë vënë.’⁶ Në atë çast, Shpëtimtari i ringjallur që tani qëndronte në këmbë prapa saj, i foli: “O grua, pse po qan? Kë kërkon? Ajo, duke menduar se ishte kopshtari, i tha [me përgjërime]: ‘Zot, po e pate hequr ti, më trego ku e vure dhe unë do ta marr’.”⁷





Plaku Xhejms E. Talmeixh shkroi: “Ishte Jezusi, Ai me të cilin ajo foli, Zoti i saj i dashur, edhe pse ajo nuk e dinte. Një fjalë nga buzët e Tij të gjalla, e shndërruan hidhërimin e saj të munduar në gëzim të papërmbajtur. Jezusi i tha asaj: ‘Mari’. Zëri, toni, theksi i butë që ajo kishte dëgjuar dhe dashur në ditët e mëparshme, e ngritën atë nga thellësitë dëshpëruese në të cilat ishte fundosur. Ajo u kthye dhe pa Zotin. Në një kaplim gëzimi ajo i zgjati krahët e saj për ta përqaftuar Atë, duke shqiptuar vetëm fjalën e shtrenjtë e adhuruese: ‘Rabboni’, që do të thotë Mësuesi im i dashur.”⁸

Dhe kështu, kjo grua e bekuar u bë e vdekshmja e parë që e shihte dhe i fliste Krishtit të ringjallur. Më vonë po atë ditë, Ai iu shfaq Pjetrit në ose pranë Jerusalemit⁹; dy dishepujve rrugës për në Emaus¹⁰; dhe në mbrëmje 10 Apostujve e të tjerëve, duke u shfaqur papritmas në mes tyre duke thënë: “Shikoni duart e mia dhe këmbët e mia, sepse unë jam. Më prekni dhe shikoni, sepse një frymë nuk ka mish e eshtra, si po shihni se unë kam!”¹¹. Më pas, për t’i bindur me tej “duke qenë se ende nuk besonin prej gëzimit dhe ish-in të çuditur”¹², Ai hëngri një pjesë peshku të pjekur dhe një huall mjalti përpara tyre¹³. Më vonë, Ai i udhëzoi ata: “Do të bëheni dëshmitarët e mi në Jeruzalem dhe në gjithë Judenë, në Samari dhe deri në skajin e dheut”¹⁴.

Përveç këtyre dëshmimeve të vërtetuarra në Jeruzalem, ne kemi shërbesën e

pakrahasueshme të Zotit të ngritur te banorët e lashtë të hemisferës perëndimore. Në tokën Begati, Ai zbriti nga qielli dhe e ftoi turmën e grumbulluar, afro 2.500 veta, që të vinin përpara një e nga një derisa ata të gjithë shkuan përpara duke i vënë duart në gjymtyrët e Tij e duke i ndier gjurmët e gozhdëve në duart dhe këmbët e Tij.¹⁵

“Dhe kur të gjithë shkuan përpara dhe dëshmuan nga vetja e tyre, ata thirrën njëzëri, duke thënë:

‘Hosana! I bekuar qoftë emri i Më të Lartit Perëndi!’ Dhe ata ranë te këmbët e Jezusit dhe e adhuruan atë.”¹⁶

Ringjallja e Krishtit tregon se ekzistenca e Tij është e pavarur dhe e përhershme. “Sepse, sikurse Ati ka jetë në vetvete, kështu ia ka dhënë dhe Birit të ketë jetë në vetvete.”¹⁷ Jezusi tha:

“Prandaj Ati [im] më do, sepse unë e lë jetën time që ta marr përsëri.

Askush nuk mund të ma heqë, por e lë nga vetja; unë kam pushtet ta lë e pushtet ta marr përsëri.”¹⁸

Shpëtimtari nuk varet për jetën nga ushqimi ose uji apo oksigjeni a ndonjë substancë, fuqi apo njeri tjetër. Edhe si Jehova, edhe si Mesia, Ai është i madhërishmi Unë Jam, Perëndia vet-ekzistues.¹⁹ Ai thjesht është dhe do të jetë përgjithnjë.

Me anë të Shlyerjes dhe Ringjalljes së Tij, Jezu Krishti i ka mposhtur të gjitha anët e Rënies. Vdekja fizike do të jetë e përkohshme dhe madje vdekja shpirtërore ka një fund, në atë që të gjithë do të kthehen në praninë e

Perëndisë, të paktën përkohësisht, për t’u gjykuar. Ne mund të kemi mirëbesim e siguri përfundimtare në fuqinë e Tij për ta mposhtur gjithçka tjetër e për të na dhuruar jetë të përjetshme.

“Sepse, ashtu si erdhi vdekja me anë të një njeriu, kështu erdhi dhe ringjallja e të vdekurve me anë të një njeriu.

Ashtu sikur të gjithë vdesin në Adamin, kështu të gjithë do të ngjallen në Krishtin.”²⁰

Në fjalët e Plakut Nill A. Makuell: “Fitorja e Krishtit mbi vdekjen i dha fund gjendjes së vështirë njerëzore. Tani ka vetëm gjendje të vështira vetjake dhe prej tyre gjithashtu ne mund të shpëtohem duke zbatuar mësimet e atij që na shpëtoi nga zhdukja e përgjithshme.”²¹

Duke qenë se i përbushu kërkesat e drejtësisë, Krishti tani hyn në vendin e drejtësisë; ose mund të themi, Ai është drejtësia, pikërisht siç Ai është dashuria.²² Po ashtu, përveç të qenit një Perëndi “i përsosur e i drejtë”, Ai është një Perëndi i përsosur e i mëshirshëm.²³ Ndaj, Shpëtimtari i rregullon të gjitha gjërat. Asnjë padrejtësi në vdekshmëri nuk është e përhershme, madje as vdekja, sepse Ai e rikthen jetën sërish. Asnjë dëmtim, paaftësi, tradhti apo shpërdorim nuk kalon pa u dëmshpërblyer në fund për shkak të drejtësisë dhe mëshirës së Tij përfundimtare.

Në të njëjtën mënyrë, ne jemi të gjithë përgjegjës para Tij për jetën, zgjedhjet dhe veprimet tona, madje edhe për mendimet tona. Për shkak se na ka shëlbuar nga Rënia, jeta jonë në të vërtetë është e Tija. Ai shpalli:

“Vini re, unë ju kam dhënë ungujllin tim dhe ky është ungujlli që ju kam dhënë se unë erdha në botë për të bërë vullnetin e Atit tim, sepse Ati im më dërgoi.

Dhe, Ati im më dërgoi që të mund të ngrihesha në kryq; dhe pasi u ngrita

në kryq, që t'i tërheq të gjithë njerëzit tek unë, që ashtu si unë u ngrita nga njerëzit, ashtu dhe njerëzit të ngrihen nga Ati, që të qëndrojnë para meje për t'u gjykuar për veprat e tyre, qofshin ato të mira ose qofshin ato të liga.”²⁴

Merrni parasysh për një çast rëndësinë e Ringjalljes për zgjidhjen një herë e mirë të identitetit të vërtetë të Jezusit të Nazaretit dhe për përplasjet filozofike dhe pyetjet e mëdha të jetës. Nëse Jezusi në fakt u ringjall me kuptimin e plotë të fjalës, kjo ndiqet patjetër nga fakti se Ai është një qenie hyjnore. Asnjë i vdekshëm i thjeshtë nuk e ka fuqinë brenda vetes që të vijë në jetë përsëri pasi vdes. Për shkak se u ringjall, Jezusi nuk mund të ketë qenë vetëm një marangoz, një mësues, një rabbi apo një profet. Për shkak se u ringjall, Jezusi duhej të ishte një Perëndi, madje Biri i Vetëmlindur i Atit.

Prandaj, ajo që Ai dha mësim është e vërtetë; Perëndia nuk mund të gënjejë.²⁵

Prandaj, Ai ishte Krijuesi i tokës, sikurse Ai tha.²⁶

Prandaj, qielli dhe ferri janë të vërtetë, sikurse Ai dha mësim.²⁷

Prandaj, ka një botë shpirtrash që Ai e vizitoi pas vdekjes së Tij.²⁸

Prandaj, Ai do të vijë përsëri sikurse thanë engjëjt²⁹ dhe “do të mbretërojë personalisht mbi tokë”.³⁰

Prandaj, ka një ringjallje dhe një gjykim përfundimtar për të gjithë.³¹

Për shkak se Ringjallja e Krishtit është realitet, dyshimet rreth plotfuqisë, gjithëdijenisë dhe mirëdashjes së Perëndisë, Atit – i cili dha Birin e Tij të Vetëmlindur për shëlbimin e botës – janë të pabazuara. Dyshimet rreth domethënies dhe qëllimit të jetës janë të pathemelta. Jezu Krishti është në fakt i vetmi emër apo udhë nëpërmjet të cilës njerëzimit mund t'i vijë shpëtimi. Hiri i Krishtit është i vërtetë, duke i siguruar edhe falje, edhe pastrim

mëkatarit të penduar. Besimi është në të vërtetë më tepër sesa përfytyrim apo shpikje psikologjike. Ka të vërtetë themelore e të përbotshme dhe ka standarde të paanshme e të pandryshueshme morale sikurse u dhanë mësim prej Tij.

Prej faktit se Ringjallja e Krishtit është realitet, pendimi për çdo shkelje të ligjit dhe urdhërimeve të Tij, është sa i mundur aq edhe i ngutshëm. Mrekullitë e Shpëtimtarit ishin të

vërteta, ashtu siç është premtimi i Tij ndaj dishepujve të Tij që ata të mund të bënin vepra të njëjta e madje edhe më të mëdha.³² Priftëria e Tij është patjetër një fuqi e vërtetë që “administron ungjillin dhe mban çelësin e mistereve të mbretërisë, madje çelësin e diturisë së Perëndisë. Si rrjedhim, në ordinancat e saj, fuqia e perëndishmërisë manifestohet.”³³ Prej faktit se Ringjallja e Krishtit është realitet, vdekja nuk është fundi ynë dhe megjithëse





“mbas shkatërr[imit] të [trupave tanë], në mishin [tonë ne do ta shohim] Perëndinë”³⁴.

Presidenti Tomas S. Monson tregon për një Robert Bletçford, i cili 100 vite më parë “në librin e tij *God and My Neighbor* [Perëndia dhe i Afërmi Im], sulmoi me forcë bindjet e pranuar të krishtera të tilla si Perëndia, Krishti, lutja dhe pavdekshmëria. Ai pohoi me guxim: ‘Pretendoj se e kam vërtetuar gjithçka që kam pasur për qëllim të vërtetoi, aq plotësisht dhe vendosmërisht, sa asnjë i krishterë, sado i zoti apo i aftë qoftë ai, nuk mund t’u përgjigjet argumenteve të mia apo të ma hedhë poshtë çështjen.’ Ai e rrethoi veten me një mur skepticizmi. Pastaj ndodhi diçka e habitshme. Muri i tij papritmas u shkrëmoq në pluhur. . . . Ngadalë, ai filloi të ndiente rrugën e kthimit për te besimi që e kishte përçmuar e përçesur. Çfarë e kishte shkaktuar këtë ndryshim të thellë në pikëpamjen e tij? *Bashkëshortja e tij [k ishte] vdekur*. Me zemër të thyer ai shkoi në dhomën ku qëndronte gjithçka që qe e vdekshme prej saj. Ai pa përsëri fytyrën që e deshte aq shumë. Duke dalë, ai i tha një miku: ‘Ajo është dhe prapëseprapë nuk është. Gjithçka ka ndryshuar. Diçka që qe atje më parë, është zhdukur. Ajo nuk është e njëjta. Çfarë mund të ketë ikur përveç shpirtit?’”³⁵

A vdiq dhe u ngrit përsëri me të vërtetë Zoti? Po. “Parimet themelore të besimit tonë janë dëshmia e Apostujve dhe Profetëve në lidhje me Jezu Krishtin, që Ai vdiq, u varros, u ngrit sërish ditën e tretë dhe u ngjit në qiell, dhe gjithë gjërat e tjera që i përkasin besimit tonë janë vetëm shtojca të kësaj.”³⁶

Teksa afrohej lindja e profetizuar e Jezusit, kishte nga ata mes popujve të lashtë nefitë e lamanitë që besonin, edhe pse shumica dyshonin. Më në fund, shenja e lindjes së Tij mbërriti – një ditë e një natë dhe një ditë pa errësirë – dhe të gjithë e kuptuan.³⁷ Madje kështu edhe sot, disa besojnë në Ringjalljen e vërtetë të Krishtit dhe shumë dyshojnë ose nuk besojnë. Por disa e dinë. Në fund, të gjithë do të shohin dhe të gjithë do ta dinë; vërtet “çdo gju do të gjuhëzohet dhe çdo gjuhë do të pohojë para tij”³⁸.

Deri atëherë, unë i besoj dëshmitarët e shumtë të Ringjalljes së Shpëtimtarit, përvojat dhe dëshmitë e të cilëve gjenden në Dhiatën e Re – Pjetrin dhe shokët e tij nga Të Dymbëdhjetët dhe Maria Magdalenën e dashur e të pastër, mes të tjerëve. I besoj dëshmitë që gjenden në Librin e Mormonit – të Apostullit Nefi me turmën pa emër në tokën Begati, mes të tjerëve. Dhe i besoj dëshmisë së Jozef Smithit dhe Sidni Rigdonit

të cilët, pas shumë dëshmish të tjera shpallën dëshminë e madhërishme të kësaj periudhe të fundit ungjillore “se ai jeton! Sepse ne e pamë atë.”³⁹ Nën vështrimin e syrit të tij gjithçka-parës, qëndroj vetë si një dëshmitar se Jezusi i Nazaretit është Shëlbuesi i ringjallur dhe dëshmoj për gjithçka që rrjedh nga *fakti* i Ringjalljes së Tij. E marrshi bindjen dhe ngushëllimin e po të njëjtës dëshmi, lutem unë, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Lluca 24:5–7.
2. Mateu 28:6–7.
3. Gjoni 20:2.
4. Gjoni 20:5, 7.
5. Gjoni 20:8, 9.
6. Gjoni 20:13.
7. Gjoni 20:15.
8. James E. Talmage, *Jesus the Christ*, bot. i 3-të (1916), f. 681.
9. Shih Lluca 24:34; 1 Korintasve 15:5.
10. Shih Marku 16:12; Lluca 24:13–35.
11. Lluca 24:39.
12. Lluca 24:41.
13. Shih Lluca 24:42–43.
14. Veprat e Apostujve 1:8.
15. Shih 3 Nefi 11:14–15.
16. 3 Nefi 11:16–17.
17. Gjoni 5:26.
18. Gjoni 10:17–18.
19. Shih Eksodi 3:14.
20. 1 Korintasve 15:21–22.
21. *The Neal A. Maxwell Quote Book*, red. Cory H. Maxwell (1997), f. 287.
22. Shih 1 Gjoni 4:8.
23. Alma 42:15; shih edhe Mosia 15:8–9.
24. 3 Nefi 27:13–14.
25. Shih Enosi 1:6.
26. Shih, për shembull, 3 Nefi 9:15.
27. Shih, për shembull, Doktrina e Besëlidhje 76.
28. Shih Doktrina e Besëlidhje 138.
29. Shih Veprat e Apostujve 1:10–11.
30. Nenet e Besimit 1:10; shih edhe Udhëzuesin Tematik, “Jezu Krishti, Mbretërim Mijëvjeçar.”
31. Shih, për shembull, 2 Nefi 9:15.
32. Shih Gjoni 14:12.
33. Doktrina e Besëlidhje 84:19–20.
34. Jobit 19:26.
35. Thomas S. Monson, “I Know That My Redeemer Lives!” *Liahona*, maj 2007, f. 23.
36. *Mësimet e Presidentëve të Kishës: Jozef Smith* (2007), f. 52.
37. Shih 3 Nefi 1:15–20.
38. Mosia 27:31.
39. Doktrina e Besëlidhje 76:22–23.



Nga Presidenti Tomas S. Monson

Kur Prapë të Takohemi

Shpirti që kemi ndier gjatë këtyre dy ditëve të kaluara, qoftë dhe banoftë me ne ndërsa kryejmë ato gjëra që na angazhojnë çdo ditë.

Vëllezër e motra të dashura, çfarë konference e mrekullueshme ka qenë kjo! Jemi ushqyer shpirtërisht ndërsa kemi dëgjuar fjalët e frymëzuara të burrave dhe grave që na kanë folur. Muzika ka qenë madhështore, mesazhet janë përgatitur dhe paraqitur nën nxitjet e Shpirtit të Shenjtë dhe lutjet na kanë afruar me qiellin. Ne jemi lartësuar shpirtërisht në çdo mënyrë ndërsa kemi marrë pjesë së bashku.

Shpresoj se do ta gjejmë kohën që t'i lexojmë mesazhet e konferencës kur të mundësohen te LDS.org brenda pak ditëve të ardhshme dhe kur të shtypen në numrat e ardhshëm të revistave *Ensign* dhe *Liahona*, sepse

e meritojnë shqyrtimin dhe studimin tonë të kujdesshëm.

E di se bashkoheni me mua për t'u shprehur mirënjohjen tonë të singertë atyre vëllezërve dhe motrave që u liruan nga thirrjet gjatë kësaj konference. Ata kanë shërbyer mirë dhe kanë dhënë kontribute të rëndësishme në punën e Zotit. Përkushtimi i tyre ka qenë i plotë.

Ne kemi mbështetur gjithashtu, duke ngritur duart, vëllezër që janë thirrur në detyra të reja përgjegjësie. U urojmë mirëseardhjen dhe dëshirojmë që ta dinë se mezi po presim të shërbejmë me ta në kauzën e Mësuesit.

Ndërsa përsiatim për mesazhet që kemi dëgjuar, marrshim vendim

që të veprojmë pak më mirë nga sa kemi bërë në të shkuarën. Qofshim të sjellshëm dhe të dashur me ata që nuk ndajnë besimet tona dhe standardet tona. Shpëtimtari solli në këtë tokë një mesazh dashurie dhe vullneti të mirë për të gjithë burrat dhe gratë. E ndjekshim përgjithmonë shembullin e Tij.

Ne përballemi me shumë sfida të rënda në botë sot, por unë ju siguroj se Ati ynë Qiellor është i vëmendshëm ndaj nesh. Ai do të na udhëzojë dhe bekojë ndërsa e vendosim besimin dhe mirëbesimin tonë tek Ai dhe do të na ndihmojë përmes çfarëdo vështirësie që përjetojmë.

Bekimet e qiellit qofshin me secilin prej nesh. Shtëpitë tona u mbushëshin me dashuri e mirësjellje dhe me Shpirtin e Zotit. I ushqefshim vazhdimisht dëshmitë tona të ungjillit, që ato do të jenë një mbrojtje për ne kundrejt goditjeve të kundërshtarit. Shpirti që kemi ndier gjatë këtyre dy ditëve të shkuara, qoftë e qëndroftë me ne ndërsa merremi me gjërat që na angazhojnë çdo ditë dhe u gjendshim gjithmonë duke bërë punën e Zotit.

Unë jap dëshmi se kjo punë është e vërtetë, se Shpëtimtari ynë jeton dhe se Ai e udhëzon dhe e drejton Kishën e Tij këtu mbi tokë. Unë ju lë dëshminë dhe dëshminë time se Perëndia, Ati ynë i Përjetshëm, jeton dhe na do. Ai është me të vërtetë Ati ynë dhe Ai është i çdonjërit dhe i vërtetë. E kuptofshim se sa afër nesh është i gatshëm të vijë Ai, sa larg është i gatshëm të shkojë Ai për të na ndihmuar, dhe se sa shumë na do Ai.

Vëllezërit e motrat e mia, Perëndia ju bekoftë. Paqja e Tij e premtuar qoftë me ju tani dhe gjithmonë.

Ju them lamtumirë derisa prapë të takohemi pas gjashtë muajsh dhe e bëj këtë në emrin e Jezu Krishtit, Zotit dhe Shpëtimtarit tonë, amen. ■





Nga Rozmari M. Uiksom,
Presidente e Përgjithshme e Fillores

Mbajtja e Besëlidhjeve Na Mbron, Na Përgatit dhe Na Fuqizon

Ne jemi gra të të gjitha moshave që kanë bërë besëlidhje, të cilat po ecin në shtegun e vdekshmërisë për t'u kthyer në praninë e Tij.

O, motra, ne ju duam. Ndërkohë që vizitoja Meksikën së fundi, përjetova pakëz nga motëria që po ndiejmë të gjitha sonte. Përfytyrojeni këtë skenë: Sapo kishim mbaruar Filloren një të diel në mëngjes dhe fëmijët, mësuesit dhe unë, po përhapshim në korridorin e ngjeshur nga njerëzit. Pikërisht atëherë, u hap dera e klasës së Të Rejave, dhe unë pashë të rejtat dhe udhëheqëset e tyre. Ne të gjitha u zgjatëm për një përqaftim. Me fëmijët që kapeshin pas fundit tim dhe gratë aq përreth meje, dëshiroja t'i shprehja ndjenjat që pata pikërisht në atë çast.

Nuk e flas spanjishten, ndaj, në mendje më erdhën vetëm fjalë në anglisht. I pashë fytyrat e të gjithave dhe thashë: “Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor, i cili na do ne dhe ne e duam Atë”. Të gjitha m'u bashkuan menjëherë në spanjisht. Ja ku ishim, në një korridor të mbushur plot, duke

recituar së bashku temën e Të Rejave teksa thoshim: “Ne do të [qëndrojmë] si dëshmitar[e] të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet”.

Sonte, ne mbledhemi së bashku kudo nëpër botë, si dishepullet e

Tij, me një dëshirë për ta mbrojtur e përkrahur mbretërinë e Perëndisë. Ne jemi bija të Atit tonë Qiellor. Ne jemi gra të të gjitha moshave që kanë bërë besëlidhje, të cilat po ecin në shtegun e vdekshmërisë për t'u kthyer në praninë e Tij. Mbajtja e besëlidhjeve na mbron, na përgatit dhe na fuqizon.

Ka vajza mes nesh sonte që janë në moshën e Fillores. Disa prej jush, së fundi, e keni hedhur atë hap të parë në shtegun drejt jetës së përjetshme me ordinancën e pagëzimit.

Shihni përreth vetes. E ardhmja është e ndritur kur shikoni gra që kanë bërë gjithashtu besëlidhje dhe janë gati t'ju tregojnë rrugën përgjatë shtegut që është përpara.

Nëse jeni 8, 9, 10 ose 11 vjeçe, qoftë [këtu] në qendrën e konferencave, në shtëpinë tuaj apo në një shtëpi mbledhjeje nëpër botë, a do të ngriheni ju lutem? Mirëserdhet në mbledhjen e përgjithshme të grave. Tani, ju lutem të qëndroni të ngritura sepse duam t'ju ftojme të merrni pjesë sonte. Unë do të këndoj nën zë një këngë të Fillores. Sapo ta njihni melodinë, a do të filloni ta këndonin me mua? Tani, ju duhet të këndonin me zë të lartë që t'ju dëgjojnë të gjithë.



Meksiko-Siti, Meksikë

*Mësom' t'ec' në drit'n e dashurisë' Tij;
Mësom' t'i lutem Atit të shtrenjt';
Mësom' t'vërtetën që unë ta di;
Mësom', mësom' të eci në drit'.*

Qëndroni të ngritura, vajza, ndërko-
hë që çdonjëra që është 12 vjeç e lart
të këndojë tani strofën e dytë.

*Eni fëmij', së bashku të mësojm'
Urdh'rimet e tij që rrugën të gjejm'
Në prani të Tij me të të jetojm' –
Gjithmon', gjithmon' në dritë të
shkojm'.¹*

Ajo ishte e bukur. Mund të uleni.
Ju faleminderit.

Si gra të të gjitha moshave, ne ecim
në dritën e Tij. Udhëtimi ynë në shteg
është vetjak dhe i ndriçuar mirë me
dashurinë e Shpëtimtarit.

Ne hymjë në portën e shtegut të
jetës së përjetshme me ordinancën
dhe besëlidhjen e pagëzimit dhe më
pas, marrim dhuratën e Frymës së
Shenjtë. Plaku Robert D. Hejls na pyet:
“A e kuptojmë [ne] dhe a e kuptojnë
fëmijët [tanë] se kur [ne] pagëzohemi
[ne] ndryshohemi përgjithnjë?”

Ai shpjegoi edhe se “kur ne e kup-
tojmë besëlidhjen tonë të pagëzimit
dhe dhuratën e Frymës së Shenjtë, ajo
do të na e ndryshojë jetën dhe do të
krijojë besnikërinë tonë të plotë ndaj
mbretërisë së Perëndisë. Kur hasim
në tundime, nëse do të dëgjojmë,
Fryma e Shenjtë do të na kujtojë se
kemi premtuar ta kujtojmë Shpëtim-
tarin dhe t'u bindemi urdhërimeve të
Perëndisë.”²

Çdo javë, teksa i marrim simbolet
e sakramentit, ne e përtërijmë be-
sëlidhjen tonë të pagëzimit. Plaku
Dejvid A. Bednar tha: “Kur qëndrojmë
në ujërat e pagëzimit, ne shohim drejt
tempullit. Kur marrim sakramentin, ne
shohim drejt tempullit. Ne zotohemi ta
kujtojmë gjithmonë Shpëtimtarin dhe



t'i mbajmë urdhërimeve të Tij si përgatit-
je për të marrë pjesë në ordinancat e
shenjtë të tempullit.”³

Ordinancat e tempullit çojnë
drejt bekimeve më të shkëlqyera që
gjenden nëpërmjet Shlyerjes së Jezu
Krishtit. Ato janë ato ordinanca të ne-
vojshme për ekzaltimin tonë në mbre-
tërinë çelestiale. Teksa mundohemi t'i
mbajmë besëlidhjet tona, ndjenjat tona
të papërshtatmërisë dhe papërsosur-
isë fillojnë të zhduken, ndërkohë që
ordinancat dhe besëlidhjet e tempullit
marrin jetë. Gjithkush është i mirëpritur
të ecë në atë shteg drejt jetës së
përjetshme.

Jam e mahnitur nga forca e vajza-
ve, të rejave dhe grave që kam takuar
nëpër botë, këmbët e të cilave janë
ngulur vendosmërisht në këtë shteg.
Më lini t'ju tregoj disa shembuj vajzash
e grash të besëlidhjes që kam takuar.

Luana ishte 11 vjeçe kur vizito-
va familjen e saj në Buenos-Ajres të
Argjentinës. Për shkak të një ndodhie
tronditëse në fëmijërinë e saj, Luana
nuk mund të fliste. Ajo nuk kishte
folur prej vitesh. Ajo qëndronte e ulur

në heshtje teksa ne të gjithë bisedo-
nim. Vazhdoja të shpresoja qoftë edhe
për një pëshpërimë prej saj. Ajo më
shihte me përqendrim, sikur shqiptimi
i fjalëve të mos ishte i nevojshëm për
mua që t'ia njihja zemrën. Pas një lut-
jeje, ne u ngritëm për t'u larguar dhe
Luana më dha një vizatim. Ajo kishte
vizatuar Jezu Krishtin në kopshtin e
Gjetsemanit. Atëherë, unë e dallova
dëshminë e saj të fortë e të qartë.
Luana kishte bërë një besëlidhje në
pagëzim që të qëndronte si dëshmi-
tare e Perëndisë “në të gjitha kohërat
dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha
vendet”⁴. Ajo e kuptonte Shlyerjen e
Jezu Krishtit, gjë që u dëshmuar nëpër-
mjet vizatimit të saj. A kishte arritur
ajo ta dinte se, nëpërmjet forcimit dhe
fuqisë mundësuese të Shlyerjes, ajo
mund të shërohej e të fliste përsëri?
Që nga ajo ditë e tre viteve më parë,
Luana ka përparuar në përpjekjen e
saj për të folur. Ajo tani po merr pjesë
tek Të Rejat me shoqet e saj. Besnike
ndaj besëlidhjes që bëri në pagëzim,
ajo vazhdon ta japë dëshminë e saj
për Shpëtimtarin.

Të rinjtë nga e gjithë bota tërhiqen nga tempujt. Në Limë të Perusë, takova një baba dhe tri nga bijat e tij jashtë hyrjes së tempullit. E pashë dritën në fytyrat e tyre. Dy nga bijat ishin me aftësi të kufizuara ndjeshëm dhe ishin të ulura në karrige me rrota. Bija e tretë, ndërkohë që kujdesej për nevojat e motrave, shpjegoi se kishte edhe dy motra të tjera në shtëpi. Edhe ato ishin në karrige me rrota. Ato nuk ishin në gjendje të udhëtonin 14 orë për në tempull. Tempulli kishte kaq shumë domethënie për këtë baba dhe bijat e tij, sa që ata të katërt kishin ardhur në tempull atë ditë – dy prej tyre thjesht për të vëzhguar atë që mund të pagëzohej për të vdekurit e të kryente atë ordinancë të shenjtë. Sikurse Nefi, ato “kënaq[shin] në besëlidhjet [e] Zotit[t]”.⁵

Një grua beqare që njoh, e vlerëson ordinancën javore të sakramentit dhe premtimin e shenjtë të saj “që [ajo] të mund të ke[të] gjithmonë Shpirtin e Tij me [të]”⁶. Ai shoqërim i vazhdueshëm është një premtim që i zbut dallgët e vetmisë së saj. I jep asaj forcë për ta zhytur veten në zhvillimin e talenteve të saj dhe një dëshirë për t’i shërbyer Zotit. Ajo ka gjetur gëzim të madh te dashuria e madhe për të gjithë fëmijët e saj dhe kur ajo kërkon paqe prehëse, ju do ta gjeni në tempull.

Së fundi, një grua e moshuar në të 90-tat e saj i ka parë fëmijët dhe nipërit e mbesat e saj të rriten dhe stërnipërit e stërmbesat e saj të vijnë në botë. Si shumë prej nesh, ajo ka pasur një jetë të mbushur me hidhërimi, vuajtje e gëzim të papërshkrueshëm. Ajo rrëfen se po ta rishkruante historinë e

jetës së saj, nuk do të kishte zgjedhur të përfshinte disa prej kapitujve që janë shkruar. Prapëseprapë, me një buzëqeshje, ajo thotë: “Duhet të jetoj edhe pak më gjatë e të shikoj se si do të shkojë e gjithë kjo!” Ajo vazhdon të kapet fort pas besëlidhjeve në shteg.

Nefi dha mësim:

“Pasi ju të keni hyrë në këtë shteg të ngushtë dhe të ngushtuar, unë do t’ju pyesja nëse gjithçka është bërë? Vini re, unë ju them juve, Jo; . . .

Kështu që, ju duhet të shkoni përpara me një vendosmëri në Krisht, duke pasur një ndriçim të përkryer të shpresës dhe një dashuri për Perëndinë dhe për gjithë njerëzit. Prandaj, në qoftë se ju do të shkoni përpara, duke u ushqyer me bollëk mbi fjalën e Krishtit dhe të duroni deri në fund, vini re, kështu thotë Ati: Ju do të keni jetën e përjetshme.”⁷

Secila prej nesh është në atë shteg. Sonte, ne kënduam rreth ecjes në dritë nëpër shteg. Si individë, ne jemi të forta. Së bashku me Perëndinë, ne jemi të pandalshme.

Zoti i tha Ema Smithit: “Prandaj, gëzohu në zemrën tënde e ngazëllehu dhe kapu pas besëlidhjeve që ke bërë”.⁸

Gëzohemi që, nëpërmjet mbajtjes së besëlidhjeve tona, ne mund të ndiejmë dashurinë e Atit tonë Qiellor dhe të Shpëtimtarit tonë, Jezu Krishtit. Unë dëshmoj se Ata jetojnë. Në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. “Mësom’ t’Ec’ në Drit’”, *Himne dhe Këngë të Fëmijëve* f. 66; ose *Children’s Songbook*, f. 177.
2. Robert D. Hales, “The Covenant of Baptism: To Be in the Kingdom and of the Kingdom”, *Liahona*, janar 2001, f. 8, 7.
3. Dejvid A. Bednar, “Me Nder do të Mbajë një Emër e Qëndrim”, *Liahona*, maj 2009, f. 98.
4. Mosia 18:9.
5. 2 Nefi 11:5.
6. Doktrina e Besëlidhje 20:77.
7. 2 Nefi 31:19–20.
8. Doktrina e Besëlidhje 25:13.





Nga Boni L. Oskarson,
Presidente e Përgjithshme e Të Rejave

Motëria: O, Sa Nevojë Kemi për Njëra-Tjetrën!

Ne duhet të ndalojmë së përqendruari në dallimet tona dhe të kërkojmë atë që kemi të përbashkët.

Në atë video ne pamë tetë vende dhe dëgjua nëntë gjuhë të ndryshme. Përfytyroni se sa shumë gjuhë u shtuan në atë varg të fundit. Është drithëruese të dimë se, si një motëri mbarëbotërore, ne jemi në gjendje t'i ngremë zërat tanë në dëshmi për të vërtetën e përgjithshme se ne jemi bija të një Ati të dashur Qiellor.

Çfarë privilegji i madh është të jesh këtu në këtë rast historik dhe t'u drejtohesh të gjitha grave të Kishës, nga mosha tetë vjeç e lart. Ka një fuqi të jashtëzakonshme në bashkimin tonë këtë mbrëmje. Ndërsa e shoh çdo-njërin prej nesh që jemi mbledhur së bashku në Qendrën e Konferencave dhe kur mendoj për mijëra të tjera që po e shohin këtë transmetim satelitor nga vendndodhje në mbarë botën, fuqia e ndërthurur e dëshmiave dhe e besimit tonë te Jezu Krishti përbën me siguri një nga asambletë e mbushura me më shumë besim dhe më të fuqishme të grave në historinë e Kishës, në mos në historinë e botës.

Sonte ne u gëzohemi roleve tona të shumta e të ndryshme si gra në Kishë. Megjithatë jemi të ndryshme dhe të pashoqe në shumë mënyra, ne gjithashtu e pranojmë se jemi të gjitha

bija të të njëjtit Atë Qiellor, gjë që na bën motra. Ne jemi të bashkuara në ndërtimin e mbretërisë së Perëndisë dhe në besëlidhjet që kemi bërë, pavarësisht rrethanave tona. Kjo asamble e bashkuar është, pa dyshim, motëria më e lavdishme mbi faqen e tokës!¹

Të qenit motra nënkupton se ka një lidhje të pathyeshme midis nesh. Motrat kujdesen për njëra-tjetrën, i mbajnë sytë hapur për njëra-tjetrën, e ngushëllojnë njëra-tjetrën dhe janë atje për njëra-tjetrën, në të mirë e në të

keqe. Zoti ka thënë: “Unë ju them, jini një; dhe nëse nuk jeni një, nuk jeni të mitë”².

Kundërshtari do të donte që ne të ishim kritikuese ose gjykuese ndaj njëra-tjetrës. Ai dëshiron që ne të përqendrohemi te ndryshimet tona dhe ta krahasojmë veten tonë me njëra-tjetrën. Juve mund t'ju pëlqejë shumë të stërviteni fuqimisht për një orë çdo ditë sepse ju bën të ndiheni mirë, ndërsa unë e konsideroj një ngjarje atletike të madhe nëse hipi shkallët e një kati në vend që të marr ashensorin. Ne, prapëseprapë, mund të jemi mikështa, apo jo?

Ne si gra mund të jemi veçanërisht të ashpra me veten tonë. Kur e krahasojmë veten tonë me njëra-tjetrën, ne gjithmonë do të ndihemi të papërshtatshme ose të zemëruara me të tjerat. Motra Patricia T. Holland një herë tha: “Çështja është, që ne thjesht nuk mund ta quajmë veten të krishterë dhe të vazhdojmë ta gjykojmë njëra-tjetrën – ose veten tonë – kaq ashpër.”³ Ajo vazhdon të thotë se nuk ka asgjë për të cilën ia vlen të humbasim dhembshurinë e motërinë tonë. Ne thjesht duhet të qetësohemi



Sidnei, Australi



dhe t'iu gëzohemi ndryshimeve tona hyjnore. Ne duhet të kuptojmë se të gjitha ne dëshirojmë të shërbejmë në mbretëri duke i përdorur talentet e dhuratat tona të veçanta në mënyrën tonë. Atëherë ne mund t'iu gëzohemi motërisë sonë dhe shoqëri me tona e të fillojmë të shërbejmë.

Fakti është që vërtet dhe sinqerisht ne kemi nevojë për njëra-tjetrën. Gratë natyrisht kërkojnë miqësi, mbështetje dhe shoqërim. Ne kemi kaq shumë për të mësuar nga njëra-tjetra dhe shpesh i lemë pengesat e vendosura vetë që të na largojnë nga gëzimi i shoqëri meve, të cilat mund të jenë midis bekimeve më të mëdha në jetën tonë. Për shembull, ne gratë që jemi pak më të moshuara, kemi nevojë për atë që ju vajza në moshën e Fillores keni për të dhënë. Ne mund të mësojmë shumë nga ju rreth shërbimit dhe dashurisë si të Krishtit.

Kohët e fundit dëgjova një histori të mrekullueshme rreth një vajze të vogël të quajtur Sara, nëna e së cilës pati mundësinë të ndihmonte një grua tjetër në lagjen e saj të quajtur Brenda, e cila kishte sklerozë të shumëfishtë. Sarës i pëlqente shumë që pas shkolle të shkonte me nënën e saj për ta ndihmuar Brendën. Ajo vendoste krem në duart e Brendës dhe i fërkonte gishtat e krahët e saj, sepse ajo kishte vazhdimisht dhembje. Më pas Sara mësoi t'i shtrinte butësisht krahët e Brendës mbi kokën e saj për të stërvitur

muskujt e saj. Sara i krihte flokët Brendës dhe bisedonte me të ndër-sa nëna e saj kujdesej për nevoja të tjera të saj. Sara mësoi rëndësinë dhe gëzimin e shërbimit ndaj një individi tjetër dhe arriti të kuptonte se edhe një fëmijë mund të sjellë një ndryshim të madh në jetën e dikujt.

E dua shembullin që kemi në kapitullin e parë të Llukës, i cili përshkruan marrëdhënien e mrekullueshme midis Maries, nënës së Jezusit, dhe kushërirës së saj Elizabeta. Maria ishte një e re kur u njoftua për misionin e saj të mrekullueshëm për të qenë nëna e Birit të Perëndisë. Në fillim, duhet të jetë dukur si një përgjegjësi e rëndë për t'u mbajtur vetëm. Ishte Zoti Vetë që i siguroi Maries dikë me të cilin ajo mund ta ndante barrën e saj. Nëpërmjet mesazhit të engjëllit Gabriel, Maries iu dha emri i një gruaje të besuar dhe dashamirëse tek e cila ajo mund të drejtohej për mbështetje – kushërira e saj Elizabeta.

Kjo vajzë e re dhe kushërira e saj, e cila qe e "kaluar në moshë"⁴, përjetuan një lidhje të përbashkët në shtatzënitë e tyre të mrekullueshme dhe unë mundem vetëm ta përfytyroj se sa të rëndësishme qenë për të dyja ato tre muajt e kaluar së bashku, ndërsa ishin në gjendje të bisedonin së bashku, të kishin dhembshuri për njëra-tjetrën dhe ta mbështetnin njëra-tjetrën në thirrjet e tyre të pashembullta. Çfarë shembulli i mrekullueshëm

që janë për femrat e brezave të ndryshëm që ushqejnë njëra-tjetrën.

Ato prej nesh që janë pak më të pjekura, mund të kenë një ndikim të jashtëzakonshëm te brezat më të rinj. Kur nëna ime ishte vetëm një vajzë e vogël, asnjëri prej prindërve të saj nuk qe aktiv në Kishë. Madje në moshën e njomë pesëvjeçare, ajo ecte vetëm për në kishë dhe mernte pjesë në mbledhjet e saj – Filloren, Shkollën e së Dielës dhe mbledhjen e sakramentit – të gjitha në orare të ndryshme.

Kohët e fundit e pyeta nënën time se përse ajo e bënte këtë javë pas jave, kur nuk kishte mbështetje ose nxitje në shtëpi. Përgjigja e saj qe: "Kisha mësuese të Fillores që më donin". Këto mësuese u kujdesën për të dhe i mësuan asaj ungjillin. Ato i mësuan asaj se ajo kishte një Atë në Qiell që e donte, dhe ishte shqetësimi i tyre për të që e shtyu atë të vinte javë pas jave. Nëna ime më tha: "Ai ishte një nga ndikimet më të rëndësishme në jetën time të hershme". Shpresoj që ndonjë ditë të mund t'i falënderoj ato motra të mrekullueshme! Nuk ka pengesa moshe kur vjen puna për shërbim si të Krishtit.

Dy javë më parë, takova një presidente të Të Rejave të kunjtit në Kaliforni, e cila më tha se nëna e saj 81-vjeçare qe thirrur kohët e fundit për të qenë një këshilltare e Trëndafilleve. U bëra kaq kureshtarë, sa e mora në telefon të ëmën e saj. Kur peshkopi i motrës Val Bejkër kërkoi që të takohej me të, ajo mezi po priste që të thirrej si bibliotekare ose historiane e lagjes. Kur ai i kërkoi që të shërbente si këshilltare e Trëndafilleve te Të Rejat, reagimi i saj qe: "A je i sigurt?"

Peshkopi i saj u përgjigj me seriozitet: "Motra Bejkër, mos të të gënjejë mendja; kjo thirrje është nga Zoti".

Ajo tha se nuk kishte përgjigje tjetër për atë përveçse "Sigurisht".

Më pëlqen shumë frymëzimi që ndjeu ky peshkop, se të katra Trëndafilët në lagjen e tij kanë shumë për të mësuar nga urtësia, përvoja dhe shembulli i vazhdueshëm i kësaj motre të pjekur. Dhe gjejeni se ku do të shkojë Motra Bejkër kur të ketë nevojë të hapë faqen e saj në Facebook?

Mendoj për ndihmën e madhe që mund të jenë motrat në Shoqatën e Ndihmës, në mirëpritjen e motrave të reja që deri së fundi kanë qenë te Të Rejat. Motrat tona të reja shpesh ndihen sikur nuk e kanë vendin ose nuk kanë asgjë të përbashkët me ato në Shoqatën e Ndihmës. Përpara se të bëhen 18 vjeçe, ato kanë nevojë për udhëheqëse të Të Rejave dhe nëna që do të dëshmojnë plot gëzim për bekimet e mëdha të Shoqatës së Ndihmës. Ato kanë nevojë të ndihen entuziaste rreth të bërit pjesë në një organizatë të tillë të lavdishme. Kur të rejat fillojnë të marrin pjesë në Shoqatën e Ndihmës, ajo për të cilën kanë më shumë nevojë, është një mikeshë me të cilën të mund të ulen afër, një dorë mbi supë dhe një mundësi për të dhënë mësim e për të shërbyer. Të gjitha ne, le ta shtrijmë dorën për ta ndihmuar njëra-tjetrën përgjatë periudhave kalimtare dhe domethënëse të jetës sonë.

Faleminderit të gjitha grave të Kishës të cilat po ndihmojnë, pavarësisht moshës dhe kulturës për t'i bekuar dhe për t'u shërbyer të tjerëve. Të rejat janë duke u shërbyer fëmijëve të Filllores dhe të moshuarve. Motrat beqare të të gjitha moshave kalojnë orë pafund duke u kujdesur për nevojat e atyre përreth. Ne e dimë se mijëra të reja po japin 18 muaj nga jeta e tyre për ta ndarë ungjillin me botën. Të gjitha këto gjëra janë prova se, siç e thotë himni ynë i dashur: "Dhe puna e engjëjve u jepet grave"⁵.

Nëse ka pengesa, është sepse ne vetë i kemi krijuar ato. Ne duhet të



Vienë, Austri

ndalojmë së përqendruari në ndryshimet tona dhe të kërkojmë atë që kemi të përbashkët; atëherë ne mund të fillojmë të kuptojmë potencialin tonë më të madh dhe të arrijmë të mirën më të madhe në këtë botë. Motra Marxhori P. Hinkli një herë tha: "O, sa nevojë kemi për njëra-tjetrën! Ato prej nesh që janë të moshuara, kanë nevojë për ju që jeni të reja. Dhe shpresojmë se ju që jeni të reja, të keni nevojë për disa prej nesh që janë të moshuara. Është një fakt sociologjik, që gratë kanë nevojë për gratë. Ne kemi nevojë për miqësi të thella dhe përmbushëse e besnike me njëra-tjetrën."⁶ Motra Hinkli kishte të drejtë; o, sa nevojë kemi për njëra-tjetrën!

Motra, nuk ka një grup tjetër të grave në botë që të ketë qasje ndaj bekimeve më të madhërishme siç kemi ne si gra shenjtoreshë të ditëve të mëvonshme. Ne jemi anëtare të Kishës së Zotit dhe pavarësisht rrethanave tona individuale, të gjitha ne mund t'i gëzojmë bekimet e plota të fuqisë së priftërisë nëpërmjet mbajtjes së besëlidhjeve që kemi bërë në pagëzim e në tempull. Ne kemi profetë të gjallë për të na udhëhequr e mësuar dhe gëzojmë dhuratën e madhe të Frymës së Shenjtë, i cili shërben si një ngushëllim dhe udhërrëfyes në jetën tonë. Ne jemi bekuar të punojmë krah për krah me vëllezër të drejtë ndërsa forcojmë shtëpitë dhe familjet. Ne kemi qasje ndaj forcës e fuqisë së

ordinancave të tempullit dhe shumë më tepër se kaq.

Përveç gëzimit të të gjitha këtyre bekimeve mahnitëse, ne kemi njëra-tjetrën – motra në ungjillin e Jezu Krishtit. Ne jemi bekuar me natyra të buta dhe mirëbërëse, të cilat na bëjnë të mundur t'u japim dashuri dhe shërbim si të Krishtit atyre përreth nesh. Ndërsa shohim përtej ndryshimeve në moshë, kulturë dhe rrethana për ta ushqyer [shpirtërisht] dhe për t'i shërbyer njëra-tjetrës, ne do të mbushemi me dashurinë e pastër të Krishtit dhe frymëzimin i cili na udhëheq për të ditur se kur dhe kujt t'i shërbejmë.

Unë ju jap një ftesë që u dha një më herë më parë nga një presidente e përgjithshme e Shoqatës së Ndihmës, e cila tha: "Ju ftoj që jo vetëm ta doni njëra-tjetrën më shumë, por ta doni njëra-tjetrën *më mirë*"⁷. E kuptofshim se sa shumë nevojë kemi për njëra-tjetrën dhe të gjitha [mësofshim] ta duam njëra-tjetrën më mirë, është lutja ime, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih Barbara B. Smith, "The Bonds of Sisterhood", *Ensign*, mars 1983, f. 20–23.
2. Doktrina e Besëlidhjeve 38:27.
3. Patricia T. Holland, "One Thing Needful: Becoming Women of Greater Faith in Christ", *Ensign*, tetor 1987, f. 29.
4. Lluca 1:7
5. "As Sisters in Zion", *Hymns*, nr. 309.
6. *Glimpses into the Life and Heart of Marjorie Pay Hinckley*, bot. Virginia H. Pearce (1999), f. 254–255.
7. Bonnie D. Parkin, "Choosing Charity: That Good Part", *Liahona*, nëntor 2003, f. 106.



Nga Linda K. Barton,
Presidente e Përgjithshme e Shoqatës së Ndhmës

Kërkohen: Duar dhe Zemra për Përsheptimin e Punës

Ne mund të japim duar për të ndihmuar dhe zemra për ta përsheptuar punën e mrekullueshme të Atit Qiellor.

Motra të dashura, sa shumë ju duam! Teksa pamë atë video të bukur, a e patë dorën tuaj të zgjatej për të ndihmuar dikë përgjatë atij shtegu të besëlidhjes? Po mendoja për një vajzë të vogël të Fillores, të quajtur Brin, e cila ka vetëm një dorë, dhe prapëseprapë ajo e përdor atë dorë për të ndihmuar në bekimin e familjes së saj dhe të miqve të saj – shenjtorë të ditëve të mëvonshme dhe ata të feve të tjera. A nuk është e bukur ajo? Po kështu jeni dhe ju! Motra, ne mund të japim duar për të ndihmuar dhe zemra për ta përsheptuar punën e mrekullueshme të Atit Qiellor.

Ashtu si motrat tona besnike në shkrimet e shenjta, të tilla si Eva, Sara, Maria dhe shumë të tjera, e njihnin identitetin dhe qëllimin e tyre, Brini e di se është një bijë e Perëndisë.¹ Edhe ne mund ta njohim trashëgiminë tonë hyjnore si bija të dashura të Perëndisë dhe punën jetësore që Ai ka për ne.

Shpëtimtari dha mësim: “Në qoftë se dikush don të bëjë vullnetin e tij, do ta njohë [këtë] doktrinë”². Çfarë duhet

të dimë dhe të bëjmë që “të rroj[më] me të në qiej”³? Ne mund të mësojmë nga historia e të riut pasanik, i cili e pyeti Jezusin se çfarë duhej të bënte që të merrte jetën e përjetshme.

Jezusi iu përgjigj: “Në qoftë se ti don të hysh në jetë, zbato urdhërimet”.

I riu e pyeti Atë se cilat duhej të mbante. Jezusi atëherë e kujtoi për



disa prej Dhjetë Urdhërimeve, të cilat të gjitha i njohim mirë.

I riu u përgjigj: “Të gjitha këto gjëra unë i kam zbatuar që në rini; çfarë më mungon tjetër?”

Jezusi i tha: “Në qoftë se do të jesh i përsosur, shko, shit ç’të kesh, jepua të varfërve dhe ti do të kesh një thesar në qiell; pastaj eja dhe më ndiq mua”⁴.

Jezusi e thirri që të bëhej pjesë e punës së Tij – punës së një dishepulli. Puna jonë është po kjo. Ne duhet “të lë[më] mënjanë gjërat e kësaj bote, . . . [të kapemi] pas besëlidhjeve [tona]”⁵ dhe të vijmë tek Krishti e ta ndjekim Atë. Kjo është ajo që bëjnë dishepujt!

Tani, motra, le të mos e mendojmë veten ngaqë Shpëtimtari i foli të riut pasanik rreth bërjes të përsosur. Fjala *i përsosur* në këtë rrëfim u përkthye nga një fjalë greke që do të thotë “i plotësuar”. Ndërsa përpiqemi me gjithçka mundemi të ecim përpara nëpër shtegun e besëlidhjes, ne bëhemi më të plotësuar dhe më të përsosura në këtë jetë.

Ashtu si i riu pasanik në kohën e Jezusit, ndonjëherë ne tundo kemi që të heqim dorë ose të kthehemi prapa ngaqë ndoshta mendojmë se nuk mund t’ia dalim vetëm. Dhe ne kemi të drejtë! Ne nuk mund t’i bëjmë pa ndihmë gjërat e vështira që na janë kërkuar të bëjmë. Ndhima vjen nëpërmjet Shlyerjes së Jezu Krishtit, udhëheqjes së Frymës së Shenjtë dhe duarve ndihmëtare të të tjerëve.

Një motër beqare besnike së fundi dëshmoi se, nëpërmjet Shlyerjes, ajo gjeti forcë që t’i përdorte duart e saj ndihmëtare dhe zemrën e saj të gatshme për të rritur katër fëmijët që e motra kishte lënë kur vdiq nga kanceri. Kjo më kujtoi diçka që Plaku Nil A. Maksuell tha: “Të gjitha gjërat e lehta që Kisha duhej të bënte janë bërë. Nga tani e tutje, është aventurë e madhe dhe bindja jonë do të sprovohet në

disa mënyra interesante”⁶. Ju jeni dërguar në tokë në këtë periudhë ungjillore për shkak të njeriut që jeni dhe për atë që jeni përgatitur të bëni! Pavarësisht nga ajo që Satani do të përpiqet të na bëjë të mendojmë rreth asaj se cilat jemi, identiteti ynë i vërtetë është ai i një dishepulle të Jezu Krishtit!

Mormoni ishte një dishepull i vërtetë, i cili jetoi në një kohë kur “çdo zemër u ngurtësua, . . . [dhe] kurrë nuk kishte pasur . . . një ligësi kaq të madhe mes gjithë fëmijëve të Lehit”⁷. A do t’ju pëlqente të kishit jetuar në atë kohë? Dhe prapëseprapë Mormoni shpalli me guxim: “Vini re, unë jam një dishepull i Jezu Krishtit, Birit të Perëndisë”⁸.

A nuk e doni Mormonin? Ai e dinte se kush ishte dhe cili ishte misioni i tij dhe nuk u turbullua nga ligësia që e rrethonte. Në fakt, ai e konsideroi thirrjen e tij një dhuratë.⁹

Mendoni se çfarë bekimi është të thirrëmi për t’i dhënë Zotit dhuratën tonë të të qenit dishepulle çdo ditë, duke shpallur me fjalë dhe vepra: “Vini re, unë jam një dishepull i Jezu Krishtit!”

Më pëlqen historia që Presidenti Bojd K. Paker tregoi për një motër të dashur, të cilën e tallën ngaqë ndoqi këshillën e profetit për të ruajtur ushqime. Ata të cilët e kritikuan, sugjeruan që, nëse vinin kohë të vështira, udhëheqësit e saj do t’i kërkonin që t’i ndante ushqimet e saj të ruajtura me të tjerët. Përgjigjja e saj e thjeshtë dhe e patundur si dishepulle e vërtetë ishte: “Të paktën do të kem diçka për të sjellë”¹⁰.

I dua gratë e Kishës, të reja e të moshuara. Unë e kam parë forcën tuaj. E kam parë besimin tuaj. Ju keni diçka për të dhënë dhe jeni të gatshme ta jepni atë. Ju e bëni këtë pa bujë apo publicitet, duke e tërhequr



Gilbert, Arizonë, SHBA

vëmendjen te Perëndia që ne adhurorjmë, jo te vetja juaj, dhe pa menduar për atë që do të merrni.¹¹ Kjo është ajo që bëjnë dishepujt!

Kohët e fundit takova një të re në Filipine, familja e së cilës u bë më pak aktive në Kishë kur ajo ishte vetëm 7 vjeçe, duke e lënë atë, javë mbas javë, të ecte e vetme për në kishë në një rrugë të rrezikshme. Ajo tregoi se si në moshën 14 vjeçe vendosi që do të qëndronte e vërtetë ndaj besëlidhjeve të saj, në mënyrë që të ishte e denjë për ta rritur familjen e saj të ardhshme në një shtëpi “të bekuar nga fuqia e priftërisë”¹². Mënyra më e mirë për

ta forcuar familjen e tanishme apo të ardhshme, është të mbani besëlidhjet, premtimet që i kemi bërë njëri-tjetrit dhe Perëndisë.

Kjo është ajo që bëjnë dishepujt!

Një motër besnike japoneze dhe bashkëshorti i saj vizituan misionin tonë në Kore. Ajo nuk e fliste gjuhën koreane dhe kishte aftësi të kufizuara për të folur anglisht, por ajo kishte një zemër të gatshme për t’i përdorur dhuratat e saj të rralla dhe duart ndihmëtare për të bërë punën e Zotit. Kjo është ajo që bëjnë dishepujt! Ajo u mësoi misionarëve tanë se si të bënin një copë të thjeshtë origami – një gojë që mund të hapej e mbyllej. Më pas, ajo përdori fjalët e pakta anglisht që dinte për t’u mësuar misionarëve që “t’i hap[an] gojë të tyre” për të shpërndarë ungjillin – një mësim që ata nuk do ta harrojnë kurrë, as edhe unë.

Përfytyrojini për një çast veten dhe mua duke qëndruar së bashku me miliona motra dhe vëllezër të tjerë në Kishën e Tij, duke ecur përpara me guxim, duke bërë atë që bëjnë dishepujt – duke shërbyer dhe duke dashur si Shpëtimtari. Çfarë do të thotë për ju të jesh një dishepulle e Jezu Krishtit?

Jelekët dhe bluzat e Duarve Ndhimëtare Mormone janë veshur nga qindra e mijëra dishepuj vetëmohues të Jezu Krishtit, të cilët e kanë përqaftuar mundësinë për të dhënë shërbim





*Nga mënyra si jetojm', ungjillin
[t'tjer'vej] do ua mësojm'.*

*Me çdo fjal' e veprim, ne do dëshmojm':
Ne besojm' dhe ne Jezu Krishtit
i shërbejm'.¹⁴*

Si dishepulle të vërteta, i dhëncim përherë zemrat tona të gatshme dhe duart tona ndihmëtare për ta përshpejtuar punën e Tij. Nuk ka rëndësi nëse, si Brini, ne kemi vetëm një dorë. Nuk ka rëndësi nëse nuk jemi ende të përsosura dhe të plotësuara. Ne jemi dishepulle të përkushtuara që i japim dorën dhe e ndihmojmë njëra-tjetrën përgjatë udhës. Motëria jonë shtrihet përtej brezave tek ato motra besnike që kanë ecur përpara nesh. Së bashku, si motra dhe në unitet me profetët, shikuesit dhe zbuluesit e gjallë me çelësat e rivendosur të priftërisë, ne mund të ecim të bashkuara në një, si dishepulle, si shërbëtoresh me zemra e duar të gatshme për të përshpejtuar punën e shpëtimit. Teksa e bëjmë këtë, ne vërtet do të bëhemi si Shpëtimtari. Unë dëshmoj kështu, në emrin e Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Shih "Brynn", lds.org/media-library/video/2011-01-007-brynn.
2. Gjoni 7:17.
3. "Fëmi i Per'ndis' Jam", *Himne dhe Këngë të Fëmijëve*, f. 58; ose *Children's Songbook*, f. 2-3.
4. Shih Mateu 19:16-22.
5. Doktrina e Besëlidhje 25:10, 13.
6. Neal A. Maxwell, "The Old Testament: Relevancy within Antiquity" (fjalim drejtuar mësuesve të fesë të Sistemit Arsimor të Kishës, 16 gusht 1979), f. 4; si.lds.org.
7. Mormoni 4:11-12.
8. 3 Nefi 5:13.
9. Shih Moroni 7:2.
10. Te Boyd K. Packer, "The Circle of Sisters", *Ensign*, nëntor 1980, f. 111.
11. Shih 2 Nefi 26:29-30.
12. "Love Is Spoken Here", *Children's Songbook*, f. 190-191.
13. M. Russell Ballard, "Women of Righteousness", *Liahona*, dhjetor 2002, f. 39.
14. "Holding Hands around the World", *Liahona*, tetor 2003, f. 12-13.

fizik. Por ka mënyra të tjera për të shërbyer si dishepuj të përkushtuar. Përfytyrojini me mua disa nga afishet e mundshme shpirtërore që shënojnë "kërkohet ndihmë", të lidhura me punën e shpëtimit:

- Kërkohet ndihmë: prindër që t'i rritin fëmijët e tyre në dritë e të vërtetë
- Kërkohet ndihmë: bija e bij, motra e vëllezër, emta e ungjër, kushërira dhe gjyshër e gjyshe dhe miq të vërtetë për të shërbyer si këshillues dhe për të dhënë një dorë ndihme nëpër shtegun e besëlidhjes
- Kërkohet ndihmë: ata që i dëgjojnë nxitjet e Frymës së Shenjtë dhe veprojnë sipas përshtypjeve që marrin
- Kërkohet ndihmë: ata që e jetojnë ungjillin përditë në mënyra të vogla e të thjeshta
- Kërkohet ndihmë: punonjës të historisë familjare dhe punonjës tempulli për t'i lidhur familjet në përjetësi
- Kërkohet ndihmë: misionarë dhe anëtarë për të përhapur "lajmin e mirë" – ungjillin e Jezu Krishtit

- Kërkohet ndihmë: shpëtues për të gjetur ata që e kanë humbur udhën e tyre
- Kërkohet ndihmë: mbajtës të besëlidhjeve që të qëndrojnë të palëkundur për të vërtetën dhe drejtësinë
- Kërkohet ndihmë: dishepuj të vërtetë të Zotit Jezu Krisht

Vite më parë, Plaku M. Rasëll Ballard nxori një kërkesë të mprehtë drejtuar motrave të Kishës kur tha: "Ndërmjet ditës së sotme dhe ditës kur Zoti do të vijë përsëri, Ai ka nevojë për gra në çdo familje, në çdo lagje, në çdo komunitet, në çdo komb të cilat do të ecin përpara në drejtësi dhe do të thonë me anë të fjalëve dhe veprimeve të tyre: 'Ja ku jam, dërgo-më mua'.

Pyetja ime është: 'A do të jeni një nga ato gra?'¹³

Shpresoj që secila nga ne mund të përgjigjet me një: "Po!" kumbuese. Po e mbyll me fjalët e një kënge të Fillores:

Ne jemi [bija] t'bes'lidhjes me dhuratën për t'dhën'.



Nga Presidenti Henri B. Ajring,
Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë

Bija në Besëlidhje

Shtegu . . . që duhet të ndjekim në udhëtimin tonë për t'u kthyer tek Ati ynë Qiellor, . . . shënohet nga besëlidhje të shenjta me Perëndinë.

Na është dhënë mësim me fuqi shpirtërore sonte. Lutem që fjalët e folura nga këto motra udhëheqëse të madhërisme do të hyjnë në zemrën tuaj, siç kanë hyrë në zemrën time.

Kjo është një mbledhje historike. Të gjitha gratë e Kishës të moshës tetë vjeç e lart janë ftuar që të bashkohen me ne sonte. Shumë prej nesh janë lutur që Fryma e Shenjtë do të ishte me ne. Ai bekim na u plotësua teksa i dëgjuam këto motra të flasin dhe teksa dëgjuam muzikën frymëzuese. Unë lutem që Shpirti do të vazhdojë të jetë me ne, ndërsa u them disa fjalë nxitjeje dhe dëshmie, duke i shtuar asaj që tashmë është thënë – dhe veçanërisht për të dëshmuar se çfarë na është thënë, është ajo që Zoti do të donte që të dëgjonim.

Sonte do të flas rreth shtegut – i cili në mënyra kaq të bukura është përshkruar sot – që ne duhet ta ndjekim në udhëtimin tonë për t'u kthyer tek Ati ynë Qiellor. Ai shteg shënohet nga besëlidhje të shenjta me Perëndinë. Unë do të flas me ju rreth gëzimit të bërjes dhe të mbajtjes së atyre besëlidhjeve dhe të ndihmuarit të të tjerëve për t'i mbajtur ato.

Shumë prej jush u pagëzuan kohët e fundit dhe morët dhuratën e Frymës

së Shenjtë me anë të vendosjes së duarve. Për ju ai kujtim është i freskët. Të tjera prej jush u pagëzuan kohë më parë, kështu që kujtimi i ndjenjave tuaja për atë përvojë besëlidhjeje mund të jetë më pak i qartë, por disa prej atyre ndjenjave ju kthehen sa herë që dëgjoni lutjet e sakramentit.

Nuk ka dy prej nesh që do të kemi të njëjtat kujtime të ditës kur bëmë atë besëlidhje të shenjtë të pagëzimit dhe kur morëm dhuratën e Frymës së Shenjtë. Por secili prej nesh e ndjeu miratimin e Perëndisë. Dhe ndiem dëshirë për të falur e për t'u

falur dhe një vendosmëri të shtuar për të bërë të drejtën.

Sa thellë hynë ato fjalë në zemrën tuaj, u përcaktua gjerësisht nga mënyra se si u përgatitët nga njerëz të dashur. Shpresoj se ato prej jush, të cilat hynë në mbretëri kohët e fundit, jeni të bekuara të uleni pranë nënës suaj. Nëse jeni, ju mund t'i dërgoni asaj një buzëqeshje falënderimesh pikërisht tani. Unë mund të kujtoj ndjenjën e gëzimit dhe të mirënjohjes kur u ula mbrapa nënës sime në makinë, në rrugën e kthimit për në shtëpi prej pagëzimit tim në Filadelfia në Pensilvani.

Nëna ime ishte ajo që më kishte përgatitur me kujdes për ta bërë atë besëlidhje dhe të gjitha të tjerat që do të pasonin. Ajo kishte qenë besnike lidhur me këtë detyrë të ngarkuar nga Zoti:

“Dhe përsëri, për aq sa prindërit kanë fëmijë në Sion ose në ndonjë nga kunjat e tij që organizohen, të cilët nuk i mësojnë të kuptojnë doktrinën e pendimit, të besimit në Krishtin, Birin e Perëndisë së gjallë, dhe të pagëzimit e të dhuratës së Frymës së Shenjtë me anë të vënies së duarve, kur janë tetë vjeç, mëkati qoftë mbi kokat e prindërve.



Raimond, Alberta, Kanada



Palmira, Nju-Jork, SHBA

Sepse ky do të jetë një ligj për banorët e Sionit, ose në ndonjë nga kunjat e tij, që organizohen.

Dhe fëmijët e tyre do të pagëzohen për heqjen e mëkateve të tyre, kur të bëhen tetë vjeç dhe do të marrin [Frymën e Shenjtë].”¹

Nëna ime e kishte bërë pjesën e saj. Ajo i kishte përgatitur fëmijët e saj me fjalë shumë të ngjashme me ato të Almës, siç shënohen në Librin e Mormonit:

“Dhe ndodhi që ai u tha atyre: Vini re, këtu janë ujërat e Mormonit (pasi kështu quheshin) dhe tani, pasi ju dëshironi të hyni në grigjën e Perëndisë dhe të quheni populli i tij dhe jeni të gatshëm të mbani barrat e njëri-tjetrit, që ato të mund të jenë të lehta –

Po, dhe jeni të gatshëm të vajtoni me ata që vajtojnë; po, dhe të ngushëlloheni me ata që kanë nevojë të ngushëllohen dhe të qëndroni si dëshmitarë të Perëndisë në të gjitha kohërat dhe në të gjitha gjërat dhe në të gjitha vendet që ju të gjendeni, madje deri në vdekje, që ju të mund të shëlboheni nga Perëndia dhe të numëroheni me ata të ringjalljes së parë, që ju të mund të keni jetën e përjetshme –

Tani unë ju them, në qoftë se kjo është dëshira e zemrave tuaja, çfarë keni kundër pagëzimit në emrin e Zotit, si një dëshmi para tij që ju keni hyrë në një besëlidhje me të, se ju do

t’i shërbeni atij dhe do të zbatoni urdhërimet e tij, që ai të mund të derdhë mbi ju Shpirtin e tij më me shumicë?

Dhe tani, kur njerëzit kishin dëgjuar këto fjalë, ata përplasën duart e tyre nga gëzimi dhe thirrën: Kjo është dëshira e zemrave tona.”²

Ju mund të mos i keni përplasar duart kur fillimisht e dëgjuat atë ftesë për të besëlidhur me anë të pagëzimit, por me siguri e ndiet dashurinë e Shpëtimtarit dhe një zotim më të madh që t’i ushqeni shpirtërisht të tjerët për Të. Unë mund t’i them fjalët “me siguri”, ngaqë ato ndjenja vendosen thellë në zemër për të gjitha bijat e Atit Qiellor. Kjo është pjesë e trashëgimisë suaj hyjnore prej Tij.

Ju morët udhëzim prej Tij përpara se të vinit në këtë jetë. Ai ju ndihmoi të kuptonit dhe pranoni se do të kishit sprovë, vënie në provë dhe mundësi përsosurisht të zgjedhura pikërisht për ju. Ju mësuat se Ati ynë kishte një plan lumturie për t’ju kaluar në mënyrë të sigurt përmes sprovave dhe që ju do të ndihmonit për të kaluar njerëz të tjerë në mënyrë të sigurt përmes sprovave të tyre. Ky plan shënohet nga besëlidhje me Perëndinë.

Në jemi të lirë të zgjedhim nëse i bëjmë dhe i mbajmë ato besëlidhje. Vetëm pak prej bijave të Tij e kanë në këtë jetë mundësinë që madje të mësojnë për ato besëlidhje. Ju jeni një

prej pak bijave të favorizuara. Ju, të dashura motra, secila prej jush është një bijë në besëlidhje.

Ati Qiellor ju mësoi përpara se të lindeshit, rreth përvojave që do të kishit kur u larguat prej Tij dhe erdhët në tokë. Ju u mësuat se rruga për t’u kthyer në shtëpi tek Ai nuk do të ishte e lehtë. Ai e dinte se do të ishte tepër e vështirë për ju që ta bënit udhëtimin pa ndihmë.

Ju jeni bekuar që jo vetëm ta gjeni udhën për t’i bërë ato besëlidhje në këtë jetë, por edhe që të rrethoheni nga të tjera të cilat do të ndihmojnë – të cilat, sikurse ju, janë bija të besëlidhjes së Atit Qiellor.

Ju të gjitha e keni ndier sonte bekimin e të qenit në shoqërinë e bijave të Perëndisë, të cilat janë gjithashtu nën besëlidhje për t’ju ndihmuar dhe drejtuar ju, ashtu sikurse premtuan të bënin. Unë e kam parë atë që keni parë ju, ndërkohë që motrat e besëlidhjes e mbajnë atë zotim për të ngushëlluar e ndihmuar – dhe e bëjnë atë me një buzëqeshje.

Më kujtohet buzëqeshja e Motrës Rubi Heit. Ajo ishte bashkëshortja e Plakut Dejvid B. Heit, që ishte një anëtar i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve. Kur ishte i ri, ai shërbeu si presidenti i kunjit të Palo Altos në Kaliforni. Ai lutej dhe shqetësohej për vajzat në klasën e Trëndafilëve në lagjen e vet.

Prandaj Presidenti Heit u frymëzua që ta pyeste peshkopin për të thirrur Rubi Heitin si mësuese për ato vajza të reja. E dinte se ajo do të ishte një dëshmitare e Perëndisë, e cila do t’i frymëzonte, ngushëllonte dhe donte vajzat në atë klasë.

Motra Heit ishte të paktën 30 vjet më e madhe se vajzat të cilave u jepte mësim. Përsëri, 40 vjet pasi u kishte dhënë mësim, sa herë që do të takohej me gruan time, e cila kishte qenë një



prej vajzave në klasën e saj, ajo do të zgjaste dorën, do të buzëqeshte dhe do t'i thoshte Kathit: "O! Trëndafilja ime." Unë pashë më shumë se buzëqeshjen e saj. E ndjeva dashurinë e saj të thellë për një motër, për të cilën ajo ende tregonte kujdes sikur të ishte vetë bija e saj. Buzëqeshja dhe përshëndetja e saj e ngrohtë erdhën ngaqë e shihte se një motër dhe një bijë e Perëndisë ishte ende në shtegun e besëlidhjeve drejt shtëpisë.

Ati Qiellor buzëqesh për ju po ashtu, sa herë që sheh se ndihmoni një prej bijave të Tij që të lëvizë përgjatë shtegut të besëlidhjes drejt jetës së përjetshme. Dhe Ai kënaqet çdo herë që ju përpiqeni të zgjidhni të drejtën. Ai sheh jo vetëm atë që jeni, por edhe atë që mund të bëheni.

Ju mund të keni pasur një prind tokësor që mendoi se mund të jeni më të mira nga ajo që menduat se mund të ishit. Unë e pata një nënë të tillë.

Ajo që nuk e dija kur isha i ri, ishte që Ati im Qiellor, Ati juaj Qiellor, sheh potencial më të madh te fëmijët e Tij nga sa ne, ose edhe nënat tona

tokësore, shohim brenda vetes. Dhe kurdoherë që ju ecni përpara në atë shteg drejt potencialit tuaj, i sillni Atij lumturi. Dhe mund ta ndieni miratimin e Tij.

Ai e sheh atë potencial të lavdishëm në të gjitha bijat e Tij, kudo që janë ato. Tani, kjo vendos një përgjegjësi të madhe mbi secilën prej jush. Ai pret që ta trajtoni çdo njeri që takoni, si një fëmijë të Perëndisë. Kjo është arsyeja përse Ai na urdhëron t'i duam të afërmit tonë porsia veten dhe t'i falim ata. Ndjenjat tuaja të mirësisë dhe faljes ndaj të tjerëve vijnë si trashëgimia juaj hyjnore prej Tij si bija e Tij. Çdo njeri që takoni, është fëmija i Tij i dashur shpirtëror.

Kur e keni atë ndjenjë të madhe të qenies motra, çfarë menduam se na veçonte, largohet tutje. Për shembull, motra më të reja dhe më të moshuara i shprehin ndjenjat e tyre me pritshmërinë që ato do të kuptohen dhe pranohen. Ju jeni më të ngjashme si bija të Perëndisë sesa jeni të ndryshme.

Me atë këndvështrim, të rejat duhet ta presin me gëzim hyrjen e tyre në

Shoqatën e Ndhmës, si një mundësi për ta zgjeruar rrethin e tyre të motrave, të cilat do të arrijnë t'i njohin, admirojnë e duan.

Po ajo aftësi për të kuptuar atë që mund të jemi, po rritet në familjet dhe në Fillore. Po ndodh në mbrëmjet familjare të shtëpisë dhe në programet e Fillores. Fëmijë të vegjël po frymëzohen për të thënë gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, sikurse bënë kur Shpëtimtari i zgjidhi gjuhët e tyre kur u dha mësim atyre pasi Ai u ringjall.³

Ndërkohë që Satani mund të jetë duke i sulmuar motrat në moshë gjithnjë e më të re, Zoti po i lartëson motrat në nivele gjithnjë e më të larta të shpirtmërisë. Për shembull, të rejat po i mësojnë nënat e tyre se si ta përdorin FamilySearch për të gjetur e shpëtuar paraardhësit. Disa motra të reja që unë i njoh, po zgjedhin që të shkojnë herët në mëngjes për të kryer pagëzime mëkëmbëse në tempuj pa asnjë shtytje përveç shpirtit të Elias.

Në misionet kudo në tokë, motra po thirren që të shërbejnë si udhëheqëse. Zoti krijoi nevojën për shërbimin



e tyre duke i prekur zemrat e motrave në numër gjithnjë e më të madh për të shërbyer. Shumë më tepër presidentë misionesh i kanë parë motrat misionare të bëhen gjithnjë e më të fuqishme si predikuese dhe veçanërisht si udhëheqëse plot përkujdesje.

Nëse shërbeni apo jo si një misionare kohëplotë, ju mund të fitoni të njëjtën aftësi për ta pasuruar martesën tuaj dhe mundësinë për të rritur fëmijë fisnikë me anë të ndjekjes së shembujve të grave të madhërishe.

Merrni parasysh Evën, nënën e tërë të gjallëve. Plaku Rasëll M. Nelson tha këtë për Evën: “Ne dhe tërë njerëzimi jemi bekuar përgjithmonë për shkak të kurajës dhe urtësisë së madhe të Evës. Duke e marrë frutin e para, ajo bëri atë që ishte e nevojshme të bëhej. Adami ishte mjaft i urtë sa të bënte po ashtu.”⁴

Çdo bijë e Evës ka potencialin që t’i sjellë familjes së saj të njëjtin bekim që Eva i solli familjes së vet. Ajo ishte kaq e rëndësishme në krijimin e familjeve sa ne kemi këtë raportim për krijimin e saj: “Dhe Perënditë thanë: Le ta bëjmë një ndihmëse të përshtatshme

për burrin, sepse nuk është mirë që burri të jetë i vetëm, si rrjedhim ne do të formojmë një ndihmëse të përshtatshme për të.”⁵

Ne nuk e njohim tërë ndihmën që Eva ishte për Adamin dhe për familjen e tyre. Por vërtet e njohim një dhuratë të madhe që dha ajo, të cilën mund ta japë edhe secila prej jush: ajo e ndihmoi familjen e saj për të parë shtegun drejt shtëpisë, kur udha përpara dukej e vështirë. “Dhe Eva, gruaja e tij, i dëgjoi të gjitha këto gjëra dhe u gëzua, duke thënë: Po të mos ishte për shkeljen tonë, ne kurrë nuk do të kishim patur farë dhe kurrë nuk do të kishim njohur të mirën dhe të keqen, dhe gëzimin e shëlbimit tonë, dhe jetën e përjetshme që Perëndia ua jep gjithë të bindurve.”⁶

Ju e keni shembullin e saj që ta ndiqni.

Me anë të zbulesës, Eva e dalloi udhën për në shtëpi të Perëndia. Ajo e dinte se Shlyerja e Jezu Krishtit e bëri jetën e përjetshme të mundshme brenda familjeve. Ajo ishte e sigurt, siç mund të jeni ju, se, ndërkohë që i mbante besëlidhjet e saj me Atin e saj

Qielor, Shëlbuesi dhe Fryma e Shenjtë do ta shoqëronin atë dhe familjen e saj përmes çfarëdo hidhërimesh dhe zhgënjimesh që do të vinin. Ajo e dinte se mund të mirëbesonte tek Ata.

“Ki besim tek Zoti me gjithë zemër dhe mos u mbështet në gjykimin tënd; Pranoje në të gjitha rrugët e tua, dhe ai do të drejtojë shtigjet e tua.”⁷

Unë e di se Eva u përball me hidhërimi dhe zhgënjime, por gjithashtu e di që gjeti gëzim në njohurinë se ajo dhe familja e saj mund të ktheheshin për të jetuar me Perëndinë. E di se shumë prej jush që ndodheni këtu, po përjetoni hidhërimi dhe zhgënjime. Ju lë bekimin tim se, ashtu si Eva, ju mund të ndieni të njëjtin gëzim që ndjeu ajo, ndërkohë që bëni udhëtimin e kthimit në shtëpi.

Unë kam një dëshmi të sigurt se Perëndia, Ati, përkujdeset për ju me dashuri. Ai e do secilën prej jush. Ju jeni bijat e Tij në besëlidhje. Ngaqë ju do, Ai do të sigurojë ndihmën që ju nevojitet për ta lëvizur vetveten dhe për t’i lëvizur të tjerët përpara përgjatë udhës së kthimit në praninë e Tij.

E di se Shpëtimtari e pagoi çmimin për të gjitha mëkatet tona dhe se Fryma e Shenjtë dëshmon për të vërtetën. Ju e keni ndier atë ngushëllim në këtë mbledhje. Unë kam dëshmi se të gjitha çelësat, të cilat i lidhin besëlidhjet e shenjta, janë rivendosur. Ata mbahen dhe ushtrohen sot nga profeti ynë i gjallë, Presidenti Tomas S. Monson. I lë këto fjalë ngushëllimi dhe shprese me ju, bijat e Tij të dashura të besëlidhjes, në emrin e shenjtë të Jezu Krishtit, amen. ■

SHËNIME

1. Doktrina e Besëlidhje 68:25–27.
2. Mosia 18:8–11.
3. Shih 3 Nefi 26:14.
4. Russell M. Nelson, “Constancy amid Change”, *Ensign*, nëntor 1993, f. 34.
5. Abrahami 5:14.
6. Moisiu 5:11.
7. Fjalët e Urta 3:5–6.

Treguesi i Ngjarjeve në Konferencë

Lista vijuese e përvojave të përzgjedhura të treguara gjatë konferencës së përgjithshme, mund të përdoret për studim vetjak, mbrëmje familjare dhe mësimdhënie tjetër. Numri i përket faqes së parë të bisedës.

FOLËSI	NGJARJA
Nil L. Andersen	(18) Një Dafinë e mbron martesën tradicionale megjithëse e tallin dhe e shajnë.
M. Rasëll Ballard	(78) M. Rasëll Ballard “ndjek ecurinë” me Barbara Bouenin, të cilën e takon në një mbrëmje vallëzimi në universitet, fillon ta takojë dhe përfundimisht martohet me të. Një djalë tetëvjeçar e fton shokun e tij dhe familjen e shokut në një shtëpi të hapur të lagjes në Buenos-Ajres.
Dejvid A. Bednar	(87) Një kamionçinë fiton forcën lëvizëse në borë pasi mbushet me një barrë të rëndë me dru për zjarr.
Linda K. Barton	(122) Një e re në Filipine qëndron e vërtetë ndaj besëlidhjeve të saj. Një motër japoneze që viziton Korenë, u jep mësim misionarëve.
Kuentin L. Kuk	(44) Vajlet Kimball i shkruan burrit të saj për “doktrinën [n] e lavdishme” të pagëzimit për të vdekurit, siç u zbulua nëpërmjet Jozef Smithit.
Henri B. Ajring	(22) Hainrih Ajring emigron në Amerikë, bashkohet me Kishën, shërben besnikërisht në tre misione dhe i lë familjes së tij një trashëgimi shprese. (62) Henri B. Ajring formohet sipas heronjve të fëmijërisë, babai i tij, udhëheqësi i tij i Priftërisë Aaronë, një marins i SHBA-së dhe një lojtar bejsbolli, Xho DiMazhio. (125) Dyzet vite pasi ishte thirrur t’i jepte mësim Kathi Xhonsanit (bashkëshortesë së ardhshme të Henri B. Ajringut), Rubi Heiti, ende tregonte dashuri dhe shqetësim për të.
Donald L. Hallstrom	(53) Me gjithë kufizimet e tij fizike, një burrë besnik në Indi shërben në një mision dhe përgatitet bashkë me familjen e tij që të vulozen në Tempullin e Hong-Kongut në Kinë.
Xhefri R. Holland	(6) Dy motra misionare largohen pa i thënë asnjë fjalë një burri i cili i shan, hedh ushqime mbi to dhe përpiqet ta qëllojë njëren prej tyre.
Tomas S. Monson	(66) Një detar 18-vjeçar lutet çdo natë me gjithë talljet nga të tjerët në kompani. Një i ri jep dëshmi gjatë mbledhjes së sakramentit, por e shohin më vonë po atë ditë duke pirë cigare. (91) Dy gra bëhen shoqe për të gjithë jetën pasi njëra e ndihmon tjetrën që ta mësojë punën e saj si rrobaqepëse në një punishte veshjesh. Pasqajerët, në një fluturim me aeroplan, nuk ankohen kur aeroplani i tyre del nga kursi për të marrë një fëmijë të plagosur dhe për ta çuar atë në spital. Një grua ndien keqardhje pasi nuk e ka lejuar një fqinj që të kalojë në një rrugë të shkurtër nëpër pronën e saj.
Rasëll M. Nelson	(29) E bija e Rasëll M. Nelsonit, Emilia, tregon kurajë dhe besim ndërsa po vdes nga kanceri.
Boni L. Oskarson	(119) Një vajzë e vogël mëson gëzimin e shërbimit ndaj të tjerëve ndërsa ajo dhe nëna e saj kujdesen për një grua me sklerozë të shumëfishtë. Një motër 81-vjeçare thirret që të ndajë urtësinë, përvojën dhe shembullin e saj si këshilltarja e lagjes për Trëndafilët.
Bojd K. Paker	(94) Bojd K. Paker merr një shfaqje shpirtërore për vërtetësinë e ungjillit ndërsa lutet në një bunker gjatë Luftës II Botërore.
Ronald A. Rasband	(9) Një vajzë e klasës së pestë përfshihet në një tornado dhe mbrohet nga engjëjt.
Linda S. Rivs	(15) Linda S. Rivs i mëson bijës së saj se si të marrë ndihmë nëpërmjet Shlyerjes së Shpëtimtarit pasi e bija sheh pamje shqetësuese në televizor.
Rendëll L. Rid	(56) Një i ri vendos që të shërbejë në mision në vend që të martohet, pasi kupton paksa se cili ishte në botën para lindjes.
Riçard G. Skot	(32) Dashuria dhe shembulli i gjyshes së Riçard G. Skotit dhe bashkëshortesë së tij të ardhshme e ndihmojnë atë në përparimin e tij shpirtëror.
Xhin A. Stivens	(81) Xhin A. Stivens nxitet ta marrë në makinë një të ri që i kishte ikur autobusi nga shkolla për në shtëpi. Pjesëtarët e familjes Gatrell kapen fort pas ungjillit pasi Vëllai Gatrell diagnostikohet me një kancer agresiv.
Geri E. Stivenson	(84) Sportistja olimpike shdm Noell Pajkës-Peis fiton një medalje argjendi në rrëshqitjen me slitë skeleton pasi vitësh ushtrimi dhe përgatitjeje. Sportistja olimpike shdm Tora Brajt shfaq dashuri si të Krishtit pasi përfaqon një konkurrente nervoze në garën në gjysmë-rampë.
Majkëll Xhon U. Teh	(106) Një grua 73-vjeçare filipinase qëndron e vërtetë ndaj ungjillit pasi një tërmet dhe një tajfun i vrasin familjen.
Uilliam R. Uolker	Robert dhe Maria Harris bashkohen me Kishën dhe qëndrojnë të vërtetë e besnikë ndaj ungjillit me gjithë vështirësitë dhe ndarjen.
Klaudio D. Zivic	(39) Klaudio D. Zivic merr një shteg të gabuar duke ndjekur një ekskurSIONIST tjetër.
W. Krejg Zuik	(41) W. Krejg Zuik dhe gruaja e tij tregojnë dashuri për njëri-tjetrin pasi ajo hidhet bashkë me të birin e tyre foshnjë nga kabina e mbushur me tym e kamionit të tyre.

Ta Bëjmë Konferencën Pjesë të Jetës Sonë

Mbani parasysh që t'i përdorni disa nga këto veprimtari dhe pyetje si pikënisje për diskutim familjar apo përsiatje vetjake.

Për Fëmijët

- Presidenti Diter F. Uhtdorf, Këshilltar i Dytë në Presidencën e Parë, dha mësim se ne mund të zgjedhim të jemi mirënjohës, pavarësisht se çfarë gjërash të vështira ndodhin në jetën tonë (faqe 70). Të qenit mirënjohës do të na ndihmojë të jemi më të lumtur e të mirësjellshëm dhe të kemi besim e të mirëbesojmë te Perëndia. Si ndiheni kur jeni mirënjohës? Çfarë mund të bëni për të ndier mirënjohje çdo ditë?
- Boni L. Oskarson, presidente e përgjithshme e Të Rejave, tregoi për Sarën, një vajzë të vogël, e cila shkoi me mamën e saj për të ndihmuar Brendën, një grua me

sklerozë të shumëfishtë. Sara i kreu flokët Brendës, vendosi krem në duart e saj, i fërkoi gishtat e krahët e saj dhe e ndihmoi të shtrinte [krahët] (faqe 119). Mendoni për mënyra se si mund të shërbeni. Edhe kur jeni të vegjël, ka shumë gjëra që mund të bëni.

- Plaku L. Tom Peri, nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, dha mësim se si një drejtues përdor pajimet dhe frerët për ta drejtuar dhe udhëhequr butësisht një grup kuajsh (faqe 100). Drejtuesi e di më mirë dhe kali e ndjek udhëheqjen e drejtuesit, pikërisht ashtu si Zoti e di se çfarë është më e mira për ne dhe ne mund të jemi të lumtur kur

e ndjekim Atë. Pajimet dhe frerët janë si nxitjet e Frymës së Shenjtë. Kur e keni ndier Frymën e Shenjtë t'ju udhëheqë? Çfarë ndjenje ishte?

- Xhin A. Stivens, këshilltare e parë në presidencën e përgjithshme të Fillores, tregoi një ndodhi për një djalë që i kishte ikur autobusi i fundit i ditës dhe po shkonte në këmbë për në shtëpi (faqe 81). Ngaqë i kishin mbetur shumë kilometra, ai u frikësua dhe u gjuhëzua që të lutej. Disa minuta më vonë, Motra Stivens u nxit nga Shpirti që të ndalonte dhe ta ndihmonte atë. A mund të mendoni për rastet kur Ati Qiellor iu përgjigj lutjeve tuaja? Si keni ndihmuar ju për t'iu përgjigjur lutjes së dikujt tjetër?

Për Rininë

- Presidenti Tomas S. Monson dha mësim se neve na nevojitet "guxim për të thënë jo kur duhet ta themi atë, guxim për të thënë po kur është e duhur, guxim për ta bërë gjënë e drejtë ngaqë është e drejtë". Ndërsa e studioni bisedën e tij (faqe 66), mendoni për sfidat me të cilat përballeni. Çfarë plani mund të hartoni që të zhvillonin këtë lloj guximi?
- Plaku Xhefri R. Holland, nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, na kujtoi që, nëse e duam Shpëtimtarin, ne do t'i mbajmë urdhërimet e Tij dhe do t'i duam të tjerët ashtu siç i deshi Ai (faqe 6). Edhe kur e bëjmë këtë, ne duhet të qëndrojmë gati për t'i mbrojtur bindjet tona "me mirësjellje dhe me dashamirësi". A njihni ndonjë njeri që nuk është dakord me ndonjë nga bindjet tuaja? Si mund të jeni plot respekt ndërsa i diskutoni dhe i mbronni ato bindje?
- Disa folës i folën drejtpërsëdrejti rinisë. Për shembull, Plaku Nil L.





Andersen, nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, dha disa sugjerime për rininë mbi mënyrën se si t'i kapërcejnë "vorbullat e erërave shpirtërore", të tilla si gjetja e paqes në tempull (faqe 18). Ndërsa lexoni bisedën e tij dhe biseda të tjera të konferencës së përgjithshme, merrni parasysh të shkruani ide mbi mënyrën se si të mbeteni të fortë.

- Një nga të ligat e mëdha të kohës së sotme është pornografia. Linda S. Rivs, këshilltare e dytë në presidencën e përgjithshme të Shoqatës së Ndhimës, tha se filtri më i mirë kundrejt një të lige të tillë është një dëshmi e thellë dhe e qëndrueshme për ungjillin e Jezu Krishtit (faqe 15). Sa i fortë është filtri juaj vetjak? Çfarë mund të bëni për ta forcuar atë?

Për të Rriturit


- Presidenti Tomas S. Monson dha mësim se, ndërsa arrijmë ta kuptojmë "dhuratë[n e] pakrahueshme" të Shlyerjes, ne mbushemi me dashuri për Atin Qiellor, Shpëtimtarin dhe për të gjithë fëmijët e Perëndisë (faqe 91). Në ç'mënyrë kjo njohuri mund ta përmirësojë studimin tuaj për jetën e Shpëtimtarit dhe Shlyerjen gjatë studimit vetjak e familjar të shkrimeve të shenjta dhe ndërkohë që jeni në mësim në kishë?

- Presidenti Henri B. Ajring, Këshilltar i Parë në Presidencën e Parë, tha se ai ia detyron një pjesë të madhe të lumturisë së tij një stërgjyshi i cili u bashkua me Kishën, shërbeu besnikërisht dhe mbeti i palëkundur deri në fund, duke i lënë familjes së tij një trashëgimi shprese (faqe 22). Merrni parasysh të bëni një listë të cilitdo në familjen tuaj dhe të shkruani se çfarë besëlidhjesh dhe ordinancash iu duhen atyre për të vazhduar në shtegun e besëlidhjes. Bëni një plan për t'i ndihmuar pjesëtarët e familjes suaj që ta marrin besëlidhjen e tyre të radhës. Ju mund të shqyrtoni mënyra se si besëlidhjet

tuaja të luajnë një rol më thelbësor në jetën tuaj, kështu që ju të mund t'i jepni familjes suaj një trashëgimi shprese.

- Plaku Dejvid A. Bednar, nga Kuorumi i Dymbëdhjetë Apostujve, shpalli se vështirësia mund të na çojë të mbështetemi te "meritat, mëshira dhe hiri i Mesias së Shenjtë", i cili "do të na ndihmojë për t'i mbajtur me lehtësi barrët tona" (faqe 87). Ndërsa lexoni bisedën e tij dhe bisedat që fillojnë në faqet 9, 18, 70, 81 dhe 106, kërkoni mënyra se si Shpëtimtari dhe ungjilli i Tij mund t'ju ndihmojnë të përballeni me sfidat e jetës.
- Programi mësimor për rininë në maj, përqendrohet te profetët dhe zbulosa. Si pjesë e diskutimeve tuaja për ungjillin, me rininë, në shtëpi dhe në kishë, merrni parasysh të studioni bisedat nga Pleqtë Lorens E. Korbrixh (faqe 103) dhe Markos A. Aidukaitis (faqe 108), nga Të Shtatëdhjetët, duke kërkuar përgjigje për pyetjet vijuese: Përse kritikuesit e Jozef Smithit nuk e lanë të qetë atë? Si mund ta dallojmë të vërtetën në një botë që i sulmon gjithmonë e më shumë mësimet e ungjillit? ■





Vihet në Dukje Përparimi Lidhur me Tempujt, Mbështeten Drejtues të Rinj në Konferencën e Përgjithshme

Gjatë gjashtë muajve të kaluar, “puna e Kishës ka shkuar përpara e papenguar”, tha Presidenti Tomas S. Monson në fjalët e tij të hapjes së Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 184-t të Kishës.

Duke rikujtuar përkushtimin e Tempullit të Gilbertit në Arizonë më 2 mars 2014, duke pritur me mjaft dëshirë përkushtimin e ardhshëm të Tempullit të Fort Lloderdejlit në Florida dhe duke parashikuar përfundimin dhe përkushtimin e tempujve në shumë pjesë të botës gjatë vitit 2014 dhe 2015, Presidenti Monson vuri në dukje se, kur të përfundohen të gjithë tempujt e lajmëruar më parë, Kisha do të ketë 170 tempuj funksionues në mbarë botën.

“Edhe pse tani po i përqendrojmë përpjekjet tona në përfundimin e tempujve të njoftuar më parë dhe nuk do të njoftojmë ndonjë tempull të ri në

të ardhmen e afërt”, tha ai, “ne do ta vazhdojmë procesin e përcaktimit të nevojave dhe të gjetjes së vendeve për tempuj që ende do të vijnë. Njoftime do të bëhen atëherë në konferenca të përgjithshme të ardhshme. Ne jemi një popull tempullndërtues dhe tempullfrekuentues.”

Gjatë konferencës, u mbështetën një anëtar i ri i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve, katër Autoritete të reja të Përgjithshme, një presidencë e re e përgjithshme e Shkollës të së Dielës dhe 42 Të Shtatëdhjetë Zonalë.

Plaku Lin G. Robins u thirr në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve.

Plaku Jorg Klebingat nga Kievi në Ukrainë dhe Plaku Çi Hong (Sam) Uong nga Hong-Kongu në Kinë u mbështetën që të shërbejnë në Kuorumin e Parë të Të Shtatëdhjetëve. Plaku Leri S. Keçer nga Miduej në Juta dhe Plaku Hugo E. Martinez

nga Aresibo në Porto-Riko u mbështetën si anëtarë të Kuoromit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve.

Plaku Ted R. Kelister, i cili ishte duke shërbyer në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve dhe si anëtar i Kuoromit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve, u mbështet si presidenti i përgjithshëm i Shkollës të së Dielës, me Xhon S. Taner dhe Devin G. Durrant si këshilltarë të parë e të dytë.

Shihni një listë të plotë të mbështetjeve dhe lirimeve nga detyrat në faqet 26–27 dhe gjeni biografitë e Plakut Robins, të Të Shtatëdhjetëve të sapothirrur dhe të presidencës së përgjithshme të Shkollës të së Dielës duke filluar në faqen 141.

Një javë përpara konferencës së përgjithshme, mbledhja e parë e përgjithshme e grave – për të gjitha gratë, të rejtat dhe vajzat e moshës tetë vjeç e lart – u mbajt në Qendrën e Konferencave. Kjo mbledhje zëvendëson mbledhjet e mëparshme të përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës dhe të Të Rejave. Të gjitha mesazhet nga mbledhja e grave mund të gjenden në faqet 116–128.

Gjithashtu përpara konferencës, u riorganizua bordi i përgjithshëm i Të Rejave, me motra të thirrura për herë të parë nga vendndodhje përveç Solt-Lejk-Sitit, duke përfshirë Perunë, Afrikën e Jugut, Japoninë, Brazilin dhe Bruklinin në Nju-Jork të SHBA-së. Lexoni biografitë dhe shihni fotografitë te lds.org/callings/young-women.

“Shpëtimtari solli në këtë tokë një mesazh dashurie dhe vullneti të mirë për të gjithë burrat dhe gratë”, tha Presidenti Monson në fund të konferencës së përgjithshme. “E ndjekshim përgjithmonë shembullin e Tij.” Ai i siguroi anëtarët e Kishës dhe të tjerët që po dëgjonin, se “Ati Qiellor është i vëmendshëm ndaj nesh. Ai do të na udhëheqë dhe bekojë kur ne e vendosim besimin dhe mirëbesimin tonë tek Ai.” ■

ARTISTËT FTOHEN TË HYJNË NË KONKURS

Muzeu i Historisë së Kishës i fton artistët shenjtore të ditëve të mëvonshme të krijojnë vepra të reja arti për Konkursin e 10-të Ndërkombëtar të Artit. Artistët nxiten t'i përdorin talentet e tyre për të krijuar art që pasqyrojnë temën e ekspozitës: "Tregomë Ngjarjet e Jezusit". Për këtë konkurrim të veçantë, punët duhet të përqendrohen vetëm në ngjarje nga Dhiata e Re.

Hollësitë dhe regjistrimi në internet mundësohen te lds.org/artcomp dhe artistët që regjistrohen, do të marrin përditësime të informacionit. Pjesët konkurruese do të pranohen nga 3 nëntor 2014 deri më 27 shkurt 2015. Të gjitha mediat, stilet artistike dhe mënyrat kulturore janë të mirëpritura. Pjesëmarrësit duhet të jenë në moshën 18 vjeç e lart. Pjesët konkurruese do të gjykoohen dhe veprat që zgjidhen, do të shfaqen në Muzeun e Historisë së Kishës dhe në internet duke filluar në tetor të 2015-s.

TRAJNIMI PËR UDHËHEQJEN E ORGANIZATAVE NDIHMËSE DO TË BËHET I MUNDSHËM NË LDS.ORG.

Për t'i plotësuar më mirë nevojat e një Kise në rritje, presidentat e përgjithshme të Shoqatës së Ndihmës, të Filllores, të Të Rejave, të Të Rinjve dhe të Shkollës të së Dieles kanë për qëllim të japin trajnim mbarëbotëror çdo vit nëpërmjet internetit. Parashikohet se ky trajnim do të gjendet te LDS.org çdo mesvit në shumë gjuhë.

Mbledhjet trajnuese të udhëheqjes së organizatave ndihmëse që u mbajtën në Solt-Lejk-Siti së bashku me konferencën e përgjithshme të prillit, nuk do të mbahen më. Presidentat e përgjithshme të organizatave ndihmëse dhe bordet e tyre do të vazhdojnë të japin trajnim ballë për ballë në mbledhjet shumëkunjëshe, sipas caktimit.

Filmi i Ri Do Të Krijojë Mundësi për t'u Njohur me Mormonët

A e gjeni ndonjëherë veten duke dëshiruar të kishte një mënyrë të thjeshtë për t'ua bërë të tjerëve të ditur se shenjtoret e ditëve të mëvonshme janë thjesht njerëz normalë që gjejnë qëllim dhe drejtim teksa e përqendrojnë jetën e tyre te Jezus Krishti? Kjo është ajo që do t'ju ndihmojë të bëni një film dokumentar që do të nxirret së shpejti nga Kisha.

Filmi *Njihua me Mormonët* fillon me një vështrim zbavitës mbi mënyrën se si anëtarët e Kishës shpesh keqkuptohen nga të tjerët. Pastaj paraqet gjashtë familje, secila duke treguar përvoja vetjake dhe duke përshkruar mënyrën se si i ndihmon ungjilli në jetën e tyre. Të përfshirët në film janë:

Peshkopi. Xhërmein Sullivan dhe e shoqja, Kombi nga Atlanta në Xhorxhia të SHBA-së, punojnë për të krijuar bashkim në një komunitet të larmishëm ndërkohë që rritin tre bijtë e tyre të vegjël.

Trajneri. Ken Niumatalolo, trajneri kryesor i ekipit të futbollit të Akademisë Detare të SHBA-së në Anapolis të Merilendit në SHBA dhe e shoqja, Barbara, me përkrahjen e fëmijëve të tyre dhe të trupës organizative të trajnerëve, e mbajnë ditën e Shabatit të shenjtë.

Bombarduesi i Karamелеve. Geil Halvorsen, një veteran 93-vjeçar i Luftës II Botërore dhe e shoqja, Loreina 90 vjeç, nga Amado në Arizonë të SHBA-së, u kujtojnë fëmijëve vlerën e shërbimit. Ende një pilot, vëllai Halvorsen hedh karamele nga një aeroplan sikurse bënte gjatë Urës Ajrore të Berlinit pas luftës.

Boksierja. Karolina Marin, një sportiste kikkoksi nga San Hozé në Kosta-Rika, trajneri dhe i shoqi, Miltoni, vënë në drejtpeshim rolet



Në një shtëpi të hapur për pjesëtarët e trupës filmike, Presidenti dhe Motra Uhtdorf përshëndetin Karolina Marinën nga Kosta-Rika.

e tyre si bashkëshortë dhe si prindër të fëmijëve të tyre të vegjël, me dashurinë e tyre për ndeshjet.

Humanisti. Bishnu dhe Mangala Adikari, nga Katmandu në Nepal, i respektojnë bindjet dhe trashëgiminë e vendlindjes së tyre. Vëllai Adikari është një inxhinier i cili ka ndërtuar rrugë, shkolla dhe sisteme për ujin e pijshëm që kanë bekuar shumë komunitete të vogla.

Nëna Misionare. Kreg dhe Doun Armstrong si dhe djali i tyre Antoni, nga Solt-Lejk-Siti në Jutë të SHBA-së, tregojnë se si motra Armstrong ishte një nënë beqare e pastrehë kur takoi misionarët. Ungjilli që ata ndanë, e ndihmoi atë ta ndryshonte kryekëput jetën e saj. Ajo u martua më vonë me Kregun dhe historia bëhet një rreth i plotë kur Antoni shkon në një mision kohëplotë në Afrikën e Jugut për të ndarë ungjillin që e bekoji kaq shumë nënën e tij.

Filmi *Njihua me Mormonët* do të shfaqet në Ndërtuesen Përkujtimore të Jozef Smithit në Solt-Lejk-Siti të Jutas në SHBA dhe në vendndodhje të tjera që nuk janë përcaktuar ende. ■

Mësimdhënia në Kishë Duhet të Ndjekë Shembullin e Krishtit

Ne po përpiqemi të ecim në gjurmët e Shpëtimtarit për mësimdhënien”, tha presidenti i ri i përgjithshëm i Shkollës të së Dielës, Ted R. Kelister, pas konferencës së përgjithshme.

Kjo do të thotë të bëjmë pyetje të frymëzuara, që i ndihmojnë njerëzit të bëhen të kthyer në besim, tha ai. Qëllimi është që “t’i ndihmojmë ata ta kuptojnë dhe ta ndiejnë Shpirtin e ungjillit në jetën e tyre”.

Ai tha se i ka lënë mbresë *Ejani, Më Ndiqni*, programi mësimor në internet për rininë, që përfshin bisedat më të fundit nga konferenca e përgjithshme, si edhe mjete të medias të prodhuara nga Kisha. Pjesëmarrja i ka zëvendësuar leksionet, tha ai, dhe “ka një lëvizje të qartë nga thjeshtë mësimdhënia e një mësimi drejt përpjekjes për t’ia

përshtatur atë nevojave të studentëve në klasë”.

Ai shtoi se *Ejani, Më Ndiqni* ndihmon që të ndodhë kthimi në besim dhe jo thjeshtë të përçojë informacionin. “Mendoj se do të rrisim një brez të rinjsh që janë mësuesit më të mirë në botë, prindërit më të mirë në botë”, tha ai, “nga që ata tani po e marrin këtë përvojë në rini dhe nuk kanë përse të presin derisa [të jenë] të rritur . . . për të gjetur se si mund të jenë mësimdhënia dhe kuptueshmëria e efektshme.”

Jezu Krishti është Mësuesi Mjeshtër, tha Vëllai Kelister, dhe mësimdhënia jonë në kishë duhet t’i sjellë njerëzit te Krishti. Duke theksuar nevojën për të dhënë mësim doktrinën me qartësi dhe përpikëri, ai tha se “kurdoherë që përpiqemi t’i përngjasojmë Shpëtimtarit, ne jemi mbi një bazë të mirë”. ■



PUBLIKU I MORMON CHANNEL [STACIONIT MORMON] NË RITJE

Miliona dëgjues dhe shikues në mbarë botën kënaqen me Mormon Channel [Stacioni Mormon], i cili transmetohet në anglisht dhe spanjisht 24 orë në ditë, shtatë ditë në javë, nga Sheshi i Tempullit në Solt-Lejk-Siti në Juta të SHBA-së.

Ky stacion zyrtar i medias për Kishën filloi transmetimin pesë vjet më parë. Shumë shenjtore të ditëve të mëvonshme kanë kënaqësinë t’u tregojnë për përmbajtjen e tij bashkanëtarëve dhe të tjerëve. Përmbajtja është pa reklama dhe përfshin tre transmetime radioje me fjalë e muzikë dhe video të shkurtra të Mesazheve Mormone.

Gjejeni Mormon Channel [Stacionin Mormon] tek mormonchannel.org dhe gjithashtu në YouTube, iTunes, Roku, Tumblr, Facebook dhe Twitter. Gjithashtu mundësohen aplikime pa pagesë në telefona celularë për përdoruesit e iOS dhe Android.

Mësimet për Kohën Tonë

Nga maji i vitit 2014 deri në tetor të vitit 2014, mësimet e Priftërisë Melkizedeke dhe të Shoqatës së Ndihmës për të dielën e katërt duhet të përgatiten nga një ose më shumë biseda të dhëna në konferencën e përgjithshme të prillit 2014. Në tetor të vitit 2014, bisedat mund të përzgjedhen ose nga konferenca e përgjithshme e prillit 2014 ose nga konferenca e përgjithshme e tetorit 2014. Presidentët e kunjeve dhe të distrikteve duhet të zgjedhin se cilat biseda do të përdoren në zonat e tyre, ose ata mund t’ua caktojnë këtë përgjegjësi peshkopëve dhe presidentëve të degëve.

Ata që marrin pjesë në mësimet e të dielave të katërta, nxiten t’i studiojnë që më parë bisedat e përzgjedhura. Bisedat janë të gjindshme në shumë gjuhë në faqen conference.lds.org. ■

Teknologjia dhe Media Shoqërore Zgjerojnë Ndjekjen Mbarëbotërore të Konferencës së Përgjithshme

Përveç 100.000 e më shumë njerëzve që morën pjesë në pesë sesionet e Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 184-t në Qendrën e Konferencave në Solt-Lejk-Siti të Jutës në SHBA, miliona njerëz të tjerë i panë ose i dëgjuan sesionet në 95 gjuhë nëpërmjet transmetimeve të TV-së, radios, satelitit, dhe internetit.

Ndërkohë që Qendra e Konferencave në Solt-Lejk-Siti ka karrige për 21.000 njerëz, shikuesit ose dëgjuesit e konferencës së përgjithshme përqark globit rriten teksta miliona anëtarë të Kishës e të tjerë e ndjekin atë. Për më shumë se 50 vite, Kisha i ka përkthyer punimet në gjuhë të shumta. Sot, teknologjia e bën të mundur shikimin e drejtpërdrejtë në mbi 200 shtete anembanë botës.

Përveç transmetimeve në godinat kishtare vendore, Kisha e transmeton konferencën drejtpërdrejt në LDS.org, në kanalet BYUtv, BYUtv International, Mormon Channel, Roku, në Facebook dhe në YouTube. Shikueshmëria në internet gjatë konferencës së përgjithshme të tetorit 2013, u rrit me afro 30 përqind krahasuar me konferencën e mëparshme.

Shumë njerëz marrin pjesë në konferencën e përgjithshme edhe nëpërmjet medias shoqërore. Bëhet një vërshim publikimesh në Twitter me etiketimin #ldsconf gjatë secilës prej pesë sesioneve të konferencës, duke e bërë konferencën e përgjithshme një nga temat më të diskutuara në Twitter në atë kohë. Për shembull, gjatë tetorit të vitit 2013, u bënë 155.000 publikime

në Twitter që lidheshin me konferencën e përgjithshme. (Çdo publikim në Twitter është një koment individual me 140 ose më pak karaktere.)

Nëpërmjet kanaleve të saj zyrtare në median shoqërore, Kisha publikon mesazhe të drejtpërdrejta nga konferenca në gjuhë të shumta dhe i nxit të tjerët t'i shpërndajnë ato mesazhe. Gjatë konferencës së përgjithshme të tetorit 2013, shumë shikues apo dëgjues të tjerë i panë ose i dëgjuan mesazhet e konferencës së përgjithshme pasi panë një publikim në median shoqërore. Publikimet janë shpërndarë në anglisht, spanjisht dhe portugalisht.

Punimet e konferencës tani janë në dispozicion të një auditori më të gjerë se kurrë. ■

Punimet e konferencës tani janë në dispozicion të një auditori të gjerë, falë teknologjisë dhe medias shoqërore.



Faqet e Internetit Tregojnë për Shërbimin, Besimin

Shenjtoret e ditëve të mëvonshme japin shërbim dhe e shpërndajnë besimin e tyre në mbarë botën.

Raporte rreth veprimtarive të tilla shfaqen në faqet e internetit të redaksive të lajmeve të vendeve, të cilat përmbledhen rregullisht te newsroom.lds.org, burimi zyrtar i Kishës për mjetet e informimit, udhëheqësit e opinionit dhe publikun.

Në zonën e Paqësorit, shenjtoret e ditëve të mëvonshme furnizuan me ujë, ushqime, sharra elektrike, filtra për ujin, gjeneratorë dhe pajisje të tjera urgjence për të ndihmuar njerëzit në Tonga pas shkatërrimit nga cikloni tropikal Ian. Në Samoa, rinia SHDM

mori pjesë në një veprimtari dyditore ndërfaqetare me inkurajime shpirtërore, muzikë, vallëzim dhe sporte.

Në Brazil, anëtarët e Kishës, të veshur me bluzat Duart Ndhimtare Mormone, ndihmuan në përpjekjet e pastrimit dhe në shpërndarjen e furnizimeve pasi përmytja dëmtoi lagjet dhe bizneset vendore, duke lënë shumë vetë të pastrehë. Në pjesë të tjera, anëtarët ndihmuan me shpërndarjen kur Shërbimet Humanitare të Kishës dhuruan 211 karrige invalidësh për individë me nevoja të veçanta. Dhurimi i vazhdueshëm në Brazil tani arrin në shumën e pothuajse 700 karrigeve.

Në Guatemalë, më shumë se 500 të rinj e të reja shenjtore të ditëve të mëvonshme, mbledhen për të ndihmuar në mbjelljen e 1.944 pemëve.



Në Afrikë, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare vepruan së bashku me LDS Charities, pjesën humanitare të Kishës, në fushatën e parë kombëtare në Gana për t'i dhënë fund fruthit dhe rubeolës, duke vaksinuar fëmijët nga foshnjëria deri në moshën 14-vjeçare. Në Nigeri dhe Gana, një ditë e Duarve Ndhimtare u solli përfitim mijëra njerëzve në 100 komunitete, ndërkohë që shenjtoret e ditëve të mëvonshme të të gjitha moshave morën pjesë për të ndërtuar ura, për të mbjellë pemë, për të pastruar barëra të këqija, për të lyster ndërtesa dhe për të pastruar e zbukuruar lagjet. Në Zimbabve, më shumë se 60 të rinj e të reja shdm dolën vullnetarë për të dhuruar gjak. Dhe në Afrikën e Jugut, shenjtoria e ditëve të mëvonshme Nozibele Makanda, nënë e gjashtë fëmijëve, u zgjodh kryetare e bashkisë së Kuinstanunit, një qytet me 200.000 banorë.

Në Amerikën Qendrore, më shumë se 500 të rinj e të reja shdm në Guatemalë bashkëpunuan me qeverinë vendore për të mbjellë 1.944 pemë. Në Kosta-Rika, shtëpitë e mbledhjeve shdm u bënë pika mbledhjeje për qumësht dhe 370 vullnetarë të Kishës ndihmuan për t'ua shpërndarë atë dyqaneve të ushqimeve, duke marrë pjesë në një veprimtari për të ndihmuar njerëzit në nevojë.

Dhe në Kanada, shenjtore të ditëve të mëvonshme bashkëpunuan me organizatën për Dialogun Krishtero-Judeas të Montrealit (Kebek) për të përgatitur intervista në video përpara seancave të shqyrtimit të qeverisë mbi vlerat [morale]. Ata që u intervistuan, folën në mbështetje të zotimit të komunitetit ndaj respektit, mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare, duke theksuar se feja mbetet e rëndësishme në jetën e shumë qytetarëve të Kebekut.

Për një listë të faqeve në internet të redaksive të lajmeve nga vende ndërkombëtare në gjuhë të ndryshme, shihni mormonnewsroom.org/newsroom-country-sites. ■

Qendra e Vizitorëve në Tempullin e Meksiko-Sitit bën shumë ekspozime që u mësojnë [njerëzve] të vërtetat e ungjillit për të forcuar familjet.



Hapet Sërish Qendra e Vizitorëve në Tempullin e Meksiko-Sitit

Në muajin pas rihapjes së tij, mbi 30.000 të ftuar e vizituan Qendrën e Vizitorëve në Tempullin e Meksiko-Sitit, që i ishte nënshtruar 2 viteve të rimodelimit dhe zgjerimit. Të gjitha ekspozimet tani janë në spanjisht dhe përfshijnë materiale origjinale të zhvilluara posaçërisht për shikuesin dhe dëgjuesin meksikan. Qendra e rimodeluar është gjithashtu qendra e parë e vizitorëve që përfshin një zonë të tërë ekspozimi të projektuar posaçërisht për t'u

mësuar fëmijëve parimet e ungjillit.

Kjo qendër e vizitorëve është e treta për nga madhësia nga 17 godina të tilla; shumica e tyre gjendet pranë një tempulli ose një vendi historik të Kishës. Një qendër vizitorësh është aktualisht duke u ndërtuar pranë tempullit që po ngrihet në Romë të Italisë dhe qendra [të tjera] gjenden në Angli, Zelandën e Re, Havai dhe nëntë shtete të kontinentit amerikan. Qendrat, të projektuara për

të mirëpritur shenjtore të ditëve të mëvonshme aktive dhe më pak aktive si dhe njerëz të besimeve të tjera, jo vetëm i njohin njerëzit me Kishën, por edhe i ndihmojnë ata t'i kuptojnë bindjet e saj dhe nxitin një dëshirë për të mësuar më tepër rreth Shpëtimtarit dhe Rivendosjes së ungjillit. Ato japin edhe mesazhe për të forcuar familjet.

Meksika është një spirancë për Kishën, me mbi 1.2 milionë anëtarë, mbi 200 kunje dhe 12 tempuj. ■



Gjatë përvojës së tyre në QTM, misionarët marrin udhëzim rreth mësimdhënies së ungjillit të Jezu Krishtit.

Qendrat e Trajnimit të Misionarëve Ndhmohen në Përsheptimin e Punës për Shpëtim

15 qendra për trajnimin e misionarëve anembanë botës, sigurojnë trajnim për më shumë se 85.000 misionarë nga 143 vende. Të gjithë bashkë, misionarët mësojnë 55 gjuhë nga 1.600 mësues, pastaj shërbejnë deri në dy vite në 405 misione në më tepër se 150 kombe.

Me rritjen e numrit të misionarëve që nga koha kur u ndryshuan kriteret e moshës në tetor të vitit 2012, QTM-të po presin një numër më të madh misionarësh se kurrë më parë. Me së paku një QTM në çdo hemisferë, dielli nuk perëndon kurrë për trajnimin.

Misionarët përgjithësisht, vijnë në QTM me një bazë njohurish fetare të marra nga udhëzimi në shtëpi dhe

në Kishë. Qendrat sigurojnë trajnim shtesë që përfshin si të jepet mësim në mënyrën që Jezu Krishti dha mësim dhe mënyrën si t'u bëhen ftesa njerëzve për ta ndjekur Atë. Misionarët ushtrohen me situata mësimdhënieje, marrin trajnim për gjuhën aty ku gjen zbatim, dëgjojnë fjalime të takimeve të përjavshme shpirtërore nga udhëheqësit e Kishës dhe trupa organizative e QTM-së dhe marrin pjesë në mundësi shërbimi.

QTM-ja më e madhe gjendet në Provo të Jutës në SHBA. Ajo siguron trajnim për mijëra misionarë në 55 gjuhë. QTM-ja e dytë për nga madhësia gjendet në Meksiko-Siti të Meksikës. Në qershor të vitit 2013, ajo u zhvendos

nga një ndërtesë më e vogël në një kompleks prej 36.4 hektarësh që më parë mbante një shkollë të mesme private të Kishës të quajtur Benemerito de las Amerikas. Vendndodhja e mëparshme mund të priste rreth 125 misionarë njëherësh; vendndodhja e re mund të presë mbi 1.000.

QTM të tjera gjenden në Buenos-Ajres të Argjentinës; San-Paolo, të Brazilit; Santiago të Kilit; Bogotá të Kolumbisë; Santo-Domingo, të Republikës Dominikane; Preston të Anglisë; Akra të Ganës; Guatemala-Siti të Guatemalës; Okland të Zelandës së Re; Limë të Perusë; Manila të Filipineve; Johaneshburg të Afrikës së Jugut dhe në Madrid të Spanjës. ■

Kisha Zbaton Parimet e Mirëqenies në Përmirësimin e Gjendjes në Filipine



Vullnetarë duke ngulur kompensata në skeletin e një shtëpie të re në Takloban në Filipine.

Disa muaj pasi tajfuni Haijan goditi Filipinet në nëntor të vitit 2013, duke shkatërruar afërsisht 1,2 milionë shtëpi dhe duke vrarë më shumë se 6.200 njerëz, Kisha vazhdon të sigurojë ndihmë, duke i kaluar përpjekjet nga reagimi ndaj shkatërrimit drejt ndihmës afatgjatë. Një përpjekje veçanërisht e suksesshme përfshin vullnetarë të cilët kanë mësuar se si të ndërtojnë shtëpi për ata që ende nuk kanë strehë.

Anëtarët e mëposhtëm të komuniteteve, të ndikuar nga stuhia, janë mes shumë prej atyre që shprehën mirënjohje për ndihmën që morën nga Kisha, edhe pse ata nuk janë shenjtore të ditëve të mëvonshme:

- Një grua që gjeti strehim në një godinë kishe mormone gjatë tajfunit, mësoi më pas se shtëpia e saj ishte shkatërruar kur pemët e arrave së kokosit ranë mbi të. Ajo dhe familja e saj nuk i kishin mjetet për ta rregulluar atë, por vullnetarët e ndihmuan gruan që të ndëronte një shtëpi të re dhe ajo tani po ndihmon një familje tjetër për të ndërtuar një shtëpi. “Mësova të punoj së bashku me ata që janë gjithashtu në nevojë këtu, që ne të mund ta marrim veten nga [tajfuni] së bashku”, tha ajo.
- Një burrë që e humbi punën e tij kur u shkatërrua biznesi ku punonte, tani po mëson të ndërtojë shtëpi për familjen e tij dhe për të tjerët. “E dimë

se kemi nevojë ta ndihmojmë njëritjetrin, me qëllim që puna të mund të përfundojë më shpejt”, tha ai, duke shtuar se ai ishte mirënjohës për përpjekjet ndihmuese të Kishës.

Peshkopi Kryesues Geri E. Stivenson tha se, së bashku me përkujdesjen për të varfërit dhe nevojtarët, “ne gjithashtu po shohim të veprojë tani parimin e mbështetjes të vetja dhe është mjaft befusuese”. Ai tha: “Një nga gjërat që po përpiqemi të bëjmë, është të sigurojmë materiale ndërkohë që [marrësit e tyre] sigurojnë krahun e punës. Kushdo që po merr një strehim, gjithashtu po punon për ta ndërtuar atë strehë për vetveten.”

Udhëheqësit dhe përfaqësuesit humanitarë vendorë të Kishës po takohen me udhëheqës të komuniteteve vendore për t’u dhënë trajnim dhe specializim profesional njerëzve të cilët kanë mësuar aftësi ndërtuese. Burime të Fondit të Qarkullueshëm Arsimor janë përdorur për të sjellë në vend 20 ndërtues mjeshtra për të ndihmuar për trajnimin dhe 2.000 nga 3.000 shtëpitë e planifikuara janë përfunduar tashmë.

Njerëzit e trajnuar vendorë e tregojnë çfarë kanë mësuar duke ndërtuar 10 strehime për të marrë certifikatën qeveritare dhe një kuti me vegla nga Kisha, duke i bërë ata të aftë të kërkojnë punësim fitimprurës. Ka një nevojë të tillë të ngutshme për punonjës ndërtimi, sa

Shërbimet Katolike të Ndhmës kanë rënë dakord për të punësuar qindra prej ndërtuesve të trajnuar nga Kisha SHDM.

Peshkopi Stivenson tha se 500 anëtarë të Kishës morën pjesë në një mbledhje ku udhëheqës kishtarë përshkruan trajnimin për punën dhe certifikimin “dhe, ndërsa kjo po u përshkruhej, ata shpërthyen në brohoritje dhe lotë, duke e ditur se mund të shihnin një mënyrë . . . për të siguruar për familjet e tyre”.

Kisha gjithashtu ka punuar me disa organizata të tjera bamirëse, si edhe qeverinë filipinase, në një përpjekje të vazhdueshme për të shpërndarë ushqime, ujë, furnizime mjekësore, paketa higjienike, gjeneratorë, paketa strehimi, paketa gatimi, pajisje peshkimi dhe fara për mbjellje.

Kisha ka mësuar se mënyra më e efektshme për t’iu përgjigjur fatkeqësive natyrore është të punosh në vendndodhje, duke blerë pajisjet e nevojshme në vendin e dëmtuar, sa më pranë fatkeqësisë që të jetë e mundur. Kjo jo vetëm që siguron se të mirat materiale janë të përshtatshme për zonën, por edhe ndihmon për t’i ngritur ekonominë e dëmtuara vendore.

Anëtarët në mbarë botën nxiten për t’u lutur për njerëzit në zona fatkeqësie, larg prej vendeve ku jetojnë ata, dhe për të marrë parasysh ritjen e dhurimeve të tyre të ofertave të agjërimit ose dhurimin në fondin humanitar të Kishës. ■

Iniciativa për Ujë të Pastër Ndhmon Miliona Njerëz në Afrikë

Për më shumë se dy dhjetëvjeçarë, Kisha është përfshirë në projekte për ujë të pastër në më shumë se 100 vende. Vetëm në Afrikë, këto projekte kanë bekuar jetën e më shumë se katër milionë njerëzve duke siguruar puse, sisteme ruajtjeje dhe shpërndarjeje të ujit dhe pastrim të ujit.

Një projekt i tillë ndodhi në ishullin Idugo, pranë bregdetit të Mozambikut. Pjesa më e madhe e 15.000 njerëzve që jetojnë në ishull, punojnë në ferma familjare, peshkojnë në ujërat rrethuese të Oqeanit Indian ose punojnë në pellgjet e avullimit për të mbledhur kripë nga uji i detit. Ishulli nuk ka ujë të rrjedhshëm, energji elektrike, rrugë apo automjete. Arritja në ishull bëhet me anë të varkave të bëra me dorë ose me anë të kaikeve të gërryera nga trungje drurësh.

Për shekuj, burimet e vetme të ujit të pijshëm në Idugo kanë qenë puse të cekëta, të gërruara me dorë. Puset vazhdimisht mbushen me baltë dhe mbeturina. Ato sigurojnë ujë plot baltë dhe të vështirë për t'u arrirë. Gjatë stinës së shirave, uji bëhet i ndotur, duke shkaktuar kolerë, diarre dhe sëmundje të tjera.

Kur misionarët humanitarë të Kishës dëgjuan rreth kushteve në Idugo, ata u takuan me udhëheqësit e komunitetit atje. Së bashku ata krijuan një plan për Shërbimet Humanitare të Kishës që do të siguronte materiale, vegla dhe udhëzime për të ndërtuar 10 puse të rrethuar betoni me kapakë çeliku, me kapacitet për t'u shërbyer 1.000 njerëzve. Misionarët do të jepnin trajnimin higjienik e sanitar dhe



Në ishullin Idugo në Mozambik, fshatarë dhe autoritete vendore marrin pjesë në një ceremoni ku fillon përdorimi zyrtar nga komuniteti i një pusi.

fshatarët do të siguronin gjithë krahun e punës të nevojshëm për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e puseve.

Nga një qendër skele në kontinent, u transportuan me anije për në ishujt katër ngarkesa kamionësh me zhavorr, 300 thasë me çimento, dy ngarkesa me rërë, shufra të përforcuara çeliku dhe paleta të bëra me çelik e çimento. Furnizimet u çuan më pas nëpër ishull me këmbë ose me karroca dore. Disa anëtarë të Kishës nga Kuelimane, në Mozambik, jetuan në çadra në ishull për tre muaj, që të ndihmonin për trajnimin dhe ndërtimin.

Puset u krijuan që të lejonin kullimin e ujit të shiut, duke mënjanuar ndotjen. Në disa komunitete, banorët ndërtuan gardhe prej druri dhe udhëkalime me tulla përreth puseve, duke përdorur tulla që mësuan t'i bënë vetë me materiale të dhuruara nga Kisha.

Në ceremonitë zyrtare, pronësia e puseve iu kthye njerëzve të secilit fshat. Disa banorë, të cilët kishin punuar te puset, shprehën mirënjohje që aftësitë e tyre të sapomësura – bërja e tullave, punimi me çimento

dhe përforsimi i saj me çelik, si dhe përdorimi i veglave – do t'i ndihmonin ata që të gjenin punë shtesë. Të tjerë shprehën mirënjohje për mundësinë që të mësonin aftësi udhëheqjeje.

Pas stinës së shirave që pasoi, nuk u raportua asnjë sëmundje e shkaktuar nga uji në fshatrat me puse.

Sipas Organizatës Botërore të Shëndetësisë, më shumë se një miliard njerëzve në mbarë botën u mungon mundësia për të përdorur ujë të pastër. Falë iniciativës së Kishës për ujë të pastër, ai numër po pakësohet nëpërmjet një procesi që përfshin anëtarët e komunitetit në planifikimin dhe zbatimin e projekteve, duke siguruar krahun e punës për t'i ndërtuar godinat e nevojshme, duke marrë trajnim dhe duke mirëmbajtur burimet e përfunduara.

Përveç projekteve të ujit të pastër nëpër mbarë Afrikën, Kisha sponsorizon iniciativa për ujë të pastër në Azi, Amerikën Qendrore, Europën Qendrore, Indi, Indonezi, Ishujt e Paqësorit, Amerikën Jugore, Azinë Juglindore dhe vendndodhje të tjera anembanë botës. ■



Plaku Lin G. Robins

Presidenca e Të Shtatëdhjetëve

Që kur u thirr si Autoritet i Përgjithshëm në prill të vitit 1997, Plaku Lin G. Robins ka gëzuar “bekimin e ëmbël të të bërit shoqëri me shenjtorët nga e gjithë bota”.

“Ndien një lidhje të menjëhershme me njerëzit kudo që të shkosh”, thotë ai.

Plaku Robins shpreson të vazhdojë të takojë shenjtorë të ditëve të mëvonshme për qark globit ndërkohë që shërben si anëtar i Presidencës së Të Shtatëdhjetëve.

Lin Grant Robins iu lind më 27 tetor të vitit 1952, në Pejson të Jutës prindërve Xhoshua Grant dhe Evelin R. Robins. Ai i kaloi vitet e hershme në Springvill të Jutës, ku takoi Xhen Nilsonin, të cilën e ka njohur që në fëmijëri. Ata u martuan më 27 qershor 1974, në Tempullin e Mantit në Juta dhe janë prindër të shtatë fëmijëve; ata kanë 15 nipër e mbesa.

Plaku Robins mori diplomë universitare në spanjisht dhe në shkenca politike nga Universiteti Shtetëror i Jutës dhe një diplomë master për administrim ndërkombëtar biznesi nga Shkolla Pasuniversitare Amerikane e Administrimit Ndërkombëtar në Glendejl të Arizonës në SHBA. Ai ishte themeluesi dhe zëvendëspresident i rangut të parë i kompanisë Frenklin Kuest.

Plaku Robins po shërbente si president i Misionit të Montevideos në Uruguai kur mori thirrjen për në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve. Tri vite më vonë, u bë anëtar i Kuoromit të Parë të Të Shtatëdhjetëve. Ai ka shërbyer si president i Zonës Jugore të Amerikës së Jugut, Zonës së Amerikës Qendrore dhe Zonës Perëndimore të Amerikës së Veriut. Ai ka shërbyer edhe në zonën qendrore të Amerikës së Veriut.

Një bekim i madh i këtij shërbimi, ishte mundësia për t’u kthyer në Argjentinë, ku shërbeu si misionar kohëplotë. Ndërkohë që ishte në Argjentinë kur ishte misionar i ri, ai shërbeu në Huhui, një zonë me një degë. Kur u kthye në zonë vite më vonë, gjeti një kunj të Kishës me një duzinë njësisish.

“Këtë e shikon anembanë botës”, thotë ai. “Kjo është një kohë mrekullish”. ■



Plaku Jorg Klebingat

Kuorumi i Parë i Të Shtatëdhjetëve

Plaku Jorg Klebingat e ka jetuar jetën me ngulm. Ai beson në të qenit i bindur, në mbajtjen e urdhërimeve dhe në ndjekjen e nxitjeve të Shpirtit.

I lindur më 19 dhjetor të vitit 1967, nga prindërit Klaus-Peter dhe Doris Elke Klebingat, Plaku Klebingat u rrit në Cvaibryken të Gjermanisë pa ndikimin e ungjillit. Kur ishte adoleshent, takoi një anëtar të Kishës në një koncert muzikor dhe ata të dy u bënë shokë.

“Kur i shkova për vizitë mikut tim të ri, më la mbresa familja e tij”, kujton ai. “Ndjeva Shpirtin në shtëpinë e tij dhe dëshiroja të shkoja në kishë.”

Ishte në atë mbledhje të parë në Kishë që ai dëgjo për Librin e Mormonit. Miku i tij i dha një kopje me dëshminë e vet se [libri] ishte i vërtetë dhe Plaku Klebingat u largua nga mbledhjet i vendosur për ta zbuluar këtë vetë.

“Isha diku te 1 Nefi kur mora dëshminë se libri ishte i vërtetë”, tha Plaku Klebingat. “Marrja e një dëshmie për Profetin Jozef Smith ishte gjithashtu një çast përcaktues për mua. Në misionin tim, u kërkoja gjithmonë shokëve të mi të misionit që të mund ta tregoja unë atë pjesë të historisë.”

Përpara misionit të tij kohëplotë në Misionin e Denverit në Kolorado, Plaku Klebingat shërbeu në ushtrinë gjermane për 18 muaj. Ai u vulos me Xhulia Poltorakun në Tempullin e Solt-Lejkut më 21 dhjetor 1992. Ata kanë tre fëmijë.

Plaku Klebingat mori një diplomë pas studimit të gjuhës ruse në Kolegjin Riks dhe një diplomë masteri më vonë për sjellje organizative nga Universiteti “Brigam Jang”. Ai punoi si këshilltar i administrimit të biznesit për kompaninë Prajs Uotërhaiz dhe Artur Andersenin si dhe në disa funksione për Kishën.

Përpara kësaj thirrjeje, Plaku Klebingat shërbeu si përfaqësues i të rinjve në moshë madhore beqarë të kunjit, si president i kuoromit të pleqve, si president i Të Rinjve, si këshilltar i lartë, si president dege dhe si peshkop. Ai do ta përfundojë shërbimin si president i Misionit të Kievit në Ukrainë në qershor të vitit 2014. Ai u mbështet si anëtar i Kuoromit të Parë të Të Shtatëdhjetëve më 5 prill të vitit 2014. ■



Plaku Çi Hong (Sem) Uong

*Kuorumi i Parë i Të
Shtatëdhjetëve*

Kur ishte i sapokthyer në besim dhe student në Universitetin “Brigam Jang” – Havai, Plaku Çi Hong (Sem) Uong mori shumë më tepër se shkollimi – ai fitoi një njohuri të sigurt se ka një Perëndi i cili i di “hollësitë e jetës sonë”.

I lindur më 25 maj të vitit 1962, në Hong-Kong të Kinës, nga prindërit Ngan Ken dhe Fet Uong, Plaku Uong ishte një nga shtatë fëmijët që po rriteshin në një apartament të vogël.

Në punë ai takoi Karol Lunë, e cila e njohu atë me ungjillin. Kërkuesi i ri u pagëzua më 14 shkurt të vitit 1982.

Një vit më vonë, më 9 korrik 1983, ai u martua me Karolën. Ata u shpërngulën në Laje të Havait në SHBA, që ai të mund të ndiqte shkollën. Për shkak se ishte me vizë studentore, Plaku Uong mund të punonte vetëm 20 orë në javë. “Duhej t’i ushtronim vërtet besimin dhe lutjet tona”, tha ai për atë që iu desh të bënte për të mbajtur familjen.

Ai punoi fort për të fituar një bursë, pastaj zgjodhi aq kredite për lëndë sa ia lejonte universiteti. “Nuk ishte e lehtë”, kujton ai. “Pasi e patëm atë përvojë, e dinim se mund të mbështeteshim gjithnjë mbi fuqinë e qiellit.”

Çifti Uong u vulos në Tempullin e Lajes në Havai më 9 gusht të vitit 1984 dhe u lindi fëmija i tyre i parë; tre fëmijë do t’i bashkoheshin familjes përfundimisht. “Ato vite ishin shumë të veçanta, shumë të shenja”, tha Plaku Uong.

Plaku Uong mori një diplomë universitare për shkencë në kontabilitet dhe një diplomë nga një kolegji dyvjeçar për shkencë kompjuterike; pastaj ai ndjeu nevojën “për t’u kthyer në Hong-Kong për të shërbyer”.

Më vonë ai mori një diplomë masteri për administrim biznesi nga Universiteti i Hapur i Hong-Kongut. Plaku Uong ishte themeluesi dhe ortaku i një kompanie biznesi dhe këshillimi për cilësinë si dhe punoi në një grup hetimi dhe vënieje në provë të materialeve ku filloi si llogaritar kryesor dhe u largua nga kompania si zëvendës drejtor administrimi.

Përpara se të mbështetej më 5 prill të vitit 2014, si anëtar i Kuorumit të Parë të Të Shtatëdhjetëve, ai shërbeu si peshkop, si president kunji dhe si I Shtatëdhjetë Zonal. ■



Plaku Leri S. Keçer

*Kuorumi i Dytë i Të
Shtatëdhjetëve*

Pas shumë nxitjeve në vitet e tij si një i ri në moshë madhore, Plaku Leri S. Keçer filloi të dallonte një fuqi më të madhe që e udhëhiqte në jetën e tij. Në moshën 19-vjeçare, ndjeshmëria ndaj Shpirtit e çoi atë drejt ungjillit të Jezu Krishtit – një ndryshim që ka pasur ndikim të madh.

Ai u lind më 12 shkurt 1952, fëmija i dytë i pesë fëmijëve të lindur Albert dhe Ilej Keçerit; ai u rrit në Blumington, në Minnesota të SHBA-së.

Pas mbarimit të shkollës së mesme, shkoi në Europë për të bërë ski dhe pas më shumë se gjashtë muajsh atje, ndjeu nevojën për t’u kthyer në shtëpi. Kur u kthye në shtëpi, ai ndjeu se ishte e nevojshme të shkonte diku tjetër, por nuk e dinte se ku. Një mik i fëmijërisë kishte në plan të lëvizte në Jutë dhe Plaku Keçer vendosi të lëvizte me të. Ndërsa ndodhej në Jutë, Plaku Keçer filloi studimet në Universitetin “Brigam Jang”, mësoi rreth Kishës dhe u pagëzua.

“Ndërsa misionarët na mësonin, e ndjeva se ishte e vërtetë”, thotë ai. “Ndërsa u luta, e ndjeva që Kisha ishte e vërtetë.”

Ai vendosi të shërbente në një mision dhe u thirr në Misionin e Tahitit në Papite në vitin 1973. Pasi u kthye në shtëpi, u rikthye në shkollë në UBJ, ku u takua me Pollin Miller. Ata u martuan në Tempullin e Mantit në Jutë më 29 tetor 1976 dhe janë prindër të gjashtë fëmijëve dhe gjyshër të 11 nipërve e mbesave.

Plaku Keçer mori një diplomë universitare në psikologji dhe një diplomë masteri në sjelljen organizative – që të dyja nga Universiteti “Brigam Jang”. Karriera e tij përfshiu këshillimin e kompanive të mëdha, brenda Shteteve të Bashkuara si edhe ato ndërkombëtare.

Përpara se të mbështetej më 5 prill 2014 si anëtar i Kuorumit të Dytë të Të Shtatëdhjetëve, Plaku Keçer shërbeu si president dege, president i kuorumit të pleqve, peshkop dhe këshilltar i presidentit të kunjit. Ai kryesoi mbi Misionin e Zvicrës në Gjenevë nga viti 2000 deri në 2003. Pak vite pas kthimit të tij nga Zvicra, puna e çoi në Abu-Dabi në Emiratet e Bashkuara Arabe, ku ai u thirr të shërbente si I Shtatëdhjetë i parë Zonal në Lindjen e Mesme. ■



Plaku Hugo E. Martinez

Kuorumi i Dytë i Të Shtatëdhjetëve

Në vitin 1982, Plaku Hugo E. Martinez dhe e shoqja, Motra Nuria Alvarez de Martinez, ishin që të dy në një trajnim për specializim mjekësor në Misisipi të SHBA-së, kur dëgjuan një trokitje të papritur në derën e tyre kryesore.

Atje qëndronin dy misionarë mormonë.

“I pritëm në shtëpi, por nuk dinim asgjë për Kishën e Jezu Krishtit të Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme. Nuk dinim asgjë as për Korin Mormon të Tabernakullit”, thotë Plaku Martinez duke qeshur.

Prapëseprapë, mësimet e ungjillit të dhëna nga misionarët, ndikuan menjëherë te çifti i ri. Shpejt, ata e pranuan ftesën e misionarëve për t’u pagëzuar.

“Dhe që atëherë nuk kemi parë më kurrë prapa.”

Më 5 prill 2014, Plaku Martinez u thirr në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve, duke u bërë Autoriteti i parë i Përgjithshëm nga Karaibet. Ai është me të drejtë “i tronditur” nga detyra e tij e re.

“Por pastaj më mbulon një ndjesi e ëmbël paqeje dhe më bën të ditur se Zoti është në krye të saj”, thotë ai.

Një vit e një muaj pas pagëzimit të tyre, Hugo dhe Nuria Martinez u vulosën në Tempullin e Solt-Lejkut më 3 tetor 1983. Ata janë prindër të pesë fëmijëve dhe kanë pesë nipër e mbesa.

Plaku Martinez iu lind prindërve Hugo E. Martinez-Sandini dhe Dejali Morales-Alamo de Martinez më 10 janar të vitit 1957 në Majaguez të Porto-Rikos. Kur ishte i ri, ai zgjodhi të ndiqte udhën profesionale të të atit dhe u bë mjek. E mori diplomën e tij për mjekësi nga Universiteti i Porto-Rikos (1981) dhe e mbaroi specializimin në Universitetin e Misisipit (1984). Ai e ushtroi mjekësinë derisa doli në pension në vitin 2004.

Pak kohë pas pagëzimit të tij, u thirr për të qenë mësues i rinisë në Shkollën e së Dielës. Më vonë do të shërbente si peshkop, si këshilltar në presidencën e kunjit, si president i distriktit dhe si këshilltar në presidencën e Misionit të San-Huanit në Porto-Riko. Ai kryesoi edhe mbi Misionin e Guatemala-Sitit në Guatemalën Qendrore dhe po shërbente si I Shtatëdhjetë Zonal kur u thirr për të qenë Autoriteti i Përgjithshëm. ■



Ted R. Kelister

Presidenti i Përgjithshëm i Shkollës të së Dielës

Në jetën e Ted R. Kelisterit, Shkolla e së Dielës luajti një rol kryesor disa dekada përpara thirrjes së tij të fundit si president i përgjithshëm i Shkollës të së Dielës.

Ndërkohë që Vëllai Kelister po shërbente si president i Shkollës të së Dielës në një lagje të Universitetit “Brigam Jang”, ai njohu bashkëshorten e tij të ardhshme Ketrin L. Saporitin, me të cilën u martua më 20 dhjetor 1968 në Tempullin e Los-Anxhelosit.

Ata janë prindër të dy vajzave dhe katër djemve; ata kanë edhe 24 nipër e mbesa. “Shumë gjëra të mira ndodhin kur je president i Shkollës të së Dielës”, thotë Vëllai Kelister.

I lindur më 17 dhjetor të vitit 1945 në Glendejl të Kalifornisë, nga prindërit Rid Edington dhe Norin Kelister, ai deklaroi se - si Nefi - u lind nga “prindër të mirë”.


“Im atë ishte peshkopi im kur u rrita”, thotë Vëllai Kelister. “Ai e kishte zakon të mbante me vete letra të vogla dhe mësonte përmendsh fjalë nga fjalori, shkrime të shenjta dhe vargje nga Shekspiri.”

Sikurse i ati, Vëllai Kelister ndoqi një karrierë ligjore. Pas diplomimit si llogaritar nga Universiteti “Brigam Jang”, ai ndoqi juridikun në Universitetin e Los-Anxhelosit në Kaliforni dhe mori një diplomë masteri për ligjin e taksave nga Universiteti i Nju-Jorkut. U punësua si avokat me të drejtë ushtrimi të profesionit në firmën Kelister & Kelister.

Në kohën e thirrjes së tij, Vëllai Kelister sapo ishte liruar nga thirrja e tij në Presidencën e Të Shtatëdhjetëve dhe nga thirrja në Kuorumin e Dytë të Të Shtatëdhjetëve, ku kishte shërbyer që nga viti 2008.

Përpara kësaj, ai shërbeu si president i Misionit Lindor të Torontos në Kanada, si I Shtatëdhjetë Zonal, si përfaqësues krahinor, si president kunji, si peshkop, si president i misionit të kunjit, si president i kuoromit të pleqve dhe, kur ishte i ri, si misionar në Misionin e Shteteve të Atlantikut Lindor.

Duke komentuar mbi ndryshimet e ardhshme në programin mësimor të të rriturve për Shkollën e së Dielës, Vëllai Kelister thotë: “Programi mësimor është, sigurisht, shumë i rëndësishëm, por jo aq i rëndësishëm sa mënyra me të cilën njerëzit japin mësim. Gjëja më e rëndësishme është që ne të japim mësim sipas mënyrës së Shpëtimtarit, që ne të japim mësim me anë të Shpirtit dhe që ne të japim mësim për t’i kthyer njerëzit në besim.” ■



Xhon S. Taner

*Këshilltar i Parë në
Presidencën e Përgjithshme
të Shkollës të së Dielës*

Që nga fëmijëria, Xhon Siërs Taner ka gjetur gëzim në të mësuarin.

Ai emocion është shtrirë tek arsimimi, karriera e tij dhe në shumë mundësi të tij për të dhënë mësim për ungjillin: fillimisht si misionar në Misionin e Brazilit Jugor dhe më pas si peshkop, president kunji, këshilltar i lartë, mësues i Doktrinës së Ungjillit, president i Misionit Jugor të Brazilit, San-Paolo (që e përfundon këtë verë) dhe tani si këshilltar i parë në presidencën e përgjithshme të Shkollës të së Dielës.

“Kur [mësimdhënia] bëhet siç duhet, Fryma e Shenjtë është atje dhe ju e ndieni emocionin e të mësuarit; ju e ndieni se jeni në vend të shenjtë”, thotë Presidenti Taner.

I lindur në Solt-Lejk-Siti në Juta më 27 korrik 1950, nga Uilliam Kouts Taner i Riu dhe Atilia Siërs Taner, Presidenti Taner u rrit në Pasadinën Jugore në Kaliforni të SHBA-së, si fëmija i pestë nga 13 fëmijë. Prindërit e tij krijuan një mjedis të pasur arsimor në shtëpi, duke përfshirë një bazë qendrore të fortë të ungjillit. “Nuk më kujtohet se mësova në kishë ndonjë gjë tjetër që tashmë nuk e kisha mësuar në shtëpi”, thotë ai. Ai gjithashtu zhvilloi dashuri për letërsinë, e cila u ushqye kur vazhdoi shkollën dhe mori diplomën universitare për anglisht nga Universiteti “Brigam Jang” dhe një doktoraturë në anglisht nga Universiteti i Kalifornisë në Bërkli.

Ndërsa ishte në UBJ, ai takoi Suzan Uinderin. Që të dy zhvilluan një miqësi të fortë nga e cila ata më vonë ndërtuan një marrëdhënie romantike. Ata u martuan në Tempullin e Solt-Lejkut në 1974. Së bashku ata kanë rritur pesë fëmijë.

Presidenti Taner e filloi karrierën e tij akademike si një asistent profesor në Universitetin e Shtetit të Floridës. Ai u bë anëtar i trupit mësues në UBJ në vitin 1982; ai ka punuar atje që nga ajo kohë si asistent profesor, si bashkëpunëtor dhe si profesor me titull të plotë, dhe si shef departamenti dhe zëvendëspresident akademik.

Pjesa më e rëndësishme e mësimdhënies së ungjillit, thotë ai, vjen nga diçka që ai e mësoi që në fillim të karrierës së tij: mësimdhënia nuk duhet të vijë nga një vend frike ose ambicieje, por nga një vend dashurie – nga dashuria hyjnore, nga dashuria e pastër e Krishtit. ■



Devin G. Durrant

*Këshilltar i Dytë në
Presidencën e Përgjithshme
të Shkollës të së Dielës*

Kur Devin G. Durrant u thirr si këshilltari i dytë në presidencën e përgjithshme të Shkollës të së Dielës, është e mundur që shumë anëtarë të Kishës sollën ndërmend kujtime nga ditët e tij të lavdishme i veshur me uniformën e basketbollit të Universitetit “Brigam Jang”.

Sportet, sigurisht, kanë luajtur një rol të rëndësishëm në jetën e Presidentit Durrant. Ai madje e kaloi një sezon duke luajtur në NBA (Liga Kombëtare e Basketbollit) kundër lojtarëve më të dëgjuar të Shteteve të Bashkuara. Por ai ka qenë shumë më tepër se një sportist i mirënjohur: misionar në Madrid të Spanjës, bashkëshort, baba, gjysh, autor, biznesmen, anëtar besnik dhe tashmë presidenti i Misionit të Teksasit në Dallas për dy vjet e gjysmë.

Presidenti Durrant, i lindur më 20 tetor 1960, në Brigam-Siti në Juta, thotë se shtëpia e fëmijërisë së tij luajti një rol thelbësor në përgatitjen e tij për secilën nga ato role të jetës. Prindërit e tij, Xhorxh dhe Merilin Durrant, ishin mësues të talentuar.

“Sigurisht, ata më mësuan me anë të fjalëve të tyre – por në të vërtetë, mësimet më të mëdha që unë përjetova në shtëpi, ishin duke i vëzhguar ata që jetonin jetën e tyre.”

Presidenti Durrant dhe gruaja e tij, Xhuli Mink Durrant, e dinë mirë rëndësinë e mësuesve të fuqishëm në përgatitjen e misionarëve të ardhshëm.

“[Misionarët e ardhshëm] po mësohen mirë prej prindërve të tyre në shtëpi dhe prej mësuesve të tyre në kishë dhe në programet e shkëlqyera të seminarit dhe të institutit.”

Programi i Shkollës të së Dielës, shtoi ai, i lejon instruktorët dhe studentët e të gjitha moshave “që të japë mësim sipas mënyrës së Shpëtimtarit”.

Presidenti dhe Motra Durrant u martuan në Tempullin e Solt-Lejkut në Juta më 23 prill 1983 dhe janë prindërit e gjashtë fëmijëve dhe kanë gjashtë nipër e mbesa.

Përpara thirrjes së tij si president misioni, ai shërbeu si peshkop, këshilltar i presidencës së kunjit, anëtar i presidencës së Shkollës të së Dielës për kunjin dhe mësues instituti.

Ai mori një diplomë universitare për Studimet Amerikane nga Universiteti “Brigam Jang” dhe një diplomë master në administrimin e biznesit nga Universiteti i Jutas. Ai është pronari i një kompanie investimesh në pasuri të patundshme. ■



Dritë e Shtuar, nga Elspeth Young

Në vitin 1830, Isak Morli e lejoj 12-vjeçaren Meri Elizabet Rollins që ta merrte hua kopjen e tij fare të re të Librit të Mormonit. Meqë kjo ishte e vetmja kopje e Librit të Mormonit në Kirtland të Ohajos në atë kohë, e sapopagëzuara Meri Elizabet dhe familja e saj e lexuan me radhë atë deri natën vonë. Herët në mëngjesin tjetër, ajo e hapi sërish librin dhe mësoi përmendsh vargjet fillestare të librit 1 Nefi. Drita në pikturë simbolizon dritën që u derdh mbi Meri Elizabetën ndërsa ajo lexonte.



“Ndërsa përsiatim për mesazhet që kemi dëgjuar, marrshim vendim që të veprojmë pak më mirë nga sa kemi bërë në të shkuarën”, tha Presidenti Tomas S. Monson gjatë sesionit përmbyllës të Konferencës së Përgjithshme Vjetore të 184-t të Kishës. “Qofshim të sjellshëm dhe të dashur me ata që nuk ndajnë besimet tona dhe standardet tona. Shpëtimtari solli në këtë tokë një mesazh dashurie dhe vullneti të mirë për të gjithë burrat dhe gratë. E ndjekshim përgjithmonë shembullin e Tij.”

KISHA E
JEZU KRISHTIT
E SHENJTORËVE TË
DITËVE TË MËVONSHME